



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

PROVIMI I SHTETIT

**FONDI I PYETJEVE PËR PROFESIONIN E RREGULLUAR TË
STOMATOLOGUT**

1.Njohuri Materiale

1. Çfarë vetie është kur oksidi zhvillohet dhe është i qëndrueshëm :

- A) Vetë fizike
- B) Vetë biologjike
- C) Vetë mekanike
- D) Vetë kimike

2. Kujt metali i mungon qëndrueshmëria:

- A) Plumbit
- B) Kromit
- C) Zinkut
- D) Kallajit

3. Kujt metali i përket Fortësia 1 kg/mm?

- A) Kadmiumit
- B) Kallajit
- C) Bismuthit
- D) Plumbit

4. Sa është kufiri i elasticitetit të materialeve:

- A) 0.0005 - 0.0018 %
- B) 0.5 - 0.18 %
- C) 0.05 - 0.18 %
- D) 0.005 - 0.018 %

5. Cili metal ka temperaturën e shkrirjes 320 gradë C:

- A) Kadmiumi
- B) Zinku
- C) Kallaji
- D) Argjendi

6. Cilit metal i takon temperatura e vlimit 778 gradë C:

- A) Zinkut

- B) Bakrit
- C) Kadmiumit
- D) Argjendit

7. Kujt koncepti i referohet karakteristikës që shoqërohet me ngjyrën e objektit:

- A) Ngjyrës
- B) Vlerës
- C) Pastërtisë
- D) Nuancës

8. Kujt koncepti i referohen rrezet predominuese në syrin e njeriut:

- A) Nuancës
- B) Ngjyrës
- C) Vlerës
- D) Ndërtimit strukturor

9. Çfarë Densiteti kanë keramikat feldshpatike:

- A) 2.4 gr/cm kub
- B) 2.14 gr/cm kub
- C) 1.7-2 gr/cm kub
- D) 2.97 gr/cm kub

10. Nga çfarë përbëhet gipsi i llojit të tretë:

- A) Hemihidrat sulfat kalçiumi
- B) Alfa hemihidrat i modifikuar sulfat kalçiumi
- C) Alfa hemihidrat sulfat kalçiumi
- D) Beta hemihidrat sulfat kalçiumi

11. Nga çfarë përbëhet gipsi i llojit të katërt:

- A) Alfa hemihidrat i modifikuar
- B) Alfa hemihidrat sulfat kalçiumi
- C) Hemihidrat sulfat kalçiumi
- D) Beta hemihidrat sulfat kalçiumi

12. Çfarë koeficienti Bymimi ka allçia Begstone:

- A) 0.19%
- B) 0.9%
- C) 0.09%
- D) 0.15%

13. Nëpërmjet kujt reaksioni formohet eugenati i Zinkut në Materialet e masës oksid zink eugenol:

- A) Nëpërmjet reaksionit të oksid zinkut me ujin e pastës së katalizatorit
- B) Nëpërmjet reaksionit të oksidit të zinkut me acetat zinkun
- C) Nëpërmjet reaksionit të hidroksidit të zinkut me eugenolit
- D) Nëpërmjet reaksionit të oksidit të zinkut me Balsam Peruan

14. Për çfarë përdoren materialet e kompozicionit të nëngrupit të dytë:

- A) Masë funksionale protezë totale
- B) Masë për koronat xhaket

- C) Masë funksionale protezë parçiale
- D) Masë për urat fikse

15. Cila veti e rëndësishme i takon materialit hidrokoloide reversibël:

- A) Të derdhet lehtësisht
- B) Temperaturë e kalimit nga gjendja sol në xhel të jetë sa më e afërt me temperaturën e trupit
- C) Të mos tkurret
- D) Të hiqet lehtësisht nga gipsi

16. Për sa kohë ruhet materiali i Agar- agarit në vaskën e ruajtjes:

- A) Për 7 ditë
- B) Për 5 ditë
- C) Për 10 ditë
- D) Për 12 ditë

17. Cili është materiali dublues:

- A) Stenti
- B) Elastomeret
- C) Oksid zink eugenolit
- D) Kerri jeshil

18. Cili lloj alginati është i tretshëm në ujë:

- A) Alginat mangani
- B) Alginat manganzi
- C) Alginat kalçiumi
- D) Alginat joduri

19. Çfarë fleksibiliteti paraqesin alginatet nën një presion prej 1000 gr/cm katror:

- A) 22 - 25 %
- B) 5 - 8 %
- C) 10 - 20 %
- D) 8 - 9 %

20. Çfarë përfshin tipi i parë i alginatit:

- A) Alginatet ku transformimi në xhel bëhet shumë shpejt
- B) Alginatet ku transformimi në xhel bëhet normalisht
- C) Alginatet ku transformimi në xhel bëhet mesatarisht
- D) Alginatet ku transformimi bëhet shumë ngadalë

21. Kush nga përgjigjet është e saktë në lidhje me nuancën:

- A) I përket ndriçimit të objektit
- B) I përket ngjyrës së objektit
- C) Sa vlerë ka ngjyra e objektit
- D) I përket karakteristikës që shoqërohet me ngjyrën e objektit

22. Cili aliazh përdoret për urat metal porcelan:

- A) Aliazhi Kera 501
- B) Aliazhi Wironium plus

- C) Aliazhi vitalium
- D) Aliazhi Wirocast

23. Rezinat në materialet termo plastike futen:

- A) Të pengojnë ngjitjen e materialit me lugën
- B) Për t'i dhënë plasticitet materialit
- C) Për t'i dhënë materialit faqe të lëmuara
- D) Për të ndryshuar temperaturën

24. Plastmasat vetëpolimerizuese përdoren:

- A) Për ribazimin e protezave
- B) Për ektoprotezat
- C) Si material dublues
- D) Për endoprotezat

25. Kallaji tretet në:

- A) Acid klorhidrik i ngrohtë
- B) Acid heksacianur potasi
- C) Acid nitric
- D) Acid klorhidrik

26. Sa është dendësia e metaleve fisnike:

- A) 1.7 - 2 gr/cm kub
- B) 10.4 - 17.5 gr/cm kub
- C) 4.51 gr/cm kub
- D) 2.97 gr/cm kub

27. Gipsi hidrokal hidhet në rivestiment në sasi:

- A) 30 - 35%
- B) 20 - 25%
- C) 40 - 60%
- D) 60 - 65%

28. Sa është fortësia e titanit:

- A) 180
- B) 160
- C) 195
- D) 220

29. Kush nga aliazhet e mëposhtme përdoret për protezat e skeletuara:

- A) Nikel krom
- B) Wironium plus
- C) Kera 501
- D) Remanium Star

30. Procesi i derdhjes në vakum varet nga:

- A) Krijimi i presionit negativ në cilindër
- B) Rrjedhshmëria e metalit
- C) Përçueshmëria elektrike
- D) Sasia e metalit

31. Materialet e oksid zink eugenolit kanë acetat zinku:

- A) 1%
- B) 19%
- C) 15%
- D) 35%

32. Përdorimi i gipsit është:

- A) Material mase për protezat totale
- B) Material mase e imët
- C) Material mase për shinat në paradontozë
- D) Material mase për protezat parciales

33. Adezivi i UFI Gel P është:

- A) Butanon
- B) Celuloid
- C) Platin
- D) Salal

34. Bazis Plate ka në përberje dyllra mikrokristaline:

- A) 67.5%
- B) 3%
- C) 12%
- D) 2.5%

35. Për galvanizimin e protezave metalike dentare përdoret:

- A) Hekzacianuri i platinit
- B) Kripa e kallajit
- C) Kripa trefishe e cianurit të kaliumit
- D) Kripa e Nikelit

36. Çfarë përfshin tipi i dytë i alginatit:

- A) Alginate ku transformimi në xhel bëhet shumë shpejt
- B) Alginate ku transformimi në xhel bëhet mesatarisht
- C) Alginate ku transformimi në xhel bëhet me ngadalë
- D) Alginate ku transformimi në xhel bëhet normalisht

37. Për çfarë shërben oksidi i zinkut në materialet polysulfide:

- A) Për t'u derdhur lehtësisht modeli
- B) Për të dhënë konsistencë fortësie materialit
- C) Për ta bërë të lëmuar materialin
- D) Për të përcaktuar shkallën e viskozitetit

38. Pasta bazë e silikoneve të kondensimit quhet:

- A) Dimetil silicone
- B) Kopolimer
- C) Diklorbenzeni
- D) Polieter

39. Polieteret përdoren:

- A) Në masat funksionale për përgatitjen e protezave totale
- B) Si material për riparimin e protezës
- C) Për derdhjen e masës
- D) Si material për ribazimin e protezës

40. Temperatura e vlimit të dyllit të Bletës është:

- A) 350 gradë C
- B) 329 gradë C
- C) 236 gradë C
- D) 320 gradë C

41. Dylli karnaub përzihet me dyllin e bletës në raportin:

- A) 2 : 1
- B) 1 : 1
- C) 1 : 2
- D) 1 : 3

42. Çfarë funksioni ka dylli kandelila:

- A) Siguron saktësi të modelimit
- B) Për të ulur tkurrjen
- C) Për të ulur plasticitetin
- D) Ndikon në intervalin e shkrirjes së produktit përfundimtar

43. Vëllimi i tkurrjes nga 80 deri në 20 gradë C i dyllit inlei është:

- A) 1 %
- B) 0.15 %
- C) 1.5 %
- D) 0.1 %

44. Bazis Plate shërben si:

- A) Material për të marrë masën
- B) Material për riparimin e protezës
- C) Material për derdhjen e masës
- D) Material për përgatitjen e lugës individuale

45. Rezina sintetike në Bazis plate ka përmbajtjen:

- A) 25%
- B) 12%
- C) 3%
- D) 2.5%

46. Në cilën temperaturë depolimerizohet polimeri:

- A) 400 gradë C
- B) 125 gradë C
- C) 250 gradë C
- D) 185 gradë C

47. Çfarë quhet kopolimerizim:

- A) Reaksioni kimik përmes të cilit 1 monomer dhe polimer të ndryshëm bashkohen
- B) Reaksioni kimik përmes të cilit dy polimere të ndryshëm bashkohen

- C) Reaksioni kimik përmes të cilit dy monomer të ndryshëm bashkohen
- D) Reaksioni kimik përmes të cilit 1 monomer dhe dy polimere bashkohen

48. Çfarë ndodh kur hidhet më tepër polimer:

- A) Poroziteti i protezës
- B) Rritjen e koeficientit të përqendrimit të masës së plastmasës
- C) Mbetje e molekulave të lira të monomerit
- D) Zvogëlim i plasticitetit të brumit të plastmasës

49. Çfarë përqindje të sodës kaustike ka tretësira 86% e silikatit të sodiumit:

- A) 10%
- B) 86%
- C) 4%
- D) 22%

50. Çfarë lloj muflimi përdoret në mikroparçiale:

- A) Të kombinuar
- B) Indirekt
- C) Direkt
- D) Me shkallë

51. Në çfarë temperaturë transformohet siliciumi në kristobalit:

- A) 573 gradë C
- B) 105 gradë C
- C) 220 gradë C
- D) 106 gradë C

52. Sa është përqindja e Zinkut (Zn) në aliazhet e floririt 14 karat:

- A) 0.8 %
- B) 5.0 %
- C) 2.5 %
- D) 1.7 %

53. Çfarë është Maurevest Microflin:

- A) Material mase
- B) Material rivestimenti
- C) Material saldimi
- D) Material lustrues

54. Kristobaliti hidhet në rivestiment në sasi:

- A) 20-25%
- B) 60-65%
- C) 40-60%
- D) 30-35%

55. Parafina hidhet në materialet termoplastike për:

- A) Për t'i siguruar faqe të lëmuara
- B) Për t'i siguruar plasticitet materialit
- C) Për t'i siguruar elasticitet
- D) Për t'i siguruar saktësi materialit

56. Plastmasa elastike paraqet:

- A) Polimetilsilakson
- B) Dyrakryl
- C) Metilmetakrilat
- D) Superakryl

57. Saldatura e floririt 20 karat ka flori:

- A) 66.6%
- B) 83.3%
- C) 75.5%
- D) 87.5%

58. Polieteret përdoren për:

- A) Masë në frakturat
- B) Masë funksionale në protezat totale
- C) Masë në protezat e njëpasnjëshme
- D) Shinat në paradontozë

59. Koha dehidratuese e porcelanit gjatë pjekjes është në temperaturën:

- A) 500 gradë C-870 gradë C
- B) 490 gradë C-540 gradë C
- C) 94 gradë C-480 gradë C
- D) 870 gradë C-1065 gradë C

60. Sa është rezistenca e aliazhit Y-TZP:

- A) 900-1200
- B) 700
- C) 300
- D) 7500

61. Sa është zgjatja që merret si kufi elasticiteti:

- A) 0.0018% - 0.020%
- B) 0.06% - 0.18%
- C) 0.005% - 0.018%
- D) 0.2% - 0.6%

62. Për protezat subtotale përdoret muflimi:

- A) Indirekt
- B) I kombinuar
- C) Direkt
- D) Me cilindër

63. Sa është kufiri i elasticitetit të platini:

- A) 40 - 50 kg/mm katror
- B) 20-22 kg/mm katror
- C) Mungon
- D) 16-20 kg/mm katror

64. Izolimi i muflave kur janë të ftohta bëhet:

- A) Kalçifikohe
- B) Uji i qelqit
- C) Llak
- D) Silikat sodium

65. Përdorimi i materialeve të oksid zink eugenolit:

- A) Masë funksionale për protezat totale
- B) Urat fikse
- C) Për ektoprotezat
- D) Masë për protezat parciale

66. Cili nga përbërësit e mëposhtëm përfshihet në materialet e papërpunuara që përdoren për të bërë porcelanin dentar:

- A) Oksid zinku
- B) Oksid titani
- C) Alumina (Al_2O_3)
- D) Oksid hekuri

67. Cimara është porcelan për:

- A) Urat Metal + Porcelan
- B) Riparim
- C) Inley - onley
- D) Koronat xhakete

68. Çfarë rivestimenti fosfatik përdoret për aliazhet jo fisnike:

- A) Rivestiment fosfatik me silicium
- B) Rivestiment fosfatik me grafit (karbon)
- C) Rivestiment fosfatik me gips hidrokol
- D) Rivestiment fosfatik pa grafit (karbon)

69. Sa kohë mbahet cilindri në furrë në temperaturën 650 gradë C:

- A) 30 minuta
- B) 45 minuta
- C) 1.5 orë
- D) 60 minuta

70. Në sa grupe klasifikohet korrozioni:

- A) Në katër grupe
- B) Në pesë grupe
- C) Në dy grupe
- D) Në një grup

71. Çfarë paraqet korundi:

- A) Oksid alumini
- B) Koks
- C) Kuarc
- D) Mineral natyral i zi

72. Çfarë përmbajnë saldatura e butë:

- A) Kallaj

- B) Flori
- C) Zink
- D) Platin

73. Për çfarë përdoret Porcelani Targis vectris:

- A) Për përgatitjen e protezave totale
- B) Në korona të veçanta tek dhëmbët frontal
- C) Për përgatitjen e protezës parciale
- D) Për përgatitjen e koronave 3/4

74. Në çfarë temperature ndodh koha e ndryshimeve kimike të porcelanit:

- A) 870 gradë C
- B) 94 gradë - 480 gradë C
- C) 1090 gradë C
- D) 1300 gradë C

75. Sa faza kalon pjekja e porcelanit:

- A) Në 4 faza
- B) Në 3 faza
- C) Në 5 faza
- D) Në 6 faza

76. Në çfarë temperature kalon kuarci alfa në kuarc beta:

- A) Në 105 gradë C
- B) Në 220 gradë C
- C) 573 gradë C
- D) Në 106 gradë C

77. Cili Aliazh floriri përdoret për urat metal porcelan:

- A) Aliazhi i floririt 18 karat
- B) Aliazhi i floririt 22 karat
- C) Aliazhi i floririt 20 karat
- D) Aliazhi Degudent H

78. Çfarë metali përdoret për implantet:

- A) Krom kobaldi
- B) Aliazhi Palgar
- C) Titanium
- D) Ari i Bardhë

79. Çfarë sasive Au kanë aliazhet e forta të floririt:

- A) 78 %
- B) 68 %
- C) 83 %
- D) 70 %

80. Çfarë pjese ka paladiumi në aliazhet e floririt me paladiumin:

- A) 220 pjesë
- B) 650 pjesë
- C) 70 pjesë

D)50 pjesë

81. Çfarë përqindje ka platini në aliazhet Flori - Platin:

- A)12.15 %
- B)7.15 %
- C)8.15 %
- D)4.15 %

82. Për çfarë përdoret aliazhi i argjendit me metalet fisnike:

- A)Proteza të skeletuara
- B) Kroshet e derdhura
- C) Shtiftet
- D)Urat fikse

83. Çfarë përqindje ka karboni në çelik:

- A)0.3 %
- B)0.4 - 1.6 %
- C)1.7 - 5 %
- D)2.7 - 2.9 %

84. Çfarë përqindje ka karboni në gizë:

- A)1.7 - 5 %
- B)0.4 -1.6 %
- C)2.7 - 2.9 %
- D)0.3 %

85. Çfarë aliazhi përdoret për protezat e skeletuara:

- A)Zirkoni
- B)Remanium CS
- C)Kera 501
- D)Wironit

86. Çfarë aliazhi përdoret për urat Metal - Porcelan:

- A)Wirocast
- B)Wironium
- C)Remanium 2001
- D)Vitalium

2.Proteza e Lëvizshme Totale

1. Kufiri i bazës së shabllonit duhet të jetë:

- A)1-2mm më i shkurtër se kufiri i modelit
- B) Varet nga grada e atrofisë
- C)1-2mm më i gjatë se kufiri i modelit
- D)Sa kufiri i modelit

2. Dhëmbët anatomikë (me tuberkula të lartë) përdoren me sukses në protezat totale në nofulla:

- A)Shumë të atrofizuara
- B)Me atrofi jouniforme

- C) Të pa atrofizuara
- D) Me kreshta reziduale në formë thike

3. Atrofia e maksilës karakterizohet nga:

- A) Perimetri që mbetet i pandryshuar
- B) Zmadhim i perimetrit të saj
- C) Zvogëlim i perimetrit të saj
- D) Varet nga veçoritë klinike individuale

4. Silikoni light A (adicioni) përdoret në protezat totale për:

- A) Marrje mase anatomike
- B) Ribazim direkt
- C) Marrje mase funksionale
- D) Riparim indirekt

5. Gjatë shqiptimit të gërmës "Ah" të lehtë dhe të zgjatur, tek pacienti vërehet:

- A) Ulje poshtë e qiellzës së butë
- B) Tërheqje e ligamenteve pterigo-mandibularë
- C) Ngritje lart e qiellzës së butë
- D) Formimi i hapësirës minimale fonetike

6. Gjatë shqiptimit të gërmës "S" tek pacienti vërehet:

- A) Formimi i hapësirës minimale fonetike
- B) Ngritje lart e qiellzës së butë
- C) Tërheqje e ligamenteve pterigo-mandibularë
- D) Ulje poshtë e qiellzës së butë

7. Gjatë shqiptimit të gërmës "Ah" të prerë dhe të fortë, ose gjatë shfryrjes së hundës me vrima të mbyllura, tek pacienti vërehet:

- A) Ngritje lart e qiellzës së butë
- B) Ulje poshtë e qiellzës së butë
- C) Tërheqje e ligamenteve pterigo-mandibularë
- D) Formimi i hapësirës minimale fonetike

8. Gjatë shqiptimit të gërmës "Ah" të lehtë dhe të zgjatur, tek pacienti formohet:

- A) Linja anteriore e vibrimit
- B) Hapësira e lirë fiziologjike
- C) Hapësira minimale fonetike
- D) Linja posteriore e vibrimit

9. Gjatë shqiptimit të gërmës "Ah" të prerë dhe të fortë, ose gjatë shfryrjes së hundës me vrima të mbyllura, tek pacienti formohet:

- A) Linja posteriore e vibrimit
- B) Linja anteriore e vibrimit
- C) Hapësira minimale fonetike
- D) Hapësira e lirë fiziologjike

10. Në metodën e lodhjes së muskujve gjatë përcaktimit të okluzionit qendror, pacientin e instruktojmë të bëjë:

- A) Lëvizje hapje dhe mbyllje të gojës

- B) Lëvizje të gjuhës dhe gëlltitje
- C) Lëvizje të kokës në gjithë drejtimet
- D) Lëvizje laterale dhe propulsive

11. Gjatë shqiptimit të gërmës "M" tek pacienti formohet:

- A) Hapësira e lirë fiziologjike
- B) Linja posteriore e vibrimit
- C) Hapësira minimale fonetike
- D) Linja anteriore e vibrimit

12. Njëpërmjet Harkut facial tek pacienti regjistrohet:

- A) Lartësia e okluzionit
- B) Pozicioni i Okluzionit qendror
- C) Gjatësia e brinjës së Trekëndëshit të Bonwill-it
- D) Madhësia e maksilës

13. Në artikulatorët me vlera individuale ose pjesërisht individuale, aksesori "Guida Bi-dimensionale" (kalota) ka të inkuorporuar:

- A) Planin Camper
- B) Dy kurbat e kompensimit Spee dhe Willson
- C) Guidën kondilare
- D) Horizontalen e Frankfurtit

14. Në dhëmbët natyralë të pa abraduar, këndi i pjerrësisë së tuberkulave është mesatarisht:

- A) 10-12 gradë
- B) 20-22 gradë
- C) 40-45 gradë
- D) 30-33 gradë

15. Në dhëmbët artificialë me morfologji të reduktuar, që përdoren në protezat e lëvizshme, këndi i pjerrësisë së tuberkulave është:

- A) 10-12 gradë
- B) 40-45 gradë
- C) 30-33 gradë
- D) 20-22 gradë

16. Në dhëmbët artificialë anatomikë, që përdoren në protezat e lëvizshme, këndi i pjerrësisë së tuberkulave është:

- A) 30-33 gradë
- B) 20-22 gradë
- C) 10-12 gradë
- D) 40-45 gradë

17. Në dhëmbët artificialë joanatomikë, që përdoren në protezat e lëvizshme, këndi i pjerrësisë së tuberkulave është:

- A) 20-25 gradë
- B) 10-12 gradë
- C) 30-33 gradë
- D) 0 gradë

18. Në artikulatorët me vlera mesatare, aksesori që orienton për vendosjen e modeleve në artikulator dhe rreshtimin e dhëmbëve përfaqëson:

- A) Planin e okluzionit
- B) Planin horizontal
- C) Planin sagital
- D) Kurbën Willson

19. Brinja e Trekëndëshit të Bonwill-it është mesatarisht:

- A) 100-108 mm
- B) 10,8 mm
- C) 180-188 mm
- D) 158 mm

20. Kurba Spee formohet në planin:

- A) Frontal
- B) Sagital
- C) Horizontal
- D) Në të tre planet

21. Kurba Willson formohet në planin:

- A) Sagital
- B) Horizontal
- C) Frontal
- D) Në të tre planet

22. Boshti gjatësor i lateralëve maksilarë (12/22) në lidhje me planin sagital:

- A) Divergon distalisht
- B) Konvergon distalisht
- C) Divergon mezialisht
- D) Është paralel

23. Atrofia e mandibulës karakterizohet nga:

- A) Zvogëlim i perimetrit të saj
- B) Perimetër që mbetet i pandryshuar
- C) Zmadhim i perimetrit të saj
- D) Varet nga veçoritë klinike individuale

24. Kyçi i okluzionit ose Kyçi i Angel-it ka të bëjë më raportin e:

- A) Molarit të dytë (7) lart me molarin e dytë (7) poshtë
- B) Molarit të parë (6) lart me molarin e parë (6) poshtë
- C) Molarit të parë (6) lart me molarin e dytë (7) poshtë
- D) Molarit të dytë (7) lart me molarin e parë (6) poshtë

25. Në nofullën e sipërme harku i dhëmbëve ka formë:

- A) Parabole
- B) Elipsi
- C) Trekëndore
- D) Katërkëndore

26. Në nofullën e poshtme harku i dhëmbëve ka formë:

- A) Elipsi
- B) Trekëndore
- C) Parabole
- D) Katërkëndore

27. Në dhëmbët distalë maksilarë tuberkulat funksionalë janë:

- A) Tuberkulum Carabeli
- B) Tuberkulat vestibularë
- C) Tuberkulat palatinalë
- D) Tuberkulat vestibularë dhe palatinalë

28. Në dhëmbët distalë mandibularë tuberkulat funksionalë janë:

- A) Tuberkulat lingualë
- B) Tuberkulat vestibularë dhe lingualë
- C) Tuberkulum Carabeli
- D) Tuberkulat vestibularë

29. Në rastin e mosprotezimit për një kohë të gjatë të një pacienti me mungesë të plotë dhëmbësh, vërehet:

- A) Zvogëlim i përmasave të gjuhës
- B) Zmadhim i përmasave të gjuhës
- C) Kandidozë orale
- D) Atrofi e gjuhës

30. Një masë anatomike në nofulla pa dhëmbë merret me:

- A) Rezine vetëpolimerizuese
- B) Repinë (Oksid zink-eugenol)
- C) Silikon light ose very light
- D) Alginat

31. Një masë funksionale në nofulla pa dhëmbë merret me:

- A) Repinë (Oksid zink-eugenol)
- B) Alginat
- C) Silikon putty
- D) Rezine fotopolimerizuese

32. Shabllonat shërbejnë për:

- A) Përcaktimin e okluzionit qendror
- B) Marrjen e masës funksionale
- C) Marrjen e masës anatomike
- D) Analizën e modeleve

33. Luga individuale mund të konstruktohet me:

- A) Dyll
- B) Rezine vetëpolimerizuese
- C) Silikon
- D) Rezine elastike

34. Cili nga këto formacione anatomike duhet të përfshihet nga baza e protezës totale:

- A) Ligamenti pterigomandibular
- B) Frenulum linguae
- C) Plika bukale anteriore
- D) Kreshta mylochioide

35. Cili nga këta formacione anatomike nuk përfshihet nga kufiri i bazës së protezës:

- A) Linja oblike e jashtme (linea obliqua externa)
- B) Frenulum labi inferior
- C) Zona e vibrimit (postdamit)
- D) Linja oblike e brendshme (linea obliqua interna)

36. Baza e protezës totale të përfunduar konstruktohet me:

- A) Rezine fotopolimerizuese (që forcohet me dritë)
- B) Rezine që forcohet me nxehtësi (me zierje)
- C) Rezine vetëpolimerizuese
- D) Rezine elastike

37. Ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë e protezës totale:

- A) Sasia e pakët e pështymës
- B) Sasia e shtuar e pështymës
- C) Sasia mesatare e pështymës
- D) Kserostomia

38. Linja mediane dhe linja kanine në shabllonin e sipërm, orientojnë për zgjedhjen e:

- A) Gjerësisë së dhëmbëve frontalë maksilarë
- B) Gjatësisë së dhëmbëve frontalë maksilarë
- C) Kurbaturës vestibulare të dhëmbëve frontalë
- D) Gjatësisë së dhëmbëve distalë

39. Linja e të qeshurit dhe buza e poshtme e shabllonit të sipërm, orientojnë për zgjedhjen e:

- A) Kurbaturës vestibulare të dhëmbëve frontalë
- B) Gjerësisë së dhëmbëve frontalë maksilarë
- C) Gjatësisë së dhëmbëve frontalë maksilarë
- D) Gjerësisë së dhëmbëve distalë

40. Molarët e parë lart (16/26) prekin planin horizontal me:

- A) Të gjithë tuberkulat
- B) Tuberkulin mezio-palatinal
- C) Tuberkulin disto-palatinal
- D) Tuberkulin mezio-vestibular

41. Molarët e dytë lart (17/27) në lidhje me planin horizontal kanë këtë pozitë:

- A) E prekin me të gjithë tuberkulat
- B) E prekin me tuberkulin mezio-palatinal
- C) E prekin me tuberkulin disto-palatinal
- D) Nuk e prekin fare

42. Në molarët e parë lart (16/26) më larg planit horizontal qëndron tuberkuli:

- A) Tuberkuli mezio-palatinal

- B) Tuberkuli disto-vestibular
- C) Tuberkuli disto-palatinal
- D) Tuberkuli mezio-vestibular

43. Në molarët e dytë lart (17/27) më afër planit horizontal qëndron tuberkuli:

- A) Tuberkuli disto-palatinal
- B) Tuberkuli mezio-vestibular
- C) Tuberkuli mezio-palatinal
- D) Tuberkuli disto-vestibular

44. Në molarët e dytë lart (17/27) më larg planit horizontal qëndron tuberkuli:

- A) Tuberkuli disto-vestibular
- B) Tuberkuli mezio-vestibular
- C) Tuberkuli disto-palatinal
- D) Tuberkuli mezio-palatinal

45. Ndikon negativisht në qëndrueshmërinë e protezës totale:

- A) Tuberi maksilar
- B) Tuberkulum alveolar mandibulae
- C) Llozha bucinatore
- D) Frenulum linguae

46. Glosalgjia (djegia e gjuhës) vërehet në pacientë me:

- A) Okluzion të kryqëzuar
- B) Okluzion të lartë
- C) Okluzion të ulët
- D) Okluzion të hapur

47. Në okluzion normal në protezat totale, over-bite (mbulimi incizival) duhet të jetë:

- A) 3-4mm
- B) 1-2mm
- C) 2-3mm
- D) 0,5-1 mm

48. Në okluzion normal në protezat totale, over-jet (distanca midis frontalëve lart dhe sipërfaqes vestibulare të frontalëve poshtë) duhet të jetë:

- A) 1-2mm
- B) 0,5 mm
- C) 2-3mm
- D) 3-4mm

49. Okludatorët janë aparatet që imitojnë (riprodhojnë):

- A) Të gjitha lëvizjet e ATM
- B) Vetëm lëvizjet laterale
- C) Vetëm lëvizjet vertikale (sharnier)
- D) Vetëm lëvizjet propulsive

50. Artikulatorët janë aparatet që imitojnë (riprodhojnë):

- A) Vetëm lëvizjet vertikale (sharnier)
- B) Lëvizjet vertikale, laterale dhe propulsive të ATM

- C) Vetëm lëvizjet laterale
- D) Vetëm lëvizjet propulsive

51. Nëpërmjet metodës së gëlltitjes (në protezat totale) ne përcaktojmë:

- A) Lartësinë e okluzionit
- B) Pozicionin meziodistal të mandibulës
- C) Hapësirën minimale fonetike
- D) Planin e okluzionit

52. Në metodën e zakonshme të polimerizimit, në fillim të ciklit të polimerizimit të rezines, mufla futet në ujë me temperaturë:

- A) 0 gradë
- B) 60-65 gradë
- C) Temperaturë ambjenti
- D) 100 gradë

53. Për të realizuar shkrirjen dhe shplarjen e dyllit nga mufla, muflën e fusim për rreth 10 minuta në ujë me temperaturë:

- A) 0 gradë
- B) Temperaturë ambjenti
- C) 100 gradë
- D) 60-65 gradë

54. Riparimet me dorë të lirë indikohen kur:

- A) Duhet të shtohen kroshe
- B) Kemi thyerje të protezës me mungesë të pjesëve
- C) Kemi thyerje të protezës pa mungesë të pjesëve
- D) Proteza lëviz

55. Për një ribazim indirekt të një proteze totale duhet të merret masë:

- A) Anatomike me lugë serie
- B) Funksionale me lugë individuale
- C) E pjesshme situacioni
- D) Funksionale me protezën ekzistuese

56. Një ribazim direkt mund të realizohet me:

- A) Rezine fotopolimerizuese
- B) Alginat
- C) Oksid zink-eugenol
- D) Rezine vetëpolimerizuese

57. Në një riparim indirekt masa merret me:

- A) Oksid zink-eugenol
- B) Alginat
- C) Rezine vetëpolimerizuese
- D) Stenc

58. Premolarët e parë lart (14/24) mund të mos vendosen në protezat totale në sensitivitetit e:

- A) Prognatisë

- B) Okluzionit normal
- C) Okluzionit të thellë
- D) Progenisë

59. Premolarët e parë poshtë (34/44) mund të mos vendosen në protezat totale në sensitivitetit e:

- A) Progenisë
- B) Okluzionit normal
- C) Prognatisë
- D) Okluzionit të kryqëzuar

60. Ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë e protezës totale të sipërme:

- A) Torusi palatinal
- B) Tuberi maksilar
- C) Torusi mandibular
- D) Ruga palatine kanine

61. Ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë e protezës totale:

- A) Linea oblique interna
- B) Apofizat geniane
- C) Frenulum linguae
- D) Tuberkulum alveolar mandibulare

62. Ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë e protezës totale të poshtme:

- A) Plika bukale anteriore
- B) Linea obliqua interna
- C) Llozha retro-milohioide
- D) Torus mandibular

63. Thyerja e protezës së sipërme në nivel të linjës mediane mund të shkaktohet nga:

- A) Rreshtimi i dhëmbëve distalë më të lingualizuar
- B) Gjatësia më e madhe në zonën e postdam-it
- C) Mos lehtësimi i tuberit maksilar të shprehur
- D) Mos lehtësimi i torusit palatinal të shprehur

64. Refleksi i të vjellit nga proteza e sipërme mund të shkaktohet nga:

- A) Mos lehtësimi i torusit palatinal të shprehur
- B) Gjatësia më e madhe në zonën e postdam-it
- C) Mos lehtësimi i tuberit maksilar të shprehur
- D) Përcaktimi i gabuar i planit të okluzionit

65. Ndikon negativisht në qëndrueshmërinë e protezës totale të sipërme:

- A) Zona e postdam-it (vibrimit)
- B) Torusi palatin i shprehur
- C) Papilla incizivale
- D) Tuberi maksilar

66. Lartësia e katit të mesëm të fytyrës na ndihmon për përcaktimin e:

- A) Lartësisë së okluzionit qendror
- B) Pozicionit mezio-distal të mandibulës
- C) Nivelit të planit të okluzionit

D) Drejtimit të planit të okluzionit

67. Në protezat totale interferencat (paratakimet):

- A) Ndikojnë pozitivisht
- B) Nuk ndikojnë
- C) Ndikojnë negativisht
- D) Varet nga veçoritë individuale

68. Disku artikular ka formë:

- A) Sferike
- B) Bikonvekse
- C) Bikonkave
- D) Të sheshtë

69. Kondili artikular ka formë:

- A) Sferike të çrregullt
- B) Të sheshtë
- C) Elipsi të çrregullt
- D) Trekëndore

70. Në një artikulation temporo-mandibular normal, në fazën fillestarë të hapjes së gojës, disku artikular ndodhet:

- A) Në mes kondilit dhe fosës artikulare
- B) Prapa kondilit artikular
- C) Para kondilit artikular
- D) Varet nga veçoritë individuale

71. Ndikojnë pozitivisht në protezimin me proteza totale, kreshtat reziduale:

- A) Me atrofi jouniforme
- B) Konvergjente
- C) Divergjente
- D) Paralele

72. Gjatë rregullimit funksional të lugës individuale në zonën e vibrimit (post-damit) pacienti instruktohet:

- A) Të shfryjë hundët me vrima të mbyllura
- B) Të shqiptojë gërmën "S"
- C) Të shqiptojë gërmën "M"
- D) Të shqiptojë "Ah" të lehtë e të zgjatur

73. Gjatë rregullimit funksional të lugës individuale në zonën anteriore vestibulare, pacienti instruktohet:

- A) Të gëlltitet
- B) Të hapë gojën në maksimum
- C) Të bëjë lëvizje të gjuhës
- D) Të bëjë sikur fërshëllen

74. Gjatë fleksionit (përkuljes) së kokës maksimalisht prapa, mandibula shkon vetëvetiu në pozicionin e:

- A) Qetësisë

- B) Protruzionit maksimal
- C) Formimit të hapësirës fiziologjike
- D) Relacionit qëndror

75. Hapësira e lirë fiziologjike është mesatarisht:

- A) 2-3mm
- B) 0,5-1mm
- C) 5mm
- D) 6mm

76. Nuk mund të konstruktohet një protezë imediate në një pacient me:

- A) Probleme alergjike
- B) Hemofili
- C) Kandidozë
- D) Artrite

77. Ka qëndrueshmëri më të lartë proteza totale e sipërme:

- A) Me pllakë të plote rezine
- B) Me pllakë të reduktuar
- C) Axhuste
- D) Me pllakë të plotë metalike

78. Paraqet vështirësi për ribazim një protezë e sipërme:

- A) Me pllakë të plotë metalike
- B) Me pllakë të reduktuar
- C) Me pllakë të plote rezine
- D) Axhuste

79. Në dhëmbët distalë maksilarë tuberkulat jofunksionalë janë:

- A) Tuberkulat palatinalë
- B) Tuberkulum Carabeli
- C) Tuberkulat vestibularë
- D) Tuberkulat vestibularë dhe palatinalë

80. Në dhëmbët distalë mandibularë tuberkulat jofunksionalë janë:

- A) Tuberkulat vestibularë dhe lingualë
- B) Tuberkulat vestibularë
- C) Tuberkulum Carabeli
- D) Tuberkulat lingualë

81. Në protezimin me protezë totale në një pacient me torus palatinal të shprehur, bëhet:

- A) Gravim i modelit në zonën e torusit
- B) Lehtësim ortopedik ose kirurgjikal i torusit
- C) Lënie e torusit jashtë kufirit të protezës
- D) Thellim kirurgjikal i sulkuseve

82. Gjatë rregullimit funksional të lugës individuale në sulkusin pterigo-maksilar, pacientit i thuhet të:

- A) Bëjë sikur fërshëllen
- B) Lëvizë gjuhën anash

- C) Hapë gojën në maksimum
- D) Gëlltitet

83. Gjatë rregullimit funksional të lugës individuale në zonën sublinguale, pacientit i thuhet të:

- A) Bëjë sikur fërshëllen
- B) Hapë gojën në maksimum
- C) Të shqiptojë "Ah" të lehtë e të zgjatur
- D) Lëvizë gjuhën anash e të gëlltitet

84. Kufiri posterior i protezës së sipërme duhet të shtrihet:

- A) 2-3 mm para linjës posteriore të vibrimit
- B) 2-3 mm pas linjës posteriore të vibrimit
- C) 2-3 mm para linjës anteriore të vibrimit
- D) 0,5-1mm pas linjës posteriore të vibrimit

85. Një masë për proteza totale, e marrë me alginat:

- A) Mund të rrijë gjatë pa u derdhur
- B) Futet në një enë me ujë, derisa të derdhet
- C) Duhet të izolohet para derdhjes
- D) Duhet të derdhet brenda 5-10 min

86. Një masë për proteza totale, e marrë me allçi:

- A) Duhet të izolohet para derdhjes
- B) Duhet të derdhet brenda 5-10 min
- C) Deformohet po të rrijë gjatë pa u derdhur
- D) Futet në një enë me ujë, derisa të derdhet

87. Duhet të izolohet para derdhjes një masë e marrë me:

- A) Allçi
- B) Alginat
- C) Repinë
- D) Silikon të hollë

88. Në protezën biofunktionale, për vendosjen e centralëve lart bazohemi në pozicionin e:

- A) Frenulum labi superior
- B) Frenulum labi inferior
- C) Ppilës incizivale
- D) Plikave bukale

89. Në protezën biofunktionale, për vendosjen e kaninëve lart bazohemi në pozicionin e:

- A) Frenulum labi superior
- B) Ppilës incizivale
- C) Rugave palatinale kanine
- D) Plikave bukale

90. Cili nga tuberkulat e molarit të parë lart është më afër planit horizontal:

- A) Mezio-vestibular
- B) Disto-palatinal

- C) Disto-vestibular
- D) Mezio-palatinal

91. Zona më e rëndësishme për qëndrueshmërinë e protezës së sipërme është:

- A) Tuberat maksilare
- B) Torusi palatinal
- C) Sulkusi pterigomaksilar
- D) Zona posteriore e qiellzës së fortë (linja ah)

92. Kurba e kompensimit sagittal formohet në nivel të:

- A) Kaninëve
- B) Molarit të parë
- C) Premolarit të parë
- D) Lateralëve

93. Në protezën totale përdoret muflimi:

- A) Indirekt
- B) Direkt
- C) I kombinuar
- D) Sipas dëshirës

94. Torusi mandibular ndodhet:

- A) Në pjesën linguale të mandibulës në nivel të premolarëve
- B) Në pjesën vestibulare të mandibulës në nivel të molarëve
- C) Në pjesën vestibulare të mandibulës në nivel të kaninëve
- D) Në pjesën linguale të mandibulës në nivel të molarëve

95. Plani i okluzionit në pjesën distale është paralel me:

- A) Planin Camper
- B) Horizontalen e Frankfurtit
- C) Vijën bipupilare
- D) Mesin e procesit alveolar

96. Kufiri i protezës totale shtrihet në:

- A) Mukozën fikse
- B) Mukozën pasive të lëvizshme (neutrale)
- C) Mukozën aktive të lëvizshme
- D) Sipas rastit

97. Rruga jofiziologjike e transmetimit të forcës përtypëse shkakton:

- A) Kandidozë bucale
- B) Probleme fonetike
- C) Atrofi të mëtejshme të procesit alveolar
- D) Dekubituse në mukozë të lëvizshme

98. Tuberkulum alveolar apo trigonumi retromolar ndodhet në:

- A) Pjesën distale, në fund të procesit alveolar mandibular
- B) Pjesën linguale të mandibulës në nivel të premolarëve

- C) Fund të qiellzes së fortë
- D) Mes të qiellzës së fortë

99. Në prognati dhëmbët distalë rekomandohen të zgjidhen të:

- A) Tipit N
- B) Tipit K
- C) Dhëmbë joanatomike
- D) Tipit T

100. Në cilin nga formacionet e mëposhtme bëhet lehtësimi ortopedik ose kirurgjikal, në sensitivitetit kur ai është shume i zhvilluar?

- A) Plikat bukale
- B) Tuberkulum alveolar mandibulae
- C) Torus palatinal
- D) Llozha vestibulare bucinatore

101. Zona më e rëndësishme për qëndrueshmërinë e protezës së poshtme është:

- A) Llozha retromylohyoide
- B) Zona e kristës mylohyoide
- C) Zona e tuberkulum alveolar mandibular
- D) Zona sublinguale anteriore

102. Ribazimi i protezave totale bëhet kur:

- A) Proteza lëviz dhe ka okluzion normal
- B) Proteza lëviz dhe okluzioni qendror nuk është i rregullt
- C) Proteza lëviz dhe ka okluzion të lartë
- D) Proteza lëviz dhe ka okluzion të ulët

103. Në pjesën distale linguale, pllaka e protezës së poshtme modelohet:

- A) E trashë
- B) Konvekse
- C) E sheshtë
- D) Konkave

104. Në okluzion normal, sipas raportit të dhëmbëve kuspit-fosë, kemi raporte të tilla:

- A) Kuspidet vestibularë lart okludojnë në fosat e poshtme
- B) Kuspidet lingualë poshtë okludojnë në fosat lart
- C) Varet nga situata klinike individuale
- D) Kuspidet palatinalë lart okludojnë në fosat e poshtme

105. Bëhet gjithmonë gravim në:

- A) Zonën rreth torusit palatin
- B) Zonën vestibulare të procesit alveolar
- C) Linjën posteriore të vibrimit
- D) Tuber maksilae

106. Pas marrjes së masës anatomike, trashësia e alginatit brenda lugës duhet të jetë:

- A) Jouniforme
- B) Uniforme
- C) Varet nga situata klinike

D)S'ka rëndësi

107. Kufiri posterior i lugës (së serisë) së sipërme për marrjen e masës anatomike duhet:

- A)Të jetë para fovea palatine
- B) Varet nga situata klinike individuale
- C)Nuk ka kufi të përcaktuar
- D)Të shtrihet rreth 5 mm prapa fovea palatine

108. Ndryshimet në raportin pluhur/ujë të alginatit:

- A)Nuk ndikojnë në kohën e forcimit
- B) Pakësojnë kohën e forcimit të materialit
- C)Rrisin kohën e forcimit të materialit
- D)Ndryshojnë veçoritë kimike të materialit

109. Në pikën më të ulët të kreshtës reziduale të mandibulës, gjatë rreshtimit për protezën totale, duhet të vendoset:

- A)Premolari i dytë
- B) Molari i dytë
- C) Molari i parë
- D)Kanini

110. Dhëmbi i parë që vendoset në rreshtimin në protezën totale është:

- A)Laterali lart
- B) Molari i parë poshtë
- C) Kanini lart
- D)Incizivi central lart

111. Në një okluzion normal, dhëmbët frontalë krijojnë kontakt:

- A)Në okluzion qendror
- B)Në lëvizjen laterale djathtas
- C)Në lëvizjen laterale majtas
- D)Vetëm në protrusion të mandibulës

112. Reaksioni i polimerizimit të rezines është reaksion:

- A)Pa ndryshime temperature
- B)Endotermik
- C)Ekzotermik
- D)Varet nga raporti pluhur/lëng

113. Temperatura e ujit të alginatit ndikon në:

- A)Kohën e forcimit të materialit
- B) Vetitë mekanike të alginatit
- C)Elasticitetin e alginatit
- D)Precizionin e masës

114. Rezina fotopolimerizuese përdoret për:

- A)Marrje mase anatomike
- B) Konstruktimin e gjithë bazës së protezës
- C)Përgatitjen e lugëve individuale
- D)Riparime të ndryshme të protezës

115. Mungesa e hapësirës minimale fonetike tregon që:

- A) Lartësia e okluzionit është më e lartë se sa duhet
- B) Lartësia e okluzionit është më e ulët se sa duhet
- C) Pozicioni mezio-distal i mandibulës është përcaktuar gabim
- D) Plani i okluzionit është përcaktuar gabim

116. Cila mënyrë e bashkimit të qiellzës së fortë me qiellzën e butë ndikon më pozitivisht në qëndrueshmërinë e protezës totale:

- A) Bashkimi me kënd 180 gradë
- B) Bashkimi me kënd 120 gradë
- C) Bashkimi me kënd 135 gradë
- D) Bashkimi me kënd 90 gradë

117. Apofizat geniane ndodhen në pjesën:

- A) Linguale të mandibulës në dy anët e linjës mediane
- B) Vestibulare të mandibulës në nivel të linjës mediane
- C) Vestibulare të mandibulës në nivel të premolarëve
- D) Linguale të mandibulës në nivel të molarëve

118. Trekëndëshi i Bonwill-it formohet nga bashkimi i qendrës së dy kondileve dhe:

- A) Pikës incizivale
- B) Spina nasalis posterior
- C) Spina nasalis anterior
- D) Mentumit

119. Dhëmbët joanatomikë (pa tuberkula) përdoren me sukses në protezat totale në nofulla:

- A) Të pa atrofizuara
- B) Shumë të atrofizuara
- C) Me atrofi jouniforme
- D) Me kreshta reziduale të gjera

120. Në progeny Kyçi i Angel-it (Kyçi i okluzionit) është:

- A) I mezializuar
- B) Varet nga grada e progenisë
- C) Normal
- D) I distalizuar

121. Në prognati Kyçi i Angel-it (Kyçi i okluzionit) është:

- A) Normal
- B) I distalizuar
- C) I mezializuar
- D) Varet nga grada e prognatisë

122. Në okluzionin e balancuar bilateral, gjatë lëvizjes laterale, në anën e punës kemi:

- A) Kontakt të dhëmbëve distalë lart dhe poshtë me tuberkulat me emër të njëjtë
- B) Kontakt të dhëmbëve distalë lart dhe poshtë me tuberkulat me emër të kundërt
- C) Mungesë kontakti midis dhëmbëve distal lart dhe poshtë
- D) Rrëshqitje të kaninit poshtë në sipërfaqen palatinale të kaninit lart

123. Në okluzionin e balancuar bilateral, gjatë lëvizjes laterale, në anën balancuese kemi:

- A) Kontakt të dhëmbëve distalë lart dhe poshtë me tuberkulat me emër të njëjtë
- B) Kontakt të dhëmbëve distalë lart dhe poshtë me tuberkulat me emër të kundërt
- C) Mungesë kontakti midis dhëmbëve distalë lart dhe poshtë
- D) Rrëshqitje të kaninit poshtë në sipërfaqen palatinale të kaninit lart

124. Në okluzionin e balancuar unilateral, gjatë lëvizjes laterale, në anën balancuese kemi:

- A) Kontakt të dhëmbëve distalë lart dhe poshtë me tuberkulat me emër të kundërt
- B) Mungesë kontakti midis dhëmbëve distalë lart dhe poshtë
- C) Kontakt të dhëmbëve distalë lart dhe poshtë me tuberkulat me emër të njëjtë
- D) Rrëshqitje të kaninit poshtë në sipërfaqen palatinale të kaninit lart

125. Cili nga pohimet është i vërtetë?

- A) Plani i okluzionit është rreth 2mm mbi buzën e sipërme
- B) Plani i okluzionit është rreth 2mm mbi buzën e poshtme
- C) Plani i okluzionit është në një nivel me tuberin maksilar
- D) Plani i okluzionit është rreth 2mm nën buzën e sipërme

126. Plani i okluzionit distalisht është në nivelin:

- A) E tuber maksilare
- B) E torusit mandibular
- C) E ndarjes së 1/3 së sipërme nga 2/3 e poshtme të tuberkulum alveolar mandibulare
- D) E ndarjes së 1/3 së sipërme nga 2/3 e poshtme të tuber maksilare

127. Cili nga pohimet është i vërtetë?

- A) Maksila atrofizohet 4 herë më shpejt se mandibula
- B) Mandibula atrofizohet 4 herë më shpejt se maksila
- C) Maksila dhe mandibula atrofizohen me të njëjtën shpejtësi
- D) Maksila atrofizohet 2 herë më shpejt se mandibula

128. Zona e vetme që mund të shfrytëzohet për të zgjeruar sipërfaqen e protezës së poshtme në atrofi të shprehura të saj, është:

- A) Zona sublinguale anteriore
- B) Llozha retro-mylohoioide
- C) Dyshemeja e gojës dhe muskuli mylohoioide
- D) Zona e fornixit vestibular anterior

129. Kur gjatë lëvizjes së gjuhës majtas, konstatohet lëvizje e protezës së poshtme, kemi një protezë me:

- A) Kufi më të gjatë sublingual majtas
- B) Kufi më të gjatë vestibular djathtas
- C) Kufi më të gjatë sublingual djathtas
- D) Kufi më të gjatë vestibular majtas

130. Në pacientin për protezë totale, metoda e gëlltitjes shfrytëzohet për të përcaktuar:

- A) Planin e okluzionit
- B) Lartësinë e okluzionit

- C) Pozicionin mezio-distal të mandibulës
- D) Përmasat e dhëmbëve artificialë

131. Në pacientin për protezë totale, metoda e fleksionit të kokës prapa shfrytëzohet për të përcaktuar:

- A) Planin e okluzionit
- B) Pozicionin mezio-distal të mandibulës
- C) Përmasat e dhëmbëve artificialë
- D) Lartësinë e okluzionit

132. Në pacientin për protezë totale, metoda antropometrike (ndarja e fytyrës në kate të barabarta) shfrytëzohet për të përcaktuar:

- A) Lartësinë e okluzionit
- B) Planin e okluzionit
- C) Përmasat e dhëmbëve artificialë
- D) Pozicionin mezio-distal të mandibulës

133. Në pacientin për protezë totale, metoda e Ëalkoff-it (prekja e fundit të qiellzës me majën e gjuhës) shfrytëzohet për të përcaktuar:

- A) Planin e okluzionit
- B) Pozicionin mezio-distal të mandibulës
- C) Lartësinë e okluzionit
- D) Planin Camper

134. Pamja e thelluar e plikave nasolabiale dhe e sulkusit labio mental, tregojnë për një:

- A) Lartësi okluzioni më të ulët se sa duhet
- B) Lartësi okluzioni më të lartë se sa duhet
- C) Pozicion mezio-distal të gabuar
- D) Plan okluzioni jo të saktë

135. Pamja e tërhequr e plikave nasolabiale dhe e sulkusit labio mental, tregojnë për një:

- A) Plan okluzioni jo të saktë
- B) Lartësi okluzioni më të ulët se sa duhet
- C) Pozicion mezio-distal të gabuar
- D) Lartësi okluzioni më të madhe se sa duhet

136. Në një pacient me mungesë të plotë të dhëmbëve, dalja e mentumit shumë përpara tregon për një:

- A) Atrofi pak të shprehur
- B) Ulje të tonusit muskular
- C) Prognati
- D) Atrofi shumë të shprehur

137. Sipërfaqja vestibulare e centralëve maksilarë, në lidhje me përgjysmoren horizontale të papilës incizivale është:

- A) 1-2 mm më përpara

- B) 4-5 mm më prapa
- C) 7-9 mm më përpara
- D) 5-6 mm më prapa

138. Sipërfaqja vestibulare e kaninëve maksilarë, në lidhje me pikën më distale të rugave palatine kanine është:

- A) 1-2 mm më përpara
- B) 5-6 mm më prapa
- C) 4-5 mm më përpara
- D) 7-9 mm më përpara

139. Në pjesën frontale lartësia e shabllonit të sipërm duhet të jetë mesatarisht:

- A) 22mm
- B) 18mm
- C) 15mm
- D) 27mm

140. Në pjesën frontale lartësia e shabllonit të poshtëm duhet të jetë mesatarisht:

- A) 15mm
- B) 22mm
- C) 18mm
- D) 27mm

141. Në lidhje me kufirin e bashkimit të mukozës me papilla të gjuhës dhe mukozës së lëmuar të saj, plani i okluzionit i protezës totale duhet të jetë:

- A) 2-3mm më lart se kufiri i bashkimit të dy mukozave
- B) Në nivelin e bashkimit të dy mukozave
- C) 2-3mm më ulët se kufiri i bashkimit të dy mukozave
- D) 4-5mm më ulët se kufiri i bashkimit të dy mukozave

142. Sipas formulave të Pound-it, gjatësia e centralëve maksilarë është:

- A) Sa $1/160$ e gjatësisë së trupit
- B) Sa $1/10$ e gjatësisë së fytyrës
- C) Sa $1/16$ e gjerësisë së fytyrës
- D) Sa $1/16$ e gjatësisë së fytyrës

143. Sipas formulave të Pound-it, gjerësia e centralëve maksilarë është:

- A) Sa $1/160$ e gjerësisë së trupit
- B) Sa $1/16$ e gjerësisë së fytyrës
- C) Sa $1/16$ e gjatësisë së fytyrës
- D) Sa $1/10$ e gjerësisë së fytyrës

144. Në rreshtimin e dhëmbëve në protezat totale në progeny:

- A) Frontalët lart rreshtohen në mes të procesit alveolar
- B) Frontalët lart rreshtohen më brenda se normalisht
- C) Frontalët poshtë rreshtohen më jashtë se normalisht
- D) Frontalët lart rreshtohen më jashtë se normalisht

145. Në rreshtimin e dhëmbëve në protezat totale në prognati:

- A) Frontalët lart rreshtohen më brenda se normalisht
- B) Frontalët lart rreshtohen më jashtë se normalisht
- C) Frontalët poshtë rreshtohen më brenda se normalisht
- D) Frontalët poshtë rreshtohen në mes të procesit alveolar

146. Gjatë rregullimit funksional të lugës individuale të sipërme, në zonën e tuberave maksilarë pacienti:

- A) Bën sikur fërshëllen
- B) Bën qeshje të ekzagjeruar (ngërdheshet)
- C) Hap gojën në maksimum dhe lëviz majtas-djathtas mandibulën
- D) Shqipton "Ah" të lehtë e të zgjatur

147. Gjatë rregullimit funksional të lugës individuale të sipërme, në zonën e vibrimit (post-damit), pacienti:

- A) Bën sikur fërshëllen
- B) Shqipton "Ah" të lehtë e të zgjatur
- C) Bën qeshje të ekzagjeruar (Ngërdheshet)
- D) Hap gojën në maksimum dhe lëviz majtas-djathtas mandibulën

148. Në okludator punimet konstruktohen sipas okluzionit:

- A) Prognatik
- B) Të balancuar bilateral
- C) Organik (të mbrojtur në mënyrë të dyanshme)
- D) Të balancuar unilateral

149. Në artikulator punimet konstruktohen sipas okluzionit:

- A) Të balancuar unilateral
- B) Organik (të mbrojtur në mënyrë të dyanshme)
- C) Të balancuar bilateral
- D) Progenik

150. Në rastin e atrofive të shprehura të maksilës, papilla incizivale orienton për vendosjen (rreshtimin) e:

- A) Kaninëve maksilarë
- B) Lateralëve maksilarë
- C) Centralëve maksilarë
- D) Centralëve mandibularë

151. Në rastin e atrofive të shprehura të maksilës, ruga palatinale kanine orienton për vendosjen (rreshtimin) e:

- A) Centralëve maksilarë
- B) Kaninëve maksilarë
- C) Lateralëve maksilarë
- D) Kaninëve mandibularë

152. Gjatë rreshtimit në okluzion normal, centralët maksilarë (11/21) kanë drejtimin:

- A) Qafa në një nivel me margon
- B) Qafa më e dalë sesa margoja
- C) Qafa më e futur sesa margoja
- D) Sipas karakteristikave individuale

153. Gjatë rreshtimit në okluzion normal, lateralët maksilarë (12/22) kanë drejtimin:

- A) Sipas karakteristikave individuale
- B) Qafa më e dalë sesa margoja
- C) Qafa në një nivel me margon
- D) Qafa më e futur sesa margoja

154. Në lidhje me planin horizontal, laterali maksilar (12/22) ka këtë raport:

- A) E takon me gjithë margon prerëse
- B) Qëndron 0,5-1mm më lart
- C) Qëndron 0,5-1mm më ulët
- D) Qëndron 2-3mm më lart

155. Protezat me pllakë të reduktuar nuk mund të përdoren në pacientë me:

- A) Refleks të vjelli
- B) Atrofi të shprehur të maksilës
- C) Humbje të shijes
- D) Tubera maksilarë shumë të shprehur

156. Në muflimin indirekt të protezës totale, gjatë vendosjes së modelit në bazën e muflës, mbulohen me allçinë e bazës së muflës:

- A) Dhëmbët artificialë
- B) Vetëm anët e modelit
- C) Dhëmbët dhe baza e protezës
- D) Baza prej dylli e protezës

157. Gjatë ciklit të polimerizimit me nxehtësi të rezines, rekomandohet të mbahet temperatura konstante për rreth 1 orë në intervalin:

- A) 20-30 gradë
- B) 30-40 gradë
- C) 60-65 gradë
- D) 40-50 gradë

158. Ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë e protezës totale të sipërme një qiellzë e fortë:

- A) Në formë "V" je të përmbysur
- B) Në formë "U" je të përmbysur
- C) E sheshtë
- D) Me mukozë me reziliencë të shtuar

159. Rreshtimi i kryqëzuar i dhëmbëve distalë përdoret në:

- A) Prognati
- B) Okluzion normal
- C) Atrofi të shprehur të të dyja nofullave
- D) Okluzion të thellë

160. Rreshtimi i kryqëzuar i dhëmbëve distalë përdoret në:

- A) Okluzion normal

- B) Progeni
- C) Prognati
- D) Okluzion të thellë

161. Në rreshtimin e dhëmbëve në protezat totale në prognati, over-bite dhe over-jet:

- A) Rriten
- B) Janë normale
- C) Zvogëlohen
- D) Bëhen 0 (zero)

162. Në rreshtimin e dhëmbëve në protezat totale në progeni, over-bite dhe over-jet:

- A) Bëhen 0 (zero)
- B) Rriten
- C) Ruhen të pandryshuara
- D) Janë normale

163. Nëse një protezë totale e sipërme bie gjatë hapjes maksimale të gojës, kemi një kufi më të gjatë se sa duhet në zonën:

- A) Vestibulare frontale
- B) E sulkusit pterigomaksilar dhe ligamentit pterigo-mandibular
- C) E plikave bukale
- D) E postdam-it (linjës Ah)

164. Baza e trashë e protezës gjatë modelimit me dyll, rrit mundësinë për:

- A) Stomatite protetike
- B) Kafshim të faqeve
- C) Dekubituse
- D) Porozitete në rezine

165. Në okluzionin e balancuar unilateral, gjatë lëvizjes laterale, në anën e punës kemi:

- A) Kontakt të dhëmbëve distalë lart dhe poshtë me tuberkulat me emër të njëjtë
- B) Kontakt të dhëmbëve distalë lart dhe poshtë me tuberkulat me emër të kundërt
- C) Mungesë kontakti midis dhëmbëve distalë lart dhe poshtë
- D) Rrëshqitje të kaninit poshtë në sipërfaqen palatinale të kaninit lart

166. Fenomeni i alergjisë nga rezina e protezës shkaktohet nga:

- A) Polimeri (pluhuri)
- B) Lëndët ngjyruese
- C) Monomeri (lëngu)
- D) Inhibitorët e rezines

167. Gjatë polimerizimit primar të rezines, faza ku fillon reaksioni kimik i polimerizimit ndërmjet polimerit dhe monomerit, është faza e:

- A) Parë
- B) Tretë
- C) Dytë
- D) Katërt

168. Nëse gjatë përzierjes së polimerit me monomerin prishet raporti pluhur-lëng duke shtuar sasinë e monomerit (lëngut), proteza e përfunduar do të:

- A) Japë ngacmim të mukozës
- B) Ketë kufinj jo të saktë
- C) Ketë lartësi okluzioni më të madhe
- D) Shkaktojë deku-bituse

169. Në atrofite e shprehura mund të shkaktohen dhimbje nevralgjike nga komprimimi i nervit dhe dalja në mes të kreshtës reziduale i:

- A) Foramen mentale
- B) Foramen palatinum minor
- C) Foramen incisivale
- D) Foramen palatinum major

170. Mund të realizohet me riparim direkt në gojën e pacientit:

- A) Shtesa e një krosheje
- B) Shtesa e një pjesë të vogël të pllakës vestibulare
- C) Shtesa e disa dhëmbëve
- D) Ngjitja e dy pjesëve të thyera

171. Ribazimi indirekt kryhet kur:

- A) Proteza është thyer dhe fragmentet përputhen
- B) Proteza ka gabim okluzioni
- C) Proteza lëviz se ka ndryshuar forma e kreshtave reziduale
- D) Ka ulje të lartësisë së okluzionit

172. Gjatë parapërgatitjes kirurgjikale të gojës për protezë imediate ekstraktohen:

- A) Dhëmbët distalë dhe ruhet vetëm një çift që ruan lartësinë e
- B) Dhëmbët frontalë dhe ruhen distalët
- C) Të gjithë dhëmbët e mbetur
- D) Sipas dëshirës së pacientit

173. Nëse gjatë përzierjes së polimerit me monomerin prishet raporti pluhur-lëng duke shtuar sasinë e polimerit (pluhuri), proteza e përfunduar do të:

- A) Ketë lartësi okluzioni më të madhe
- B) Ketë lartësi okluzioni më të madhe
- C) Pësojë deformim gjatë polimerizimit
- D) Japë ngacmim të mukozës

174. Zona muskulare me tonus (tonicitet) të lartë, që ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë e protezës totale, është:

- A) Muskujt pterigoid-lateralë
- B) Muskuli mylohioid
- C) Modiolusi
- D) Muskujt geniohioid

175. Modelimi konkav i pllakës vestibulare distale të protezës shkakton:

- A) Atrofi më të shpejtë të kreshtave
- B) Grumbullim të mbeturinave ushqimore
- C) Stomatit protetik

D) Kafshim të gjuhës

176. Modelimi konkav i pllakës vestibulare distale të protezës shkakton:

- A) Atrofi më të shpejtë të kreshtave
- B) Kafshim të gjuhës
- C) Vështirësi në shqiptimin e gërmës "S"
- D) Kafshim të faqeve

177. Linja e POUNDIT formohet gjatë rreshtimit të dhëmbëve:

- A) Distalë poshtë
- B) Distalë lart
- C) Frontalë lart
- D) Frontalë poshtë

178. Zona me resiliencë më të madhe në mukozën e nofullës së sipërme është:

- A) Zonat gjendrore të Schroeder-it
- B) Zona e torusit palatinal
- C) Zona e procesit alveolar
- D) Zona e tuberave maksilarë

179. Cilët janë dhëmbët që në rreshtimin e Gizit takojnë plotësisht planin horizontal:

- A) 1,3,5
- B) 3,6,7
- C) 1,2,5
- D) 4,6,7

180. Rreshtimi i dhëmbëve artificialë distalë më jashtë se mesi i procesit alveolar shkakton:

- A) Vështirësi në gëlltitje
- B) Thyerje të protezës në linjën mediane
- C) Vështirësi në të folur
- D) Parakontakte në okluzion

181. Në një riparim indirekt për të shtuar një pjesë të thyer (që mungon) të pllakës së protezës duhet:

- A) Të merret masa në okluzion qendror
- B) Të merret masa pa protezë
- C) Të merret masa me protezë në gojë
- D) Të bëhet shtesa në goje me rezine vetëpolimerizuese

182. Lartësia e 1/3 së poshtme të fytyrës në okluzion qendror është:

- A) Sa lartësia gjatë shqiptimit të gërmës M
- B) Sa lartësia në pozicionin e qetësisë
- C) 1-2mm më e lartë se lartësia e pozicionit të qetësisë
- D) 1-2mm më e ulët se lartësia e pozicionit të qetësisë

183. Masa anatomike me presion (kompresive) merret me:

- A) Silikon të trashë (putty)
- B) Repinë
- C) Alginat

D) Allçi

184. Kufiri i lugës individuale të konstruktuar në një model të përfituar nga një masë e marrë me alginat duhet të jetë:

- A) 1-2mm më i gjatë se kufiri i modelit
- B) 1-2mm më i shkurtër se kufiri i modelit
- C) Sa kufiri i modelit
- D) 3-4 mm më i shkurtër se kufiri i modelit

185. Torusi mandibular ndodhet:

- A) Në pjesën linguale të mandibulës në nivel të premolarëve
- B) Në pjesën vestibulare të mandibulës në nivel të molarëve
- C) Në pjesën vestibulare të mandibulës në nivel të kaninëve
- D) Në pjesën linguale të mandibulës në nivel të molarëve

186. Plani i okluzionit në pjesën frontale është paralel me:

- A) Mesin e procesit alveolar
- B) Horizontalen e Frankfurtit
- C) Planin Camper
- D) Vijën bipupilare

187. Ribazimii protezave totale bëhet kur:

- A) Proteza lëviz dhe okluzioni qendror nuk është i rregullt
- B) Proteza lëviz dhe ka okluzion të ulët
- C) Proteza lëviz dhe ka okluzion të lartë
- D) Proteza lëviz dhe ka okluzion normal

188. Ribazimi i protezave totale me materiale elastike bëhet kur:

- A) Proceset alveolare janë të pa atrofizuar
- B) Mukoza është atrofike dhe ka resiliencë shumë të ulët
- C) Mukoza ka resiliencë të shtuar dhe është e trashë
- D) Ka fenomen spatule pozitiv të dyanshëm

189. Lehtësimi ortopedik i formacioneve të caktuara anatomike bëhet me:

- A) Dyllë
- B) Stenc
- C) Fletë plumbi (stanjolle)
- D) Rezine të fortë vetëpolimerizuese

190. Lehtësimi i protezës bëhet në:

- A) Linjën AH
- B) Linjën oblike interne të shprehur
- C) Linjën oblike eksterne shumë të shprehur
- D) Llozhën retromylochioide

191. Vendosja e modeleve në artikulatorin Stratos 200 bëhet duke u bazuar në:

- A) Pafilën incizivale dhe përgjysmoret e saj
- B) Tuberkulum alveolar mandibulae dhe përgjysmoret e tij
- C) Frenulum labi superior
- D) Tuberat maxilarë

192. Maceracionet e këndeve të buzëve janë shenjë e një:

- A) Proteze me okluzion të lartë
- B) Proteze që lëviz
- C) Stomatiti kandidozik
- D) Proteze me gabim okluzioni

193. Mbajtja e temperaturës konstante për një orë, në 60-65 gradë gjatë polimerizimit tradicional të plastmasës, bën që proteza e përfunduar:

- A) Të ketë kufinj të saktë
- B) Të ndahet lehtësisht nga modeli pas polimerizimit
- C) Të jetë pa porozitete
- D) Të illustrohet më me lehtësi

194. Masa anatomike me presion mesatar merret me:

- A) Silikon të trashë (putty)
- B) Repinë
- C) Alginat
- D) Allçi

195. Tuberkulum alveolar apo trigonumi retromolar ndodhet në:

- A) Në mes të qiellzës së fortë
- B) Në pjesën linguale të mandibulës në nivel të premolarëve
- C) Në pjesën distale, në fund të procesit alveolar mandibular.
- D) Në fund të qiellzës së fortë

196. Simptomat e Sindromit Disfunktional (fenomeni Costen) janë pasojë e:

- A) Uljes së shprehur të lartësisë së okluzionit
- B) Një okluzioni më të lartë sesa duhet
- C) Mungesës së hapësirës minimale fonetike
- D) Mungesës së gjithë dhëmbëve frontalë

197. Në modelin e nxjerrë nga një masë anatomike me allçi, kufiri i lugës individuale duhet të jetë:

- A) 1-2 mm më i shkurtër se kufiri i modelit
- B) 1mm më i gjatë se kufiri i modelit
- C) Sa kufiri i shënuar në model
- D) 3-4mm më i shkurtër se kufiri i modelit

198. Rreshtimi normal i dhëmbëve distale bëhet kur:

- A) Boshti interalveolar formon një kënd 120 gradë me planin e
- B) Boshti interalveolar formon një kënd 80-90 gradë me planin e okluzionit
- C) Boshti interalveolar formon një kënd 50 gradë me planin e okluzionit
- D) Boshti interalveolar formon një kënd 70 gradë me planin e okluzionit

199. Në protezat totale në progeny overbite dhe overjet janë:

- A) 3-4mm
- B) 1-2mm
- C) 0
- D) 5mm

200. Në protezën totale transmetimi i presionit përtypës bëhet sipas rrugës:

- A) Fiziologjike
- B) Jofiziologjike.
- C) Jofiziologjike-fiziologjike
- D) Fiziologjike-jofiziologjike

201. Forma e dhëmbëve frontalë lart zgjidhet sipas:

- A) Formës së fytyrës së pacientit
- B) Formës së dhëmbëve distal
- C) Linjave estetike ndihmëse
- D) Formës së torusit palatinal

202. Në atrofi të shprehura të mandibulës, këndi (angulus mandibulae):

- A) Varet nga karakteristikat individuale të pacientit
- B) Nuk ndryshon
- C) Zvogëlohet
- D) Rritet

203. Gjerësia e zonës së vibrimit (Post-dam-it) varet nga:

- A) Këndi i bashkimit të qiellzës së fortë me qiellzën e butë
- B) Grada e atrofisë së proceseve alveolare
- C) Thellësia e qiellzës
- D) Forma e qiellzës së fortë (U, V, e sheshtë)

204. Rezilienca e mukozës së nofullës së poshtme është mesatarisht:

- A) 1,5mm
- B) 0,4-0,6mm
- C) 0,6-1mm
- D) 1mm

205. Rezilienca e mukozës së nofullës së sipërme është mesatarisht:

- A) 2mm
- B) 1,5mm
- C) 0,4-0,6mm
- D) 0,6-1mm

206. Hapësira minimale fonetike vihet në dukje kur:

- A) Pacienti shqipton germën "S"
- B) Pacienti shqipton germën "F, V"
- C) Pacienti shqipton germën "E"
- D) Pacienti shqipton germën "M"

207. Rezina vetëpolimerizuese përdoret për:

- A) Riparime të ndryshme të protezës
- B) Marrje mase funksionale
- C) Konstruktimin e gjithë bazës së protezës
- D) Marrje mase anatomike

208. Rreshtimi i kryqëzuar i dhëmbëve distalë bëhet kur:

- A) Boshti interalveolar formon një kënd 90 gradë me planin e okluzionit
- B) Boshti interalveolar formon një kënd nën 70 gradë me planin e okluzionit
- C) Boshti interalveolar formon një kënd 80-90 gradë me planin e
- D) Boshti interalveolar formon një kënd 80 gradë me planin e okluzionit

209. Në rreshtimin e dhëmbëve artificialë në progeni dhe rreshtim të kryqëzuar, kurba Wilson është:

- A) Normale
- B) E përmbysur
- C) Më e theksuar (e përkulur)
- D) Sipas rastit

210. Linja anteriore e vibrimit (Silverman) vihet në dukje kur pacienti:

- A) Hap gojën në maksimum
- B) Shqipton bashkëtingëlloren S
- C) Shfryn hundët me vrima të mbyllura
- D) Shqipton AH të lehtë e të zgjatur

211. Linja posteriore e vibrimit (Silverman) vihet në dukje kur pacienti:

- A) Shfryn hundët me vrima të mbyllura
- B) Shqipton AH të lehtë e të zgjatur
- C) Hap gojën në maksimum
- D) Shqipton bashkëtingëlloren S

212. Për marrjen e masës funksionale në protezat totale cili është materiali më i përshtatshëm:

- A) Silikoni i trashë (putty)
- B) Pastat e oksid zink eugenolit
- C) Alginati
- D) Rezina vetëpolimerizuese

213. Për të shtuar një kroshe në një protezë (me riparim indirekt) duhet të:

- A) Merret masë pa protezë në gojë
- B) Bëhet shtesa në gojë me rezine vetëpolimerizuese
- C) Merret masë me protezë në gojë
- D) Merret masë në okluzion qendror

214. Dhëmbët artificialë për proteza totale fabrikohen me tuberkula:

- A) Sa dhëmbët natyralë që zëvendësojnë
- B) Më të larta se dhëmbët natyralë që zëvendësojnë
- C) Pa tuberkula (të sheshtë)
- D) Më të ulta se dhëmbët natyralë

215. Vendosja e manshetave të dyllit në masën funksionale ka si qëllim:

- A) Të mos lejojë deformimin e masës
- B) Të lehtësojë procedurën e derdhjes së modelit
- C) Të mos lejojë rrjedhjen e allçisë gjatë derdhjes së masës
- D) Të riprodhojë në model gjatësinë dhe trashësinë e kufirit të masës funksionale

216. Proteza me pllakë të reduktuar nuk mund të përdoret në pacientë me:

- A) Kandidozë bucale
- B) Qiellzë të thellë
- C) Egzostoza të shumta
- D) Atrofi të theksuar të procesit alveolar

217. Në protezën totale me okluzion normal dhëmbët frontalë sipër:

- A) Mbulojnë rreth 3-3,5 mm frontalët poshtë dhe kanë kontakt me to
- B) Mbulojnë rreth 3-3,5 mm frontalët poshtë dhe nuk kanë kontakt me to
- C) Mbulojnë rreth 0,5-1 mm frontalët poshtë dhe nuk kanë kontakt me to
- D) Mbulojnë rreth 1 mm frontalët poshtë dhe kanë kontakt me to

218. Në një riparim direkt për të shtuar një pjesë të thyer të pllakës së protezës duhet:

- A) Të merret masa me protezë në gojë
- B) Të bëhet shtesa në gojë me rezinë vetëpolimerizuese
- C) Të merret masa pa protezë
- D) Të merret masa në okluzion qëndror

219. Për ribazimin indirekt të protezës totale merret:

- A) Masë anatomike me lugë serie
- B) Masë e imët
- C) Masë funksionale me protezë në okluzion qëndror
- D) Masë me protezë, e presuar me dorë

220. Lehtësimi i protezës bëhet në:

- A) Tuberkulum alveolar mandibular të zhvilluar
- B) Linjën AH
- C) Ligamentin pterigomandibular
- D) Torus mandibular të zhvilluar

221. Gjatë shqiptimit të bashkëtingellore F dhe V, centralët lart duhet:

- A) Të mos e prekin buzën e poshtme duke qëndruar 1.5mm larg saj
- B) Të mos e prekin buzën e poshtme duke qëndruar 0,5mm larg saj
- C) Të prekin lehtë buzën e poshtme në kufirin mes pjesës së lagur dhe asaj të thatë të mukozës së buzës
- D) Të prekin buzën e poshtme duke u zhytur rreth 1 mm në të

222. Kurba e kompensimit transversal formohet në nivel të:

- A) Kaninëve
- B) Molarëve
- C) Premolarëve
- D) Centralëve

223. Kërcitja e dhëmbëve gjatë të folurit në një pacient me protezë totale tregon për një protezë me okluzion:

- A) Të ulët
- B) Të kryqëzuar
- C) Prognatik
- D) Të lartë

224. Kufiri i protezës totale të përfunduar duhet të jetë:

- A) I hollë dhe i mprehtë
- B) Në trashësinë e buzëve të masës funksionale
- C) Në trashësinë e buzëve të masës anatomike
- D) I hollë dhe i rrumbullakosur

225. Proteza axhuste përdoret kur:

- A) Atrofia e procesit alveolar është e madhe
- B) Procesi alveolar frontal në nofullën e sipërme është shumë i zhvilluar
- C) Qiellza është shumë e cekët
- D) Kur buza e sipërme është shumë e gjatë

226. Ribazimi i protezave totale bëhet kur:

- A) Proteza lëviz dhe ka okluzion normal
- B) Proteza lëviz dhe okluzioni qëndror nuk është i rregullt
- C) Proteza lëviz dhe ka okluzion të lartë
- D) Proteza lëviz dhe ka okluzion ulët

227. Në rreshtimin e dhëmbëve në prognati kurbat Spee dhe Wilson janë:

- A) Të sheshta
- B) Më të përkulura
- C) Normale
- D) Inverse (të përmbysura)

228. Gravimi i modeleve bëhet për:

- A) Lehtësimin e protezës në formacionet anatomike të zhvilluara
- B) Për të eliminuar paratakimet
- C) Për të evituar fundosjen e protezës
- D) Për të rritur qëndrueshmërinë e protezës në nofulla me procese alveolare të atrofizuara

229. Pasta e repinës është:

- A) Tiokol
- B) Silikon
- C) Oksid zink eugenol
- D) Agar-agar

230. Në protezat e lëvizshme në fëmijë përdoren:

- A) Kroshe më të holla se zakonisht (0,7mm)
- B) Nuk përdoren kroshe
- C) Kroshe më të trasha (1mm)
- D) Kroshe të zakonshme

231. Linja anteriore e vibrimit zakonisht ka formë:

- A) Të drejtë
- B) Konkave
- C) Të lakuar të dyfishte (bikonkave)
- D) Konvekse

232. Në atrofi të shprehura të mandibulës, fossa (gropa) artikulare:

- A) Varet nga karakteristikat individuale të pacientit
- B) Nuk ndryshon
- C) Bëhet më e thellë
- D) Zgjerohet (bëhet më e cekët)

233. Në pacientët më protezë totale:

- A) Relacioni qendror përputhet me okluzionin qendror
- B) Relacioni qendror është rreth 0,5-1mm më prapa se okluzioni
- C) Relacioni qendror është rreth 0,5-1mm më përpara se okluzioni qendror
- D) Relacioni qendror është rreth 3-4mm më përpara se okluzioni qendror

234. Këndi i pjerrësisë së kondileve formohet gjatë:

- A) Lëvizjes së hapjes së gojës
- B) Lëvizjes së mbylljes së gojës
- C) Lëvizjes propulsive të mandibulës
- D) Lëvizjes laterale të mandibulës

235. Këndi i Bennet-it ka mesatarisht një vlerë prej:

- A) 17 gradë
- B) 40 gradë
- C) 30 gradë
- D) 37 gradë

236. Metoda e polimerizimit të rezines me presion (SR-Ivocap) ka avantazh kryesor:

- A) Kohën më të shkurtër të polimerizimit
- B) Lidhjen më të fortë midis dhëmbëve dhe rezines
- C) Evitimin e tkurrjes dhe deformimit të protezës
- D) Peshën më të ulët të protezës së përfunduar

237. Këndi i Pjerrësisë së kondileve ka mesatarisht një vlerë prej:

- A) 7 gradë
- B) 50-60 gradë
- C) 17 gradë
- D) 30-33 gradë

238. Midis planit Camper dhe planit të okluzionit ka një distancë mesatarisht:

- A) 14mm
- B) 24mm
- C) 44mm
- D) 34mm

239. Linja që bashkon spina nasalis anterior me porus acusticus externus (tragusin e veshit) përfaqëson:

- A) Horizontalen e Frankfurtit
- B) Planin Camper
- C) Kurbën Spee
- D) Kurbën Wilson

240. Linja që bashkon pikën më të ulët të margos infraorbitale me porus acusticus externus (tragusin e veshit) përfaqëson:

- A) Horizontalen e Frankfurtit

- B) Planin Camper
- C) Kurbën Spee
- D) Kurbën Wilson

241. Në teknikën seksionale (zonale) të rregullimit funksional të lugës individuale përdoret si material:

- A) Dylli kerr
- B) Rezina fotopolimerizuese
- C) Repina (oksid zink-eugenoli)
- D) Bazis plate

242. Në teknikën globale (në një kohë) të rregullimit funksional të lugës individuale përdoret si material:

- A) Bazis plate
- B) Rezina fotopolimerizuese
- C) Dylli kerr
- D) Silikoni A (adicioni)

243. Hapësira neutrale e ekuilibrit protetik përfaqëson zonën (hapësirën) ku duhet të vendosen:

- A) Dhëmbët artificialë të dy protezave
- B) Pllakat (bazat) e protezave
- C) Kufiri i protezave të përfunduara
- D) Gjuha dhe muskuli mylohyoid

244. Mukoza neutrale (pasive e lëvizshme) përfaqëson zonën ku duhet të vendoset:

- A) Dhëmbët artificialë të dy protezave
- B) Pllaka (baza) e protezave
- C) Kufiri i protezave të përfunduara
- D) Gjuha dhe muskuli mylohyoid

245. Ngacmimet kronike nga një kufi i gjatë, i hollë dhe prerës i bazës së protezës mund të shkaktojnë:

- A) Hiperplazi të mukozës
- B) Kreshta fluktuante
- C) Atrofi të zonës përkatëse
- D) Stomatit protetik

246. Kur konstatohet gabim okluzioni në një protezë totale të përfunduar, defekti mund të korrigjohet duke:

- A) Përsëritur të dy protezat
- B) Bërë ribazim direkt të protezave
- C) Bërë ribazim indirekt të protezave
- D) Përsëritur një nga protezat

247. Në pacientët më dhëmbë natyralë dhe punime fikse relacioni qëndror:

- A) Është rreth 0,5-1mm më përpara se okluzioni qëndror
- B) Përputhet me okluzionin qëndror
- C) Është rreth 0,5-1mm më prapa se okluzioni qëndror
- D) Është rreth 3-4mm më përpara se okluzioni qëndror

248. Në pacientin për protezë totale, metoda grafike (me përdorimin e gnatometrit) shfrytëzohet për të përcaktuar:

- A) Planin e okluzionit
- B) Lartësinë e okluzionit
- C) Pozicionin mezio-distal të mandibulës
- D) Përmasat e dhëmbëve artificiale

249. Në artikulatorin me rregullim të pjesshëm, gjatë vendosjes së modeleve sipas regjistrimeve me hark facial, në artikulator vendoset:

- A) Fillimisht Modeli i poshtëm
- B) Fillimisht Modeli i sipërm
- C) Të dy modelet njëherësh
- D) Sipas zgjedhjes së laborantit

250. Mungesa e Koridorit bukal në protezën totale, bën që:

- A) Plani i okluzionit të duket i shtrembër
- B) Arkada dentare të duket shumë e ngushtë
- C) Arkada dentare të duket josimetrike
- D) Arkada dentare të duket shumë e gjerë

251. Këndi Gotik (i lëvizjeve laterale në pikën incizivale) ka një vlerë mesatare prej:

- A) 120 gradë
- B) 90 gradë
- C) 33 gradë
- D) 150 gradë

252. Gjatë përcaktimit të okluzionit qendror, me metodën e lodhjes së muskujve, ne tentojmë të lodhim muskujt:

- A) Maseter
- B) Pterigoid lateral
- C) Temporal
- D) Mylohioid

253. Adezioni ndërmjet pllakës së protezës dhe mukozës rritet kur:

- A) Rritet distanca midis protezës dhe mukozës
- B) Zvogëlohet sipërfaqja e kontaktit
- C) Rritet sipërfaqja e kontaktit
- D) Ulet sasia e pështymës

254. Gravimet bëhen në zona të mukozës ku rezilienca e saj është:

- A) E ulët
- B) Mesatare
- C) Mungon
- D) E lartë

255. Lehtësimet ortopedike bëhen në zona të mukozës ku rezilienca e saj është:

- A) E lartë
- B) Mesatare
- C) E ulët ose mungon

D)Shumë e lartë

256. Kreshtat fluktuante shkaktohen nga:

- A) Dekubituse të kronicizuar
- B) Mbingarkesa e regjionit frontal të procesit alveolar
- C) Stomatite protetike
- D) Proteza të trasha e poroze

257. Masat hiperplazike shkaktohen nga:

- A) Kandidoza
- B) Stomatitet protetike
- C) Ngacmim kronik (i përsëritur) nga proteza
- D) Proteza me kufinj të trashë

258. Mbetjet e dyllit në brendësi të muflës, të paeleminuara gjatë procedurës së shpëlarjes,

do të shkaktojnë në protezën e përfunduar:

- A) Parakontakte në okluzion
- B) Rritje të lartësisë së okluzionit
- C) Tkurrje të rezines
- D) Mos forcim të plotë të rezines

259. Këndi i pjerrësisë së kondileve (pjerrësia e rrugës kondilare) është mesatarisht:

- A) 13 gradë
- B) 23 gradë
- C) 43 gradë
- D) 33 gradë

260. Këndi i pjerrësisë incizale është mesatarisht:

- A) 10 gradë
- B) 20 gradë
- C) 40 gradë
- D) 30 gradë

261. Sindroma e djegies së gojës haset më shumë:

- A) Në burra mbi 50 vjeç
- B) Në persona me tonus muskular të ulët
- C) Njësoj në të dy sekset
- D) Në gratë në menopauz

262. Në kandidozat orale mjekimi medikamentoz shoqërohet me ribazim:

- A) Direkt të protezës me rezine të fortë vetëpolimerizuese
- B) Direkt të protezës me materiale elastike
- C) Indirekt, ku vishet me material të ri baza ekzistuese
- D) Indirekt, ku hiqet gjithë baza e protezës

263. Materialet me të cilat merret masa funksionale duhet të:

- A) Forcohen shpejt

- B) Jenë termoplastikë
- C) Jenë hidrofobë
- D) Forcohen ngadalë

264. Për të rritur stabilitetin e protezës totale të poshtme, molarët e parë poshtë (36/46) duhet të vendosen:

- A) Sa më të vestibularizuar
- B) Në pikën më të lartë të procesit alveolar
- C) Sa më të lingualizuar
- D) Në pikën më të ulët të procesit alveolar

265. Materialet me të cilat merret masa funksionale duhet te:

- A) Jenë hidrofile
- B) Forcohen shpejt
- C) Jenë hidrofobe
- D) Jenë termoplastikë

266. Porozitetet në rezinen e bazës së protezës favorizohen nga:

- A) Modelimi jo i mirë i dyllit
- B) Baza e hollë e protezës
- C) Mbetje të dyllit në brendësi të muflës
- D) Ngritja e shpejtë e temperaturës gjatë ciklit të polimerizimit

267. Në protezën totale dhëmbët artificialë duhet të vendosen në zonën ku:

- A) Barazohet forca e gjuhës, me forcën e faqeve dhe të buzëve
- B) Predominon forca e gjuhës
- C) Predominon forca e buzëve
- D) Predominojnë forcat e faqeve

268. Në kandidozat orale mjekimi medikamentoz shoqërohet me:

- A) Ribazim Direkt të protezës me rezine vetëpolimerizuese
- B) Përgatitjen e një proteze të re
- C) Ribazim Direkt të protezës me materiale elastike
- D) Ribazim Indirekt, ku vishet me material të ri baza ekzistuese

269. Këndi që formohet ndërmjet Planit Camper dhe Horizontales së Frankfurtit është rreth:

- A) 25 gradë
- B) 15 gradë
- C) 30 gradë
- D) 40 gradë

270. Në personat me dhëmbë natyralë, pozicioni i relacionit qendror përputhet me okluzionin qendror në:

- A) 20 % të njerëzve
- B) 5-10% të njerëzve
- C) 50 % të njerëzve
- D) 100 % të njerëzve

271. Në personat me proteza totale, pozicioni i relacionit qendror përputhet me okluzionin qendror në:

- A) 5-10% të njerëzve
- B) 100 % të njerëzve
- C) 50 % të njerëzve
- D) 20 % të njerëzve

272. Gjatë lëvizjes në planin sagital, kur mandibula lëviz lateralisht në njëren anë, kondili i anës së kundërt:

- A) Lëviz prapa dhe lart
- B) Lëviz përpara dhe poshtë
- C) Lëviz prapa dhe poshtë
- D) Rri në të njëjtin pozicion

273. Në një artikulation temporo-mandibular disfunksional, në fazën fillestare të hapjes së gojës, disku artikular ndodhet:

- A) Varet nga veçoritë individuale
- B) Prapa kondilit artikular
- C) Në mes kondilit dhe fosës artikulare
- D) Para kondilit articular

274. Tek okludatorët, distanca midis dhëmbëve dhe aksit të rrotullimit (rotacionit) është:

- A) Sa distanca reale në kafkë
- B) Më e gjatë se distanca në kafkë
- C) Varet nga veçoritë individuale
- D) Më e shkurtër se distanca në kafkë

275. Në artikulorët Arkon elementet kondilarë dhe fosat mekanike janë të vendosura në:

- A) Elementet kondilarë lart, fosat poshtë
- B) Dhe Elementet kondilarë dhe fosat në pjesën e poshtme
- C) Dhe Elementet kondilarë dhe fosat në pjesën e sipërme
- D) Elementet kondilarë poshtë, fosat lart

276. Në artikulorët JoArkon elementet kondilarë dhe fosat mekanike janë të vendosura:

- A) Dhe elementet kondilarë dhe fosat në pjesën e poshtme
- B) Elementet kondilarë poshtë, fosat lart
- C) Dhe elementet kondilarë dhe fosat në pjesën e sipërme
- D) Elementet kondilarë lart, fosat poshtë

277. Ndërtimi anatomik i Artikulacionit Temporo-Mandibular dhe i kapsulës artikulare, bën që të jenë shumë të kufizuara lëvizjet e tij:

- A) Propulsive (përpara)
- B) Djathtas
- C) Majtas
- D) Retropulsive (prapa)

278. Në pacientin me mungesë të plotë të dhëmbëve, kondilet artikulare në fosë janë të zhvendosur:

- A) Anterior

- B) Postero-superior (mbapa lart)
- C) Superior
- D) Inferior

279. Në stabilizimin më të mirë të protezave luan rol pozitiv muskuli:

- A) Sternocleidomastoid
- B) Buccinator
- C) Geniogloss
- D) Maseter

280. Masa pa presion aplikohet në:

- A) Atrofi të shprehur të kreshtave reziduale
- B) Mukozë me reziliencë të shtuar
- C) Mukozë të hollë e atrofike
- D) Mukozë me kandidozë e stomatite

281. Këndi i pjerrësisë incizivale formohet gjatë lëvizjeve të mandibulës:

- A) Anash dhe poshtë
- B) Para dhe poshtë
- C) Anash dhe lart
- D) Prapa dhe poshtë

282. Mos presimi i duhur i muflës gjatë polimerizimit bën që proteza e ardhshme të jetë:

- A) Me kufij më të shkurtër
- B) Më e trashë
- C) Me kufij më të gjatë
- D) Poroze

283. Lehtësimi ortopedik i formacioneve të caktuara anatomike bëhet me:

- A) Rezine të fortë vetëpolimerizuese
- B) Dyllë
- C) Stenc
- D) Rezine elastike

284. Mos presimi i duhur i muflës gjatë polimerizimit bën që proteza e ardhshme të jetë:

- A) Me kufij më të shkurtër
- B) Më e trashë
- C) Me kufij më të gjatë
- D) Me lartësi kafshimi më të madhe

285. Allçia rekomandohet për marrjen e masës për protezat totale në nofulla:

- A) Shumë të atrofizuara
- B) Me egzostoza të shumta
- C) Me mukozë me reziliencë të shtuar
- D) Me mukozë të hollë me reziliencë shumë të ulët

286. Maceracionet e këndeve të buzëve në një pacient janë shenjë e një:

- A) Kandidozë bucale
- B) Proteze me gabim okluzioni
- C) Proteze me okluzion të lartë

D) Mukozë me reziliencë të shtuar

287. Mjekimi ortopedik i sindromit COSTEN konsiston në:

- A) Uljen e lartësisë së kafshimit
- B) Mezializimin e mandibulës
- C) Ngritjen e lartësisë së kafshimit
- D) Distalizimin e mandibulës

288. Dukuria Christensen vërehet gjatë:

- A) Mbylljes së gojës
- B) Lëvizjeve laterale të mandibulës
- C) Hapjes së gojës
- D) Lëvizjeve propulsive

289. Këndi i BENETIT formohet gjatë lëvizjeve:

- A) Laterale në anën nga zhvendoset mandibula
- B) Propulsive
- C) Laterale në anën e kundërt të zhvendosjes
- D) Vertikale

290. Njëpërmjet Harkut facial bëhet orientimi individual i modeleve sipas:

- A) Planit horizontal
- B) Planit tuberal ose frontal
- C) Planit Camper
- D) Asnjë përgjigje e saktë

291. Rreshtimi i dhëmbëve artificialë distalë më brënda se mesi i procesit alveolar shkakton:

- A) Thyerje të protezës në linjën mediane
- B) Vështirësi në gëlltitje
- C) Kafshim të faqeve
- D) Vështirësi në të folur

292. Lartësia e 1/3 së poshtme të fytyrës gjatë shqiptimit të gërmës M është:

- A) Sa lartësia në pozicionin e qetësisë
- B) 1-2mm më e ulët se lartësia e okluzionit qëndror
- C) Sa lartësia e okluzionit qëndror
- D) 1-2mm më e lartë se pozicioni i qetësisë

293. Masa anatomike pa presion (me presion minimal) merret me:

- A) Alginat
- B) Allçi
- C) Silikon të trashë (putty)
- D) Repinë

294. Këndi Gotik formohet gjatë:

- A) Hapjes së gojës
- B) Lëvizjeve propulsive
- C) Lëvizjeve laterale
- D) Mbylljes së gojës

295. Në protezën imediate dhëmbët ekstraktohen:

- A) Para marrjes së masës funksionale
- B) Në provën me dhëmbë
- C) Para përcaktimit të okluzionit qëndror
- D) Pasi proteza është plotësisht e përfunduar

296. Gravimi i modeleve bëhet kur:

- A) Proceset alveolare janë shumë të zhvilluara
- B) Proceset alveolare janë shumë të atrofizuar
- C) Qiellza është shumë e thellë
- D) Kur ka egzostoza të shumta

297. Vendoësja e modeleve në artikulatorin Stratos 200 bëhet duke u bazuar në:

- A) Pafilën incizivale dhe përgjysmoret e saj
- B) Frenulum labi superior
- C) Tuberat maksilare
- D) Tuberkulum alveolar mandibulae dhe përgjysmoret e tij

298. Maceracionet e këndeve të buzëve janë shenje e një:

- A) Protezë me okluzion të lartë
- B) Protezë që lëviz
- C) Protezë me okluzion të ulët
- D) Protezë me gabim okluzioni

299. Në protezën e poshtme me krahë, zona ku shtrihen krahët e protezës është:

- A) Llozha bucinatore
- B) Zona e plikave bukale
- C) Zona sublinguale anteriore
- D) Llozha retromylohyoide

3. Proteza e lëvishme parciale

1. Qëndrueshmëria e protezës totale gjatë lëvizjeve laterale sigurohet nga rreshtimi i dhëmbëve sipas:

- A) Kurbës së kompensimit sagital (Spee)
- B) Rrafshit horizontal
- C) Kurbës së kompensimit transversal (Willson)
- D) Horizontales së Frankfurtit

2. Qëndrueshmëria e protezës totale gjatë lëvizjeve propulsive të mandibulës sigurohet nga rreshtimi i dhëmbëve sipas:

- A) Planit Camper

- B) Kurbës së kompensimit transversal (Willson)
- C) Rrafshit horizontal
- D) Kurbës së kompensimit sagital (Spee)

3. Në çfarë mbyllje të nofullave mund të kemi dëmtime morfo-funksionale :

- A) Në mbyllje fiziologjike
- B) Në mbyllje epistognatike
- C) Në mbyllje patologjike
- D) Në mbyllje Biprognatike

4. Kush ia jep reziljencën dhëmbit natyror :

- A) Periodonti
- B) Rrënja e dhëmbit
- C) Cementi i rrënjës
- D) Gingiva marginale

5. Kush ia jep reziljencën artikulationit T.M:

- A) Koka artikulare
- B) Disku dhe ligamentet
- C) Fosa artikulare
- D) Muskujt Masetar dhe Temporal

6. Kush e vë në lëvizje mukozën aktive të lëvizshme:

- A) muskujt që ndodhen në brendësi të zonës
- B) mukoza e palëvizshme
- C) submukoza
- D) mukoza pasive e lëvizshme

7. Çfarë hapësire të mukozës pasive të lëvizshme kap pllaka e protezës parciale:

- A) 0.0-0.2 mm
- B) 1-1.5 mm
- C) 0.4-1 mm
- D) 3-4 mm

8. Në çfarë zone të nofullave janë të vendosura gjendrat parotis:

- A) Në kockën temporale
- B) Në pjesën e brendshme të mandibulës
- C) Në zonën mentale të mandibulës
- D) Në krahët e mandibulës

9. Përse xhelatina hidhet në mufël në temperaturën 42 gradë C:

- A) Për të mos u lidhur me allçinë e modelit
- B) Për të mos shkrirë dyllin mbi model
- C) Për të mos krijuar flluska
- D) Për të mos avulluar

10. Në çfarë zone të cavum oris janë të vendosur gjendratsublinguale:

- A) Në zonën e këndit të mandibulës
- B) Afër frenulum lingue
- C) Mbi këndin e mandibulës

D)Në trupin e mandibulës

11. Çfarë forme ka muskuli temporal:

- A)Formë trekëndëshi
- B)Formë katërkëndëshi
- C)Formë rrethi
- D)Formë freskore

12. Çfarë funksioni kryesor kanë muskujt pterigoid të jashtëm:

- A)Në lëvizje anësore
- B)Në hapjen e gojës
- C)Në mbylljen e gojës
- D)Në lëvizjet e buzëve

13. Në çfarë zone të nofullave ndodhen plikat bukale:

- A)Në nivelin e paradhëmballëve
- B)Në nivelin e dhëmbëve ballorë
- C)Në nivelin e molarit të dytë
- D)Në nivelin e molarit të tretë

14. Në çfarë niveli ndodhet frenulum labi superior:

- A)Në nivelin e dhëmbit kanin
- B)Në nivelin ndërmjet paradhëmballëve
- C)Në nivelin ndërmjet dy centralëve
- D)Në nivelin e molarit të parë

15. Çfarë ndodh kur hiqen dhëmbë në mosha të reja dhe është koha e ndërrimit të dhëmbëve:

- A)Kemi rritje të dhëmbëve dhe proceseve alveolare
- B)Nuk ndodhin ndryshime kockore
- C)Nuk ndodhin ndryshime në vendosjen e dhëmbit
- D)Kemi mbyllje të thellë

16. Çfarë protezash kanë ngarkesë dentare:

- A)Protezat e plota me plastmasë
- B)Protezat fikse, korona, ura
- C)Protezat e skeletuara me kroshe-atashmente-teleskopike
- D)Protezat subtotale

17. Çfarë protezash kanë ngarkesë të përzier (gjysmë fiziologjike):

- A)Protezat parciale
- B)Protezat e plota me plastmasë
- C)Protezat fikse
- D)Epitezat

18. Sa çifte muskujsh marrin pjesë në mbylljen e gojës:

- A)Një
- B)Tre
- C>Dy
- D)Katër

19. Sa çifte muskujsh marrin pjesë në hapjen e gojës:
A) Një
B) Dy
C) Katër
D) Tre
20. Në cilën zonë të palatum durum nuk ka submukozë:
A) Në rrafsh palatine
B) Në zonën përreth kurorave të dhëmbëve
C) Në vijën mediane
D) Në zonën e linjës AH
21. Sa çifte gjëndrash salivare derdhin pështymën në kavitetin oral:
A) 1 çift
B) 2 çifte
C) 5 çifte
D) 3 çifte
22. Çfarë force kontraktuese ka muskuli temporal:
A) 50 kg
B) 80 kg
C) 25 kg
D) 10 kg
23. Sa është forca kontraktuese në kg e gjithë muskujve që mbyllin gojën:
A) 150 kg
B) 200 kg
C) 600 kg
D) 390 kg
24. Sa është forca e nevojshme në kg që përdoret për përthypjen e ushqimeve:
A) 20-30 kg
B) 30-50 kg
C) 100-130 kg
D) 50-80 kg
25. Sa është reziljenca normale e mukozës së palëvizshme protetike:
A) 0.1-0.2 mm
B) 0.2-0.3 mm
C) 0.11-0.15 mm
D) 0.4-0.9 mm
26. Sa është reziljenca maksimale e mukozës së palëvizshme sipas autorit Schmidt:
A) 2.5 mm
B) 4.8 mm
C) 4 mm
D) 3.5 mm
27. Deri në çfarë niveli të kurorës së dhëmbit natyror shkon abrazioni:

- A) Dentina
- B) Zmalti
- C) Pulpa
- D) Dentina sekondare

28. Sa muskuj marrin pjesë për formimin e një tingulli:

- A) 5 muskuj
- B) 20 muskuj
- C) 70 muskuj
- D) 50 muskuj

29. Në çfarë lloj mbylljeje dhëmbore kemi zhvendosje para të dhëmbëve ballorë të dy nofullave:

- A) Eugnat
- B) Biprognatik
- C) Ortognat
- D) Epistognatik

30. Në çfarë lloj mbylljeje, dhëmbët ballorë nuk takojnë ndërmjet tyre:

- A) Mbyllje e thellë
- B) Prognatike
- C) E hapur
- D) Progenike

31. Në çfarë lloj mbylljeje dhëmbore, nofulla e sipërme është e dalë para dhe nuk takojnë me dhëmbët ballorë të nofullës së poshtme:

- A) Progeni
- B) Prognati
- C) Biprognati
- D) Epistognati

32. Sa është sasia e pështymës që prodhojnë gjëndrat në 24 orë:

- A) 300 ml
- B) 2000-3000 ml
- C) 500-1500 ml
- D) 4000 ml

33. Sa është PH normal i pështymës:

- A) 6.8-7.2
- B) 5.2-5.8
- C) 4.5-6
- D) 7.7-10

34. Sa është PH acid i pështymës:

- A) 3.2-4
- B) 5.5
- C) 4.5-5
- D) 6.3

35. Sa është këndi i Benetit (mesatarja):

- A) 17 gradë
- B) 15 gradë
- C) 10 gradë
- D) 22 gradë

36. Sa është këndi Godik (mesatarja):

- A) 120 gradë
- B) 95 gradë
- C) 110 gradë
- D) 80 gradë

37. Në sa forma gjendet Torusi palatinal:

- A) Pesë forma
- B) Katër forma
- C) Dy forma
- D) Shtatë forma

38. Në çfarë lloj mbyllje dhëmbët ballorë të dy nofullave bëjnë takim majë më majë :

- A) Në mbyllje ortognatike
- B) Në mbyllje biprognatike
- C) Në mbyllje epistognatike
- D) Në mbyllje eugnatike

39. Në cilën zonë të palatumit ndodhen rrudhat palatinale (Raffepalatine):

- A) Në pjesën e prapme afër linjës -AH-
- B) Në vijën mediane të palatumit
- C) Në zonën e Posdamit
- D) Në pjesën e përparme të palatumit

40. Cili çift i gjendrave salivare e derdh pështymën në nivelin e molarit të parë sipër:

- A) Gjendrat submandibulare
- B) Gjendrat sublinguale
- C) Gjendrat limfatike
- D) Gjendrat Parotis

41. Cilat gjendra salivare derdhen pështymën nëpërmjet kanalit të Wartonit:

- A) Gjendrat Parotis dhe submandibulare
- B) Gjendrat submandibulare dhe sublinguale
- C) Gjendrat Parotis dhe sublinguale
- D) Gjendrat Limfatike

42. Çfarë force kontraktuese kanë dy muskujt Maseter së bashku:

- A) 100 kg
- B) 150 kg
- C) 130 kg
- D) 110 kg

43. Çfarë sipërfaqe ka muskuli pterigoid i brendshëm:

- A) 4.9 cm katror
- B) 3.8 cm katror

- C) 3 cm katror
- D) 6.7 cm katror

44. Çfarë force kontraktuese kanë dy muskujt pterigoid të brendshëm së bashku:

- A) 80 kg
- B) 70 kg
- C) 50 kg
- D) 100 kg

45. Çfarë force kontraktuese kanë dy muskujt Temporal së bashku:

- A) 100 kg
- B) 140 kg
- C) 190 kg
- D) 160 kg

46. Cili nga muskujt që ulin nofullën e poshtme përbëhet nga dy pjesë:

- A) Muskuli milolohyoid
- B) Muskuli genohyoid
- C) Muskuli Temporal
- D) Muskuli digastrik

47. Në çfarë mbyllje dhëmbore ka vështirësi në lëvizjet anësore:

- A) Në mbylljen Eugnat
- B) Në mbylljen Epistognatik
- C) Në mbylljen Biprognatik
- D) Në mbylljen ortognat

48. Cila pjesë përbërëse e protezës parciale realizon qëndrimin e saj në gojë:

- A) Pllaka e protezës
- B) Dhëmbët artificialë
- C) Elementët lidhës (kroshtetë)
- D) Adezioni

49. Çfarë veprimi duhet të ketë krosheja mbi dhëmbët ku mbështetet:

- A) Aktive gjatë gjithë kohës
- B) Aktive në funksion dhe pasive në qetësi
- C) Passive gjatë gjithë kohës
- D) Pa efekt veprues mbi dhëmbë

50. Cila pjesë e elementëve fiksues të protezës parciale të skeletuar kontrollon më tepër forcat vertikale:

- A) Lidhësi sekondar
- B) Krahu okuzal i krosheve
- C) Krahu stabilizues i krosheve
- D) Dhëmbët artificial

51. Përcaktimi i ngjyrës së dhëmbëve artificial në protezat parciale kryhet:

- A) Nga laboranti dentar
- B) Nga pacienti
- C) Nga mjeku stomatolog

D)Nuk është e nevojshme të përcaktohet

52. Planifikimi i elementëve retentive në protezat e skeletuara bëhet:

- A)Nga laboranti dentar
- B)Nuk është e nevojshme
- C)Nga mjeku specialist
- D)Nga numri i dhëmbëve që mungojnë

53. Në çfarë klase të Kennedit përdoret krosheja Xhekson:

- A)Në klasin e parë
- B)Në klasin e katërt
- C)Në klasin e tretë
- D)Në klasin e dytë

54. Sa kuadrate të sipërfaqes vestibulare së kurorës së dhëmbëve në paradhëmballë përshkon krahu retentiv i kroshejës:

- A)Tre kuadrate
- B)Dy kuadrate
- C)Një kuadrat
- D)Katër kuadrate

55. Sa kuadrate të sipërfaqes vestibulare së kurorës së dhëmbëve molar përshkon krahu retentiv i kroshejës:

- A)Një kuadrat
- B)Katër kuadrate
- C)Tre kuadrate
- D)Dy kuadrate

56. Nga sa pjesë përbëhet krosheja e telit me një krahë:

- A)Nga tre pjesë
- B)Nga dy pjesë
- C)Nga një pjesë
- D)Nga pesë pjesë

57. Në çfarë lloj muflimi të protezës parciale nuk kemi rritje të lartësisë së protezës pas polimerizimit të plastmasës me zierje:

- A)Në muflim indirekt
- B)Në muflim direkt
- C)Në muflimin e kombinuar
- D)Në muflime që lihen të lirë dhëmbët artificial

58. Kur përfundon polimerizimi i plastmasës, pas sa orësh hapet mufla:

- A)Pas 2 orësh
- B)Pas 24 orësh
- C)Pas 20 orësh
- D)Pas 8 orësh

59. Për lustrimin e protezës me plastmasë çfarë materiali përdoret:

- A)Allçi
- B)Sapun

- C) Rërë silici
- D) Pomice

60. Cila nga protezat parciales ka pllakë bazale të reduktuar:

- A) Proteza parciales me pllakë plastmasi
- B) Proteza parciales imediate me plastmas
- C) Proteza parciales e skeletuar
- D) Proteza parciales axhuste me plastmas

61. Cila nga protezat parciales vlerësohet si protezë parciales fundosëse:

- A) Proteza parciales e skeletuar
- B) Proteza parciales e skeletuar me koronë teleskopike
- C) Proteza parciales e skeletuar me atashmente
- D) Proteza parciales me plastmas

62. Pllaka palatinale e protezës së skeletuar duhet të jetë:

- A) Fleksibël
- B) Reziljente
- C) Elastike
- D) Rigide

63. Në çfarë lloj mbyllje tuberkulat e dhëmbëve anësor të nofullës së sipërme futen në fisurën qendrore të sipërfaqeve përtypëse të dhëmbëve të nofullës së poshtme:

- A) Në mbyllje të thellë
- B) Në mbyllje të hapur
- C) Në mbyllje të kryqëzuar
- D) Në mbyllje prognatike

64. Në çfarë lloj mbyllje dhëmbët ballorë të nofullës së poshtme mbulojnë dhëmbët ballorë të nofullës së sipërme:

- A) Në mbyllje prognatike
- B) Në mbyllje ortognatike
- C) Në mbyllje Biprognatike
- D) Në mbyllje progenike

65. Në cilën klasë të Kennedit kemi defekt të njëanshëm apo të dyanshëm të kufizuar:

- A) Klasa e tretë e Kennedit
- B) Klasa e dytë e Kennedit
- C) Klasa e parë e Kennedit
- D) Klasa e katërt e Kennedit

66. Në cilën shkallë lëvizshmërie dhëmbi natyrorë ka dhe lëvizje mezio-distale:

- A) Shkalla e tretë
- B) Shkalla e dytë
- C) Shkalla e parë
- D) Shkalla e katërt

67. Në cilën shkallë lëvizshmërie dhëmbi natyrorë ka lëvizje vestibulo-palatinale:

- A) Shkalla e dytë
- B) Shkalla e parë

- C) Shkalla e tretë
- D) Shkalla e katërt

68. Në cilën fazë të përgatitjes speciale përgatiten vendet për krahët mbështetës të krosheve:

- A) Përgatitja terapeutike
- B) Përgatitja Ortopedike (protetike)
- C) Përgatitja Ortodontike
- D) Përgatitje kirurgjikale

69. Në cilën sistem retentive të protezës parciale, lidhja e protezës parciale me dhëmbin bëhet nëpërmjet matricës dhe patricës:

- A) Sistemi retentive sipas Akersit
- B) Sistemi i Atashmenteve
- C) Sistemi Ney i retensionit
- D) Sistemi i koronave teleskopike

70. Çfarë shpërndarje të forcave përtypëse bëjnë koronat teleskopike:

- A) Horizontale
- B) Rrotulluese
- C) Aksiale
- D) Diagonale

71. Kur mund të realizohet riparimi i protezës parciale me pllakë në klinikë:

- A) Kur kemi thyerje në mes të pllakës së protezës
- B) Kur kemi për të zëvendësuar një dhëmb proteze të frakturuar
- C) Kur kemi dëmtim të krosheve
- D) Kur kemi humbje të një pjese të pllakës së protezës

72. Në çfarë moshe buza prerëse e dhëmbëzuar e dhëmbëve prerës në fëmijë lëmohe:

- A) 6-8 vjeç
- B) 10-12 vjeç
- C) 8-10 vjeç
- D) 14-15 vjeç

73. Në cilën shkallë të abrazionit kemi abradim të dentinës:

- A) Shkalla e dytë
- B) Shkalla e parë
- C) Shkalla e tretë
- D) Shkalla e katërt

74. Në cilën shtresë të mukozës kemi ind lidhor me fije elastike, enë gjaku, nerva, enë limfatike si dhe gjendra dhjamore:

- A) Shtresa e parë e mukozës
- B) Shtresa e submukozës
- C) Shtresa e mukozës së vërtetë
- D) Shtresa e mukozës së lëvizshme

75. Cila nga shtresat e mukozës është vazhdimisht në ripërtëritje:

- A) Shtresa e lëvizshme aktive
- B) Shtresa e mukozës së vërtetë
- C) Shtresa e submukozës
- D) Shtresa e parë sipërfaqësore

76. Si është vlerësuar reziljenca e mukozës nga autorë të ndryshëm në nofullën e sipërme:

- A) 0.6-1.6 mm
- B) 0.0-0.5 mm
- C) 0.9-2.7 mm
- D) 1.2-3.7 mm

77. Si është vlerësuar reziljenca e mukozës nga autorë të ndryshëm në nofullën e poshtme:

- A) 0.0-0.2 mm
- B) 0.8-1 mm
- C) 0.3-0.6 mm
- D) 1.1-1.6 mm

78. Në cilën zonë të mukozës së lëvizshme shtrihet pllaka e protezës dhe ndikon në rritjen e qëndrueshmërisë së saj:

- A) Në mukozën aktive të lëvizshme
- B) Në zonën e gjendrave
- C) Në zonën e submukozës
- D) Në mukozën pasive të lëvizshme

79. Në çfarë zone të nofullës së sipërme gjendet tuberi maksilar:

- A) Në zonën e molarëve
- B) Në zonën e kaninëve
- C) Në zonën e paradhëmballëve
- D) Në zonën e dhëmbëve ballor

80. Kur përfshihet nga pllaka e protezës tuberkuli alveolar mandibule:

- A) Kur është i lëvizshëm
- B) Kur është i fiksuar (nuk lëviz)
- C) Kur është i butë
- D) Kur është hipertrofikë

81. Dhëmbët në arkadë qëndrojnë në bazë të një ekuilibri të ballancuar forcash :

- A) Në bazë të dy forcave
- B) Në bazë të katër forcave
- C) Në bazë të tre forcave
- D) Në bazë të gjashtë forcash

82. Në sistem dhëmbor me mangësi, kur kemi grupe funksionale :

- A) Kur në njërin nofull kemi 3-4 dhëmbë rradhazi
- B) Kur në njërin nofull kemi defekt në zonën ballore
- C) Kur dhëmbët e njëres nofull nuk kanë antagonist

D) Kur në dy nofullat kemi grupe dhëmbësh që okludojnë

83. Çfarë ndodh në dhëmbët ballorë kur ato janë grupe funksionale dhe përdoren për përtyrje:

- A) Ruhet gjendja e tyre fillestare
- B) Abradohen
- C) Ruhet forma e dhëmbëve
- D) Ndryshojnë ngjyrë

84. Çfarë mungesa dhëmbore përfshihen në klasin e parë të Wildit:

- A) Defekte të njëanëshme të pakufizuar
- B) Defekte të vogla deri në tre dhëmbë
- C) Defekte të dyanëshme të pakufizuar
- D) Defekte të mëdha deri në 8 dhëmbë

85. Çfarë mungesa dhëmbore kemi në klasin e katërt sipas Wildit :

- A) Mungesa deri në 5 dhëmbë
- B) Mungesë të plotë të sistemit dentar
- C) Mungesa deri në 10 dhëmbë
- D) Mungesa deri në 8 dhëmbë

86. Në cilën shkallë të lëvizshmërisë së dhëmbit kemi lëvizshmëri fiziologjike:

- A) Shkalla e tretë
- B) Shkalla e dytë
- C) Shkalla e parë
- D) Shkalla e katërt

87. Si vlerësohet krahu i krosesë që vendoset në anën vestibulare të dhëmbit:

- A) Krahu mbështetës
- B) Krahu stabilizues
- C) Retension indirekt
- D) Krahu fiksues

88. Si vlerësohet krahu i krosesë që vendoset në anën palatinale apo lingual të dhëmbit:

- A) Krahu mbështetës
- B) Krahu fiksues
- C) Krahu stabilizues
- D) Krahu retentive

89. Cili nga elementët e protezës nuk e lejon protezën të fundoset:

- A) Krahu mbështetës i krosesë
- B) Krahu fiksues i krosesë
- C) Krahu stabilizues i krosesë
- D) Pllaka e protezës

90. Çfarë këndi duhet të ketë lidhësi sekondar me krahun mbështetës të krosesë:

- A) Këndi 50 gradë
- B) Këndi 70 gradë
- C) Këndi 120 gradë
- D) Këndi 90 gradë

91. Në cilët dhëmbë përdoret kryesisht krosheja në formë -Y-:
- A) Në dhëmbët central
 - B) Në dhëmbë kanin të shkurtër
 - C) Në molar me kurora të larta
 - D) Në premolar e molar me kurora të shkurtra
92. Në cilën klasë të Kennedit kemi defekt të njëanshëm distal pa kufizim:
- A) Klasa e dytë
 - B) Klasa e parë
 - C) Klasa e tretë
 - D) Klasa e katërt
93. Në cilën klasë të Kennedit kemi defekt ballor:
- A) Klasa e parë
 - B) Klasa e dytë
 - C) Klasa e katërt
 - D) Klasa e tretë
94. Në cilën shkallë lëvizshmërie dhëmbi natyror ka edhe lëvizje vertikale:
- A) Klasa e katërt
 - B) Klasa e dytë
 - C) Klasa e tretë
 - D) Klasa e parë
95. Nga sa pjesë përbëhet proteza parciale me pllakë:
- A) 2 pjesë
 - B) 4 pjesë
 - C) 3 pjesë
 - D) 6 pjesë
96. Sa është numri i sistemit retentiv primar të protezës parciale:
- A) 3
 - B) 2
 - C) 5
 - D) 6
97. Kush bën pjesë në sistemin retentiv sekondar të protezës:
- A) Koronat teleskopike
 - B) Krosheja
 - C) Atashmenti
 - D) Pllaka e protezës
98. Në cilën anë të kurorës së dhëmbit vendoset krahu retentiv i kroshe:
- A) Distale
 - B) Palatinale
 - C) Meziale
 - D) Vestibulare
99. Në cilën klasë të Kennedit përdoret krosheja Xhekson:

- A) Në klasën e parë
- B) Në klasën e tretë
- C) Në klasën e dytë
- D) Në klasën e katërt

100. Në cilën klasë të Kennedit nuk është nevoja të përdoren shablone për përgatitjen e protezës parciale:

- A) Në klasën e tretë
- B) Në klasën e dytë
- C) Në klasën e parë
- D) Në klasën e katërt

101. Sa mm me të larta se dhëmbët natyrore bëhen cilindrat kafshues në protezat parciale:

- A) 8-10 mm
- B) 3-4 mm
- C) 6-7 mm
- D) 1.5-2 mm

102. Në çfarë lloj muflimi për protezë parciale me pllakë mbulohen vetëm elementet e fiksimit (kroshtetë):

- A) Në muflimin direkt
- B) Në muflimin e kombinuar
- C) Në muflimin indirekt
- D) Të gjitha të vërteta

103. Në çfarë lloj muflimi për proteze parciale me pllakë nuk mbulohen as dhëmbët artificialë as elementet e fiksimit:

- A) Në muflimin direkt
- B) Në muflimin e kombinuar
- C) Në muflimin indirekt
- D) Të gjitha të vërteta

104. Sa orë duhet për të realizuar polimerizimin e plastmasës me metodën e zierjes (proteza parciale me pllakë):

- A) 1 orë
- B) 1.5 orë
- C) 3 orë
- D) 2.5 orë

105. Riparimi me dorë të lirë në çfarë lloj dëmtimi të protezës realizohet:

- A) Në thyerje të një dhëmbi
- B) Në thyerje të pllakës së protezës
- C) Në zëvendësimin e një krosheje
- D) Në zëvendësimin e një dhëmbi të hequr

106. Ku realizohet riparimi indirekt i protezës:

- A) Në klinikë
- B) Në gojën e pacientit
- C) Në laborator

D)Të gjitha të vërteta

107. Në çfarë lloj proteze parciale, bëjmë reduktim të pllakës së protezës:

- A)Në protezë parciale me pllakë
- B)Në protezë parciale imediate
- C)Në protezë parciale të skeletuar
- D)Të gjitha të vërteta

108. Gjatë përgatitjes së protezës parciale të skeletuar, a mund të mbështetemi mbi dhëmbë me lëvizshmëri të shkallës së katërt:

- A)Mund të mbështetemi
- B)Mund të mbështetemi pas mjekimit paradontal të ketyre dhëmbëve
- C)Ndryshojmë llojin e elementeve të fiksimit
- D)Nuk mund të mbështetemi

109. A lejohet të vendosen proteza parciale me kroshe në mosha të reja që nuk i ka përfunduar dalja e plotë e dhëmbëve:

- A)Ka indikacion
- B)Vendosim atashmente
- C)Vendosim kroshe Adams
- D)Nuk ka indikacion

110. Çfarë trashësie duhet të ketë pllaka palatinale (proteza e skeletuar):

- A)0.4-0.5 mm
- B)0.75-0.80 mm
- C)0.63-0.70 mm
- D)0.80-0.90 mm

111. Sa është gjërësia e brezave palatinalë në protezat e skeletuara:

- A)3-5 mm
- B)10-12 mm
- C)6-9 mm
- D)12-14 mm

112. Kur nuk ushtrohet mbingarkesë mbi dhëmbët mbështetës në protezat e skeletuara:

- A)Kur pllaka palatinale është rigide
- B)Kur pllaka palatinale është elastike
- C)Kur pllaka palatinale është fleksibël
- D)Kur pllaka palatinale është reziljente

113. Në protezat parciale të skeletuara me breza, sa është trashësia e brezit:

- A)1mm
- B)0.7mm
- C)0.3mm
- D)2mm

114. Cili nga krahët e krosheve në protezat e skeletuara nuk i lejon protezat parciale të fundosen:

- A)Krahu vestibular
- B)Krahu palatinal

- C) Krahu okluzal
- D) Krahu lingual

115. Në çfarë sensitivitetish të dhëmbëve natyror duhet bërë ngritja e nivelit të ekuatorit për kroshe:

- A) Kur këndi i konvergencës është mbi 20 gradë
- B) Kur këndi i konvergencës është mbi 10 gradë
- C) Kur këndi i konvergencës është mbi 15 gradë
- D) Kur këndi i konvergencës është nën 10 gradë

116. Krosheja e derdhur Bonwil është modifikimi i kroshe:

- A) Kroshe tipit Ney 1
- B) Kroshe tipit G
- C) Kroshe tipit T
- D) Kroshe tipit V

117. Cili nga krosheetë e tipit Ney ka dy krahë okluzal:

- A) Tipi i parë
- B) Tipi i tretë
- C) Tipi i pestë
- D) Tipi i katërt

118. Në çfarë lloj defektesh sipas Kennedit mund të përdoret masa kompresive:

- A) Në klasën e tretë
- B) Në klasën e dytë
- C) Në klasën e parë
- D) Në klasën e katërt

119. Në vartësi të reziljencës së indeve mbështetës të protezës kur përdorim masën kompresive:

- A) Kur reziljenca shkon deri në 0.9mm
- B) Kur reziljenca shkon deri në 1.4mm
- C) Kur reziljenca shkon deri në 4mm
- D) Kur reziljenca shkon deri në 2mm

120. Si quhet aparati që përdoret për përcaktimin e ekuatorit protetik të dhëmbëve, ku do të vendosen krosheetë:

- A) Paralelometër
- B) Artikulator
- C) Okludator
- D) Vibrator

121. Si quhen instrumentat që përdoren për të përcaktuar thellësinë gingivare të kurorës së dhëmbëve:

- A) Instrumentat Ney
- B) Shufra ngjyruese
- C) Shufra cilindrike
- D) Spatula e paralelometrit

122. Çfarë trashësie ka dylli i vendosur mbi procesin alveolar gjatë përgatitjes së modelit për dublim:

- A) 0.3-0.5mm
- B) 0.1-0.2mm
- C) 0.8-1mm
- D) 1.2 mm-1.5mm

123. Sa kohë duhet për t'u ftohur xhelatina pas hedhies në mufël:

- A) 10 minuta
- B) 60 minuta
- C) 40 minuta
- D) 100 minuta

124. Në çfarë aparati duhet të përzihet revestimenti për të përgatitur modelin e punës:

- A) Në Gelovit
- B) Në tas gome
- C) Në Trimer
- D) Në vakumat

125. Cilat nga kroshetë fiksuese të derdhura kanë kontakt me një sipërfaqe të vogël të dhëmbit:

- A) Kroshetë supra ekuatoriale
- B) Kroshetë tipi Ney
- C) Kroshetë subekuatoriale
- D) Kroshetë Bonwil

126. Lugët e serisë për çfarë lloje mase përdoren:

- A) Për ribazim direkt të protezës
- B) Për masë funksionale
- C) Për masë anatomike
- D) Për ribazim indirekt të protezës

127. Me çfarë aparati përcaktojmë ekuatorin protetik të dhëmbëve:

- A) Paralelometër
- B) Me mikromotor
- C) Me laps kopjativ
- D) Me turbinë

128. Para se të bëjmë dublimin në xhelatinë modelin e fusim në ujë:

- A) Në temperaturë 25 gradë C deri në 50 minuta
- B) Në temperaturë 60 gradë C deri në 20 minuta
- C) Në temperaturë 38 gradë C deri në 10 minuta
- D) Në temperaturë 90 gradë C deri në 30 minuta

129. Pas derdhjes së metalit në protezat e skeletuara si duhet të bëhet ftohja:

- A) Duke e futurë në ujë të ftohtë cilindrin e nxehtë
- B) Duke ulur temperaturën deri në 500 gradë C dhe pastaj ftohet në ujë
- C) Duke e lënë të ftohet gradualisht në temperaturën e ambjentit
- D) Duke e lënë pas derdhjes 30 minuta dhe pastaj ftohet në ujë

130. Deri në çfarë temperature metali në protezat duhet të qëndrojë në furrë për të qenë i gatshëm për derdhje:

- A) Në temperaturë 600 gradë C
- B) Në temperaturë 1000 gradë C
- C) Në temperaturë 800 gradë C
- D) Në temperaturë 1300 gradë C

131. Me çfarë materiali largohet revestimenti nga skeleti metalik:

- A) Përdoret sabloza me rërë 250 mikron në presion 4-6 bar
- B) Përdoret sabloza me rërë 170 mikron në presion 2-3 bar
- C) Përdoret sabloza me rërë 100 mikron në presion 2 bar
- D) Përdoret sabloza me rërë 400 mikron në presion 8 bare

132. Çfarë vlere ka elektroliza për skeletin:

- A) Për të eleminuar revestimentin
- B) Për të ilustruar skeletin
- C) Për të larguar oksidet nga skeleti
- D) Për të bërë elastik aliazhin

133. Në çfarë temperature realizohet elektroliza:

- A) Në temperaturën e ambjentit
- B) Në temperaturën 40-60 gradë C
- C) Në temperaturën 20-30 gradë C
- D) Në temperaturën 80-100 gradë C

134. Për të realizuar ribazimin e protezës parciale të skeletuar duhet:

- A) Të pastrohet sipërfaqja e brendshme e pllakës dhe të thahet
- B) Të pastrohet me sablozë
- C) Të gërryhet me freza laboratorike sipërfaqja e pllakës dhe kufijtë
- D) Nuk është e domosdoshme përpunimi

135. Cili nga atashmentet ka stabilitet më të mirë:

- A) Atashmenti ekstradentar jo reziljent
- B) Atashmenti intradentar
- C) Atashmenti ekstradentar reziljent
- D) Atashmenti në formë shine

136. Në çfarë vlere mesatare të reziljencës gingivare i përgjigjet atashmenti ekstradentar reziljent:

- A) Në reziljencën 0.6mm
- B) Në reziljencën 0.3mm
- C) Në reziljencën 0.9mm
- D) Në reziljencën 1.2mm

137. Si realizohet vendosja e atashmentit në dhëmbët mbështetës të protezës së skeletuar:

- A) Me anë të paralelometrit
- B) Mbi procesin alveolar
- C) Në dorë të lirë
- D) Në anën distal të dhëmbit

138. Çfarë vendosje duhet të kenë retensionet indirekte tek Protezat e Skeletuara në krahasim me retensionet direkte:

- A) Duhet të jenë afër protezës
- B) Duhet të jenë së bashku me retensionet direkte
- C) Duhet të vendosen në anën vestibulare të dhëmbëve
- D) Duhet të jenë larg bazës së protezës

139. Në klasin e parë të Kennedit retensionet indirekte vendosen:

- A) Në margot incizale të dhëmbëve ballorë
- B) Në sipërfaqet palatinale apo lingual të dhëmbëve
- C) Në sipërfaqet okluzale të dhëmbëve
- D) Në anët vestibulare të dhëmbëve

140. Në klasin e dytë të Kennedit retensionet indirekte vendoset:

- A) Në margot incizale të dhëmbëve
- B) Në sipërfaqet vestibulare të disa dhëmbëve
- C) Vendoset kroshe tek premolari i parë në anë të kundërt të defektit
- D) Në sipërfaqen palatinale apo linguale të dhëmbëve

141. Çfarë largësie duhet të kenë buzët e lugës së serisë nga nofulla për të krijuar shtresën e nevojshme për materialin e masës:

- A) 0.0-1mm
- B) 6-8mm
- C) 2-3mm
- D) 9-12mm

142. Para se të përgatitet luga individuale a është e nevojshme të bëhet rregullimi i modelit:

- A) Nuk është e nevojshme
- B) Mbulohen dhëmbët në model dhe zonat retentive me dyll rozë
- C) Lyhet modeli me vaj recini
- D) Izolohet modeli me pudër talk

143. Sa duhet të jetë hapësira e nevojshme për vendosjen e barit lingual (frenulum lingue-margo gingivare):

- A) 7mm
- B) 5mm
- C) 6mm
- D) 4mm

144. Sa është shkarkimi funksional i barit lingual kur proteza ka mbështetje dentare:

- A) 0.7mm
- B) 0.3mm
- C) 0.5mm
- D) 0.2mm

145. Çfarë trashësie duhet të ketë krahu mbështetës i kroshtësë në fillim dhe në fund të tij:

- A) 2.5-3mm
- B) 1.5-2mm
- C) 3.5-4mm
- D) 4.5-6mm

146. Tipi -G- i kroshtësë në çfarë lloj defekti sipas Kennedit përdoret:

- A) Kombinim klasës së tretë dhe të katërt
- B) Klasa e tretë
- C) Klasa e katërt
- D) Klasa e parë

147. Tipi -E- i kroshe në çfarë lloj defekti sipas Kennedit përdoret:

- A) Klasa e parë
- B) Klasa e katërt
- C) Klasa e tretë
- D) Kombinim klasës së tretë dhe të katërt

148. Krosheja tipi -T- vendoset mbi ekuatorin apo poshtë ekuatorit të dhëmbit:

- A) Vendoset poshtë ekuatorit të dhëmbit
- B) Vendoset mbi ekuatorin e dhëmbit
- C) Vendoset në sipërfaqen okluzale
- D) Vendoset në anën distal të dhëmbit

149. Krosheja tipi -V- në sa kurora dhëmbësh vendoset:

- A) Vendoset në një dhëmb
- B) Është kroshe e vazhduar
- C) Vendoset në tre dhëmbë
- D) Vendoset në dy dhëmbë

150. Në cilët dhëmbë vendosen retensionet indirekte në defektet e klasit të parë të Kennedit:

- A) Në sipërfaqe vestibulare të dhëmbëve ballorë
- B) Në sipërfaqe palatinale apo linguale të dhëmbëve ballorë
- C) Në sipërfaqet përtpëse të dhëmbëve
- D) Në sipërfaqet aproksimale

151. Në cilët dhëmbë vendosen retensionet indirekte në defektet e klasit të dytë të Kennedit:

- A) Tek molarët e anës tjetër të defektit
- B) Në dhëmbin në të njëjtin drejtim me defektin
- C) Në sipërfaqet okluzale të molarëve të anës tjetër të defektit
- D) Të gjitha të vërteta

152. Cili nga instrumentat e paralelometrit përdoret për përcaktimin e ekuatorit të përbashkët protetik:

- A) Boshti i paralelometrit
- B) Spatula
- C) Instrumentat Ney
- D) Shufra cilindrike

153. Cilët nga instrumentat e paralelometrit përdoren për përcaktimin e zonës retentive të dhëmbit mbështetës:

- A) Spatula e paralelometrit
- B) Instrumentat Ney
- C) Shufra cilindrike
- D) Boshti i paralelometrit

154. Në çfarë temperature hidhet xhelatina në muflën për dublimin e modelit:

- A) Në temperaturën 90 gradë
- B) Në temperaturën 42 gradë
- C) Në temperaturën 54 gradë
- D) Në temperaturën 72 gradë

155. Modeli i revestimentit i përfutur nga dublimi me silikon, në çfarë temperature thahet:

- A) 70 gradë
- B) 100 gradë
- C) 150 gradë
- D) 50 gradë

156. Modeli i revestimentit i përfutur nga dublimi me xhelatin, në çfarë temperature thahet:

- A) 700 gradë
- B) 350 gradë
- C) 170 gradë
- D) 250 gradë

157. Në atashmentet intradentare, ku është e vendosur matrica e atashmentit:

- A) Në sipërfaqen linguale të dhëmbit
- B) Në sipërfaqen palatinale të dhëmbit
- C) Në sipërfaqen okluzale
- D) Në sipërfaqen vestibulare

158. Në cilën klasë të Kennedit mund të aplikohet atashmenti reziljent:

- A) Kombinim klasës së tretë dhe të katërt
- B) Klasa e tretë
- C) Klasa e katërt
- D) Klasa e parë

159. Atashmenti ekstradentar në formë shine minimalisht sa dhëmbë duhet të kapë:

- A) Dy
- B) Një
- C) Tre
- D) Pesë

160. Si sigurohet retensioni i protezës nëpërmjet koronave teleskopike:

- A) Nëpërmjet sigurimit të sipërfaqeve aproksimale paralele të kurorave të para
- B) Nëpërmjet cimentimit të kurorave
- C) Nëpërmjet saldimit të dy kurorave
- D) Të gjitha të vërteta

161. Cila nga kurorat teleskopike illustrohet:

- A) Sipërfaqja e brendshme e kurorave të dyta
- B) Sipërfaqja e jashtme e kurorave të para
- C) Sipërfaqja e jashtme metalike e kurorave të dyta
- D) Sipërfaqja e brendshme e kurorave të para

162. Kur cimentoohen kurorat e para teleskopike:

- A) Para përgatitjes së kurorave të dyta
- B) Kur përfundon proteza me kurora të dyta
- C) Gjatë përgatitjes së kurorave të dyta
- D) Kur provohen në gojë kurorat e dyta

163. Çfarë mbyllje patologjike kemi kur dhëmbët ballorë lart dhe poshtë nuk takojnë:

- A) Mbyllje të hapur
- B) Mbyllje progenike
- C) Mbyllje të kryqëzuar
- D) Mbyllje të thellë

164. Çfarë shkalle abrazioni të dhëmbit është kur konsumohet dentina sekondare:

- A) Shkallë e parë
- B) Shkallë e tretë
- C) Shkallë e dytë
- D) Shkallë e katërt

165. Çfarë rezeliencie normale ka mukoza e nofullës së sipërme:

- A) 0-1.1mm
- B) 0.6-1.6mm
- C) 0.4-0.5mm
- D) 0.2-0.3mm

166. Çfarë roli kanë muskujt pterigoid të jashtëm:

- A) Në hapjen e gojës
- B) Në mbylljen e gojës
- C) Në lëvizjet anësore
- D) Në lëvizjet propulsive

167. Çfarë protezash kanë ngarkesë të plotë gingivare:

- A) Proteza totale
- B) Proteza fikse
- C) Inley-Onley
- D) Proteza parciale

168. Çfarë lloj protezash parciale vlerësohen si proteza fundosëse:

- A) Protezat me pllakë
- B) Protezat e skeletuara
- C) Protezat e skeletuara me atashmente
- D) Protezat e skeletuara me korona teleskopike

169. Çfarë largësie nga gingiva marginale duhet të ketë krahu i krosesë prej teli në protezat parciale me pllakë:

- A) 0.5mm
- B) 1mm
- C) 4mm
- D) 1.5-2 mm

170. Çfarë lloj defekti për protezim pjesor nuk ka nevojë të përdorim shablone:

- A) Në defektet klasi I sipas Kennedit

- B) Në defektet klasi II sipas Kennedit
- C) Në defekte të kombinuara klasi II + klasi III sipas Kennedit
- D) Në defektet klasi III sipas Kennedit

171. Në çfarë sipërfaqe të kurorës së dhëmbit vendoset krahu stabilizues i krosheës:

- A) Në sipërfaqen vestibulare të kurorës
- B) Në sipërfaqen palatinale apo linguale
- C) Në sipërfaqet aproksimale
- D) Në sipërfaqen okluzale të dhëmbit

172. Sa është koha maksimale që duhet për të derdhur masën anatomike me alginat:

- A) 5 orë
- B) 2 orë
- C) 1 orë
- D) 10 orë

173. Çfarë vlere ka përzierja e rivestimentit në vakumat:

- A) Për të mos e përzierë me spatul
- B) Për ta përzierë shpejt që të mos forcohet
- C) Për të shtypur kokrrizat e rivestimentit
- D) Për ta bërë një masë homogjene dhe për të larguar flluskat e ajrit

174. Çfarë aliazhi përdoret sot për përgatitjen e protezave të skeletuara:

- A) Bronz
- B) Krom kobalt
- C) Aliazh alumini
- D) Nikel krom

175. Çfarë vlere ka elektroliza për skeletin:

- A) Zvogëlimin e trashësisë së skeletit
- B) Për të hequr kanalet e derdhjes
- C) Për lustrimin e skeletit
- D) Për largimin e oksideve

176. Çfarë sigurohet nëpërmjet ribazimit të protezës parciale:

- A) Normalizim okluzioni
- B) Rregullim i ngjyrës së plasmës
- C) Rregullim i sipërfaqes së jashtme të protezës
- D) Krijimi i një baze të re te protezës

177. Çfarë shkarkimi funksional ka lidhësi sekondar i skeletit:

- A) 1mm
- B) 0.4mm
- C) 0.5mm
- D) 0.2mm

178. Çfarë shkarkim funksional ka proteza me mbështetje dentare:

- A) 0.6mm
- B) 0.4mm
- C) 0.2mm

D)0.8mm

179. Çfarë shkarkim funksional ka proteza kur aksi i rrotullimit është para barit lingual:

- A)0.2mm
- B)0.6mm
- C)0.4mm
- D)0.8mm

180. Çfarë shkarkimi funksional ka proteza kur aksi i rrotullimit është pas barit lingual:

- A)0.2mm
- B)0.6mm
- C)0.4mm
- D)0.8mm

181. Çfarë vlere ka shufra me ngjyruet e paralelometrit për protezat e skeletuara:

- A)Për të caktuar thellësinë gingivare
- B)Për të shënuar ekuatorin e dhëmbit
- C)Për të vizatuar skeletin me model
- D)Për paralelizmin e dhëmbëve mbështetës

4. Protetika Fikse

1. Në bazë të kujt klasifikohet skema okluzale në modelimin me dyll:

- A) Nga kontakti i kuspideve vestibulare mbi kreshtat marginale në pozicionin e interkupidimit maksimal
- B) Nga lokalizimi i kontakteve okluzale që realizohen nga kuspidet funksionale mbi dhëmbët antagonistë në pozicionin e relacionit qëndror
- C) Nga vendosja e kupidit lingual në pozicionin mezo-distal të sipërfaqes okluzale
- D) Nga vendosja e kupidit mezo-vestibular në pozicionin e relacionit qëndror

2. Si duhet të jetë intermediari në urat fikse:

- A) Sa më i kurbuar
- B) Sa më i përkulur për estetikë
- C) Sa më i gjerë
- D) Paralel me dhëmbët e tjerë

3. Cili është funksioni i antasialogeve:

- A) Mungesa e ndryshimeve të pakthyeshme e gingivës
- B) Ndikojnë në shtimin e pështymës
- C) Ndikojnë në tharjen e hemoragjisë
- D) Ndikojnë në tharjen e pështymës

4. Cila është teknika e ekspozimit të linjës së mbylljes:

- A) Teknika e kyretazit instrumentar
- B) Teknika mekanike
- C) Teknika e preparimit të linjës së mbylljes shpatulla
- D) Teknika e preparimit të linjës së mbylljes chamfer

5. Konektori jo rigid ka për qëllim:

- A) Pozicion më posterior në vend të një pozicioni fiziologjik

- B) Rrugë drejtuese për mandibulën
- C) Konektori jo rigid është e mjaftueshme për të parandaluar transformimin e forcave nga pjesa që ngarkohet në pjesën tjetër të urës fikse
- D) Tërë forcat që shpërndahen në gjithë artikulationin

6. Kurorat metal qeramik kanë një gjerësi mesatare vestibulare linguale për kurorat e floririt:

- A) 0.71mm
- B) 0.60mm
- C) 0.30mm
- D) 0.35mm

7. Në lëvizjet laterale të përsëritura sa është deviacioni mesatar në relacionin qendror:

- A) 0.8mm
- B) 0.3mm
- C) 0.4mm
- D) 0.2mm

8. Për kurorat tërësisht qeramike përdoret:

- A) Linja në formë shpatulle me kënd 90 gradë
- B) Linja tërësisht e trashë
- C) Shpatull me bizotim
- D) Linja në formë shpatulle

9. Në rrugë kirurgjikale zgjatja e kurorës arrin:

- A) 0.3 - 1mm
- B) 2.5 mm
- C) 1.5 mm
- D) 3.0 mm

10. Sa është reduktimi okluzal për kuspidet jo funksionale për kurorat metal-porcelan:

- A) 0.5-1.0mm
- B) 2.0mm
- C) 1.5-2.0mm
- D) 1.0-1.5mm

11. Në mekanizmin e formimit të zhurmës (klikut në ATM) luan rol:

- A) Aksi sagital i lëvizjes së mandibulës
- B) Aksi horizontal i lëvizjes së mandibulës
- C) Pozicioni më posterior i kondilit në vend të një pozicioni fiziologjik
- D) Aksi vertikal i lëvizjes së mandibulës

12. Gropa e Tomasit zbatohet në pjesën:

- A) Distale të molarit të parë mandibular
- B) Meziale të molarit të dytë mandibular
- C) Meziale të premolarit të dytë mandibular
- D) Distale të premolarit të parë mandibular

13. Çfarë lloj okluzioni zbatohet gjatë modelimit me dyll sipas raportit kupid-fossë:

- A) Okluzioni majë më majë

- B) Okluzioni një dhëmb me dy dhembë antagonistë
- C) Okluzioni një dhëmb me një dhëmb
- D) Okluzion i kryqëzuar

14. Nga se kushtëzohet vendosja e linjës së mbylljes:

- A) Nga shtrirja e restaurimeve të mëparshme
- B) Të riprodhohet nga materiali i masës
- C) Të përpunohen lehtë nga dentisti
- D) Nga zgjatja e kurorës

15. Pse për kurorat tërësisht qeramike realizohet linja e mbylljes shpatull dhe jo chamfer:

- A) Siguron estetikën
- B) Paraqesin fuqi më të madhe
- C) Mënjanon kariesin
- D) Lehtësi manipulimi

16. Urat e cementuara me rezine kundërrindikohen:

- A) Dhëmb shtyllë jo të kariuar
- B) Si shina paradontale
- C) Kafshim i thellë
- D) Alergji ndaj floririt

17. Mungesa e pragjeve eliminohet me një konicitet minimal:

- A) 22 gradë
- B) 6 gradë
- C) 12 gradë
- D) 2.5 gradë

18. Kriteret e përgatitjes së ulluqeve në dhëmbë shumë të dëmtuar:

- A) Të shmangët perforimi i membranës periodontale
- B) Nuk duhet të kalojë në pulpë
- C) Nuk duhet të reduktohet asnjë mur dentine
- D) Të jenë sa më të gjata me qëllim që të përmirësohet rezistenca

19. Çfarë vlere ka inklinimi incizal protruziv:

- A) 30.4 gradë
- B) 50-70 gradë
- C) 33 gradë
- D) 60 gradë

20. Çfarë vlere ka inklinimi i rrugës kondilare:

- A) 30.4 gradë
- B) 50 - 70 gradë
- C) 33 gradë
- D) 55 gradë

21. Si paraqiten kuspidet kur mbulimi vertikal incizal është i madh:

- A) Të shkurtra
- B) Mesatare

- C) Të sheshta
- D) Të gjata

22. Si paraqiten kuspidet kur mbulimi vertikal incizal është i vogël:

- A) Të vogla
- B) Mesatare
- C) Të sheshta
- D) Të gjata

23. Si paraqiten kuspidet kur mbulimi incizal horizontal është i madh:

- A) Të mëdha
- B) Të vogla
- C) Mesatare
- D) Të sheshta

24. Si paraqiten kuspidet kur mbulimi horizontal incizal është i vogël:

- A) Të mëdha
- B) Të vogla
- C) Mesatare
- D) Të sheshta

25. Çfarë quhet lëvizje kufi:

- A) Lëvizje tridimensionale
- B) Limitet e jashtme të të gjitha lëvizjeve të realizuara nga mandibular
- C) Lëvizje protruzive
- D) Lëvizje laterale

26. Çfarë riprodhon inklinimi i rrugës kondilare:

- A) Një vije zikzake
- B) Një gjysëm rrethi
- C) Një vije të lakuar
- D) Një elips

27. Si riprodhohet inklinimi i rrugës kondilare në një artikulator:

- A) E lakuar
- B) Si një vijë e drejtë
- C) Një gjysëm rrethi
- D) Gjysëm elipsi

28. Çfarë metode përdoret për regjistrimet interokluzale:

- A) Me shabllone
- B) Me pantograf
- C) Metoda bilaterale
- D) Me harkun e fytyrës

29. Çfarë metode përdoret për regjistrimet interokluzale:

- A) Me pantograf
- B) Me shabllone
- C) Me harkun e fytyrës
- D) Metoda bilaterale

30. Çfarë metode përdoret për regjistrimet interokluzale:

- A) Me pantograf
- B) Me shabllone
- C) Pa guidë
- D) Me harkun e fytyrës

31. Në çfarë këndi rregullohet guida kondilare gjatë montimit të modelit maksilar:

- A) 50-70 gradë
- B) Në 30 gradë
- C) 45 gradë
- D) 30.4 gradë

32. Çfarë kontrollojmë gjatë montimit mandibular:

- A) Nëse vija mediane është në mes të modelit
- B) Nëse modeli përshatet me artikulatorin
- C) Nëse modeli është i lagur mirë
- D) Nëse elementët kondilarë të secilës janë në muret posteriore dhe superior të guidës kondilare

33. Çfarë sigurojnë kurorat e plota:

- A) Ruajtje të strukturës dentare
- B) Retension
- C) Konsiderata financiare
- D) Një restaurim jo të mirë

34. Amalgami kompleks çfarë lloj restaurimi është:

- A) Ekstrakoronal
- B) Intrakoronal
- C) Radikular
- D) Koronal

35. Çfarë lloj restaurimi është Glasionomeret:

- A) Koronal
- B) Intrakoronal
- C) Radikular
- D) Extrakoronal

36. Çfarë lloj restaurimi janë inlayet:

- A) Extrakoronal
- B) Radikular
- C) Koronal
- D) Intrakoronal

37. Çfarë lloj restaurimi është kurora tërësisht qeramike:

- A) Intrakoronale
- B) Koronale
- C) Radikulare
- D) Extrakoronale

38. Çfarë lloj restaurimi është Faseta Vener:

- A) Intrakoronale
- B) Extrakoronale
- C) Radikulare
- D) Koronale

39. Çfarë restaurimi është kurora Metal-Qeramikë:

- A) Intrakoronale
- B) Koronale
- C) Extrakoronale
- D) Radikulare

40. Çfarë është e rëndësishme në vlerësimin e një dhëmbi:

- A) Ngjyra e dhëmbit
- B) Raporti i dhëmbit me punimin protetik
- C) Raporti i dhëmbit me okluzionin
- D) Konfiguracioni i rrënjës

41. Çfarë është e rëndësishme në vlerësimin e një dhëmbi:

- A) Shtirirja e ligamentit periodontal
- B) Raporti i dhëmbit me kurorën artificiale
- C) Raporti i rrënjës me okluzionin
- D) Ngjyra e dhëmbit

42. Çfarë forcash të dëmshme shkaktohen nga ngarkesat jo normale mbi dhëmbë:

- A) Levë të harkut
- B) Vertikale
- C) Rrëshqitëse
- D) Horizontale

43. Çfarë forme ka korrektori rigid:

- A) Formë ovale
- B) Formë T
- C) Formë cilindrike
- D) Formë të sheshtë

44. Çfarë forme ka korrektori që vendoset brenda ankoruesit:

- A) Formë ovale
- B) Formë të sheshtë
- C) Formë bishtdallëndyshe
- D) Formë katrore

45. Çfarë ankoruesish vendosen në molarë shtyllë të inklinuar:

- A) Kurorë teleskopike
- B) Dhëmbë me vidë
- C) Protezë parciales
- D) Kurorë xhakët

46. Çfarë vlere ka sipërfaqja e rrënjës së Molarit të parë maxilarë:

- A) 1.2

- B) 2.8
- C) 2.4
- D) 1.3

47. Çfarë vlere ka sipërfaqja e rrënjës së kaninit mandibular:

- A) 2.8
- B) 1.5
- C) 1.3
- D) 1.7

48. Çfarë vlere ka sipërfaqja e rrënjës së Molarit të parë mandibular:

- A) 2.8
- B) 2.4
- C) 1.7
- D) 1.8

49. Çfarë drejtimi ka rruga punuese dhe jo punuese:

- A) Bukal
- B) Mezial
- C) Lingual e distobukal
- D) Buko-mezial

50. Cila është përgjigja e saktë se si duhet të jetë profili i emergjencës:

- A) Konvekse
- B) Konkav
- C) I kombinuar konkav-konveks
- D) I drejtë

51. Sa është ekspansioni higroskopik i rivestimentit:

- A) 0.4%
- B) 0.8%
- C) 2.3-2.4%
- D) 1.2-2.2%

52. Stresi i cementit midis dhëmbit dhe restaurimit rritet me shpejtësi në:

- A) 20 gradë
- B) 3 gradë-5.6 gradë
- C) 10 gradë-14 gradë
- D) 2.5 gradë-6.5 gradë

53. Lëvizja mandibulare në aksin vertikal ndodh:

- A) Në planin horizontal kur mandibula lëviz lateralisht
- B) Në planin sagital kur mandibula lëviz përpara
- C) Në planin sagital kur mandibula lëviz prapa
- D) Në planin sagital kur mandibula bën lëvizje hapje-mbyllje

54. Inklinimi mezio-distal i rrugës së inserimit të kurorës artificiale duhet të jetë paralel me:

- A) Murin vestibular të dhëmbit
- B) Murin lingual të dhëmbit

- C) Pikat e kontaktit të dhëmbëve fqinjë
- D) Margon incizale të dhëmbit

55. Përcaktuesit e lëvizjes mandibulare janë:

- A) Muskujt përtypës
- B) Muskujt rezorius
- C) ATM në të dy anët
- D) Muskujt e faqes

56. Në sa plane reduktohet sipërfaqja vestibulare për kurorën metal-porcelan:

- A) Në një plan
- B) Në dy plane
- C) Në tre plane
- D) Në katër plane

57. Vendosja e modeleve në artikulatort për diagnostikim bëhet me kondilet në:

- A) Pozicionin e interkuspidimit maksimal
- B) Okluzion qendror
- C) Pozicionin e relacionit qendror
- D) Pozicionin majë më majë

58. Për krijimin e linjës së mbylljes chamfer në kurorat e plota metalike përdoret guri i diamantit:

- A) Gurë torpedo
- B) Guri me fund të sheshtë
- C) Cilindriko-konik
- D) Gurë me majë të hollë

59. Trashësia e kapuçit metalik në kurorat metal-porcelan për metalet e zakonshme është:

- A) 0.7mm
- B) 0.5-0.6mm
- C) 0.2-0.3mm
- D) 0.4mm

60. Nëpërmjet kujt elementeve porcelani fiton opacitetin:

- A) Oksid Hekurit
- B) Oksid Titaniumit
- C) Oksid Aluminit
- D) Oksid Plumbit

61. Çfarë shkakton mungesa e bizotimit të kuspitit funksional:

- A) Rritjen e estetikës
- B) Një hapësirë të mjaftueshme për materialin
- C) Rritjen e retensionit
- D) Një zonë me trashësi të vogël

62. Varësia e inklinimit të rrugës kondilare në lëvizjen protruzive me lartësinë e kuspideve:

- A) Inklinim i vogël, lartësia e kuspideve e madhe
- B) Inklinim i theksuar, lartësia e kuspideve e vogël

- C) Inklinim i theksuar, lartësia e kuspideve e madhe
- D) Inklinim i theksuar, lartësia e kuspideve mesatare

63. Sa është këndi i inklinimit inciziv protruziv:

- A) 50 gradë-70 gradë
- B) 30 gradë
- C) 38 gradë
- D) 22 gradë

64. Kërkesat për një kapuç të saktë në punimet metal-porcelan është:

- A) Formimi i oksideve të shumta
- B) Sigurimi i estetikës
- C) Aftësia e metalit për lustrim
- D) Vendi ku bashkohet metali me porcelanin duhet të ketë një kënd 90 gradë

65. Gjërësia mesatare vestibulo-linguale e kurorës metal qeramike është:

- A) 0.71mm
- B) 0.36mm
- C) 0.75mm
- D) 0.83mm

66. Modifikimi i dhëmbëve të dëmtuar shumë bëhet:

- A) Vlerësimi i fortësisë së mureve të mbetura
- B) Finalizimi i preparimit
- C) Kunjat parapulpare
- D) Preparimi i strukturës dentare të mbetur

67. Në cilin lloj punimi indikohet sistemi Ips-empres:

- A) Urat metal-porcelan
- B) Urat e merylandit
- C) Urat krejt metal
- D) Onlay

68. Çfarë vlere ka sipërfaqja e rrënjës së premolarit të parë maxilar:

- A) 1.2
- B) 1.3
- C) 1.5
- D) 1.1

69. Çfarë vlere ka translacioni lateral progresiv:

- A) 1.5mm
- B) 2.6mm
- C) 2.0mm
- D) 0.4mm

70. Çfarë shënje karakteristike përcakton disfunkcionin e ATM:

- A) Prishja e planit të okluzionit
- B) Dukuria e godon popovit
- C) Gojë e vogël
- D) Vështirësi në hapjen e gojës

71. Çfarë vlerësohet nëpërmjet modeleve diagnostikuese:

- A) Lëvizshmëria e dhëmbit
- B) Stabiliteti i dhëmbit në alveolë
- C) Diskrepancat okluzale
- D) Raporti kurorë-rrënjë

72. Në sa akse lëviz mandibula:

- A) Në dy akse
- B) Në tre akse
- C) Në aksin transversal sagital
- D) Në katër akse

73. Cilët janë përcaktuesit e lëvizjes mandibulare:

- A) Muskujt përtypës
- B) Muskujt e qafës
- C) Muskujt rezorius
- D) Dhëmbët

74. Çfarë lloj interferencash ekzistojnë:

- A) Tre lloj
- B) Dy lloj
- C) Katër lloj
- D) Pesë lloj

75. Çfarë është interference jo punuese:

- A) Kur dhëmbët janë në pozicion protruziv
- B) Është një kontakt i dhëmbëve kur kondilet janë në fossë
- C) Është një kontakt okluzal midis dhëmbëve maksilarë dhe mandibularë në anën e kundërt të lëvizjes laterale të mandibulës
- D) Kur dhëmbët janë në pozicionin e kontaktit maksimal

76. Çfarë e karakterizon një okluzion optimal:

- A) Dhëmbët janë në pozicion protruziv
- B) Dhëmbët janë në pozicion lateral
- C) Dhëmbët janë në pozicion retruziv
- D) Forcat okluzale janë sipas aksit të madh të dhëmbëve

77. Okluzioni i Balancuar Bilateral përdoret:

- A) Në përgatitjen e urave fikse
- B) Në përgatitjen e dhëmbit me vidë
- C) Në përgatitjen e koronës xhaket
- D) Në përgatitjen e protezës totale

78. Çfarë ndodh me dhëmbët posterior në qëndrimin vertikal:

- A) Nuk kontaktojnë
- B) Kontaktojnë pjesërisht
- C) Kontaktojnë më fortë se sa anteriorët
- D) Kontaktojnë lateralisht

79. Sa është deviacioni mesatar në relacionin qëndror në lëvizjet laterale të mandibulës:
A) 0.7mm
B) 0.3mm
C) 0.2mm
D) 0.8mm
80. Çfarë përmasa ka deviacionin mesatar në anën punuese në lëvizjet laterale të mandibulës:
A) 0.3mm
B) 0.2mm
C) 0.7mm
D) 0.8mm
81. Çfarë përmasa ka deviacioni mesatar në anën jo punuese në lëvizjet laterale të mandibulës:
A) 0.8mm
B) 0.3mm
C) 0.2mm
D) 0.7mm
82. Çfarë hapësire krijohet nga matjet e disokluzioneve nga majat e kuspitit meziobukal të molarit të parë mandibular në lëvizjet jo punuese:
A) 0.7mm
B) 0.5mm
C) 1.0mm
D) 1.1mm
83. Çfarë hapësire krijohet nga matjet e disokluzioneve nga majat e kuspitit meziobukale të molarit të parë mandibular në lëvizjet protruzive:
A) 0.5mm
B) 1.0 mm
C) 0.8mm
D) 1.1mm
84. Si paraqiten kuspidet kur translacioni lateral është i madh:
A) Të shkurtra
B) Mesatare
C) Të larta
D) Të sheshta
85. Si paraqiten kuspidet kur translacioni lateral është i vogël:
A) Të shkurtra
B) Të sheshta
C) Të larta
D) Mesatare
86. Në modelimin me dyll të koronës full metal, sa janë përmasat e kuspitit lingual të premolarit të parë në krahasim me kuspidin vestibular të premolarit të dytë mandibular:
A) 3.3mm
B) 2.6mm

- C) 2.8mm
- D) 2.0mm

87. Me çfarë lloj punimi zëvendësohet defekti kur mungojnë nga 5 dhëmbë:

- A) Me protezë parçiale
- B) Me urë me korona xhaket
- C) Me protezë totale
- D) Me urë me metal+porcelan

88. Si duhet të pozicionohet linja e mbylljes:

- A) Linja e mbylljes duhet të vendoset në dentinë
- B) Linja e mbylljes duhet të vendoset në zmalt
- C) Linja e mbylljes duhet të vendoset në cement
- D) Linja e mbylljes duhet të vendoset në gingivë

89. Si duhet të pozicionohet linja e mbylljes:

- A) Të sigurohet okluzioni
- B) Të sigurohet estetika
- C) Të pozicionohet në mënyrë të tillë që të përpunohet nga dentisti
- D) Të sigurohet kontakti me dhëmbët fqinjë

90. Nga çfarë kushtëzohet vendosja e linjës së mbylljes:

- A) Nga gjatësia e rrënjës
- B) Nga shtrirja e restaurimeve të mëparshme
- C) Nga gjerësia e qafës së dhëmbit
- D) Nga gjerësia e rrënjës

91. Çfarë gurë diamante përdoret për preparimin e kurorës së plotë metalike:

- A) Gurë diamante me fund të sheshtë
- B) Cilindriko-konik me fund të sheshtë
- C) Cilindriko-konik me fund të rrumbullakët
- D) Frezë Nr.170 L

92. Çfarë përmase ka gutaperka që mbetet pas vendosjes së dhëmbit me vidë:

- A) 2.0mm
- B) 1.5mm
- C) 4.0mm
- D) 7mm

93. Çfarë vlere ka sipërfaqja e Atakut të rrënjës meziale të Molarit të parë mandibular:

- A) 37%
- B) 32%
- C) 24%
- D) 31%

94. Vlora mesatare e translacionit lateral të menjëhershëm është:

- A) 2.6mm
- B) 1.5mm
- C) 2.0mm
- D) 0.4mm

95. Faktori që vlerëson dhëmbin është raporti:

- A) I kurorës me procesin karioz
- B) I rrënjës me alveolën
- C) I kurorës me buzën
- D) Kurorë-rrënjë

96. Shkaku pse dhëmbët anteriorë janë të përshtatshëm për drejtimin e mandibulës:

- A) Pragu proprioceptiv dhe reflektet shoqëruese zvogëlojnë forcat
- B) Dhëmbët anteriorë kanë kurorë të madhe
- C) Dhëmbët anteriorë sigurojnë estetikë
- D) Dhëmbët anteriorë kariohen më pak

97. Kunjat parapulpare përdoren në:

- A) Pesë mënyra
- B) Katër mënyra
- C) Tre mënyra
- D) Dy mënyra

98. Nga se varet zgjedhja e aliazhit për një kurorë të plotë metalike:

- A) Përkulshmëria e tij
- B) Zvogëlimi i oksideve
- C) Kuspidet mezio-disto-bukale
- D) Derdhshmëria

99. Kush nga kuspidet e molarëve të poshtëm do të jenë më të shkurtër:

- A) Kuspidet linguale
- B) Kuspidi disto-bukal
- C) Kuspidet bukale
- D) Kuspidet mezio-disto-bukale

100. Grada optimale për konicitetin e preparimit të molarit të dytë maksilar është :

- A) 14 gradë
- B) 28 gradë
- C) 24 gradë
- D) 21 gradë

101. Çfarë bën përqëndrimi i madh i Aluminit në porcelan:

- A) Formohen kristale që parandalojnë frakturat
- B) Formohen kristale që janë rregulluese
- C) Formohen kristale që sigurojnë estetikën
- D) Formohen kristale që parandalojnë ngjitjen

102. Gjatë preparimit të një dhëmbi për kurora metal-porcelan, si duhet të jenë dy muret e kundërta të jashtme:

- A) Duhet të divergojnë
- B) Duhet të konvergojnë
- C) Duhet të jenë paralele
- D) Duhet të jenë të shpërndara

103. Kërkesa më e rëndësishme për kurorat provizore është:

- A) Mbrojtja e pulpës
- B) Përdorimi i plastmasës bis-gma
- C) Përgatitja e lehtë
- D) Përgatitja direkt në zgavrën e gojës

104. Përdorimi i Aliazheve të Arit të tipit të parë është për:

- A) Urat fiske
- B) Inley të vogla
- C) Shinat në paradontologji
- D) Protezat parciale të skeletuara

105. Linja e mbylljes për kurorën metal porcelan për dhëmbët distalë është:

- A) Shpatull
- B) chamfer
- C) Teh thike
- D) Shpatull e rrumbullakosur

106. Trashësia e porcelanit në kurorat metal porcelan është:

- A) 2-2.7mm
- B) 1.0-1.5mm
- C) 1.5-2mm
- D) 0.7-1mm

107. Faseta Vener përdoret në dhëmbët:

- A) Me pozicion të theksuar vestibular
- B) E dekoloruar
- C) Me pozicion të theksuar lingual
- D) Me rrotacion të theksuar

108. Kurora metalike përdoret:

- A) Për mjekimin protetik të paradontozës
- B) Për sigurimin e estetikës
- C) Për mjekimin e mikrodoncisë
- D) Në dhëmbët me hipoplazi

109. Ulluku horizontal në kurorat 3/4 anteriore bëhet:

- A) Në mesin e faqes linguale
- B) Në 1/3 cervikale të faqes linguale
- C) Paralel me faqet proksimale
- D) Direkt nën margon incizale të faqes linguale

110. Ana negative e intermedierit higjienik:

- A) Nuk siguron estetikën
- B) Nuk takon gingivën
- C) Nuk dëmtohen indet e buta
- D) Lehtësi për pastrimin e ushqimit

111. Kur metali është i gatshëm të derdhet në cilindrin e skuqur:

- A) Kur metali i shkrirë është me ngjyrë tekuqe
- B) Kur metali ka ngjyrë të bardhë pa shkëlqim
- C) Kur metali ka ngjyrë portokalli
- D) Kur metali i shkrirë ka ngjyrë të bardhë si pasqyrë

112. Kush janë kufijtë vestibularë më të përdorshëm në kurorën metal-porcelan:

- A) Vilar metalik
- B) Porcelan që mbulon vilarin
- C) Kufiri metal-porcelan
- D) Kufi krejt porcelani

5.Ortodonci

1. Cili është funksioni i harkut vestibular në aparatën e levizshëm ortodontik:

- A) Retrudon dhëmbët frontalë
- B) Intrudon dhe lingualizon dhëmbët frontalë
- C) Intrudon dhëmbët frontalë
- D) Ekstrudon dhëmbët frontalë

2. Kush është forca optimale për lëvizjen intruduese dentare:

- A) 0,05-0,1 N
- B) 5-10 N
- C) 0,5-1.0 N
- D) 0,2-0,4 N

3. Sindromi Treacher-Collins është rezultat i:

- A) Traumës postnatale
- B) Defekt i migrimit të qelizave të kreshtës neurale
- C) Të dyja së bashku
- D) Traumës gjatë lindjes

4. Egocentrizmi është veti psikologjike e fëmijëve të moshës:

- A) 2-5 vjeç
- B) 0-2 vjeç
- C) 5-7 vjeç
- D) Të gjitha të vërteta

5. Si një dentist i përgjithshëm, cili pacient kërkon trajtim të menjëhershëm:

- A) 8 vjeçar me devijim të vijës mediane vetëm në pozicionin e okluzionit qëndror
- B) 8 vjeçar me kafshim të thellë
- C) 8 vjeçar me malokluzion të klasës II/2
- D) 8 vjeçar me malokluzion të klasës I-re me grumbullime serioze

6. Në një kafshim të kryqëzuar: molari i parë i sipërm është i zhvendosur palatinal, molari i parë mandibular është lingual. Si do ta korrigjoni këtë gjendje:

- A) Përdoret një plan i inklinuar
- B) Përdoret një aparat me vidë sagitale
- C) Përdoret një headgear
- D) Përdoret një elastik i kafshimit të kryqëzuar mes dy molarëve

7. Në humbjen e hershme spontane të kaninëve të qumështit:

- A) Rezultat i kariesit të pa mjekuar
- B) Ndodh në sensitivitetin e mungesës kongjenitale të 33,43
- C) Një simptomë e grumbullimit të dhëmbëve permanentë
- D) Një indikacion për vendosjen e ruajtësit të vendit

8. Cefalometria jep të dhëna:

- A) Funksionale
- B) Vertikale dhe transversale
- C) Sagitale dhe vertikale
- D) Sagitale dhe transversale

9. Cili model heqjeje është më i përshtatshëm për një pacient me klasë të II/1:

- A) 14,24 dhe 34,44
- B) 15,25 dhe 34,44
- C) 14,24 dhe 35,45
- D) 14,24

10. Trajtimi ortodontik në moshat e rritura mund të përfshijë korrigjimin:

- A) E klasës së II-të skeletale
- B) E klasës së III-të skeletale
- C) E klasës së II-të dentare
- D) Devijimin lateral skeletal

11. Headgear cervikal përdoret për:

- A) Korrigjimin e klasës së III-të dentare
- B) Korrigjimin e klasës së III-të skeletale
- C) Korrigjimin e komprimimit skeletal transversal
- D) Perforcues ankorimi

12. Në pamjen cefalometrike, një simfizë e gjatë dhe e shkurter është karakteristikë e subjektit me tipologji:

- A) Dolikofaciale
- B) Brakofaciale
- C) Normofaciale
- D) Mikse

13. Një kënd i vogël i inklinimit maksilar çon në:

- A) Tendencë për kafshim normal
- B) Rrit over-jet
- C) Të dyja të vërteta
- D) Buzëqeshje gingivare

14. Prezenca në ekzaminimin klinik e diastemës është shpesh rezultat i:

- A) Thithjes së gishtit
- B) Frenulumit hipertrofik superior
- C) Respiracionit oral
- D) Makroglosisë

15. Në sindromën e obstruksionit respirator, cila nga simptomat e mëposhtme është prezente:

- A) Rritja e tipit horizontal
- B) Buzët kompetente
- C) Mbulimi i rritur vertikal
- D) Rotacioni mandibular posterior

16. Humbja parakohe e dhëmbit 75 mund të shkaktojë:

- A) Grumbullime posteriore
- B) Klasë të III-të molare bilaterale
- C) Pseudo klasë të III-të molare majtas
- D) Kafshim të kryqëzuar bilateral

17. Cila nga këndet cefalometrike parashikon rritjen e dimensioneve vertikale:

- A) ANB
- B) NSGn
- C) SNA
- D) NSAr

18. Cila është një arsye për të përfshirë heqjen si pjesë e planit trajtues ortodontik:

- A) Asimetria e harkut
- B) Kafshimi i kryqëzuar
- C) Hapësirat dentare
- D) Incizivët e retruduar

19. Cila është e vërtetë për sa i përket aparateve të lëvizshme:

- A) Mund të tërheqin dhëmbet në mënyrë trupore
- B) Nuk përdoren në subjektet e rritura
- C) Mund të korrigjojnë dhëmbet me rotacion
- D) Zhvillojnë një forcë të rendë të vazhdueshme

20. Çfarë tregon këndi ANB në cefalometri?

- A) Prognati maksilare
- B) Prognati mandibulare
- C) Klasat sagitale vertikale
- D) Klasat sagitale skeletale

21. Zhvillimi i iniciativës sipas psikologëve është karakteristike për moshën:

- A) 0-2 vjeç
- B) 14-17 vjeç
- C) 9-12 vjeç
- D) 3-6 vjeç

22. Modifikimi morfologjik i këndit mandibular i atribuohet:

- A) Teorisë piezoelektrike
- B) Teorisë së Moss-it
- C) Teorisë kartilagjinoze
- D) Teorisë së rrjedhjes së gjakut

23. Mikrosomia hemifaciale shoqërohet me:
- A) Vështirësi në frymëmarrje
 - B) Asimetri mandibulare
 - C) Humbje të dëgjimit
 - D) Dhëmbë supernumeratum
24. Proceset mediane nazale kontribuojnë në formimin e:
- A) Maksilës
 - B) Palatumit terciar
 - C) Palatumit sekondar
 - D) Palatumit primar
25. Fytyra embrionale perbehet nga:
- A) 5 procese primitive
 - B) 3 procese primitive
 - C) 4 procese primitive
 - D) 2 procese primitive
26. Mandibula merr origjinën nga:
- A) Harku i 4-të brankial
 - B) Harku i 2-të brankial
 - C) Harku i 3-të brankial
 - D) Harku i 1-rë brankial
27. Ku është e lokalizuar qendra e rrotullimit të dhëmbit:
- A) Në 1/3 gingivare të koronës
 - B) Ndryshon në raport me sistemin e forcave të aplikuara mbi elementet dentare
 - C) Në 1/3 gingivare të rrënjës
 - D) Në 1/3 apikale të rrënjës
28. Harku palatinal Nance:
- A) Favorizon humbjen e ankorimit posterior
 - B) Favorizon retraksionin e bllokut inciziv
 - C) Rrit ankorimin e molarëve
 - D) Asnjë përgjigje e saktë
29. Përdorimi i retainer fiks këshillohet në:
- A) Mbas mbylljes së hapësirave interdental
 - B) Mbas korigjimit të kafshimit të kryqëzuar lateral
 - C) Prezencë të deviacionit të vijës mediane
 - D) Mbas ndërhyrjes së germektomisë
30. Kafshimi konstruktiv me dyll për përparatitjen e aparatit Frankel 2, merret:
- A) Duke centruar linjat mediane
 - B) Pa ndryshuar okluzionin
 - C) Duke centruar linjat mediane dhe tërhequr mandibulën para
 - D) Duke centruar linjat mediane dhe tërhequr mandibulën mbrapa
31. Rimodelimi i koronave të kaninëve kryhet në prani të:
- A) Agenezisë së incizivëve lateralë
 - B) Incizivëve lateralë me diametër mesio-distal të rritur

- C) Agenezisë së premolarëve të parë
- D) Grumbullimeve në sektorin anterior

32. Pllaka labiale superiore është prezent në:

- A) Aparatin Frankel 3
- B) Aparatin Frankel 2
- C) Aparatin fiks
- D) Bionator

33. Për çfarë shërbejnë elastikët e klasës së II-të:

- A) Për të spostuar distalisht kaninët superiorë dhe mezialisht molarët inferiorë
- B) Për të spostuar distalisht kaninët superiorë
- C) Për të ricentruar linjat mediane asimetrike
- D) Për të spostuar distalisht kaninët inferior

34. Pllaka labiale inferiore është prezent në:

- A) Aparatin fiks
- B) Bionator
- C) Aparatin Frankel 3
- D) Aparatin Frankel 2

35. Kafshimi konstruktiv me dyll për përparatjen e aparatit Frankel 3, merret:

- A) Duke centruar linjat mediane dhe tërhequr mandibulën mbrapa
- B) Pa ndryshuar okluzionin
- C) Duke centruar linjat mediane
- D) Duke centruar linjat mediane dhe tërhequr mandibulën para

36. Përdorimi i retainer fiks nuk këshillohet:

- A) Mbas korrigjimit të rotacioneve të dhëmbëve frontalë
- B) Mbas mbylljes së hapësirave interdente
- C) Mbas korrigjimit të kafshimit të kryqëzuar lateral
- D) Mbas korrigjimit të rotacioneve të dhëmbëve distalë

37. Për çfarë shërbejnë elastikët e klasës së III-të:

- A) Për të spostuar distalisht kaninët superiorë dhe mezialisht molarët inferiorë
- B) Për të spostuar distalisht kaninët superiorë
- C) Për të ricentruar linjat mediane asimetrike
- D) Për të spostuar distalisht kaninët inferiorë

38. Indikacioni për lip-bumper:

- A) Buzë inferiore hipotonike
- B) Linguo-versioni i incizivëve inferiorë nga hipertonia labiale
- C) Thithje e gishtit
- D) Gëlltitje atipike

39. Në çfarë manovre terapeutike duhen ekstraktuar kaninët e qumështit:

- A) Në ekstraksionet seriale
- B) Kur kërkohet hapësirë për të kaluar kroshtetë e aparatit
- C) Në klasën e III-të me hipozhvillim maksilar
- D) Në terapinë e klasës II/1

40. Programi i ekstraksioneve seriale fillon:

- A) Në moshën 4-5 vjeç
- B) Në moshën 6-7 vjeç
- C) Në moshën 10-11 vjeç
- D) Në moshën 8-9 vjeç

41. Kur indikohet ekstraksioni i dhëmbëve permanentë në harkadën superiore:

- A) Në klasën e II/2 hiperdivergente me grumbullime anteriore
- B) Në klasën e III-të skeletale hipodivergente
- C) Në klasën e II/2 hipodivergente
- D) Në klasën e II/1 me kafshim të thellë skeletal

42. Në çfarë tipi të malokluzionit përdoret grila fikse ose e lëvizshme:

- A) Gëlltitje atipike
- B) Respiracion oral
- C) Malokluzion shkaktuar nga ankiloglosia
- D) Në klasën e II/1 me kafshim të hapur

43. Lamina pasardhëse shfaqet në:

- A) Në fazën e bulzës së dhëmbëve të qumështit
- B) Në fazën e këmbanës së dhëmbëve të qumështit
- C) Në fazën e kupës së dhëmbëve të qumështit
- D) Në procesin e mineralizimit

44. Dhëmbët që preken më shpesh nga variacionet e numrit dhe formës janë:

- A) Premolarët maksilarë
- B) Lateralët mandibularë
- C) Lateralët maksilarë
- D) Premolarët mandibularë

45. Dhëmbët që preken më shpesh nga pozicioni ektopik janë:

- A) Premolarët mandibularë
- B) Molarët mandibularë
- C) Kaninët maksilarë
- D) Lateralët maksilarë

46. Ndryshimi i pozicionit të kockës maksilare gjatë zgjerimit të shpejtë:

- A) Përcakton një rotacion anterior të mandibulës
- B) Përcakton një ulje të dimensioneve vertikale anteriore
- C) Nuk influencon rotacionin mandibular
- D) Përcakton një rotacion posterior të mandibulës

47. Është e mundur të kombinohet aparati i lëvizshëm me një ekstraoral:

- A) Po
- B) Po, por vetëm nëse aparati i lëvizshëm ka të inseruara elementet për ekstraoralin
- C) Po, por vetëm në pacientë që kanë mbaruar rritjen
- D) Jo

48. Ekzistojnë aparate funksionale të tipit fiks:

- A) Jo

- B) Herbst
- C) Bionator
- D) Frankel

49. Kur indikohet fibrotomia e fibrave suprakreshtale:

- A) Xhepa paradontalë më shumë se 4 mm
- B) Ankioloza e dhëmbëve të qumështit
- C) Për të parandaluar recidivën në sensitivitetit e derotacioneve
- D) Ankioloza e dhëmbëve permanentë

50. Çfarë është harku W:

- A) Është hark ekspansioni
- B) Është harku i nivelimit
- C) Është harku ideal
- D) Është hark ekstraoral

51. Si matet forca në tërheqjen ekstraorale:

- A) Me dinamometër vetëm në një anë të tërheqjes
- B) Me dinamometër në të dyja anët e tërheqjes
- C) Me goniometër
- D) Me sy

52. Prevensioni në ortodonci përfshin:

- A) Heqjen e veseve
- B) Ekstraksionet
- C) Higjenën orale dhe fluorizimin
- D) Trajtimet endodontike

53. Çfarë drejtimi duhet të ketë mentoniera në rastin e tendencës të rritjes orare:

- A) Poshtë
- B) Lart
- C) Cervikal
- D) Anterior

54. Cili është funksioni i planit (trashjes) anterior në aparatit e lëvizshëm:

- A) Lingualizim i incizivëve superiorë
- B) Intruzioni i kaninëve superiorë
- C) Vestibularizim i incizivëve superiorë
- D) Favorizimi i ekstruzionit të dhëmbëve posteriorë

55. Është e mundur të përdoret elastik intramaksilar për të distalizuar kaninin në një hapësirë ekstraksioni:

- A) Po, gjithmonë
- B) Po, duke marrë në konsideratë edhe situatën ankoruese
- C) Jo, kurrë
- D) Po, nëse kanini ndodhet në vestibuloversion

56. Çfarë kuptohet me ankorimin në biomekanikën ortodontike:

- A) Rezistenca e ofruar nga dhëmbët posteriorë ndaj spostimeve
- B) Rezistenca e ofruar nga grupet e dhëmbëve ndaj distalizimeve
- C) Të treja janë të vërteta

D) Rezistenca e një dhëmbi ose grup dhëmbësh ndaj spostimeve

57. Cili sistem force duhet të përdoret për levizjen intruduese:

- A) Një kopje forcash
- B) Një forcë në drejtim lingual
- C) Një sistem i përbërë nga forcë e vetme dhe kopje forcash
- D) Një forcë e vetme drejtuar gjatë aksit të elementit dentar

58. Për sa orë këshillohet të mbahet aparati ekstraoral për të marrë efekt ortopedik:

- A) 14 orë
- B) 20 orë
- C) 18 orë
- D) 24 orë

59. Cilat janë elementet retentive në një aparat të lëvizshëm:

- A) Kroshetë, harku vestibular, pllaka e rezines
- B) Kroshetë
- C) Kroshetë, sustat, vida
- D) Kroshetë, sustat, harku vestibular

60. Cilat janë elementet aktive në një aparat të lëvizshëm:

- A) Kroshetë, sustat, harku vestibular
- B) Harku vestibular, sustat, vida zgjeruese
- C) Kroshetë
- D) Sustat, harku vestibular, pllaka e rezines

61. Cili është funksioni biomekanik i pllakave laterale dhe labiale të aparatit Frankel:

- A) Eliminimi i presionit të indeve të buta
- B) Aplikimi i forcës ortodontike mbi elementet dentare të harkadës inferiore
- C) Aplikimi i presionit mbi indet e buta
- D) Retensioni

62. Cili është funksioni biomekanik i harkut transpalatinal:

- A) Ankorues, ekspandues palatinal dhe derotullues për molarët
- B) Ekspandues palatinal
- C) Eviton interinferencat në lëvizjet laterale
- D) Ankorues

63. Cili sistem force aplikohet nga një aparat të lëvizshëm:

- A) Asnjë përgjigje e saktë
- B) Një forcë e vetme
- C) Një kopje forcash
- D) Një forcë e vetme ose një kopje forcash

64. Cili është funksioni biomekanik i kthesave vertikale në harkun vestibular në një aparat të lëvizshëm:

- A) Ul reziliencën e telit
- B) Rrit gjatësinë e telit dhe elasticitetin
- C) Rrit mundësinë e rezistencës ndaj deformimeve të telit
- D) Asnjë përgjigje e saktë

65. Aktivizimi i kthesave vertikale në harkun vestibular në një aparat të lëvizshëm çon në:

- A) Lëvizje dentare në planin vertikal
- B) Lëvizje dentare në planin horizontal për dhëmbët anteriorë
- C) Lëvizje dentare në planin horizontal për anteriorët dhe vertikal për posteriorët
- D) Lëvizje dentare në planin horizontal për posteriorët dhe vertikal për anteriorët

66. Cilat janë pikat e aplikimit të elastikëve të klasës së III-të:

- A) Një pikë aplikimi në harkadën inferiore dhe superiore
- B) Një pikë aplikimi në harkadën inferiore distalisht në lidhje me atë superiore
- C) Nuk kanë rëndësi ku janë pikat e aplikimit
- D) Një pikë aplikimi në harkadën inferiore mezialisht në lidhje me atë superiore

67. Cilat janë pikat e aplikimit të elastikëve të klasës së II-të:

- A) Një pikë aplikimi në harkadën inferiore dhe superiore
- B) Nuk kanë rëndësi ku janë pikat e aplikimit
- C) Një pikë aplikimi në harkadën inferiore mezialisht në lidhje me atë superiore
- D) Një pikë aplikimi në harkadën inferiore distalisht në lidhje me atë superiore

68. Proceset e apozicionit dhe rezorbimit në nofulla:

- A) Janë të lidhura me faktorët e fituar dhe hereditarë
- B) Varen nga influencat gjenetike
- C) Varen nga faktorët e fituar
- D) Asnjë përgjigje e saktë

69. Në një subjekt ortognatik drejtimi i rritjes së maksilës është:

- A) Poshtë dhe përpara
- B) Mbrapa dhe poshtë
- C) Lart dhe përpara
- D) Mbrapa dhe lart

70. Në një subjekt ortognatik drejtimi i rritjes së mandibulës është:

- A) Lart dhe përpara
- B) Poshtë dhe përpara
- C) Mbrapa dhe lart
- D) Mbrapa dhe poshtë

71. Cilët nga faktorët influencojnë rritjen e vultës kraniale:

- A) Aktiviteti i suturave dhe i sinkondrozës sfeno-oksipitale
- B) Zhvillimi i kompleksit maksilo-facial
- C) Aktiviteti i sinkondrozës sfeno-oksipitale
- D) Aktiviteti i suturave dhe zhvillimi i trurit

72. Tipologjia normofaciale është karakteristikë e një fytyre:

- A) Të gjërë e të shkurtër
- B) Të ngushtë e të shkurtër
- C) Asnjë përgjigje e saktë
- D) Të ngushtë e të gjatë

73. Tipologjia brakofaciale është karakteristikë e një fytyre:

- A) Të ngushtë e të gjatë
- B) Të ngushtë e të shkurtër
- C) Të gjërë e të shkurtër
- D) Asnjë përgjigje e saktë

74. Në sindromën e klasës së II-të skeletale mund të vihet re:

- A) Mandibula normale dhe maksila protuze
- B) Maksila protuze dhe mandibula protuze
- C) Maksila normale dhe mandibula protuze
- D) Maksila retruze dhe mandibula protuze

75. Në sindromën e klasës së III-të skeletale mund të vihet re:

- A) Maksila protuze dhe mandibula protuze
- B) Maksila retruze dhe mandibula protuze
- C) Mandibula normale dhe maksila protuze
- D) Maksila retruze dhe mandibula retruze

76. Cili nga malokluzionet është më shpesh e tipit gjenetik:

- A) Klasa e III-të skeletale
- B) Klasa II/1
- C) Laterodevijimi skeletal
- D) Asimetria skeletale

77. Çfarë është AMP ciklike:

- A) Asnjë përgjigje e saktë
- B) Medikament
- C) Kompozit për aplikimin e bracket
- D) Mediator qelizor prezent në qeliza

78. Në raportin kanin të klasës I-rë:

- A) Kanini inferior gjendet më mbrapa në krahasim me atë superior
- B) Kanini inferior gjendet i avancuar në krahasim me atë superior
- C) Kuspidi i kaninit inferior prek atë superior
- D) Kanini superior gjendet lingualisht në krahasim me atë inferior

79. Në raportin kanin të klasës II-të:

- A) Kanini inferior gjendet më mbrapa në krahasim me atë superior
- B) Kanini inferior gjendet i avancuar në krahasim me atë superior
- C) Kuspidi i kaninit inferior prek kuspidin e lateralit superior
- D) Kanini superior gjendet lingualisht në krahasim me atë inferior

80. Në gëlltitjen atipike infantile:

- A) Është prezent interpozicioni i gjuhës midis dhëmbëve
- B) Ka ulje të levizshmërisë së gjuhës
- C) Mungon peristaltika orofaringeale
- D) Është prezent alergjia ndaj qumështit maternal

81. Metodat e hapjes së kafshimit përfshijnë:

- A) Intruzionin e dhëmbëve posteriorë dhe ekstruzionin e atyre anteriorë

- B) Mezializimin e dhëmbëve posteriorë
- C) Intruzionin e dhëmbëve anteriorë dhe ekstruzionin e atyre posteriorë
- D) Retroinklinimin e incizivëve

82. Metodatat e mbylljes së kafshimit përfshijnë:

- A) Mezializimin e dhëmbëve posteriorë
- B) Intruzionin e dhëmbëve anteriorë dhe ekstruzionin e atyre posteriorë
- C) Intruzionin e dhëmbëve posteriorë dhe ekstruzionin e atyre anteriorë
- D) Retroinklinimin e incizivëve

83. Pjerrësimi kortikal është proces rritjeje që përshin:

- A) Depozitimin e kockës
- B) Rezorbimin e kockës
- C) Depozitimin dhe rezorbimin e kockës
- D) Përkuljen e kockës

84. Momenti përcaktohet si:

- A) Forcë x Veprim suste
- B) Forcë x Distancë nga qendra e rezistencës
- C) Forcë x Modul elasticiteti
- D) Forcë x Distancë nga qendra e rrotullimit

85. Ankorimi minimal përcaktohet si:

- A) Absolutisht asnjë lëvizje e dhëmbëve anteriorë
- B) 1/2 e hapësirës ekstraktuese përdoret nga uniti ankorues
- C) 1/3 e hapësirës ekstraktuese përdoret nga uniti ankorues
- D) 2/3 e hapësirës ekstraktuese përdoret nga uniti ankorues

86. Ankorimi reciprok përcaktohet si:

- A) 2/3 e hapësirës ekstraktuese përdoret nga uniti ankorues
- B) Absolutisht asnjë lëvizje e dhëmbëve anteriorë
- C) 1/3 e hapësirës ekstraktuese përdoret nga uniti ankorues
- D) 1/2 e hapësirës ekstraktuese përdoret nga uniti ankorues

87. Ankorimi maksimal përcaktohet si:

- A) 1/3 e hapësirës ekstraktuese përdoret nga uniti ankorues
- B) 1/2 e hapësirës ekstraktuese përdoret nga uniti ankorues
- C) 2/3 e hapësirës ekstraktuese përdoret nga uniti ankorues
- D) Absolutisht asnjë lëvizje e dhëmbëve anteriorë

88. Lloji klasik i ekstraksionit në kamuflimin e klasës II-të është:

- A) Ekstraksioni i premolarëve 1 sipër dhe kaninëve poshtë
- B) Ekstraksioni i premolarëve 2 sipër dhe premolarëve 1 poshtë
- C) Ekstraksioni i të katër premolarëve 1
- D) Ekstraksioni i premolarëve 1 sipër dhe premolarëve 2 poshtë

89. Cefalograma frontale përdoret për:

- A) Overjet
- B) Të vlerësuar simetrinë faciale
- C) Kompensimin dentar në planin sagital
- D) Kafshimin vertikal

90. Dhëmbët natalë definoohen:

- A) Dhëmbë që eruptojnë në muajin e 2-3-të
- B) Dhëmbë që janë prezentë në kohën e lindjes
- C) Dhëmbë që eruptojnë mbas vitit të 3-të
- D) Dhëmbë që eruptojnë midis muajit të 6-të dhe vitit të 2-të

91. Face mask përdoret për të prodhuar efekt:

- A) Anteriposterior
- B) Transversal
- C) Vertikal
- D) Dorsal

92. Relapsi në dhëmbë të rotulluar mund të eliminohet:

- A) Me fibrektomi cirkulare
- B) Duke ruajtur integritetin e harkut
- C) Me ekstraksion të dhëmbëve të përmbajtur
- D) Me frenektomi

93. Ekstraksioni është i detyruar në trajtimin e grumbullimeve, nëse dëndësimi është:

- A) Më pak se 4 mm
- B) 4 mm - 6 mm
- C) Më shumë se 10 mm dhe overjet negativ
- D) Më shumë se 10 mm

94. Në klasën II/1 me kënd të madh intermaksilar tendenca në mjekim është që

Pogonion ta çojë:

- A) Përpara dhe lart
- B) Mbrapa dhe lart
- C) Përpara dhe poshtë
- D) Mbrapa dhe poshtë

95. Cilat nga vlerat nuk janë cefalometrike:

- A) SNB
- B) SNA
- C) Këndi NSD
- D) Aksi Y i

96. Cila thënie është e vërtetë:

- A) Lëvizja e tepruar labiale e incizivëve mund të shkaktojë tërheqje gingivare
- B) Aparati ortodontik shkakton probleme paradontale
- C) Trajtimi ortodontik për pacientet e rritur me probleme paradontale është i kundërrindikuar
- D) Trajtimi i dhëmbi që i është prekur pulpa duhet vonuar deri pas trajtimit ortodontik

97. Epiteli i brendshëm dentar:

- A) Do të formojë ameloblastet
- B) Është e vetmja shtresë e organit të smaltit, që është më pranë enëve të gjakut
- C) Bëhet pulpë dentare
- D) Do të kombinohet me qelizat e papilës dentare për të formuar membranën e rrenjës

98. Nga formohet ligamenti periodontal:

- A) Membrana epiteliale e rrenjës
- B) Organi i smaltit
- C) Papila dentare
- D) Folikula dentare

99. Germi i premolarit 2 do të zhvillohet:

- A) Anterior me molarin 2 të qumështit mandibular
- B) Si një bulëz e ndarë, bukal me molarin 2 të qumështit mandibular
- C) Posterior me molarin 2 të qumështit mandibular
- D) Lingual me molarin 2 të qumështit mandibular

100. Zgjeruesi i shpejtë përbëhet nga:

- A) 2 unaza të cementuara tek molarët 1 permanentë
- B) 2 unaza të cementuara tek molarët 1 permanentë dhe 2 unaza tek premolarët 1
- C) 2 unaza të cementuara tek molarët 1 permanentë dhe 2 unaza tek premolarët 2
- D) 2 unaza të cementuara tek molarët 1 permanentë dhe 2 tek molarët 2 permanentë

101. Cili është funksioni i spiraleve (kthesave) në sustën protuduese?

- A) Janë pjesë ndihmëse për të lidhur ligaturën ose fijet elastike
- B) Diapazoni i veprimit rritet
- C) Bëjnë që susta të qëndroj më mirë në gojë
- D) Forca e veprimit rritet
- E) Moduli i elasticitetit ulet

102. Forca e kundërt e përdorur për të neutralizuar momentet në rastin e lëvizjeve trupore vestibulo-linguale kërkon:

- A) Një forcë të barabartë me krahun
- B) Një forcë më të madhe me një krah më të shkurtër
- C) Një forcë më të vogël me një krah më të gjatë
- D) Një forcë më të vogël me një krah të shkurtër
- E) Një forcë të vetme

103. Cili është një veprim që nuk i atribuohet headgear cervikal?

- A) Distalizim i rregjionit maksilar
- B) Ndalon rritjen përpara të maksilës
- C) Ndalon ekstrudimin e molarëve maksilarë
- D) Ndhmon korrigjimin e kafshimit të thellë
- E) Asnjë e vërtetë

104. Ankorimi aplikohet në çdo ndërhyrje ortodontike. Ankorimi nuk mund të aplikohet në subjektet e rritur.

- A) Të dyja të gabuara
- B) E para e gabuar, e dyta e vërtetë
- C) Të dyja të vërteta
- D) E para e vërtetë, e dyta gabim

105. Kush është forca optimale për lëvizjen pjerrësuese dentare?

- A) 0,05 - 0,1 N
- B) 0,5 - 1,0 N

- C) 02 - 0,4 N
- D) 5 - 10 N
- E) 50 - 100 N

106. Çfarë karakteristike të përbashkët kanë elastikët e klasës II dhe III-të?

- A) Tipi i forcës së ushtruar që është i lehtë
- B) Përcillen jashtë kavitetit oral
- C) Të dyja së bashku
- D) Magnituda e forcës vjen duke u rritur
- E) Pikat e aplikimit të forcës që janë intra-orale

107. Ekstrudimi i molarëve:

- A) Shkaktohet nga headgear tërheqës i sipërm
- B) Shkaktohet nga headgear tërheqës i poshtëm
- C) Rrit gjatësinë e harkut
- D) Do të ndihmojë në korrigjimin e problemeve transversale

108. Mezioklinimi simetrik i dhëmbëve 11,21, ka më shpesh si shkak:

- A) Mezioidens të impaktuar
- B) Agenezi të 12,22
- C) Frenulum hipertrofik
- D) Të gjitha së bashku
- E) Traumën okluzale nga dhëmbët poshtë

109. Kundërrindikacionet e lip-pumber në nofullën e poshtme:

- A) Të dyja së bashku
- B) Kur incizivët poshtë janë të labializuar
- C) Kur ka tendencë të klasës së III-të
- D) Në buzë hipotonike
- E) Asnjë e vërtetë

110. Si një dentist i përgjithshëm, cili pacient nuk kërkon trajtim të menjëhershëm?

- A) 8 vjeçar me kafshim të kryqëzuar posterior bilateral
- B) 8 vjeçar me malokluzion të klasës II/2
- C) 8 vjeçar me devijim të vijës mediane vetëm në pozicionin e okluzionit qëndror
- D) 15 vjeçar me malokluzion të klasës I-re me grumbullime serioze

111. Cili shoqëron zakonisht korrigjimin e malokluzionit të klasës II-të funksionale?

- A) Zgjerimi i harkut mandibular
- B) Distalizimi i molarëve të poshtëm
- C) Zgjerimi i harkut maksilar
- D) Heqja e premolarëve të poshtëm
- E) Ekstraksioni i dhëmbëve 53,63

112. Në një kafshim të kryqëzuar: molari i parë i sipërm është i zhvendosur palatinal, molari i parë mandibular është korrekt. Si do ta korrigjoni këtë gjendje?

- A) Përdoret një plan i inklinuar
- B) Asnjë e vërtetë
- C) Përdoret një elastik i kafshimit të kryqëzuar mes dy molarëve
- D) Përdoret një headgear

E) Përdoret një aparat me vidë sagitale

113. Pse inkorporohen spiralet (kthesat) në susta?

- A) Për të ndryshuar pikën e aplikimit të forcës
- B) Për të ulur papërkuelshmërinë e sustës
- C) Për të zhvilluar një forcë më të fuqishme
- D) Për ta bërë sustën më të adaptueshme me relievin e gojës
- E) Për ti rezistuar forcave kundërvepruese

114. Eruptimi ektopik i 26-tes në një pacient 8-vjeçar ka shkaktuar rënie të 65. Çfarë duhet bërë?

- A) Vendosja e një ruajtësi vendi
- B) Bërja e një cefalometrie për të gjykuar mbi modelin skeletal
- C) Vendosja e një aparati për të lëvizur 26 distalisht
- D) Bërja e një RO periapikale për të parë nëse 25 është prezente
- E) Vendosja e fituesit të vendit

115. Humbja e hershme spontane e dhëmbëve 73,83, është:

- A) Rezultat i kariesit të pa mjekuar
- B) Një simptomë e grumbullimit të dhëmbëve permanentë
- C) Një indikacion për vendosjen e ruajtësit të vendit
- D) Ndodh në sensitivitetin e mungesës kongjenitale të 33,43
- E) Prania e një kafshimi të thellë

116. Cili është shkaku i zakonshëm i kafshimit të kryqëzuar posterior Unilateral (majtas) të shoqëruar me zhvendosje funksionale të mandibulës?

- A) Ngushtimi unilateral i maksilës
- B) Prania e karieseve në anën e kundërt
- C) Humbja e parakohshme e molarëve të qumështit
- D) Ngushtimi bilateral i maksilës
- E) Të gjitha të vërteta

117. Diagnoza definitive e zhvendosjes funksionale laterale bazohet:

- A) Ekzaminimi klinik
- B) Në Ro panoramike
- C) Matjet e gjërësisë maksilare intermolare
- D) Studimi i modeleve të derdhura të allçisë
- E) Cefalometri

118. Cili model heqjeje është më pak i përshtatshëm për një pacient me klasë të II/1?

- A) 14,24 dhe 35,45
- B) 14,24
- C) 14,24 dhe 34,44
- D) 15,25 dhe 34,44

119. Trajtimi ortodontik mund të përfshijë edhe ekstraksionin e dhëmbëve permanentë. Cila nga situatat nuk është e vlefshme për ekstraksion?

- A) Korrigjimi i klasës II-të ose të III-të
- B) Mosbalancimi i sasisë së materialit dhembor në harkun e sipërm ose të poshtëm
- C) Asnjë e vërtetë
- D) Ulja e protuzionit dentar dhe sforcimit të buzës

E) Evitimi për të përdorur aparate fikse

120. Headgear mund të aplikohet tek molarët e dytë permanentë, sepse frenimi i rritjes maksilare është më i madh.

- A) Thënia dhe arsyeja janë të vërteta
- B) Thënia e vërtetë, arsyeja e gabuar
- C) Thënia dhe arsyeja janë të gabuara
- D) Thënia e gabuar, arsyeja e vërtetë

121. Në pamjen cefalometrike, një simfizë e shkurtër dhe e gjërë është karakteristikë e subjektit me tipologji:

- A) Asnjë e saktë
- B) Dolikofacial
- C) Normofacial
- D) Brakofacial
- E) Mikse

122. Një kënd i madh i inklinimit maksilar çon në:

- A) Buzëqeshje gingivare
- B) Asnjë e vërtetë
- C) Të dyja të vërteta
- D) Tendencë për kafshim normal
- E) Rrit over-jet

123. Prezenca e deviacionit të vijës mediane në denticionin e qumështit varet nga:

- A) Grumbullimet e incizivëve
- B) Malformacioni kongjenital
- C) Kontraksioni monolateral i harkadës
- D) Veset
- E) Parakontakti i kaninëve

124. Prezenca në ekzaminimin klinik e diastemës dhe vestibularizimi i incizivëve inferiorë është rezultat i:

- A) Thithjes së gishtit
- B) Problemeve paradontale
- C) Respiracionit oral
- D) Makroglosisë
- E) Prezencës së adenoideve

125. Në sindromën e obstruksionit respirator, cila nga simptomat e mëposhtme nuk është prezente:

- A) Mikrorinia
- B) Buzët inkompetente
- C) Rritja e tipit horizontal
- D) Rotacioni mandibular posterior
- E) Respiracioni oral

126. Humbja parakohe e dhëmbit 55 mund të shkaktojë:

- A) Pseudo klasë të II-të molare djathtas
- B) Klasë të III-të molare
- C) Kafshim të kryqëzuar bilateral

- D) Grumbullime anteriore
- E) Asnjë përgjigje e saktë

127. Në kursin e trajtimit ortodontik tek një subjekt dolikofacial duhet evituar:

- A) Ekstruzioni dhe distalizimi molar
- B) Ekstruzioni dhe distalizimi incizival
- C) Ekstruzioni incizival
- D) Intruzioni dhe distalizimi incizival
- E) Distorotacioni i kaninëve

128. Në prezencë të disharmonisë dento-bazale, ekstraksioni i premolarëve të dytë indikohet:

- A) Kur diskrepanca është anteriore
- B) Kur kërkohet ankorim minimal posterior dhe maksimal anterior
- C) Kur kërkohet ankorim maksimal posterior dhe minimal anterior
- D) Në sensitivitetit me vestibulo-version të theksuar të incizivëve
- E) Në prezencë edhe të një kafshimi të thellë anterior

129. Cila nga planet cefalometrike me rritjen e femijës ndryshojnë më pak dimensionet:

- A) SN
- B) Sgo
- C) SGn
- D) NPog

130. Humbja parakohe e dhëmbit 65 mund të shkaktojë:

- A) Grumbullime anteriore
- B) Asnje përgjigje e saktë
- C) Kafshim të kryqëzuar bilateral
- D) Klasë së II-të molare djathtas
- E) Klasë së III-të molare

131. Cila është një arsye për të mos përfshirë heqjen si pjesë e një plani trajtimi ortodontik?

- A) Incizivët e protoduar
- B) Asimetria e harkut
- C) Grumbullimet dentare
- D) Kafshimi i kryqëzuar

132. Një zonë pa qeliza mund të shfaqet në ligamentin periodontal pas aplikimit të forcës:

- A) Dhe të shkaktoj vonesë të lëvizjes së dhëmbit
- B) Dhe të zëvendësohet nga qelizat e gingivës së lirë
- C) Dhe është më e zakonshme kur përdoren aparate të lëvizshme
- D) Por mund të mënjanohet duke rritur forcën

133. Cila është e vërtetë përse i përket aparateve të lëvizshme?

- A) Mund të tërheqin dhëmbet në mënyrë trupore
- B) Rezultatet e trajtimit varen nga pacientët
- C) Nuk mund të korrigjojnë dhëmbet e rrotulluar
- D) Zhvillojnë një forcë të rendë të vazhdueshme

134. Çfarë tregon pika N në cefalometri?
A) Pikën e hundës
B) Nasion të indeve të buta
C) Pika më anteriore e suturës naso-frontale
D) Spina nasale anteriore

135. Vetia e animizmit sipas psikologëve është karakteristike për moshën:
A) 4-7 vjeç
B) 2-5 vjeç
C) 0-2 vjeç
D) 7-11 vjeç

136. Modifikimi morfologjik i këndit mandibular i atribuohet:
A) Muskulit maseter e buçinator
B) Muskulit temporal
C) Muskulit buçinator e pterigoid ektern
D) Muskulit maseter e pterigoid intern

137. Tipologjia dolicocefalike është karakteristike e një fytyre:
A) Të ngushtë e të gjatë
B) Të ngushtë e të shkurtër
C) Të gjërë e të shkurtër
D) Asnjë përgjigje e saktë

138. Rritja e kompleksit facial:
A) Procedon në mënyrë konstante e uniforme deri në pubertet
B) Asnjë përgjigje e saktë
C) Është aktive gjatë gjithë jetës
D) Nuk procedon në mënyrë uniforme, por me faza aktive e qetësie

139. Mandibula bëhet një kockë e vetme:
A) Gjatë lindjes
B) Me daljen e molarëve të parë
C) Në pubertet
D) Në vitin e parë të jetës
E) Në muajin e 8-të të jetës intrauterine

140. Ekstraksioni serial është një program:
A) Preventiv
B) Të gjitha së bashku
C) Korrigjues
D) Interceptiv

141. Ekuacioni KOCH ka këtë formulë:
A) Shkak-konsequencë-kohë
B) Konsequencë-shkak
C) Kohë-inde-shkak-konsequencë
D) Shkak-kohë-inde-pasojë

142. Dysostosis cleidocranial shoqërohet me:

- A) Dhëmbë supernumeratum
- B) Humbje të dëgjimit
- C) Kafshim i hapur
- D) Veshitësi në frymëmarrje

143. Cili është shkaku më i zakonshëm i humbjes së hapësirës brenda harqeve dentare?

- A) Migrimi mesial i molarëve të parë permanentë pas humbjes së hershme të molarëve të parë të qumështit
- B) Migrimi mesial i molarëve të parë permanentë pas humbjes së hershme të molarëve të dytë të qumështit
- C) Kariesi interproksimal tek dhëmbet frontalë
- D) Migrimi mesial i molarëve të parë permanentë në saj të eruptimit ektopik të kaninëve permanentë

144. Çfarë është OVER-jeti?

- A) Perimetri i harkadës superiore
- B) Distanca midis sipërfaqes orale të frontalëve sipër dhe vestibulare të frontalëve poshtë
- C) Një matje cefalometrike
- D) Mosperputhja vertikale midis nofullës së sipërme e të poshtme

145. Diastema është:

- A) Hapësira që krijon dhëmbi mbas ekstraksionit
- B) Hapësira midis harkadave të sipërme dhe të poshtme
- C) Hapësira mbrapa 8-tave
- D) Hapësira midis 2 centralëve jo në kontakt

146. Cilën nga forcat do të zgjidhni për lëvizjen e dhëmbëve?

- A) Të ndërprerë të lehtë
- B) Të ndërprerë të rëndë
- C) Të vazhdueshme të lehtë
- D) Secilën prej tyre

147. Cila procedurë ndihmon për ndalimin grumbullimeve pas trajtimit të incizivëve poshtë?

- A) Plani i trajtimit me dy stadi
- B) Heqja e premolarëve
- C) Retensioni i zgjatur
- D) Të gjitha të vërteta

148. Cila është sequenca sipas të cilës plotësohet rritja e nofullës?

- A) Gjatësi-lartësi-gjerësi
- B) Gjerësi-lartësi-gjatësi
- C) Gjerësi-gjatësi-lartësi
- D) Lartësi-gjerësi-gjatësi

149. Diastema interincizive mbas zgjerimit të shpejtë shoqërohet me:

- A) Intruzion i incizivëve
- B) Lëvizje radikulare konvergente të incizivëve
- C) Asnjë lëvizje as radikulare, as koronare e incizivëve
- D) Lëvizje radikulare divergente të incizivëve

150. Në prezencë të një dhëmbi qumështi të ankilozuar, terapia e rekomanduar është :

- A) Rikonstruksioni i koronës së dhëmbit
- B) Heqja e dhëmbit kur është gati eruptimi i pasardhësit
- C) Heqja e dhëmbit dhe vendosja e ruajtësit të hapësirës
- D) Lënia në mënyrë permanente

151. Kush nuk është pasojë e dhëmbit të qumështit të ankilozuar:

- A) Korona nën nivelin okluzal
- B) Të gjitha të vërteta
- C) Vështirësi rënie spontane
- D) Mosinklinimi i dhëmbëve fqinjë

152. Në prezencë të kafshimit të hapur anterior dento-alveolar është e nevojshme:

- A) Të intrudohen incizivët superiorë dhe inferiorë
- B) Riedukim funksional i gjuhës
- C) Ekstraksioni i premolarëve
- D) Interventi kirurgjikal

153. Elastikët e klasës së II-të:

- A) Mezializojnë maksilën
- B) Distalizojnë mandibulën
- C) Asnjë përgjigje e saktë
- D) Përcaktojnë ekstruzion dentar

154. Germektomia e molarëve 3 inferiorë indikohet:

- A) Kur trajtimi ortodontik kërkon spostimin distal të molarëve 2 ose 1
- B) Në prezencë të kafshimit të thellë anterior
- C) Në prezencë të agenezisë së premolarëve
- D) Në trajtimin ortodontik që parashikon ekstraksionin e molarëve 2 ose 3

155. Elastikët e klasës së III-të:

- A) Përcaktojnë inklinim korono-distal të molarëve superiorë
- B) Përcaktojnë intruzion të incizivëve superiorë
- C) Përcaktojnë inklinim radikulo-distal të molarëve inferiorë
- D) Përcaktojnë ekstruzion të molarëve superiorë

156. Në cilin rast nuk kërkohet retension pas terapisë:

- A) Kafshimi i kryqëzuar anterior me overbite normal
- B) Mbyllje e hapësirave interdentare
- C) Kafshim i hapur skeletal
- D) Rotacion dentar

157. Dhëmbët që preken më shpesh nga rezorbimi radikular mbas trajtimit ortodontik janë:

- A) Kaninët inferiorë
- B) Kaninët superiorë
- C) Incizivët centralë
- D) Molaret 1 superiorë

158. Striptimi përdoret:

- A) Në prezencë të dëndësimeve në sektorin anterior
- B) Për të eliminuar kontaktet deflektive
- C) Në prezencë të sasisë së pakët të kockës midis radikseve
- D) Për të përmirësuar estetikën në sektorin frontal

159. Fibrotomia përdoret për:

- A) Në grumbullimet dentare
- B) Në terapinë e dhëmbëve të ankilozuar
- C) Të liruar kaninët ektopikë
- D) Për të evituar rrotullimin e dhëmbëve pas derotacionit

160. Pllaka palatinale me vidë sagitale:

- A) Është aparat kontensioni
- B) Përcakton ulje të dimensioneve vertikale inferiore
- C) Përcakton linguo-inklinim të incizivëve inferiorë
- D) Përcakton vestibulo-inklinim të incizivëve superiorë

161. Retraksioni gingivar është komplikacion i:

- A) Distalizimit
- B) Përdorimit të zgjatur të elastikëve intermaksilarë
- C) Kryqëzimit të incizivëve
- D) Intruzionit dentar

162. Diametri i telit në harkun vestibular është:

- A) 0.7-0,8mm
- B) 0.5-0,6mm
- C) 0.2-0,4mm
- D) 0.10-0,11mm

163. Cilat sutura janë përgjegjëse për rritjen e premaksilës:

- A) Incizivo-kanine e palatinale transversale
- B) Interincizive e palatinale mediane
- C) Incizivo-kanine e interincizive
- D) Nazo-fronto-maksilare

164. Cila struktura merr në konsideratë linja estetike e Ricketts:

- A) Buza, mentumi
- B) Hunda, buza, mentumi,
- C) Buza, hunda
- D) Faqet, mentumi

165. Kush nga dhëmbët ka formë konoide:

- A) Premolarët maksilarë
- B) Incizivët lateralë maksilarë
- C) Kaninët maksilarë
- D) Incizivët centralë maksilarë

166. Gjatë erupsionit të dhëmbëve frontalë permanentë, prania e hapjes anteriore varet nga:

- A) Gëlltitja anormale

- B) Erupsioni dentar jo i konkluduar
- C) Ankiuloza dentare
- D) Ekstruzioni i molarëve

167. Cila është karakteristika kryesore e klasës II/2:

- A) Kënd interincizival të vogël
- B) Vestibuloversion i centralëve e linguoversion i lateralëve superiorë
- C) Vestibuloversion i lateralëve e linguoversion i centralëve superiorë
- D) Potencë mastikatorë të rritur

168. Cila nga vlerat duhet të vlerësohet në cefalometri për të diagnostikuar një klasë III skeletale:

- A) Gjatësia e trupit mandibular
- B) Këndi i divergjencës
- C) Këndi interciziv
- D) Konveksiteti facial

169. Cila nga anomalitë vërehet në displazinë ektodermale:

- A) Oligodonti
- B) Amelogeneza imperfeta
- C) Agenezi e kaninëve
- D) Kontraksioni bilateral i maksilës

170. Në subjektet brakofaciale ekstraksionet:

- A) Çojnë në përmirësim të profilit
- B) Duhet evituar
- C) Duhet bërë në çdo rast
- D) Pranohen vetëm ekstraksionet monolaterale

171. Cili është tipi dentar që provokon më me vështirësi rezorbim radikular :

- A) Intruzioni
- B) Ekstruzioni
- C) Angulacioni
- D) Derotacioni

172. Sa faza biologjike identifikohen në lëvizjen dentare iniciale:

- A) Tre
- B) Dy
- C) Një
- D) Katër

173. Në çfarë niveli vepron zgjeruesi i shpejtë:

- A) Dento-alveolar vetëm në moshë pubertale
- B) Alveolar
- C) Dentar
- D) Skeletal

174. Interkuspidimi i harkadës inferiore në monoblllokun Andresen paraqet një orientim:

- A) Në drejtim distal
- B) Asnjë orientim

- C) Në drejtim vestibular
- D) Në drejtim mezial

175. Çfarë është hapësira Nance:

- A) Hapësira midis 2 centralëve
- B) Hapësira e ekstraksionit
- C) Diferenca e shumë të diametrit mezio-distal të dhëmbëve të qumështit e permanentë
- D) Hapësira fiziologjike e gjuhës

176. Në çfarë niveli vepron zgjeruesi i aparatit palatinal të levizshëm:

- A) Dentar
- B) Alveolar
- C) Skeletal
- D) Skeletal vetëm në moshë pubertale

177. Distanca interkanine mandibulare përfundon në moshën:

- A) 8 vjeç
- B) 10 vjeç
- C) 9 vjeç
- D) 11 vjeç

178. Kur është koha e përshtatshme për trajtim ortodontik:

- A) Në denticion qumështi
- B) Sipas llojit të anomalisë
- C) Në denticion permanent
- D) Në denticion të përzjerë

179. Si reflekton në okluzion një deficiencë maksilare transversale:

- A) Kafshim i thellë
- B) Kafshim i hapur
- C) Kafshim i kryqëzuar
- D) Overjet

180. Cila përshkruan marrëdhënie normale meziodistale të dhëmbëve bukalë:

- A) Neutroukluzion
- B) Meziokluzion
- C) Distookluzion
- D) Asnjë e vërtetë

181. Cila përshkruan më mirë klasën II/2:

- A) Agenezia e prerësve lateralë
- B) Retroinklinim i centralëve të sipërm
- C) Hapësirat interdentalë
- D) Kaninët e retinuar

182. Cila pikë cefalometrike lokalizohet në një suturë midis 2 kockave:

- A) Gonion
- B) Sela
- C) Porion
- D) Nazion

183. Çfarë përdoret për të përcaktuar statusin e rritjes së pacientit:
- A) Historia dentare
 - B) Radiografi e kyçit të dorës
 - C) Fotografia faciale
 - D) Studimi i modeleve
184. Këndi facial përcakton pozicionin e:
- A) Mandibulës
 - B) Ballit
 - C) Maksilës
 - D) Hundës
185. Superpozimi cefalometrik mbas disa viteve tregon se molari sipër ka lëvizur distalisht. Shpjegimi është:
- A) Korrigjimi i një kafshimi të kryqëzuar posterior
 - B) Trajtimi i malokluzionit të klasës së dytë
 - C) Rritje normale
 - D) Trajtimi i malokluzionit të klasës së tretë
186. Ku duhet të aplikohet një forcë e vetme që dhëmbi të translatohet:
- A) Në apeks
 - B) Në margon incizivale
 - C) Nëper qendrën e rezistencës
 - D) Nëper qendrën e rrotullimit
187. Për çfarë lloj lëvizjeje dhëmbësh nuk përdoret aparati i lëvizshëm:
- A) Lëvizje labiale e incizivëve
 - B) Translatimi i kaninit
 - C) Ekstrudimi pasiv i dhëmbëve posteriorë
 - D) Lëvizje linguale e incizivëve
188. Kroshetë duhen në aparatën e lëvizshëm sepse sustat e aktivizuara zhvendosin aparatën:
- A) Thënia dhe arsyeja janë korrekte dhe jo të lidhura
 - B) Thënia dhe arsyeja janë korrekte dhe të lidhura
 - C) Thënia është korrekte dhe arsyeja jo
 - D) Thënia nuk është korrekte dhe arsyeja po
189. Cili është një avantazh i aparateve funksionale:
- A) Sigurojnë rezultate të shpejta
 - B) Nuk kërkohet kooperimi i pacientit
 - C) Të lehta të mbahen pastër
 - D) Dhëmbët mund të pozicionohen me saktësi të madhe
190. Cili është efekti i sustës Coffin në aparatën e lëvizshëm:
- A) Të pengojë zgjerimin e incizivëve
 - B) Të zgjerojë harkun dentar
 - C) Të prodhojë lëvizje distale të dhëmbëve posteriorë
 - D) Asnjë e saktë

191. Në cilin prej malokluzioneve përdoret më shpesh ekstraksioni serial:

- A) Klasa II/2
- B) Klasa e parë pa dëndësime
- C) Klasa II/1
- D) Klasa e parë me dëndësime të dukshme

192. Cili aparat përdoret për të trajtuar malokluzionin skeletal të klasës III, me deficiencë maksilare:

- A) Chin cup
- B) Rregullatori i funksionit
- C) Face mask
- D) Headgear me tërheqje sipër

193. Çfarë duhet korrigjuar para retroinklinimit të incizivëve maksilarë:

- A) Kafshimi i kryqëzuar
- B) Overjet-i
- C) Kafshimi i thellë
- D) Hapësirat interdental

194. Kush nga anomalitë nuk duhet të korrigjohet në denticionin e hershëm miks:

- A) Kafshimi i kryqëzuar anterior
- B) Kafshimi i kryqëzuar posterior
- C) Humbja e gjatësisë së harkut
- D) Diastema qendrore

195. Kush nuk është konsekuencë e erupsionit ektopik mezial të molarit 1 maksilar:

- A) Kafshimi i kryqëzuar posterior
- B) Retinimi i premolarit 2
- C) Humbja e gjatësisë së harkut
- D) Humbja para kohe e molarit 2 të qumështit

196. Çfarë është një çift forcash:

- A) 2 forca jo të barabarta në të njëjtin drejtim
- B) 2 forca të barabarta në të njëjtin drejtim
- C) 2 forca të barabarta në drejtime të kundërta
- D) 2 forca jo të barabarta në drejtime të kundërta

197. Cili përshkruan relacionin horizontal të incizivëve të sipërm dhe të poshtëm:

- A) Kafshimi i kryqëzuar
- B) Infraokluzion
- C) Kafshimi i thellë
- D) Overjet

198. Një nga termat nuk i përket ankorimit në ortodonci është:

- A) Spinal
- B) Cervikal
- C) Reciprok
- D) Stacionar

199. Çfarë profili ka një pacient me klasë III skeletale:

- A) Konveks
- B) Të drejtë
- C) Konkav
- D) Asnjë e saktë

200. Të gjitha pikat cefalometrike janë bilaterale përveç:

- A) Kufirit të poshtëm të mandibulës
- B) Orbital
- C) Porion
- D) Sela

201. Çfarë është zona aqelizore:

- A) Një gjendje normale që ndodh në denticion të shëndetshëm
- B) Një zonë presioni pas aplikimit të forcës ortodontike
- C) Një sipërfaqe e rezorbimit të brëndshëm të rrënjës
- D) Mungesa e fibrave gingivare pas fibrotomisë

202. Gjatë zgjerimit të shpejtë çfarë tregon diastema qëndrore:

- A) Zgjerimi është shumë i shpejtë dhe duhet ngadalësuar
- B) Sutura mes-palatinale është hapur
- C) Po ndodh vetëm zgjerim dentar
- D) Zgjerimi është shumë i ngadaltë dhe duhet shpejtuar

203. Cili është hapi i parë në vendosjen e aparateve fikse:

- A) Zgjedhja e tipit të cementit
- B) Ndarja e dhëmbëve ku do të vendosen unazat
- C) Zgjedhja e masës së saktë të unazave
- D) Shtytja e unazës me anë të kafshimit

204. Humbja e hapësirës së lirë mund ta kthejë një rast të lehtë në të vështirë. Molarët e parë permanentë mandibularë translatohen më lehtë distalisht nga lip-bumper:

- A) Të dyja të vërteta
- B) E para e gabuar, e dyta e vërtetë
- C) E para e vërtetë, e dyta e gabuar
- D) Të dyja të gabuara

205. Kush ka qënë malokluzioni i korigjuar nga përdorimi i headgear cervikal tek molarët maksilarë:

- A) Një 11 vjeçar me klasa II/1
- B) Një 10 vjeçar me kafshim të kryqëzuar anterior funksional
- C) Një 10 vjeçar me klasa I dhe me mungesë kongjenitale të premolarëve 1 mandibularë
- D) Një 35 vjeçar me klasa II/2

206. Cili term do të përshkruante ankorimin, kur pas ekstraksionit të premolarit I, posteriorët nuk duhen lejuar të vijnë përpara:

- A) Minimal
- B) Maksimal
- C) I moderuar
- D) Reciprok

207. Cili tip i lëvizjes së dhëmbit është i aftë të shkaktojë komprimim të ligamentit periodontal gjatë gjithë një ane të dhëmbit:

- A) Ekstrudimi
- B) Translatimi
- C) Rrotullimi
- D) Intruzioni

208. Nazioni në cefalometri gjendet në bashkimin e:

- A) Kockave maksilare dhe nazale
- B) Kockave maksilare dhe temporale
- C) Kockave nazale dhe frontale
- D) Kockave nazale dhe temporale

209. Cila nuk duket qartë në cefalometri:

- A) Kufiri i bazës kraniale
- B) Profili i indeve të forta
- C) Profili i indeve të buta
- D) Kariesi dentar

210. Cila është dukja e zakonshme e incizivëve të sipërm në gjendje qetësie:

- A) 2-3 mm
- B) Nuk duken
- C) 4-5 mm
- D) E gjithë korona e dhëmbit

211. Një individ me mandibul të vogël do të ketë:

- A) Profil konkav
- B) Profil katërkëndësh
- C) Profil të drejtë
- D) Profil konveks

212. Cila linjë përdoret për të përfaqësuar bazën kraniale anteriore:

- A) S-N
- B) N-Pog
- C) Go-Pog
- D) Horizontalja e Frankfurtit

213. Ku është lokalizuar qendra e rezistencës e dhëmbit me një rrënjë:

- A) Në një pikë në rrënjë, midis kreshtës alveolare dhe apeksit
- B) Në një pikë në kurorë, midis bashkimit smalt-cement dhe margos incizivale
- C) Në apeksin e rrënjës
- D) Në margon incizivale

214. Një forcë e drejtuar në qendrën e rezistencës së dhëmbit do të rezultojë në:

- A) Rrotullim
- B) Intruzion
- C) Lëvizje trupore
- D) Pjerrësim

215. Zgjerimi skeletal i harkut të sipërm kryhet më mirë me:

- A) Zgjerues të shpejtë palatinal
- B) Elastikët e kafshimit të kryqëzuar, mbajtur 24 orë/ditë
- C) Tel zgjerues
- D) Zgjerimi palatinal nuk mund të kryhet

216. Një pseudookluzion i klasës III-të ekziston kur:

- A) Është prezente një zhvendosje funksionale anteriore e mandibulës
- B) Mandibula dhe maksila janë prognatike
- C) Mandibula normale dhe maksila prognatike
- D) Mandibula është asimetrike

217. Një pacient me SNA të rritur dhe SNB normal, Çfarë malokluzioni ka:

- A) Klasa II-të
- B) Klasa I-rë
- C) Klasa III-të
- D) Klasa IV-tërt

218. Dhëmbët kanë tendencë të dalin më shpejt në maksilë sesa në mandibul. Dhëmbët kanë tendencë të dalin më shpejt në djem se sa në vajza:

- A) E para e vërtetë, e dyta e gabuar
- B) E para e gabuar, e dyta e vërtetë
- C) Të dyja të gabuara
- D) Të dyja të sakta

219. Pse duhet të vendoset retainer në fund të trajtimit ortodontik:

- A) Për ndalimin e kthimit të dhëmbëve në pozicionin e tyre origjinal
- B) Për ndalimin e grumbullimeve shkaktuar nga molarët 3
- C) Për zgjerimin e zonës kanin-kanin
- D) Për lëvizjen e dhëmbëve kur nuk arrihet me aparate fikse

220. Çfarë ndodh kur dhëmbët lëvizin si rezultat i forcave ortodontike:

- A) Dhëmbi do të lëvizë vetëm 1mm, sepse gjaku i enëve apikale nuk toleron të tillë distancë
- B) Kocka alveolare zgjerohet për akomodimin e dhëmbëve që lëvizin
- C) Koronat e dhëmbëve lëvizin, por rrënjët qëndrojnë në pozicionin e tyre origjinal
- D) Qelizat rimodelojnë ligamentin periodontal dhe kockën alveolare

221. Çfarë termi ju është dhënë molarëve 1 permanentë:

- A) Krenaria e vjetër
- B) Shtylla e harkut
- C) Determinuesi gjenetik
- D) Çelësi i okluzionit

222. Cila prej termave nuk duhet përshkruar në lëvizjen ortodontike të dhëmbit:

- A) Pjerrësuese
- B) Avulsive
- C) Intruduese
- D) Translatuese

223. Në lëvizjen ortodontike të dhëmbit:

- A) Kocka hiqet nga zona e tensionit dhe depozitohet në zonën e
- B) Kocka hiqet si nga zona e tensionit dhe zona e presionit
- C) Kocka hiqet nga zona e presionit dhe depozitohet në zonën e
- D) Asnjë e saktë

224. Teoritë për lëvizjen e dhëmbit i përfshijnë të gjitha përveç teorisë:

- A) Izokinetike
- B) Të defleksionit të kockes alveolare
- C) Piezoelektrike
- D) Presion-tensioni

225. Në cilën kockë skeletale shtrihet pika bazion në cefalometri:

- A) Zigomatike
- B) Sfenoidale
- C) Temporale
- D) Oksipitale

226. Aksi Y njihet është:

- A) Indikativ për sasinë e modelit të rritjes faciale
- B) Indikativ për drejtimin e modelit të rritjes faciale
- C) Është e palidhur me rritjen
- D) Aksi i tij është paralel me rritjen e pacientit në gjatësi

227. Një pacient me zgjerues të shpejtë ju thotë në telefon se midis 2 dhëmbëve të parë ka një hapësirë. Cila do të jetë përgjigjja juaj:

- A) Mos vazhdoni zgjerimin me këtë aparat
- B) Duhet tju shoh menjëherë
- C) Vazhdoni zgjerimin me këtë aparat
- D) Ktheni vidën në drejtim të kundërt

228. Çfarë informacioni nuk mund të merret nga cefalometria:

- A) Relacioni vertikal
- B) Relacioni transversal
- C) Relacioni anterioposterior
- D) Relacioni i indeve të buta

229. Nëse shohim një vajzë 12 vjeç me headgear të sipërm, cili është malokluzioni i saj:

- A) Klasa II me kafshim të hapur
- B) Klasa III me kafshim të thellë
- C) Klasa II me kafshim të thellë
- D) Klasa III me kafshim të hapur

230. Cili pozicion është më i rëndësishëm në diagnozën e kafshimit të kryqëzuar anterior:

- A) Interkuspidimi maksimal
- B) Pozicioni i zakonshëm
- C) Zhvendosja laterale
- D) Pika e kontaktit të parë në relacion qëndror

231. Një klasa II/1 ku nuk pritet rritje e mëtejshme, ortodonti vendos ta trajtojë duke hequr dy premolarët 1 sipër. Rezultati do të jetë:

- A) Molarët klasa I, kaninët klasa II
- B) Molarët klasa II, kaninët klasa II
- C) Molarët klasa I, kaninët klasa I
- D) Molarët klasa II, kaninët klasa I

232. Cila nuk mund të vlerësohet nga modelet e studimit:

- A) Sasia e overjet-it
- B) Grumbullimet e harkut
- C) Lokalizimi i kafshimit të kryqëzuar
- D) Lokalizimi i dhëmbëve të paeruptuar

233. Kur një dhëmb i nënshtrohet pjerrësimit, sa zona presioni ka në ligamentin periodontal:

- A) Asnjë
- B) Dy
- C) Një
- D) Tre

234. Cila nuk është patjetër e pranishme në klasa II/1 skeletale:

- A) Marrëdhëniet e molarëve klasa II
- B) Overjet i rritur
- C) Kafshimi i thellë
- D) SNB i madh

235. Bazion është pikë mesore në kufirin anterior të foramen magnum.

Snj është pjesë e kockës palatinale:

- A) Të dyja të vërteta
- B) E para e gabuar, e dyta e vërtetë
- C) E para e vërtetë, e dyta e gabuar
- D) Të dyja të gabuara

236. Një fëmijë ka mandibul prognatike kur dhëmbët janë në okluzion, por një profil të drejtë kur dhëmbët janë lehtësisht të ndara. Cila është diagnoza e mundshme:

- A) Zhvendosje anteriore funksionale
- B) Klasa III skeletale
- C) Dhimbje faciale
- D) Kafshimi i kryqëzuar anterior

237. Cili malokluzion shoqërohet më shpesh me trauma të incizivëve maksilarë:

- A) Klasa I
- B) Klasa II/1
- C) Klasa II/2
- D) Klasa III/1

238. Cili shkakton ndryshim në qendrën e rezistencës së dhëmbit:

- A) Ndryshimi nga tel i rumbullakët në kënddrejtë
- B) Shtimi i momentit dhe forces së aplikuar
- C) Ndryshimi në gjatësinë e rrënjës së dhëmbit
- D) Qendra e rezistencës së dhëmbit nuk ndryshon kurrë

239. Qendra e rezistencës së dhëmbit varion sipas mënyrës së aplikimit të forcave. Qendra e rrotullimit të dhëmbit nuk ndryshon pavarësisht se si aplikohet forca:

- A) Të dyja të gabuara
- B) E para e gabuar, e dyta e vërtetë
- C) E para e vërtetë, e dyta e gabuar
- D) Të dyja të vërteta

240. Cila është metoda më e mirë për të gjykuar moshën skeletike:

- A) Stadi i zhvillimit dentar
- B) Radiografia e kyçit të dorës
- C) Karakteristikat sekondare seksuale
- D) Tabelat e gjatësisë dhe peshës

241. Cili prej dhëmbëve nuk mund të lëvizë në mënyrë ortodontike:

- A) Dhëmbi permanent
- B) Dhëmbi i ankilozuar
- C) Dhëmbi i qumështit
- D) Dhëmbi i retinuar

242. Çfarë lloj përgjigje të indeve jep lëvizja ortodontike e dhëmbit:

- A) Inflatore
- B) Psikologjike
- C) Patologjike
- D) Neurologjike

243. Cila është sequenca për ekstraksion serial:

- A) Lateral i qumështit, kanini i qumështit, premolari 1
- B) Molari 1 i qumështit, kanini i qumështit, premolari 1
- C) Kanini i qumështit, molari 1 i qumështit, premolari 1
- D) Kanini i qumështit, molari 2 i qumështit, premolari 1

244. Cili është kundërindikacion për ekstraksion serial:

- A) Modeli skeletal i klasës I-rë
- B) Kafshimi i thellë
- C) Denticioni miksi
- D) Dëndësimet e rënda

245. Kujt i referohet ankorimi në ortodonci:

- A) Rezines që përdoret për ngjitjen e briketave
- B) Lëvizjeve të dhëmbëve nga aparati ortodontik
- C) Cementit që përdoret për ngjitjen e unazave
- D) Rezistencës ndaj lëvizjeve të padëshiruara të dhëmbëve

6. Pedodonti

1. Kariesi evolutiv në dhëmbët e qumështit lokalizohet:

- A) Në sipërfaqet distal të molarit të parë
- B) Shoqërohet me sindromin e septumit
- C) Shtrihet në dentinë
- D) Në sipërfaqen distale të molarit të dytë

2. Kariesi i biberonit zhvillohet te fëmijët në moshën:
- A) 1-2 vjeç
 - B) 4-5 vjeç
 - C) 3-4 vjeç
 - D) 2-3 vjeç
3. Kariesi i biberonit shkakton:
- A) Anomali kockore dhe okluzioni
 - B) Inklinim lingual të mandibulës
 - C) Anomali kockore
 - D) Inklinim vestibular të maxilës
4. Molari i parë permanent preket më shpesh nga kariesi për arsye se:
- A) Ka fisura të thella
 - B) Të tre faktorët
 - C) Higjiena jo e mirë sepse ka denticion të përzier
 - D) Ka smalt të pamaturuar
5. Aplikimi i këllëfëve të prefabrikuar aplikohen në dhëmbët e qumështit:
- A) Në molar të kariuar
 - B) Në molar të devitalizuar dhe të destruktuar
 - C) Në dentinogenezis imperfecta
 - D) Në molar të devitalizuar
6. Përcaktimi i materialit për mbushje në dhëmbët e qumështit me karies bëhet sipas kriterëve:
- A) Kriteri biologjik
 - B) Kriteret mekanike
 - C) Të tre kriteret
 - D) Moshë e fëmijës dhe risku i kariesit
7. Sipas sistemit të numërimit të dhëmbëve 23 nënkupton:
- A) Molarin e parë majtas poshtë
 - B) Kaninin majtas sipër
 - C) Premolarin e dytë djathtas sipër
 - D) Kaninin djathtas poshtë
8. Indi i pamineralizuar i dhëmbit është:
- A) Smalti
 - B) Pulpa
 - C) Dentina
 - D) Cementi
9. PH i përshtymës në kushte normale është:
- A) 7
 - B) 7.8
 - C) 5.5
 - D) 6.8

10. Sasia e përshtymë së prodhuar në 24 orë është:

- A) 600-800ml
- B) 500-1500ml
- C) 1000-1500ml
- D) 1500-2000ml

11. Silantet si mjet profilaktik aplikohen në:

- A) Dhëmbë të sapodalë me fisuara të thella
- B) Dhëmbë të sapodalë në fisura të cekëta
- C) Dhëmbë të sapodalë të dyshimte me karies
- D) Dhëmbë në moshën e adoleshencës

12. Përshtyma e kryen funksionin baktericit nëpërmjet:

- A) Lizozimës
- B) Laktoferinës
- C) Amilazës
- D) Mucinës

13. Cila nga këto forma të periodontitit kronik nuk takohet në dhëmbët e qumështit:

- A) Periodontit kronik granular
- B) Periodontit kronik fibroz
- C) Periodontit kronik gangrenoz
- D) Periodontit kronik granulomatoz

14. Mbulimi indirekt i pulpës në dhëmbët e qumështit ndikohet sipas stadeve fiziologjike:

- A) Në stadin e dytë
- B) Në stadin e parë
- C) Në stadin e tretë
- D) Kur dhëmbi do të qëndrojë për një kohë të gjatë

15. Cilat nga këto shënja klinike përcakton sindromën e septumit:

- A) Prekja e molarëve nga kariesi në sipërfaqet aproximale
- B) Të tre shenjat klinike
- C) Inflamacion në bordin gingivar të dhëmbit
- D) Infamacion të papilës ndër dhëmbore

16. Në rastin e pulpiteve në dhëmbët e qumështit me nekrozë të pulpës me patologji pulpare në stadin e tretë kemi trajtim:

- A) Pulpotomi
- B) Extraksion
- C) Mjekim Biologjik
- D) Trajtim dhe mbushje kanalesh

17. Cili nga materialet përdoret me sukses për mbulimin indirekt në dhëmbët e qumështit:

- A) Ca (OH) 2
- B) Oksid-Zink-Eugenol
- C) E.B.A. Cement
- D) Glassionomer

18. Materialet që përdoren për trajtimin e kariesit në dhëmbët e qumështit në klasën e dytë të Blakut janë:

- A) Glassionomer
- B) Rezin kompozite
- C) Të tre materialet
- D) Amalgam

19. Cili është disavantazhi i cement glassionomereve në Pedodonti:

- A) Adeziv
- B) Estetik
- C) I prekshëm erozioni
- D) Lëshon Fluor

20. Cili është disavantazhi i amalgamit në trajtimin e kariesit në pedodonti:

- A) I thjeshtë në përdorim
- B) Kërkon retension mekanik
- C) Ekonomik
- D) I fortë

21. Cili nga medikamentet ka dhënë rezultate të shkëlqyera në pulpotominë pulpare në dhëmbët e qumështit:

- A) Formokrezoli
- B) Ca (OH)₂
- C) M.T.A
- D) Glutaraldehidi

22. Pulpektomia në dhëmbët e qumështit aplikohet:

- A) Në stadin e dytë
- B) Në stadin e parë fiziologjik
- C) Në stadin e tretë
- D) Në asnjërin prej stadeve të mësipërme

23. Cili nga materialet është i suksesshëm në trajtimin e mbulimit indirekt në dhëmbet permanent me rënjë të paformuar:

- A) Oksid-Zink-Eugenol me forcim të shpejtë
- B) Ca(OH)₂
- C) M.T.A
- D) Dykal

24. Kur realizohet mbyllja e rrënjës së kaninit maxilar permanent :

- A) 10-11 Vjeç
- B) 11-12 Vjeç
- C) 13-14 Vjeç
- D) 9-10 Vjeç

25. Kur realizohet mbyllja e rrënjës së molarit të dytë permanent:

- A) 14-15 vjeç
- B) 11-13 vjeç
- C) 13-14 vjeç
- D) 10-11 vjeç

26. Kur realizohet mbyllja e rrënjës së lateralit permanent:

- A) 10-11 vjeç
- B) 9-10 vjeç
- C) 11-12 vjeç
- D) 12-13 vjeç

27. Në mjekimin indirekt në dhëmbët permanent me rrënjë të paformuar, kontrolli radiologjik do të bëhet:

- A) Mbas 10 ditëve
- B) Mbas 20 ditëve
- C) Mbas 40 ditëve
- D) Mbas 90 ditëve

28. Në cilën nga këto mosha traumat e dhëmbëve të qumështit japin dëmtim të rëndë të dhëmbit permanent:

- A) 2 vjeç
- B) 1 vjeç
- C) 3 vjeç
- D) 4 vjeç

29. Cila nga proteinat e poshtëshënuara është enzimë:

- A) Hemoglobina
- B) Tripsina
- C) Insulina
- D) Mioglobina

30. Gingivo stomatiti Herpetik në fëmijë arrin pikun në paraqitjen klinike në moshat:

- A) 6 muaj
- B) 2-4 vjeç
- C) 10 muaj
- D) 5 vjeç

31. Erozioni i smaltit në fëmijë shaktohet nga:

- A) Flora bakteriale e kavitetit oral
- B) Nga Bruksizmi
- C) Nga dieta e pasur me produkte acide
- D) Ekspozimi në një mjedis me acide

32. Në amputimin vital në dhëmbët permanent cili nga këto medikamente përdoret:

- A) Oksid-Zink-Eugenol
- B) Kreozot-jodoformë
- C) Trikrezol-formalinë
- D) Ca(OH)₂

33. Osteoklastet janë qeliza:

- A) Embrionale
- B) Të sistemit limfatik
- C) Të sistemit retikulo-endotelial
- D) Të sistemit Imunitar

34. Të gjitha qelizat janë me origjinë mezenkimale, me përjashtim:

- A) Mast qelizat
- B) Fibroblastet
- C) Osteoklastet
- D) Qeliza Malases

35. Përdorimi i fenildontonoinës në fëmijë shkakton:

- A) Rezorbim koskor
- B) Atrofi Gingivare
- C) Ulceracione papilare
- D) Hiperplazi Gingivare

36. Kush e përcakton formimin e gurit dentar:

- A) Prezenca e pllakës bakteriale
- B) Duhani
- C) Gingiviti
- D) Parodontiti marginal

37. Lamina dura është:

- A) Imazhi radiografik i kockes alveolare propium
- B) Pareti i jashtëm i një kisti maxilar
- C) Pareti i jashtëm i odontomës
- D) Epiteli ku merr origjinë smalti dentar

38. Molari i parë permanent superior paraqet:

- A) 7 Kuspide
- B) 5 Kuspide
- C) 4 Kuspide
- D) 3 Kuspide

39. Doza optimal e përditëshme e fluorit në një fëmijë dy vjeç është:

- A) 1 mg
- B) 0,25 mg
- C) 0,75 mg
- D) 0,75 dc

40. Fluori në kripën e gjellës për përdorim duhet të jetë:

- A) 90 p.p.m.
- B) 300 p.p.m.
- C) 400 p.p.m.
- D) 250 p.p.m.

41. Veprimi efikas i fluorit është në periudhën:

- A) Embrionale
- B) Në periudhën e formimit të koronës së dhëmbit
- C) Periudha post eruptive
- D) Në periudhën e formimit të rrënjës

42. Trajtimi i një periodontiti kronik i fisturizuar në dhëmbë qumështi mund të realizohet:

- A) Në dy seanca
- B) Tre seanca
- C) Në një seancë
- D) Katër seanca

43. Në Hipoplazinë e smaltit në pjesën bazale prizmat e tij i gjejmë në drejtim:

- A) Tangencial
- B) Horizontal
- C) Radial
- D) Pingul me bazën

44. Doza optimale e përditëshme e Fluorit për një fëmijë gjashtë vjeç është:

- A) 1dc
- B) 0,50mg
- C) 1gr
- D) 1mg

45. Ku gjendet pulpa e organit të smaltit:

- A) Në sulkusin gingivar
- B) Në pjesën koronare te embrionit dentar
- C) Në kavitetin intern të dhëmbit
- D) Në sipërfaqen e smaltit para se ai të dalë

46. Cili nga mikroelementët e mëposhtëm gjendet në indet e forta të dhëmbëve të qumështit më shumë se në dhëmbët permanent:

- A) Magneziumi
- B) Stronciumi
- C) Vanadiumi
- D) Molibdeni

47. Mikrobi përgjegjës për formimin e pllakës bakteriale është:

- A) Streptokoku Mutans
- B) Streptokoku Mitis
- C) Streptokoku salivar
- D) Laktobacili acidofilis

48. Diagnoza e një pulpiti në dhëmbët e qumështit përcaktohet nga të dhënat:

- A) Anamneza
- B) Testi termik
- C) Testi Klinik
- D) Të treja së bashku

49. Ameloblastet qelizat formuese të smaltit janë:

- A) Sferike
- B) Cilindrike
- C) Të sheshta
- D) Në formë ylli

50. Cili është funksioni primar i pulpës:

- A) Prodhues i dentinës

- B) Sensitiv
- C) Mbrojtës
- D) Ushqyes

51. Në pulpitin akut purulent dhimbja qetësohet nga:

- A) Të nxehtat
- B) Provokohet nga mastikacioni
- C) Të ftohtat
- D) Nuk ndikohet nga asnjë ngacmim termik

52. Pllaka bakteriale është shkaktare e:

- A) Sëmundjes Karioze
- B) E Sëmundjes karioze dhe paradontale
- C) Sëmundjeve Paradontale
- D) Jep dëmtim të sulkusit gingivar

53. Dhimbja në kariesin aproximal në dhëmbët e përhershëm karakterizohet:

- A) Spontane
- B) Pulsante
- C) E Vazhdueshme
- D) Provokuese

54. Në matriksin organik të smaltit cila nga këto proteina nuk bën pjesë:

- A) Enamelinhë
- B) Dentinë SialoPHoproteina (DSPP)
- C) Amelogenina
- D) Ameloblastina

55. Cila është periudha për monitorimin me kujdes të suplementeve të fluorit në fëmijë:

- A) 6-7 vjeç
- B) 4-6 vjeç
- C) 0-4 vjeç
- D) 7-9 vjeç

56. Cilët nga këta faktorë luajnë rol në etiologjinë e traumave dentare:

- A) Të tre faktorët
- B) Anatomik
- C) Patologjik
- D) Social

57. Në pulpotominë parciale sipas CVEK në sensitiviteti traumash sa milimetra është heqja e pulpës me frezë:

- A) 2mm
- B) 1mm
- C) 0,5mm
- D) 1,5mm

58. Membrana e Nansmit derivon nga:

- A) Nga guajana e Hertvingut
- B) Nga indi kartilaginoz

- C) Nga Osteoblasti
- D) Nga organi i smaltit

59. Në procesin karioz infiltrimi mikrobik takohet:

- A) Në shtresën e parë
- B) Në shtresën e dytë
- C) Në shtresën e katërt
- D) Në shtresën e tretë

60. Ekuilibri mineral në dhëmbë me karies realizohet:

- A) Të treja së bashku
- B) Remineralizim
- C) Mineralizim
- D) Demineralizim

61. Cili nga modifikimet e strukturave indore ndikon në rezorbimin fiziologjik të dhëmbëve të qumështit:

- A) Modifikim të strukturës parodontale
- B) Të tre modifikimet
- C) Modifikim në zonën intraradikulare
- D) Modifikim pulpar

62. Kush është faktori etiologjik në parodontitin juvenil:

- A) Hipertiroidizmi
- B) Diabeti
- C) Pllaka bakteriale
- D) Mungesë e vitaminës C

63. Kalçifikimi i rrënjës së molarit të dytë poshtë të qumështit kryhet në moshën:

- A) 2-2.5
- B) 2.5-3
- C) 4-4.5
- D) 3-3.5

64. Kanini i qumështit del në muajt:

- A) 16-20
- B) 14-16
- C) 20-22
- D) 22-25

65. Në dhëmbët e qumështit amputimi mortal ka indikacion absolut në:

- A) Pulpit purulent
- B) Pulpit kronik ulceroz
- C) Pulpit akut seroz
- D) Kariesin e thellë

66. PH kritik i pllakës bakteriale është:

- A) 5-4.5
- B) 5.5-5
- C) 6-6.5

D)6.5-6

67. Në një dhëmb të traumatizuar permanent me rrënjë të pakalçifikuara kontrolli klinik do të kryhet:

- A)21 ditë
- B)18 ditë
- C)8 ditë
- D)90 ditë

68. Embrioni i kaninit të përhershëm fillon të zhvillohet në:

- A)Javën e 25 të jetës intrauterine
- B)Javën e 30 të jetës intrauterine
- C)Javën e 32 të jetës intrauterine
- D)Javën e 17 të jetës intrauterine

69. Denticioni i përzjerë është përgjithësisht prezent në moshat:

- A)6-18 vjeç
- B)6-12 vjeç
- C)9 -12 vjeç
- D)12-18 vjeç

70. Në pulpitin akut purulent dhimbja:

- A)Qetësohet nga të nxehtët
- B)Ulet nga të ftohtit
- C)Qetësohet nga të ftohtit
- D)Provokohet nga mastikacioni

71. Në stomatitin primar superficial bëjnë pjesë të gjitha përveç:

- A)Stomatitit kataral
- B)Aftoz
- C)Soor stomatitin
- D)Hipertrofik

72. Në Morbus Moller -Barlow nevoja ditore për vitaminë C është:

- A)20-30 mg
- B)30-50 mg
- C)50-100 mg
- D)60-80 mg

73. Faktori primar në etiologjinë e hypoplazisë së smaltit:

- A)Çrregullimet gastrointestinale
- B)Çrregullimet e metabolizmit të kalçiumit dhe fosforit
- C)Ushqime artificiale
- D)Sëmundje endokrine

74. Dhënia e tabletave të fluorit bëhet sipas:

- A)Moshës
- B)Peshës
- C)Kombinimi i të gjithave
- D)Përmbajtjes së fluorit në ujin e pijshëm

75. Në Çfarë moshe fillon formimi i indeve të forta të molarit të parë permanent:

- A) 6 muaj të jetës intrauterine
- B) 6 muaj pas lindjes
- C) 1 vjeç
- D) 9 muaj të jetës intrauterine

76. Doza optimale e përditshme e fluorit në fëmijët mbi 6 vjeç është:

- A) 0.5 decigram
- B) 1 decigram
- C) 1 gram
- D) 1 miligram

77. Përdorimi i ksilitolit kontraindikohet në moshat:

- A) 1-2 vjeç
- B) 4 vjeç
- C) 3 vjeç
- D) 5 vjeç

78. Cili nga këta irrigues në trajtimin e pulpektomisë të dhëmbëve të qumështit dëmton folikulin e dhëmbit permanent:

- A) EDTA 17%
- B) Na OCl 10%
- C) NaOCl 5%
- D) Uji Steril

79. Sa është doza toksike mg për kg peshë trupore:

- A) 6 mg/Kg peshë trupore
- B) 1 mg/Kg peshë trupore
- C) 2 mg/Kg peshë trupore
- D) 5 mg/Kg peshë trupore

80. Për të përcaktuar molarin e dytë të qumështit inferior të majtë formula është:

- A) 57
- B) 75
- C) 77
- D) 35

81. Mbeturinat Malasess gjenden në:

- A) Gjuhë
- B) Në glandulat Salivare
- C) Në hapësirën periodontal
- D) Në pulpën dentare

82. Në rastin e një luksasioni të komplikuar me dëmtim shkëputës të indit periodontal cilat janë komplikacionet:

- A) Rezorbim zëvendësues
- B) Ankilozë
- C) Të tre dëmtimet janë të mundshme
- D) Rezorbim inflamator

83. Nga cilat fibra është i përbërë ligament alveolo-dentar:
- A) Elastike
 - B) Muskulare
 - C) Kolagene
 - D) Epiteliale
84. Përqindja e malokluzionit si rezultat i humbjes së dhëmbëve të qumështit konsiderohet:
- A) 60%
 - B) 40%
 - C) 20%
 - D) 90%
85. Korona e molarit të parë të qumështit superior paraqet:
- A) 4 kuspide
 - B) 3 kuspide
 - C) 5 kuspide
 - D) 2 kuspide
86. Prania e cipave jeshile tek dhëmbët e qumështit është nga:
- A) Dieta jo korekte
 - B) Flora orale jo normale
 - C) Higjena orale jo e mirë
 - D) Anemi hipokromike
87. Në fëmijë, gingivostomatiti herpetik nga një gingivostomatit nekrotik nga çfarë dallohet:
- A) Temperatura
 - B) Dhimbje të gingivës marginale
 - C) Nekrozë të papilës interdentalë
 - D) Prezenca e ulçerës të dhimbshme të mukozës dhe gjuhës
88. Kush është dhëmbi më voluminoz në dhëmbët e përhershëm:
- A) Molari i parë superior
 - B) Molari i parë inferior
 - C) Molari i dytë superior
 - D) Molari i dytë inferior
89. Kërkesa për vitaminë D (ergosteron) për fëmijë është:
- A) 100 UI
 - B) 400 UI
 - C) 750 UI
 - D) 250 UI
90. Ku gjenden qelizat e retikulo-steliate:
- A) Në sarkomë
 - B) Në organin e smaltit
 - C) Në odontomë
 - D) Në Epulit

91. Shenjat e para të zhvillimit të dhëmbit duken në:
A) Në javën 8-9 embrionale
B) Në javën 6-7 embrionale
C) Në javën 7-8 embrionale
D) Në javën 4-5 embrionale
92. Nga sakusi dentar do të zhvillohet:
A) Cementi
B) Të tre indet e mësipërme
C) Ligamenti paradontal
D) Kocka alveolare
93. Rezorbimi i kaninit maksilar të qumështit fillon:
A) Në moshën 5 vjeç
B) Në moshën 8 vjeç
C) Në moshën 7 vjeç
D) Në moshën 9 vjeç
94. Në anomalitë e dhëmbëve makro dhe mikrodoncia hyjnë në procesin e:
A) Morfodiferencimit të dhëmbit
B) Histodiferencimit të dhëmbit
C) Formimit të dhëmbit
D) Anomali pozicioni
95. Amelogenezis imperfekta paraqitet në formën:
A) Hypoplazike
B) Në të tri format
C) Hypomaturuar
D) Hypokalcifikuar
96. Përfundimi i formimit të rrënjës së një laterali maksilar të përhershëm është mosha:
A) 9 vjeç
B) 10 vjeç
C) 11 vjeç
D) 12 vje
97. Rizaliza patologjike takohet në:
A) Kista
B) Në të tri format
C) Osteomelit
D) Neoplazma
98. Sindromi Turner është i shkaktuar nga:
A) Patologjitë kronike të molarëve të qumështit
B) Dëmtimet traumatike të dhëmbëve të qumështit
C) Nga përdorimi i antibiotikeve në moshë të vogël
D) Nga mungesa e Ca
99. Hidroksi apatite paraqitet në formën:

- A) $\text{Ca}_8(\text{PO}_4)_6(\text{OH})_2$
- B) $\text{Ca}_{10}(\text{PO}_4)_6(\text{OH})_2$
- C) $\text{Ca}_2(\text{PO}_4)_6(\text{OH})_2$
- D) $\text{Ca}(\text{PO}_4)_6(\text{OH})_2$

100. Rreziku i moderuar i kariesit është:

- A) 2 leziona të reja në vit
- B) 1 lezion i ri në vit
- C) 3 leziona të reja në vit
- D) 4 leziona të reja në vit

101. Indikacionet për ruajtjen e dhëmbëve të qumështit janë:

- A) Të treja në konsideratë
- B) Pranimi i terapise nga prindërit
- C) Agenezi e dhëmbëve permanent
- D) Pacienti bashkëpunues

102. Koha e daljes së molarit të parë të qumështit është:

- A) 0-16 muajsh
- B) 2 vjeç
- C) 3-10 muajsh
- D) 12-18 muajsh

103. Sasi të dhëmbëve supernumerat takohen në:

- A) Në distosi cleido-cranica
- B) Në sindromin Melkerson Rosenthal
- C) Në sindromin Pierr Robin
- D) Në sindromin Jegers

104. Rreziku i lartë i kariesit është:

- A) 2 leziona të reja në vit
- B) 3 leziona të reja në vit
- C) > se 4 në vit
- D) > se 3 në vit

105. Cili nga këta dhëmbë paraqet 2 rrënjë dhe 3 kanale:

- A) Molari superior
- B) Premolari superior
- C) Molari inferior
- D) Premolari inferior

106. Në dhëmbët e trumtazuar të përhershëm të pakalcifikuar me ekspozim të gjerë pulpë do të përdorim:

- A) Pulpotomi (parcial ose total)
- B) Mbulim direkt
- C) Pulpektomi
- D) Të gjitha kanë mundësi

107. Në pulpitin kronik hiperplazik ka dhimbje:

- A) Të gjitha të gabuara

- B) Të vazhdueshme pulsante
- C) Dhimbje pas stimulit termik
- D) Spontane

108. Në paradont nuk përfshihet:

- A) Dentina
- B) Cementi
- C) Gingiva
- D) Ligament para dontal

109. Kariesi shume i shpejte(akutisima) është karakteristike për :

- A) Në dhëmbët e sistemit dentar mikst
- B) Dhëmbët e qumështit të moshës 3-5 vjeç
- C) Në dhëmbët e përhershëm të moshës 15-18 vjeç
- D) Në moshat mbi 50 vjeç

110. Në dhëmbët e qumështit me nekroze pulpare të shoqëruar me patologji paradontale dhimbja është:

- A) Nga të nxehtit
- B) Nga të ftohtit
- C) Gjatë mastikacionit
- D) Reagon nga testi elektrik

111. Në mjekimin biologjik të pulpës në dhëmbë të përhershëm cila nga pastat ka sukses të lartë mjekimi:

- A) Ca(OH)₂
- B) Euzhenat
- C) Cement karboksilat
- D) MTA

112. Dhëmbi i parë i qumështit që del në arkadën dentare në normë është:

- A) Incizivi central superiore
- B) Incizivi lateral inferior
- C) Kanini inferior
- D) Incizivi central inferior

113. Dhoma pulpare e dhëmbëve të qumështit përkundrejt dhëmbëve permanent është:

- A) Është më vogël në të gjithë diametrin e saj
- B) Është më e gjerë vetëm në proksimitetin e sipërfaqes okluzale
- C) Është më gjerë në të gjithë diametrin e saj
- D) Është më vogël vetëm në diametrin mezio-distal

114. Në rastin e një frakture dentare ekstraksioni është i indikuar në:

- A) Frakturë të tretës apikale të rrënjës
- B) Frakturë trasversale të rrënjës
- C) Frakturë të tretës së mesme të rrënjës
- D) Frakturë komplet të koronës

115. Agenezia e një dhëmbi permanent më frekuent është:

- A) Premolari superior

- B) Kanini superior
- C) Incizivi inferior
- D) Premolari inferior

116. Për të përcaktuar me numurim me 2 shifra kaninin e qumështit sipër në të djathtë formulimi i drejtë është:

- A) 35
- B) 23
- C) 53
- D) 31

117. Dhëmbi i parë permanent që del në arkadën dentare është në normë:

- A) Molari i parë inferior
- B) Incizivi central inferior
- C) Molari i parë superior
- D) Incizivi parë superior

118. Për një diagnozë radiologjike të kariesit aproksimal në molarët e qumështit janë përcaktuese :

- A) Rx ortopantomike të arkadave dentare
- B) 2 Rx endorale - okluzale
- C) 2 Rx endorale peri-apikale
- D) 2 Rx endorale bite-wing

119. Qendra e rrotullimit të një dhëmbi ndodhet:

- A) Nuk është një pikë fikse, varet nga distanca e forcës nga qendra e rezistencës
- B) Në 1/2 të rrënjës
- C) Në qëndër të koronës klinike
- D) Në apeks të rrënjës

120. Kush është shkaku i një ekstraksioni dentar të një dhëmbi permanent?

- A) Kariesi destruktues me shkatërrim të koronës me rezorbim kockor periradikular
- B) Kariesi i grades se dyte
- C) Pulpit akut
- D) Cimentoma apikale

121. Kush është përcaktimi më i përshtatshëm i "epulis":

- A) Një kist me lokalizim supra gingival
- B) Një proces inflamator perikoronar
370. Diagnoza diferenciale e ulçerës karcinomatoze nuk bëhet me:

- A) Ulçerën nga antraksi
- B) Ulçerën dekubitale
- C) Ulçerën tuberkulare
- D) Ulçerën sifilitike

371. Kanceri i lëkurës së fytyrës nuk shkaktohet nga :

- A) Përdorimi i duhanit
- B) Dermatozat kronike
- C) Rrezatimi djellor
- D) Gjëndjet prekanceroze

372. Kush nga shenjat e mëposhtme nuk është karakteristikë për tumoret malinj të nofullave:

- A) Luksim i dhëmbëve
- B) Otorhea
- C) Simptoma Vincenti
- D) Foetor ex-oris

373. Kush nga simptomat e mëposhtme nuk është karakteristikë për kancerin e maksilës:

- A) Dhimbje të tipit neuralgjik
- B) Enoftalmus
- C) Egzoftalmus
- D) Rinoragji

374. Kush nga patologjitë e mëposhtme nuk bën pjesë në malformacionet e rralla:

- A) Makrostomia
- B) Labium duplex

- C) Fistulat labiale
- D) Keiloskizis simplex

375. Kush nga sindromet e mëposhtme nuk shoqërohet me skiza:

- A) Piere-Robin
- B) Meckel
- C) Franchesketi
- D) Melkerson-Rosendal

376. Kush nga teknikat e mëposhtme nuk përdoret në trajtimin e defekteve të lindura të buzës:

- A) Veau
- B) Tenyson
- C) Millard
- D) ABBE

377. Kush nga teknikat e mëposhtme nuk përdoret për korigjimin e palatoskizis:

- A) Langenbeck
- B) Karapanziç
- C) Furlow
- D) Vardil-Killner

378. Kush nga anomalitë e mëposhtme nuk bën pjesë në ato të sensit vertikal:

- A) Mordex aperta
- B) Intruzio dentis
- C) Mordex profundum
- D) Mordex mixt

379. Kush nga osteotomitë e mëposhtme nuk përdoret në Mandibul:

- A) Osteotomi në formë drejtkëndëshi në ramus horizontalis mandibule
- B) Osteotomi në formën e "Z" në ramus horizontalis mandibule
- C) Osteotomi në formën e "L" në ramus horizontalis mandibule
- D) Osteotomi oblike ramus ascendant

380. Kush nga osteotomitë nuk përdoret në nofullën e sipërme:

- A) Kole
- B) Le Fort II
- C) Wasmund
- D) Le Fort I

381. Kush nga lembot e mëposhtme nuk egziston:

- A) Le Fort
- B) Mc Gregor
- C) Random
- D) Bakamian

382. Kush nga plastikët e mëposhtme nuk egziston:

- A) Homoplastikë
- B) Heteroplastikë
- C) Sklopoplastike

D) Aloplastikë

383. Skin grafti nuk përdoret për zëvendësimin e:

- A) Gjuhës
- B) Lëkurës
- C) Mukozës
- D) Indit kockor

384. Kush nga shenjat e mëposhtme nuk është karakteristikë e sindromit Apert:

- A) Hypoplazi maksilare
- B) Skizë palatinale
- C) Alopeci
- D) Syndaktili

385. Kush nga shenjat e mëposhtme është karakteristikë e sindromet Frey:

- A) Otoragji
- B) Dhimbje koke
- C) Të vjella
- D) Bula djerse

386. Kush nga shenjat e mëposhtme nuk është karakteristikë e sindromit Maffuci:

- A) Flebolite
- B) Endokondroma
- C) Hemangioma
- D) Skize palatine

387. Kush nga shenjat e mëposhtme nuk është karakteristikë e sindromit Piere-Robin:

- A) Mikrognati
- B) Hemangioma multiple
- C) Defekt qiellze
- D) Glosoptozë

388. Kush nga shenjat e mëposhtme nuk është karakteristikë e sindromit Francesketi:

- A) Anomali në gishta
- B) Anomali nofullash
- C) Difekt qiellze
- D) Anomali në veshë

389. Kush nuk është karakteristikë e sindromi Treacher-Collins:

- A) Hypoplazi mandibulare
- B) Glosoptozë
- C) Ren polikistik
- D) Defekt në sy

390. Kush nga veçoritë e mëposhtme nuk është karakteristikë për osteomyelitin në fëmijë:

- A) Shfaqet në 9 mujin e parë të lindjes
- B) Prek kryesisht maksilën
- C) Diagnoza e hershme është e rëndësishme për të evituar komplikacionet dhe mortalitetin

D)Prek kryesisht mandibulën

391. Kush nga shkaktarët e mëposhtëm nuk akuzohet për osteomyelitin në fëmijë:

- A) Mastiti
- B) Rruga hematogjene
- C) Sakusi lakrimal i infektuar
- D) Dhëmbët

392. Kush nga shenjat e mëposhtme nuk është karakteristikë për osteomyelitin në fëmijë:

- A) Otagji
- B) Debulesë
- C) Të vjella
- D) Epilepsi

393. Kush nga shenjat e mëposhtme lokale nuk është karakteristikë në osteomyelitin në fëmijë:

- A) Poliperiodontit
- B) Celulit periorbital
- C) Edemë faciale
- D) Rrjedhje pusi ne vestibulum ose palatum

394. Kush nga komplikacionet e osteomyelitit infantil nuk egziston:

- A) Otiti
- B) Meningiti
- C) Verbimi
- D) Abcesi cerebral

395. Radioterapia nuk jep:

- A) Hypovaskularizim të indeve
- B) Hiperaktivitet
- C) Hypoksi
- D) Hypocelularitet

396. Më shpesh nga osteoradionekroza preket:

- A) Mandibula
- B) Maksila
- C) Kocka hyoide
- D) Klavikula

397. Arsyet e osteoradionekrozës nuk janë:

- A) Ekstraksione para radiacionit
- B) Higjena e keqe
- C) Doza e madhe
- D) Ekstraksione pas radiacionit

398. Kush nga deformimet e mëposhtme nuk është kongenital:

- A) Fascia adenoide
- B) Disostozat kraniofaciale
- C) Defektete e buzës dhe të qiellzës
- D) Mikrosomia hemifaciale

399. Kush nga deformimet e mëposhtme nuk lidhet me zhvillimin:
- A) Disostozat kraniofaciale
 - B) Osteomyeliti
 - C) Malnutricioni
 - D) Traumat
400. Kush nga të sëmurët e mëposhtëm nuk përbën faktor rrishtor. I sëmurë me:
- A) Defektet kongenital të zemrës
 - B) Anomali dentare
 - C) Deformime të shtyllës
 - D) Asthma
401. Kush nga shenjat e mëposhtme nuk është përcaktuese për disfunkcionin e A.T.M:
- A) Marrje mendësh
 - B) Dhimbje koke persistente
 - C) Spazma muskulare
 - D) Të vjella
402. Kush nga zonat topografike të faqes nuk egziston:
- A) Zona submandibulare
 - B) Zona preaurikulare
 - C) Zona suborbitale
 - D) Zona orale dhe buko-mandibulare
403. Kush nga etiologjitë e mëposhtme nuk është e saktë për malokluzionin:
- A) Etiologjia hematogjene
 - B) Etiologjia skeletike
 - C) Etiologjia sindromike
 - D) Etiologjia dentare
404. Një shkatërrim të madh dhe të menjëhershëm emocional pacientit i sjellin:
- A) Defektet jatrogjene
 - B) Defektet e lindura
 - C) Defektet sindromike
 - D) Defektet traumatike
405. Traumat dento-maxillo-faciale takohen më shumë:
- A) Në fëmijë
 - B) Në të rritur
 - C) Në meshkujt e ri
 - D) Në të moshuar
406. Kush nga funksionet e mëposhtme nuk i takon hundës:
- A) Funksioni estetik
 - B) Të folurit
 - C) Filtrimi i ajrit
 - D) Lëngështim dhe ngrohje e ajrit
407. Kush nga ndërhyrjet e mëposhtme nuk shkakton deformim të hundës:

- A) Kirurgjia ortognatike
- B) Rinoplastika
- C) Septorinoplastika
- D) Operacioni Caldwellluck

408. Kush nga donorët kartilagjenoz të mëposhtëm nuk egziston:

- A) Kosto-kondral
- B) Septum nazal
- C) Kreshta iliake
- D) Konka aurikulare

409. Kush nga problemet e mëposhtme në materialet alo-plastike nuk egziston :

- A) Flakja
- B) Migracioni
- C) Infeksioni
- D) Vaskularizimi

410. Kush nga problemet e mëposhtme në graftet kockore nuk egziston:

- A) Flakja
- B) Vaskularizimi
- C) Migracioni
- D) Infeksioni

411. Kush nga specialistët e mëposhtëm nuk luan rol të madh në vënien e diagnozës për tumoret beninj apo malinj të regjionit O.M.F:

- A) Anestezist-reaminatori
- B) Imazheristi
- C) Anatomo-patologu
- D) Kirurgu O.M.F

412. Ameloblastoma takohet më shumë në:

- A) Maxillë
- B) Kockat zygomatike
- C) Mandibul
- D) Kockat orbitale

413. Kush është faktori kryesor i kancerit oral:

- A) Alkoli
- B) Droga
- C) Duhani
- D) Faktorët ambjental

414. Nje ulcer në gojë që nuk mund të shërohet nuk duhet ndjekur me:

- A) Egzaminim objektiv intra dhe ekstraoral
- B) Gargara dezinfektante
- C) Follow-up
- D) Biopsi

415. Kush nga fenomenet e mëposhtme flet për prognozë të keqe të kancerit oral:

- A) Gjaktosja e ulcerës
- B) Forma e ulcerës

- C) Ngjyra e ulcerës
- D) Limfonoduli metastatic

416. Në trajtimin kirurgjikal të kancerit oral më shumë rëndësi ka:

- A) Heqja në kufij të shëndoshë
- B) Heqja në thellësi
- C) Verifikimi i margove kirurgjikale të ekscizionit
- D) Heqja në gjërësi

417. Kush nga origjinat e mëposhtme akuzohet më rrallë për metastazat mandibulare:

- A) Truri
- B) Prostata
- C) Ca e veshkave
- D) Gjoksi

418. Kush nga teknikat e mëposhtme nuk përdoret për trajtimin kirurgjikal të mandibulës së përfshirë nga kanceri:

- A) Simfizektomi radikale
- B) Lingulektomi
- C) Mandibulektomi pa exartikulim
- D) Rezekcioni parcial

419. Kush nga funksionet e mëposhtme nuk i takon mandibulës:

- A) Gëlltitja
- B) Përtycja
- C) Njomja e ushqimit
- D) Të folurit

420. Kush nga funksionet e mëposhtme nuk i takon mandibulës:

- A) Estetik
- B) Personalitet
- C) Ngrohja e ajrit
- D) Ana psiko-sociale

421. Kush nga qëllimet e mëposhtme nuk përfshihet ne follow-up:

- A) Vënia e diagnoses (recidiva)
- B) Aktiviteti fizik i të sëmurit
- C) Trajtimi i recidivës
- D) Trajtimi i komplikacioneve

422. Kush nga faktoret e mëposhtëm nuk luan rol në uljen e përqindjes së ostomyelitit :

- A) Rritja e nivelit të edukates shëndetësore
- B) Rritja e nivelit të ushqyerjes
- C) Kujdesi i mire për gojën dhe dhëmbët
- D) Nekrektomia

423. Në diferencimin e një osteomyelitit me një tumor malinj, kush është më e rëndësishme:

- A) Klinika
- B) Ro'grafia

- C) Anamneza
- D) Tërheqja e procesit pas antibiotiko-terapisë

424. Kush nga arsyet e mëposhtme nuk qëndron për prekjën më të rrallë të maxillës nga ostomyeliti:

- A) Vaskularizimi më i mire
- B) Ka një kockë kortikale më të hollë
- C) Infeksioni shpërndahet në kavitetet fqinje
- D) Prania e dhëmbëve sinuzal

425. Kush nga egzaminimet e mëposhtme nuk ka vlere në përcaktimin e osteomyelitit:

- A) Ro'grafi me lëndë kontsensiviteti
- B) IRM
- C) Technecium-Skaneri
- D) CT

426. Kush nga thëniet e mëposhtme nuk është karakteristikë e osteomyelitit kronik :

- A) Frakturë patologjike
- B) Fistula
- C) Trizmusi
- D) Temperatura ondulante

9. Endodonti

1. Cila nga vetitë e materialeve të mbushjes së kanalit ka vlere për ritrajtimet:

- A) Të mos tkurret kur futet në kanal
- B) Të hiqet me lehtësi kur është nevojë
- C) Të jete steril
- D) Të mos ngjyroset indet e dhëmbit

2. Cila nga vetitë e materialeve të mbushjes së kanalit ka vlerë për estetikën:

- A) Të hiqet me lehtësi kur është nevojë
- B) Të mos tkurret kur futet në kanal
- C) Të mos ngjyroset indet e dhëmbit
- D) Të jete steril

3. Në cilët pacientë kërkohet konsultë me mjekun specialist:

- A) Në pacientë të moshuar
- B) Në asnjë nga këto sensitiviteti
- C) Në pacientë që kanë kaluar hepatit
- D) Në pacientë që marrin steroide

4. Cilët pacientë janë më të predispozuar për ekzacerbime midis seancave të trajtimeve endodontike:

- A) Gratë shtatzëna
- B) Pacientët alergjikë
- C) Pacientët me sëmundje gjaku
- D) Pacientët me hipertension

5. Cilat nga këto mikroorganizma të gojës mund të jenë shkaktare të endokarditit infeksioz:
- A) Neiseriet
 - B) Fusobakterium
 - C) Aktinomyces
 - D) Streptokoket
6. Cilat nga këto procedura dentare mund të shkaktojnë një endokardit infeksioz:
- A) Vetëm pastrimi i gurëzave
 - B) Çdo procedurë që shoqërohet me hemoragji
 - C) Vetëm ekstraksionet
 - D) Vetëm procedura endodontike
7. Terapia profilaktike me antibiotikë para trajtimeve endodontike rekomandohet:
- A) Në pacientë që përdorin aspirine
 - B) Në pacientë alergjike
 - C) Në gratë shtatzëna
 - D) Në pacientë me imunitet të komprometuar
8. Cila nga këto procedura lejohet të bëhen në semestrin e parë të shtatzënisë:
- A) Trajtimet endodontike të vështira
 - B) Trajtimet emergjente
 - C) Rezekcioni apikal
 - D) Ekstraksione
9. Në cilët pacientë rekomandohet marrja e sedativëve para trajtimit endodontik:
- A) Në pacientët anksioze
 - B) Në pacientë me AIDS
 - C) Në pacientë me çrregullime të hemorragjisë
 - D) Në pacientë me transplant organesh
10. Cila nga këto situata kërkon trajtim imediat:
- A) Hipersensibiliteti dentinar
 - B) Frakturat e kurorës së dhëmbëve me zbulim të pulpës
 - C) Kariesi profund
 - D) Abrazioni
11. Në cilat sensitiviteti kërkohet konsulta me kirurgun oromaksilofacial:
- A) Kur trauma koronare kombinohet me frakturë të kockës alveolare
 - B) Kur trauma koronare shoqërohet me zbulim të pulpës
 - C) Kur trauma koronare prek dy dhëmbë
 - D) Asnjëra nga këto
12. Në cilat nga këto procedura mund të ndodhë zbulimi aksidental i pulpës:
- A) Gjatë acidifikimit
 - B) Gjatë bizotimit të mureve
 - C) Gjatë dezinfektimit të kavitetit
 - D) Gjatë përgatitjes së kavitetit në një karies të thellë
13. Në cilën patologji dhimbja dentare bëhet shkak që të zgjojë pacientin nga gjumi:

- A) Pulpit akut
- B) Periodontit kronik granular
- C) Karies profund
- D) Pulpit kronik ulçeroz

14. Cila është arsyeja që pyesim pacientin se me çfarë medikamenti qetësohet dhimbja:

- A) Për të përcaktuar thellësinë e kavitetit
- B) Për të përcaktuar llojin e mikroorganizmave
- C) Për të përcaktuar intensitetin e dhimbjes
- D) Për të përcaktuar origjinën e dhimbjes

15. Në cilën nga këto patologji pacienti ankon ndjeshmëri të gjeneralizuar nga të ftohtat dhe të nxehtat:

- A) Erozionet cervikale
- B) Periodontit kronik i riakutizuar
- C) Karies profund
- D) Absces apikal

16. Pacienti pyetet nëse ka pasur ndonjë traum kohë me parë kur:

- A) Gjatë përgatitjes së kavitetit në një karies të thelle
- B) Gjatë bizotimit të mureve
- C) Në ekzaminimin objektiv vërejmë një dhëmb me ngjyrë të errët
- D) Gjatë dezinfektimit të kavitetit

17. Dhimbjet e forta të dhëmbit janë treguese të:

- A) Një patologjie akute pulpare
- B) Një patologjie kronike pulpare
- C) Abrazionit dentar
- D) Një patologjie kronike periodontale

18. Në cilat nga këto situata rekomandohet heqja e dhëmbit:

- A) Frakturë e dhëmbit me zbulim të pulpës
- B) Pamjaftueshmëri të strukturave të dhëmbit për tu restauruar
- C) Patologji periapikale e fistulizuar
- D) Dhimbje të forta pulpare

19. Sa kohë i duhet pulpës për të rikuperuar dëmet nga trauma procedurale:

- A) 2-4 javë
- B) Një javë
- C) 4 deri 6 javë
- D) 3 muaj

20. Në një dhëmb të mbushur me kompozite dhimbja e provokuar nga të nxehtit vjen:

- A) Nga nekroza e pulpës
- B) Pulpit purulent
- C) Hipersensibilitet pulpar
- D) Periodontiti purulent

21. Dhimbjet e lehta në kafshim pas procedurës së mbushjes vijnë nga:

- A) Mbushje e lartë në okluzion

- B) Hipersensibiliteti dentinar
- C) Pulpiti total
- D) Peridontiti apikal

22. Dhimbja pulsante me intermisione është karakteristike për:

- A) Pulpitet purulente
- B) Perikoronaritet
- C) Nekrobiozën e pulpës
- D) Periodontitet purulente

23. Prezenca e fistulës në forniks është karakteristike për:

- A) Periodontitin marginal
- B) Perforacionin furkal
- C) Peridontitin apikal
- D) Kanal i pambushur

24. Përhapja e dhimbjes drejt orbitës vjen:

- A) Pulpiti purulent në molarë
- B) Periodontiti purulent
- C) Nga sinuziti maksilar
- D) Aberacioni i kanalit nazolakrimal

25. Hemorragjia e provokuar nga thithja e dhëmbit është shenjë e:

- A) Pulpitit hipertrofik
- B) Periodontit apikal
- C) Perikoronariti
- D) Pulpiti ulceroz

26. Persistenca e dhimbjeve pulpore pas trajtimit endodontik ndodh:

- A) Pas një amputimi mortal,
- B) Pas një mbushje tej apeksit,
- C) Pas një amputimi vital,
- D) Pas një mbushje që nuk arrin apeksin

27. Dressing me Hidroksid Kalciumi është i efektshëm në trajtimin e flare-up se:

- A) Redukton bakteret dhe nivelin e produkteve toksike të metabolizmit bakterial
- B) Të gjitha të mësipërmet
- C) Alkaliniteti i tij ndihmon në neutralizimin e toksinave
- D) Ka efekt antibakterial

28. Ritrajtimi endodontik është imediat në:

- A) Dhëmbë me mbushje kanali jo adekuate dhe periodont normal
- B) Dhëmbë me mbushje kanali të rregullt por sqarimi nuk është reduktuar edhe pas një viti
- C) Dhëmbë me instrument të thyer në kanal pa shenja subjektive dhe objektive
- D) Dhëmbë me mbushje kanali të rregullt dhe me fistul

29. Cila është arsyeja më e shpeshtë për ritrajtim endodontik:

- A) Thyerja e instrumenteve
- B) Gabimi në diagnozë

- C) Kariesi recidivans
- D) Rënia e mbushjes koronare

30. Fraktura vertikale e rrënjës është më e shpeshtë gjatë :

- A) Shplarjes së kanaleve
- B) Teknikës me shumë kone
- C) Teknikës me një kon
- D) Kondensimit lateral

31. Cili nga këto nuk hyn në grupin e faktorëve jatrogene:

- A) Kunjat parapulpare
- B) Bruksizmi
- C) Presioni gjatë marrjes së masës
- D) Cementimi

32. Kush hyn në grupin e mediatorëve jo specifike të inflamacionit:

- A) Kalcitonina
- B) Histamina
- C) Katepsina G
- D) Elastaza

33. Kur dhimbjet janë të shkurtra, të mprehta dhe qetësohen menjëherë pas largimit të shkakut:

- A) Mbahet në observacion
- B) Bëhet trajtim endodontik
- C) Bëhet trajtim konservativ i pulpës
- D) Rekomandohen antibiotike

34. Nëse edhe pas trajtimit konservativ të pulpës dhimbjet persistojnë ose rikthehen duhet:

- A) Përsëritur mjekimi
- B) Dhënë antibiotike
- C) Bërë trajtim endodontik
- D) Mbajtur në observacion 1 muaj

35. Në cilat sensitiviteti rekomandohet ekstraksioni në një pulpit ireversibel:

- A) Kur ka dhimbje edhe në perkusion vertikal
- B) Kur kaviteti është shumë i thelle nën gingivë
- C) Kur ka dentikla pulpare
- D) Kur pacienti ka më shumë se një javë me dhimbje

36. Cili nga këto gabime shkaktohet nga hyrja e ngushtë endodontike:

- A) Mbizgjerim i kanalit
- B) Thyerje e mureve laterale të kurorës
- C) Mbinstrumentim
- D) Lënie e mbeturinave pulpare

37. Mbihapja e kavitetit endodontik:

- A) Vështirëson instrumentimin
- B) Rrit riskun për frakturë të kurorës

- C) Rrit mundësinë e thyerjes së instrumenteve
- D) Bëhet shkak për pragje

38. Perforimi i mureve laterale të kurorës evitohet:

- A) Duke u orientuar nga dhëmbët fqinjë
- B) Duke u orientuar nga dhëmbët antagonistë
- C) Duke punuar me turbinë
- D) Duke punuar paralel me aksin gjatësor të dhëmbit

39. Faktori kryesor përgjegjës për inflamacionin pulpar është:

- A) Faktori nervor
- B) Të dyja të mësipërmet
- C) Faktori indor
- D) Asnjëra e vërtetë

40. Periodontiti kronik apikal diferencohet nga periodontiti apikal akut përmes:

- A) Testit pulpar dhe radiografisë
- B) Radiografisë dhe shenjave klinike
- C) Testit pulpar dhe shenjave klinike
- D) Testit pulpar, radiografisë dhe shenjave klinike

41. Shumica e pacientëve që kanë dhimbje të forta të dhëmbit diagnostikohen me:

- A) Absces periodontal
- B) Periodontit apikal akut
- C) Pulpit ireversibël
- D) Absces apikal akut

42. Një pacient ankon për dhimbje konstante prej tre ditësh në anën e majtë të fytyrës, e cila shtohet kur pacienti ndërton pozicion apo vrapon. Në këtë rast diagnoza mund të jetë:

- A) Infarkt miokardi
- B) Pulpit ireversibel
- C) Dhimbje atipike faciale
- D) Sinuzit maksillar

43. Flare -ups (ekzacerbimet) gjatë një trajtimi endodontik:

- A) Janë më të shpeshta në dhëmbet me pulpë vitale se në ato me pulpë nekrotike
- B) Janë më të shpeshta në dhëmbet me leziona akute periapikale se ato me inde periapikale normale
- C) Janë më të shpeshta në dhëmbet simptomatikë me pulpë nekrotike
- D) Janë më të shpeshta në trajtimet endodontike me një seancë

44. Dhimbja nuk pushon pas largimit të ngacmuesit në:

- A) Hipereminë pulpare
- B) Kariesin profund
- C) Rezorbimin intern
- D) Pulpitin ireversibël

45. Apeks-lokatorët elektronikë nuk rekomandohen:

- A) Mbulim direkt të pulpës

- B) Kur strukturat anatomike mbivendosen mbi apeksin e rrënjës
- C) Një grua shtatzanë nuk dëshiron të bëjë radiografi
- D) Në paciente fizikisht të sëmurë

46. Në sensitivitetin e inflamacioneve reversibile të pulpës trajtimi është:

- A) Vendosja e hidroksidit të kalciumit +cement ZnOE
- B) Trajtim endodontik
- C) Mbajtja në observacion e dhëmbit pa trajtim
- D) Pulpotomia

47. Cila nga këto shenja është karakteristikë për periodontitin simptomatik apikal:

- A) Dhimbja nga të ëmblat
- B) Ndryshimi i ngjyrës
- C) Dhëmbi duket si i zgjatur
- D) Dhimbja e vazhdueshme

48. Në trajtimin e abscesit akut apikal dhënia e antibiotikëve rekomandohet:

- A) Në varësi nga përmasat e lezionit
- B) Në varësi nga gjendja e pacientit
- C) Në varësi nga mosha
- D) Nëse ka ose jo dhimbje

49. Cila nga këto është e vërtetë : Në një pacient që ka kaluar infarkt miokardi:

- A) Të gjitha të mësipërmet
- B) Mund të kryhet trajtim endodontik menjëherë pas infarktit
- C) Gjatë trajtimeve endodontike në këta pacientë nuk është e nevojshme të shoqërohen me terapi me antibiotikë
- D) Nuk duhet të kryhet trajtim endodontik deri në 6 muaj pas infarktit

50. Efekti i sterilizimit në instrumentat endodontike është :

- A) Neutral, asnjë efekt në vetitë fizike të tyre
- B) Negativ dhe proporcional me numrin e sterilizimeve
- C) Pozitiv, ai përmirëson fleksibilitetin e humbur gjatë përdorimeve
- D) Rrit fortësinë dhe qëndrueshmërinë

51. Cilat elemente të pulpës reagojnë ndaj temperaturës mbi 43 gradë:

- A) Zgjatimet odontoblastike
- B) Fibrat A
- C) Fibrat C
- D) Odontoblastet

52. Cila nga këto veti i përket pastave të kanalit:

- A) Të jetë opake ndaj rrezeve Roentgen
- B) Të jetë estetike
- C) Të ketë fortësi
- D) Të ketë veti bactericide

53. Funkzioni më i rëndësishëm i pastave të kanalit është:

- A) Lubrifikues
- B) Antinflamator

- C) Restaurues
- D) Sterilizues

54. Cili nga elementet e mëposhtme përdoret me shpesh për të vendosur për një trajtim endodontik:

- A) Dhëmb pranë një proteze ekzistuese
- B) Thellësia e zgavrës
- C) Rëndësia e dhëmbit në harkun dentar
- D) Lëvizshmëria e dhëmbit

55. Hapja e kavitetit endodontik paraqet vështirësi në:

- A) Dhëmbët monoradikularë
- B) Në kavitetet vestibulare
- C) Në frontalët mandibularë
- D) Në dhëmbët e abraduar

56. Reduktimi i tuberkulit meziobukal rekomandohet:

- A) Në kavitete të thella
- B) Për të lehtësuar pamjen
- C) Kur mungojnë dhëmbët antagonistë
- D) Kur ka dentikla radikulare

57. Kanali duhet përpunuar në kushte lagështie:

- A) Për të qetësuar dhimbjet
- B) Për të kursyer kohë
- C) Për të reduktuar mundësinë e thyerjes së instrumenteve
- D) Për eksplorimin e kanaleve laterale

58. Dalja e pastës së kanalit me bazë ZnOE tej apeksit ndikon në:

- A) Shërimin e shpejtë
- B) Uljen e edemës
- C) Nuk ka asnjë efekt
- D) Dhimbje pasoperatore të madhe

59. Cili nga këto është përbërësi kryesor i pastës Sealapeks:

- A) Dexamethasone
- B) Eugenoli
- C) Stearat siliciumi
- D) Hidroksid kalciumi

60. Në cilin vit janë zbuluar rrezet X:

- A) 1879
- B) 1890
- C) 1899
- D) 1895

61. Në vitin 1905 u fut në përdorim:

- A) Gazi gazmor
- B) Mikroskopi
- C) Novokaina

D)Guttaperka

62. Proceset e odontoblasteve janë në:

- A)Pulpë
- B)Smalt
- C)Dentinë
- D)Cement

63. Endodonti përbëhet nga:

- A)Pulpa
- B)Dentina dhe pulpa
- C)Dentina
- D)Pulpa dhe periodonti

64. Dentina sekondare fiziologjike modifikon:

- A)Përbërjen e pulpës
- B)Vetëm përmasat dhe formën e kanalit të rrënjës
- C)Përmasat dhe formën e dhomës pulpare dhe kanaleve
- D)Përbërjen e dentinës primare

65. Formimi i dentinës intertubulare fillon:

- A)Në apeksin e dhëmbit
- B)Në brendësi të kanalit
- C)Në kurorë
- D)Në dhomën pulpare

66. Fibrat elastike të pulpës janë të vendosura:

- A)Në matriksin interqelizor
- B)Pranë mureve të vazave të mëdha të gjakut
- C)Pranë kapilareve
- D)Në dentinë

67. Fibroza e pulpës ka të bëjë me:

- A)Procesin e plakjes
- B)Praninë e inflamacioneve periapikale
- C)Formimin e dentinës sekondare
- D)Formimin e dentinës primare

68. Cementi është i ngjashëm me:

- A)Indin kockor
- B)Indin lidhor
- C)Indin dhjamor
- D)Asnjëra

69. Lënda inorganike në cementin e rrënjës përbën:

- A)60%
- B)65%
- C)70%
- D)75%

70. Periodonti ka inervim:

- A) Autonom dhe sensor
- B) Motor
- C) Sensitiv dhe motor
- D) Sensitiv

71. Fibrat e ligamentit periodontal janë kryesisht me natyrë:

- A) Elastike
- B) Fibroze
- C) Kolagjenike
- D) Elastike dhe fibroze

72. Kontinuiteti i lamina dura në një radiografi tregon:

- A) Shtim të cementogenezes
- B) Për sëmundje të tij
- C) Për gjendje të shëndoshë të periodontit
- D) Formim të kockës së re

73. Kufiri limit i shpejtësisë së frezës gjatë pastrimit të masës karioze është:

- A) 4000rpm
- B) 4500rpm
- C) 5000rpm
- D) 3000rpm

74. Në një kanal të infektuar prania e baktereve anaerobe është më e shtuar në:

- A) Në brirët pulpare
- B) Në dhomën pulpare
- C) Në pjesën apikale të kanalit
- D) Në hyrje të kanaleve

75. Cila nga këto substanca bën pjesë në hormonet e inflamacionit:

- A) Leukotoksina
- B) Lipopolisaharidet
- C) Histamina
- D) Asnjëra

76. Mbinstrumentimi ndodh:

- A) Kur nuk kemi matur ekzakt gjatësinë e kanalit
- B) Kur kanali është i kthyer
- C) Kur nuk punojmë në kushte lagështie
- D) Kur nuk kemi hapur sa duhet dhomën pulpare

77. Cili nga këto fenomene shkakton zbulimin e tubulave dentinare:

- A) Pastrimi i gurëzave
- B) Erozioni cervikal
- C) Frakturat e smaltit
- D) Të treja të mësipërmet

78. Nerv-heqësit nuk duhen përdorur:

- A) Në një kanal të gjerë

- B) Në një kanal të ngushtë
- C) Në një kanal të obliteruar
- D) Në dhëmbët me shumë rrënjë

79. Gutapercha ka strukturë kristaline:

- A) 40%
- B) 30%
- C) 60%
- D) 80%

80. Cila nga këto veti të gutaperkës ndikon në një mbushje tredimensionale:

- A) Bëhet plastike kur ngrohet
- B) Ka shkrirës
- C) Nuk ngacmon indet
- D) Nuk ngjyros indet e dhëmbit

81. Pulpotomia në një dhëmb permanent të paformuar është e suksesshme kur:

- A) Pacienti është asimptomatik
- B) Zhvillimi i rrënjës vazhdon normal
- C) Dhëmbi është pozitiv në testet pulpare
- D) Të gjitha të mësipërmet

82. Cementet e kanalit janë toksike në:

- A) Pas forcimit
- B) Pas 24 orësh
- C) Pas 48 orësh
- D) Momentin e përzierjes

83. Kanali i lateralit maksilar është zakonisht i kthyer në drejtim:

- A) Distal
- B) Bukal
- C) Mezial
- D) Palatinal

84. Kanalet laterale në premolarët maksilarë janë:

- A) Rutinë
- B) Me sensitiviteti
- C) Të shpeshta
- D) Të pazakonta

85. Cili nga këto dhëmbë maksilarë perforohen me shpesh:

- A) Premolarët
- B) Lateralet
- C) Kaninët
- D) Molarët

86. Molari i parë maksilar mund të ketë 4 kanale në:

- A) 60% të sensitivitive
- B) 20 % të sensitivitive
- C) 40% të sensitivitive

D) 10% të sensitivitive

87. Cila nga rrënjët e molarit të parë maksilar mund të ketë dy kanale:

- A) Meziobukale
- B) Palatinale
- C) Distobukale
- D) Të treja

88. Perforacioni i rrënjës palatinale tek molarët maksilarë ndodh për shkak të:

- A) Drejtimit të instrumentit
- B) Hapjes së pamjaftueshme
- C) Inklinimit bukolingual
- D) Mbihapjes së kavitetit endodontik

89. Cilat elemente të pulpës reagojnë ndaj ngacmimeve mekanike:

- A) Fibrat A
- B) Fibrat C
- C) Zgjatimet odontoblastike
- D) Odontoblastet

90. Cilat elemente të pulpës reagojnë ndaj ngacmimeve osmotike:

- A) Fibrat A
- B) Odontoblastet
- C) Qelizat e padiferencuara pulpare
- D) Fibrat C

91. Shtyrja e mbeturinave të pulpës tej apeksit është minimale:

- A) Në kanale shumë të kthyer
- B) Në kanale të gjerë me teknikat manuale
- C) Në kanale të gjerë me teknikat rotatore
- D) Me teknikat ultrasonike

92. Cila nga këto është vërtetë:

- A) Dhimbja pas mbushjes së kanalit ka lidhje me nivelin e mbushjes
- B) Dhimbja pas mbushjes së kanalit ka lidhje me moshën e pacientit
- C) Dhimbja pas mbushjes së kanalit nuk ka lidhje me largimin e masave putride
- D) Dhimbja pas mbushjes së kanalit nuk ka lidhje me nivelin e mbushjes

93. Indikacionet për vida në kanal varen nga:

- A) Numri i rrënjëve
- B) Sasia e strukturës së mbetur në dhëmb
- C) Lloji i retensionit
- D) Diagnoza paraprake

94. Ngjyrosja në gri e dhëmbëve është pasojë e:

- A) Mbetjes së pastës në dhomë pulpare
- B) Hiperkalcifikimit dentinar
- C) Hemorragjisë intrapulpare
- D) Marrjes së tetraciklinës gjatë shtatzënisë

95. Në cilat nga këto sensitiviteti indikohet zbardhja e dhëmbëve:

- A) Në pacientë me humbje të smaltit
- B) Në pacientë me mbushje të mëdha
- C) Në pacientë me dhëmbë të shëndetshëm
- D) Në pacientë alergjikë

96. Objektivat e përpunimit të kanalit janë:

- A) Biologjike dhe mekanike
- B) Mekanike
- C) Biologjike
- D) Retentive

97. Cila nga këto rregulla nuk vlen për përpunimin e kanalit:

- A) Kanali duhet përpunuar në disa seanca
- B) Kanali duhet përpunuar duke ruajtur formën
- C) Nuk duhet të kalohet apeksi gjatë përpunimit
- D) Kanali duhet përpunuar në kushte lagështie

98. Cila nga këto është e pavërtetë:

- A) Mbushja provizore e kanalit ka qëllim të eliminojë bakteret e
- B) Mbushja provizore e kanalit ka qëllim të parandalojë rikolonizimin
- C) Mbushja provizore e kanalit ka qëllim të shkrijë mbeturinat indore
- D) Mbushja provizore ka qëllim zgjerimin e kanalit

99. PH i Hipokloritit të natriumit varion nga:

- A) 12-14
- B) 7.5-8.9
- C) 10.7-12.2
- D) 5.7-7.8

100. Solucioni 15% i EDTA është mjaft efektiv ndaj:

- A) Florës aerobe
- B) Florës anaerobe
- C) Sporeve
- D) Kërpudhave

101. EDTA 10% përdoret në:

- A) Kanalet e gjerë
- B) Kanalet sklerotike
- C) Dhëmbët me pulpë vitale
- D) Dhëmbët me rrënjë të paformuar

102. Trashësia e periodontit në dhëmbët e të rinjve është:

- A) 0.40mm
- B) 0.10-0.15mm
- C) 0.20-0.25mm
- D) 0.30-0.35mm

103. Kur dentiklat pulpare janë evidente në radiografi kjo tregon:

- A) Që duhet të bëhet pulpektomia vitale

- B) Që pacienti do të ketë dhimbje pulpare në të ardhmen
- C) Një pulpë normale
- D) Që pulpa ka qene dëmtuar në të kaluarën dhe është mbrojtur

104. Në një dhimbje dentare cili nga ekzaminimet e mëposhtme vlen me shumë për përcaktimin e diagnozës:

- A) Ekzaminimi radiologjik
- B) Perkusioni
- C) Një ekzaminim i plotë hap pas hapi
- D) Ekzaminimi subjektiv

105. Zona sqarimi janë evidente në një ekzaminim radiologjik kur:

- A) Dhëmbi është sensibil nga të ftohtat
- B) Zona kortikale e kockës është shkatërruar
- C) Dhëmbi është sensibil ndaj perkusionit
- D) Është identifikuar një frakturë

106. Trajtimi endodontik kundraindikohet kur:

- A) Ka një lezion periapikal të gjerë
- B) Kanali është i kalcifikuar
- C) Pacienti nuk është i motivuar
- D) Dhëmbi ka nevojë për zgjatje periodontale të kurorës

107. Në një incisor mandibular cila është sipërfaqja që perforohet me shpesh:

- A) Linguale
- B) Distale
- C) Meziale
- D) Labiale

108. Rrënja që ka më rrallë dy kanale është:

- A) Rrënja distobukale në molarin maksilar
- B) Rrënja e centralit mandibular
- C) Rrënjët e premolarit të dytë maksilar
- D) Rrënja distale e molarit të parë mandibular

109. Pasta e kanalit nuk preferohet të dalë jashtë apeksit sepse:

- A) Rrezorbohet
- B) Nxit rritjen bakteriale
- C) Ngjyros indet e buta
- D) Është irrituese dhe vonon shërimin

110. Hiperemia e pulpës është:

- A) Proces kronik
- B) Proces kronik i riakutizuar
- C) Proces akut
- D) Asnjë e vërtetë

111. Në pulpitin akut purulent dhimbja:

- A) Qetësohet nga të nxehtat
- B) Provokohet nga mastikacioni

- C) Qetësohet nga të ftohtat
- D) Asnjë e vërtetë

112. Në pulpitin kronik hipertrofik ka:

- A) Dhimbje gjatë ngrënies
- B) Dhimbje të vazhdueshme pulsante
- C) Dhimbje pas stimulit termik
- D) Dhimbje spontane

113. Rolin kryesor në vendosjen e diagnozës së pulpiteve e ka:

- A) Radiografia
- B) Anamneza
- C) Perkusioni
- D) Testi elektrik

114. Niveli i mbushjes së kanalit në patologjitë pulpare duhet të jetë deri:

- A) Në majën e rrënjës
- B) 1 mm afër majës së rrënjës
- C) 4 mm nga maja e rrënjës
- D) Tej majës së rrënjës

115. Cili nga testet e mëposhtme nuk është i vlefshëm për diagnozën e hiperemisë pulpare:

- A) Testi klinik
- B) Testi termik
- C) Testi elektrik
- D) Testi radiologjik

116. Në cilat patologji ka më shumë vlerë elektrotesti pulpar:

- A) Hipereminë pulpare
- B) Pas nje traume akute
- C) Kariesin aproksimal
- D) Erozionin dentar

117. Në pulpitet kronike proceset proliferative janë:

- A) Nuk luajnë asnjë rol
- B) Më hipoaktive
- C) Më hiperaktive
- D) Më akute

118. Dhimbja spontane që zakonisht fillon natën është:

- A) Në pulpitin akut purulent
- B) Në pulpitin kronik gangrenoz
- C) Në pulpitin akut seroz total
- D) Në nekrozën pulpare

119. Në cilat nga këto patologji përhapet dhimbja:

- A) Në pulpit kronik ulceroz
- B) Në pulpit akut purulent
- C) Në periodontit kronik fibroz

D) Në hiperemi pulpare

120. Teknika e amputimit vital përdoret kryesisht në:

- A) Kur nuk ka përfunduar formimi i rrënjevë
- B) Pulpitin traumatik
- C) Pulpitin akut seroz parcial
- D) Pulpit kronik

121. Cila nga këto janë simptoma të pulpitit akut serozë total:

- A) Zgavër e madhe karioze ku dhoma e pulpës është e hapur
- B) Dhimbje pulsante
- C) Qetësohet nga të ftohtat
- D) Kriza dhimbje të shpeshta e të gjata, me periudha qetësie të shkurtra

122. Numri i tubulave dentinarë është më i madh:

- A) Në afërsi me smaltin
- B) Në afërsi me cementin
- C) Në afërsi me pulpën
- D) Në të gjitha të mësipërmet

123. Fibroblastet janë qeliza të pulpës përgjegjëse për:

- A) Multifunkionale
- B) Inflamacionin
- C) Prodhimin e lëndës bazale dhe kolagjenit
- D) Dentinogenezën

124. Cila nga këto janë veti të faktorit të nekrozës tumorale (TNF):

- A) TNF përmirëson rrigjenerimin kockor
- B) TNF shton formimin e kolagjenit
- C) TNF është një stimulues i fuqishëm i rezorbimit kockor
- D) TNF nxit proliferimin qelizor

125. Shqetësimet pas procedurave terapeutike parandalohen nëse:

- A) Rruhen principet bazë biologjike
- B) Zbatohet parimi mekanik
- C) Rruhet asepsia
- D) Asnjë e vërtetë

126. Solucioni 2.5% i hipokloritit të natriumit:

- A) Nuk ka efekt antibakterial të mirë
- B) Ka efekt antibakterial të mirë por jo shkrirës
- C) Ka efekt antibakterial të mirë dhe shkrirës
- D) Ka efekt asnjëanësues

127. Në lezionet periapikale që dominohen me vështirësi nga trajtimi endodontik flora bakteriale përbëhet nga:

- A) Mikroorganizma gram-
- B) Mikroorganizma virusale
- C) Mikroorganizma gram+ dhe -
- D) Mikroorganizma aerobe

128. Reflektimi i verdhë në kafe në një dhëmb intakt është pasojë:

- A) Maturimit të zmalit
- B) E erozionit cervikal
- C) E një traume kohë më parë
- D) Demineralizimit

129. Cili nga këto materiale rekomandohet për testin me të nxehtë:

- A) Lampa e polimerizimit
- B) Ujë i nxehtë
- C) Instrument i nxehtë
- D) Shkop gutaperke e ngrohur

130. Në cilat situata rekomandohet anestezia selektive:

- A) Kur pacienti nuk përcakton dot dhëmbin shkaktar
- B) Kur pacienti ka dhimbje në perkusion vertikal
- C) Kur pacienti është pa dhimbje dhe ka fistul intraorale
- D) Kur pacienti është me dhimbje dhe nuk e përcakton dot dhëmbin shkaktar

131. Cila nga këto substanca i bën radiopake materialet e mbushjes se kanalit:

- A) Sulfat bariumi
- B) Thymoli
- C) Dexamethazoni
- D) Oksid zinku

132. Si identifikohet një perforacion i rrënjës në radiografi:

- A) Kur kemi trashje të ligamentit periodontal
- B) Kur kemi zgjerim të ligamentit periodontal apikal
- C) Kur kemi ndërprerje të dentinës së rrënjës
- D) Kur kemi rezorbim ekstern

133. Mbushja e kanalit në pulpitet ireversibile nuk duhet jete më e shkurtër se:

- A) 4mm nga apeksi i rrënjës
- B) 2mm nga apeksi i rrënjës
- C) 3mm nga apeksi i rrënjës
- D) 5mm nga apeksi i rrënjës

134. Mbushja e kanalit në patologjitë periapikale nuk duhet jete më e shkurtër se:

- A) 0.5mm nga apeksi i rrënjës
- B) 2 mm nga apeksi i rrënjës
- C) 2.5 mm nga apeksi i rrënjës
- D) 1.5 mm nga apeksi i rrënjës

135. Medikamentet në kanal bëhen inaktive pas:

- A) Dy javësh
- B) Një jave
- C) Një muaji
- D) 24 orëve

136. Efekti i zgjatur antibakterial i pastës së hidroksidit të kalciumit varet nga:

- A) Koha e përzierjes
- B) Sasia e pastës
- C) PH alkaline i lartë e konstant
- D) Solucioni me të cilin përzihet

137. Për cilën nga këto arsye pacienti ankon dhimbje dhe pas anestezisë:

- A) Moshë e pacientit
- B) Diagnoza e pasaktë
- C) Trauma okluzale
- D) Sasia e pamjaftueshme e anestetikut

138. Aliazhi nikel-titanium në instrumentet e kanalit rrit:

- A) Tendencën për pragje
- B) Kohën e manipulimit
- C) Vështirësitë operatorë
- D) Fleksibilitetin

139. Kanalet laterale dhe furkale krijohen:

- A) Gjatë formimit të dhëmbit
- B) Pas formimit të dhëmbit
- C) Gjatë formimit të kurorës
- D) Pas daljes së dhëmbëve

140. Sa % e kanaleve janë të kthyera:

- A) Afërsisht 75%
- B) 80%
- C) Mbi 90%
- D) 65%

141. Cilat nga këto rrënjë nuk ka asnjëherë dy kanale:

- A) Kaninët mandibulare
- B) Rrënja palatinale tek molarët maksilarë
- C) Rrënja distale e molareve mandibulare
- D) Premolarët maksilarë me një rrënjë

142. Cila nga këto është e vërtetë:

- A) Brirët pulpare janë më larg kuspideve tek të rinjtë
- B) Brirët pulpare janë më afër kuspideve tek të moshuarit
- C) Brirët pulpare janë më afër kuspideve tek të rinjtë
- D) Lokalizimi i brirëve pulpare nuk varet nga moshë

143. Cila nga këto është e vërtetë:

- A) Në dhëmbët e të moshuarve dhoma pulpare ndodhet në mesin e kurorës
- B) Në dhëmbët e të moshuarve dhoma pulpare ndodhet në afërsi të kufirit smalt-cement
- C) Në dhëmbët e të moshuarve dhoma pulpare ndodhet në afërsi të kufirit smalt-dentinë
- D) Në dhëmbët e të moshuarve dhoma pulpare nuk ndryshon lokalizimin në të rinjtë

144. Kanalet laterale gjenden më shpesh në:

- A) Regjionin koronar të rrënjëve të dhëmbëve frontale mandibulare
- B) Regjionin koronar të rrënjëve të dhëmbëve frontale maksilarë

- C) Regjionin e mesëm të rrënjëve të premolarëve maksilarë
- D) Regjionin e të tretës apikale të dhëmbëve posteriore

145. Gjatësia mesatare e centralit maksilar është:

- A) 28mm
- B) 31mm
- C) 20.0mm
- D) 22.5mm

146. Gjatësia mesatare e molarit të parë mandibular:

- A) 21.0mm
- B) 22.5 mm
- C) 18.0 mm
- D) 25mm

147. Reduktimi i kuspideve në trajtimet endodontike:

- A) Ul mundësinë e thyerjes së mureve
- B) Lehtëson manipulimet
- C) Ndihmon në fazën e mbushjes së kanalit
- D) Ndihmon në përcaktimin e gjatësisë së dhëmbit

148. Përbërësit aktivë të iriganteve duhet të kenë:

- A) Toksicitet të lartë indor
- B) Vetë të larta antibakteriale
- C) Tension sipërfaqësor të lartë
- D) Vetë remineralizuese

149. Radiografia në kafshim jep informacion:

- A) Për strukturën e 16 dhëmbëve
- B) Për strukturën e gjithë dhëmbëve
- C) Për strukturën e 2 dhëmbëve
- D) Për strukturën e 4 dhëmbëve

150. Nëse një dhëmb është sensitiv ndaj perkusionit dhe shtypjes, ka lëvizshmëri dhe duket si i zgjatur diagnoza është:

- A) Patologji pulpare akute
- B) Patologji pulpare kronike
- C) Rezorbim intern
- D) Patologji periapikale akute

151. Hidroksidi i kalciumit për të arritur efektin antibakterial maksimal duhet të rrije:

- A) Dy ditë në kanal
- B) Një javë në kanal
- C) Katër ditë në kanal
- D) Tre ditë në kanal

152. Cila nga këto veti nuk i realizon irrigimi me hipoklorit natriumi:

- A) Hemostazë
- B) Shkatërron mikrobet

- C) Shkrirje të debris
- D) Lubrifikim të instrumenteve

153. Faktori më efektiv për largimin e mbeturinave në kanal është:

- A) Instrumentet me numër të vogël
- B) Solucionet gërryese
- C) Shpeshtësia dhe sasia e iriguesit
- D) Majat ultrasonike

154. Gutaperka në kontakt me indet është:

- A) Biokompatibël
- B) Relativisht inerte
- C) E paqëndrueshme
- D) Karcinogene

155. Nuk duhet që pasta të dalë jashtë apeksit sepse:

- A) Zakonisht nuk rezorbohet
- B) Ngjyros indet
- C) Ngacmon indet dhe vonon shërimin
- D) Nxit rritjen bakteriale

156. Trajtimi endodontik në një seancë rekomandohet:

- A) Kur pulpa është vitale asimptomatike
- B) Kur pulpa është gangrenoze
- C) Kur pulpa është nekrotike dhe simptomatike
- D) Kur pulpa është vitale dhe simptomatike

157. Cili është shkaku më i shpeshtë për dhimbjet kronike dentare:

- A) Erozioni dentar
- B) Abrazioni
- C) Kariesi recidivans nën një mbushje apo inlejt
- D) Mbushjet massive

158. Në cilat sensiviteti shfaqet më shpesh pulpiti hiperplastik:

- A) Kavitetet vestibulare
- B) Kavitete aproksimale në të rritur
- C) Kavitete aproksimale tek dhëmbët frontalet
- D) Kavitete okluzale tek të rinjtë

159. Cila nga këto formacione mund të keqinterpretohet si patologji periapikale në një radiografi:

- A) Kanali mandibular
- B) Sinusi maksillar
- C) Forameni incizival
- D) Foramen mentale

160. Cila dentinë zvogëlon madhësinë e hapësirës pulpare koronare dhe radikulare me kalimin e moshës:

- A) Intertubulare
- B) Terciare

- C) Primare
- D) Sekondare

161. Cila nga këto aparatura është e domosdoshme për diagnostikimin në traumat dentare:

- A) Pulp testeri
- B) Apeks lokatori
- C) Radiografia
- D) Aparatet ultrasonike

162. Cili nga këto faktorë etiologjike të patologjive periapikale nuk është kimik:

- A) Përbërës të materialeve të mbushjes
- B) Solucionet iriguese
- C) Toksinat bakteriale
- D) Medikamentet kanalore

163. Në fazën e parë të inflamacionit kush drejton ndryshimet vasculare:

- A) Fibrinogjeni
- B) Qelizat e padiferencuara
- C) Histamina
- D) Bradikinina

164. Era e keqe në gangrenën e dhëmbit vjen nga:

- A) Putrescina dhe kadaverina
- B) Proteinat bakteriale
- C) Acidet yndyrore
- D) Ekzotoksinat bakteriale

165. Gangrena e mbyllur vjen zakonisht pas një:

- A) Mbulimi direkt të pulpës
- B) Traume
- C) Kariesi profund
- D) Pastrimi gurëzash

166. Për të parandaluar shtyrjen e masave putride drejt apeksit:

- A) Duhet të bëhet përpunimi mekanik në të thatë
- B) Duhet të evitohet vibracioni i shtuar
- C) Duhet të bëhen lëvizjet lart e poshtë në kanal
- D) Duhet të jepen antibiotike

167. Shenja kryesore e perforacionit është:

- A) Gjakrrjedhja
- B) Dhimbja e fortë
- C) Edema pasoperatore
- D) Dhimbja në palpacion

168. Cili nga këta faktorë ndikon për daljen e mbushjes jashtë apeksit:

- A) Përdorimi i konit më të vogël se zgjeruesi i fundit
- B) Përdorimi i iriganteve
- C) Kthesat apikale

D) Lloji i pastës

169. Kur pas një trajtimi endodontik lezioni periapikal zmadhohet rekomandohet:

- A) Ekstraksion
- B) Antibiotikoterapi
- C) Ritrajtim endodontik
- D) Konstruksion protetik

170. Pulpa e ekspozuar gjatë pastrimit të masës karioze konsiderohet:

- A) E infektuar
- B) Normale
- C) E inflamuar dhe infektuar
- D) Sklerotike

171. Cili nga këto kritere nuk vlerësohet në mbulimin direkt të pulpës:

- A) Mungesa e ndryshimeve radiologjike
- B) Mungesa e dhimbjes spontane
- C) Madhësia e kavitetit
- D) Mungesa e dhimbjes në perkusion

172. Cili nga këto faktorë është determinues për indikacionin e një mbulimi direkt të pulpës:

- A) Përmasat e ekspozimit
- B) Pozicioni i ekspozimit
- C) Materiali për mbulim
- D) Moshë e pacientit

173. Pulpotomia konsiderohet metodë trajtimi e përkohshme në:

- A) Dhëmbët e frakturuar
- B) Dhëmbët me pulpit kronik ulceroz
- C) Dhëmbët me rrënjë të paformuar
- D) Dhëmbët nekrotike

174. Pulpektomia duhet të pasojë një pulpotomi kur:

- A) Ka përfunduar formimi i rrënjës
- B) Qetësohen simptomat
- C) Zhduket fistula
- D) Ulet edema

175. Likuidi seroz në kanal mund të vijë nga:

- A) Veprimi i solucioneve anestetike
- B) Irritimi kalimtar i indeve periapikale
- C) Trauma okluzale
- D) Orania e bakteve anaerobe

176. Cila nga këto nuk është kriter për mbushjen e kanalit:

- A) Mungesa e eksudatit
- B) Era e keqe nga kanali
- C) Gjakrrjedhja nga gingiva
- D) Dhimbja në perkusion

177. Cila nga këto nuk është kriter vlerësues për cilësinë e mbushjes së kanalit:

- A) Hapësira midis mbushjes dhe mureve të kanalit në RO
- B) Materiali duhet të jetë uniform që nga pjesa koronare e kanalit deri në majën e rrënjës në RO
- C) Gutaperka duhet të ketë formën e kanalit në RO
- D) Prezenca e simptomave pas mbushjes

178. Në cilat nga këto sensitiviteti nuk rekomandohet mbushja e kanalit me Hidroksid kalciumi:

- A) Në perforacionet
- B) Për apeksifikimin e rrënjës
- C) Në lezionet periapikale
- D) Pulpektomi vitale për arsye protetike

179. Cili nga këto avantazhe i përket teknikes së kondensimit vertikal:

- A) Manipulohet lehtë
- B) Kontrollon nivelin e mbushjes
- C) Mbush të gjitha parregullsitë e sistemit të kanalit
- D) Nuk kërkon pajisje të veçanta

180. Pragu formohet gjatë:

- A) Në kanalet e gjerë
- B) Në kanalet e drejta
- C) Përpunimit me instrumente fleksibel
- D) Nga një hyrje jo e mjaftueshme

181. Cili është materiali më i zgjedhur për trajtimin e perforacionit:

- A) Amalgami
- B) Dycal
- C) Oksifosfat cementi
- D) MTA

182. Kufiri maksimal për mbushjen e kanalit është:

- A) 2 mm nën apeks
- B) Maja e rrënjës
- C) 4mm nën apeks
- D) Kufiri midis dentinës dhe cementit

183. Fraktura vertikale e rrënjës ndodh më shpesh gjatë:

- A) Teknikes me një kon
- B) Kondensimit lateral
- C) Teknikes me shume kone
- D) Kondensimit vertikal

184. Cila nga këto faza favorizon frakturën vertikale:

- A) Mbushja e kanalit me një dressing
- B) Përcaktimi i gjatësisë së instrumentimit
- C) Vendosja e vidave në kanal
- D) Irrigimi me ultrasonic

185. Cili është mjete më efikas për parandalimin e inspirimit të instrumenteve të imët:

- A) vendosja e rubberdamit
- B) Informimi i pacientit
- C) Përvoja profesionale
- D) Pozicioni i pacientit

186. Ndjeshmëria pas pulpektomisë është normale deri:

- A) Në një muaj
- B) Në një javë
- C) Në 3-4 ditë
- D) Në tre muaj

187. Neuralgia pas pulpektomise ndodh më shpesh tek:

- A) Lateralët maksilarë
- B) Molarët e tretë maksilarë
- C) Premolarët mandibularë
- D) Dhëmbët e qumështit

188. Në cilat nga këto sensitiviteti nuk indikohet kirurgjia endodontike:

- A) Frakturë radikulare në një të tretën apikale
- B) Rrënjë të shkurtra
- C) Hapje e madhe e foramenit apikal
- D) Kalcifikim i plotë i kanalit

189. Në cilat sensitiviteti indikohet rezeksioni apikal:

- A) Rrezik për infeksion fokal
- B) Thyerja e instrumenteve në një të tretën apikale
- C) Rezorbim intern me perforim
- D) Shtatzënia

190. Cila nga këto është e vërtetë:

- A) Jonoforeza shkurton numrin e seancave
- B) Jonoforeza ndikon në gjithë gjatësinë të kanalit
- C) Jonoforeza nuk kërkon aparaturë speciale
- D) Ndikon në shërimin e shpejtë të vatrave inflamatorë

191. Jonoforeza me klorur zinku përdoret:

- A) Në një pulpit kronik ulceroz
- B) Në perforacionin lateral të rrënjës
- C) Në kanale të infektuar
- D) Kur kemi instrumente të thyer në kanal

192. Cila nga këto nuk është e vërtetë:

- A) Në jonoforzën hidroksile joni OH nuk ndikon fermentet
- B) Në jonoforzën hidroksile joni OH ul virulencën e mikrobeve
- C) Në jonoforzën hidroksile joni OH kthen PH nga acid në alkalin
- D) Në jonoforzën hidroksile joni OH ndihmon veprimtarinë e leukociteve

193. Cila nga këto sensitiviteti ndikon në mbushjen jo të plotë të kanalit:

- A) Formimi i pragut
- B) Shtyrja e mbeturinave drejt apeksit
- C) Kthesat e forta
- D) Kalcifikimet në kanal

194. Kur odontoplastet shkatërrohen ato zëvendësohen nga diferencimi i:

- A) Fibroblastet
- B) Qelizave mezenkimale të padiferencuara
- C) Odontoblasteve të padiferencuara
- D) Preodontoplastet

195. Sistemi limfatik në pulpën dentare:

- A) Transporton limfocitet në regjionin e inflamuar
- B) Nuk luan rol për shkak të daljes së tyre nga enët e gjakut
- C) Ndhmon në reduktimin e eksudatit
- D) Nuk mund të demonstrohet se janë të njëjta me venulat

196. Pas trajtimit endodontik prognoza mund të jetë e keqe kur pacienti:

- A) Kur lëvizshmëria e dhëmbit është klasa III dhe e shoqëruar me humbje të kockës alveolare
- B) Ka kaluar një flare-up midis seancave
- C) Ka dhimbje si ankesën kryesore
- D) Ka një sqarim periradikular të vogël

197. Në kundraindikacionet për një trajtim endodontik hyjnë:

- A) Historia mjekësore
- B) Kanale të kthyera
- C) Vështirësi në përpunimin e kanaleve
- D) Mosdëshira e pacientit për trajtim

198. Pulpotomia është metodë që përdoret :

- A) Në dhëmbët e qumështit
- B) Në dhëmbët me patologji periapikale
- C) Në dhëmbët me pulpit total
- D) Në dhëmbët permanentë tek të rinjtë

199. Fibrat elastike të pulpës vendosen:

- A) Pranë mureve të vazave të mëdha të gjakut
- B) Në matriksin intraqelizor
- C) Në odontoplastet
- D) Në dentinë

200. Irrigimi me hipoklorit natriumi ka vetitë e mëposhtme përveç njëjës. Cila është?

- A) Shplarje mekanike
- B) Lubrifikim të instrumentave
- C) Hemostazë
- D) Shpërbërje të indeve nekrotike

201. Periodontiti apikal asimptomatik zbulohet zakonisht:

- A) Gjatë vizitës me sondë eksplorative

- B) Testi termik
- C) Nga anamneza
- D) Gjatë kontrolleve radiologjike rutinë

202. Cila nga këto nuk është e vërtetë:

- A) Ngacmimi gjatë elektrotetit nuk mund të dozohet me saktësi
- B) Reaksionet fizike dhe kimike gjatë elektrotetit janë të kthyeshme
- C) Rryma elektrike gjatë elektrotetit vepron menjëherë
- D) Ngacmimi gjatë elektrotetit mund të përsëritet pa dëmtuar indet.

203. Për cilat nga këto arsye e referojmë te një koleg specialist një trajtim endodontik:

- A) Rasti studiohet dhe vlerësohet i vështirë
- B) Një lezion që shërohet në kohë
- C) Thyerje të lentylosë
- D) Pulpit akut

204. Hyrja e kavitetit endodontik në molarët maksilarë lokalizohet:

- A) Në pjesën distale të faqes okluzale
- B) Në pjesën meziale të faqes okluzale
- C) Në qendër të faqes okluzale
- D) Vetëm në tuberkulim më të madh

205. Një kanal i katërt zakonisht gjendet në:

- A) Rrënjën distobukale të molarit të parë maksilar
- B) Rrënjën meziale të premolarit të parë maksilar
- C) Rrënjën palatinale të molarit të parë maksilar
- D) Rrënjën meziobukale të molarit të parë maksilar

206. Ritrajtimi i kanaleve të mbushura rekomandohet kur ato kanë qenë të ekspozuar në ambientin e gojës për një periudhë:

- A) Një muaj
- B) Dy javë
- C) Tre muaj
- D) Pesë javë

207. Aktiviteti antimikrobiale i pastës së hidroksidit të kalciumit varet nga:

- A) Koncentrimi i joneve OH-
- B) Konsistenca
- C) Raporti pluhur-lëng
- D) Përqëndrimi i likidit

208. Në pulpitet aretro flora mikrobiale është:

- A) E njëjtë me atë të xhepave paradontale
- B) Gram-negative
- C) A dhe B
- D) Gram-pozitive

209. Cila nga këto simptoma i përket pulpitit akut seroz parcial:

- A) Kriza dhimbje të shpeshta dhe të gjata
- B) Dhimbje pulsante
- C) Pacienti nuk përcakton dot dhëmbin shkaktar

D) Dhimbje spontane, natën në formë krize me ndërprerje të gjata

210. Në cilën nga këto patologji i sëmurit mban ujë të ftohtë në gojë për tu qetësuar:

- A) Në pulpitin kronik ulceroz
- B) Në pulpitin akut purulent
- C) Në hipereminë pulpare
- D) Në pulpitin akut seroz parcial

211. Cila është diagnoza më e mundshme kur dhëmbi përgjigjet negativisht në testin elektrik dhe termik:

- A) Hiperemi pulpare
- B) Karies profund
- C) Nekrozë pulpare
- D) Pulpit akut total

212. Formimi i periodontit përfundon:

- A) Në një kohë me majën e rrënjës
- B) Një vit pas formimit të majës së rrënjës
- C) 6 muaj pas formimit të majës së rrënjës
- D) Një vit e gjysmë pas formimit të majës së rrënjës

213. Në cilën fazë të periodontitit akut qelbëzues ka më shumë dhimbje pacienti:

- A) Subperiostale
- B) Kockore
- C) Periodontale
- D) Mukozale

214. Në cilat forma të periodontiteve nuk kemi ndryshime radiologjike:

- A) Kronike
- B) Kronike granulare
- C) Kronike të riakutizuara
- D) Akute

215. Cila është shenja kryesore në një periodontit kronik granular:

- A) Temperatura e lartë
- B) Dhimbja në perkusion
- C) Fistula
- D) Dhimbja pulsante

216. Medikamentet në kanal vendosen për të:

- A) Zgjeruar kanalit
- B) Lehtësuar fazën e mbushjes së kanalit
- C) Eliminuar florën bakteriale
- D) Ulur edemën

217. Në sensibilitetin dentinar dhimbja:

- A) Zgjat disa orë
- B) Fillon menjëherë pas stimulimit nga disa faktorë
- C) Pushon nga të nxehtat
- D) Shfaqet natën

218. Dhimbja që nuk pushon pas largimit të ngacmuesit ndodh në:

- A) Peridontitet kronike
- B) Kistën apikale
- C) Hiperemine pulpare
- D) Pulpitet ireversibile

219. Cila është arsyeja që pacienti vjen me dhimbje të forta pas daljes së anestezisë pas trajtimit endodontik në një pulpit ireversibel:

- A) Hemorragjia gjatë ekstirpimit
- B) Heqja jo e plotë e pulpës
- C) Përdorimi i instrumenteve rotary
- D) Përdorimi i ujit të oksigjenuar

220. Polipi pulpar zhvillohet:

- A) Në kariesin okluzal në pacientë të rinj
- B) Në pacientë të moshuar
- C) Në pacientë diabetike
- D) Në pacientë që konsumojnë shumë karbohidrate

221. Në periodontitin apikal simptomatik rekomandohet:

- A) Vazhdimi i manipulimeve të trajtimit endodontik
- B) Perforimi i foramenit apikal
- C) Dhënia e antibiotikeve
- D) Lënia pa mjekim

222. Ndërhyrja kirurgjikale në periodontitin apikal asimptomatik rekomandohet:

- A) Në pacientë të moshuar
- B) Në dhëmbë multiradikular
- C) Kur është me natyrë nga kariesi i pamjekuar
- D) Për të shpejtuar shërimin

223. Abscesi kronik apikal është rezultat:

- A) I një infeksioni viral
- B) I një infeksioni bakterial me virulencë të ulët
- C) I një infeksioni bakterial me virulencë të lartë
- D) Vetëm i një infeksioni mykotik

224. Kolesterolit gjendet:

- A) Në kavitetin kistoz
- B) Në kanalën e rrënjës në periodontitin akut apikal
- C) Në kanalën e rrënjës në pulpitin kronik fibroz
- D) Në kanalën e rrënjës në pulpitin akut seroz

225. Analiza dhe vlerësimi i të dhënave për të përcaktuar diagnozën bëhet:

- A) Para marrjes së anamnezës shëndetësore
- B) Pas informimit të pacientit mbi trajtimin
- C) S'ka rëndësi se kur
- D) Pas ekzaminimeve radiologjike

226. Për cilat nga këto sëmundje nuk është i domosdoshëm informacioni gjatë anamnezës:
- A) Sëmundjet kardiake
 - B) Diabeti
 - C) Sëmundjet e traktit respirator
 - D) Sëmundjet e gjakut
227. Cili nga këto teste ka vlere më të madhe në përcaktimin e periodontitit apikal:
- A) Testi termik
 - B) Testi elektrik
 - C) Testi i palpacionit
 - D) Testi i perkusionit
228. Thellime të kufizuara të xhepit paradontal mund të jenë:
- A) Periodontitit akut apikal
 - B) Indikacion i një frakture të rrënjës
 - C) Gangrena e dhëmbit
 - D) Pulpit kronik gangrenoz
229. Qëllimi kryesor i pulpotomisë në dhëmbët me rrënjë të paformuar është:
- A) Të formohet plotësisht rrënja
 - B) Të ulë shenjat e inflamacionit
 - C) Të mbetet sa më shumë ind pulpar
 - D) Të qetësojë dhimbjen
230. Cila nga këto shenja përbën kundraindikacion për pulpotominë:
- A) Dhimbja nga të ftohtat
 - B) Sensibiliteti në perkusion
 - C) Dhimbja që pushon me largimin e shkakat
 - D) Dhimbja që zgjat disa minuta
231. Cila është metoda më e preferuar e trajtimit të pulpalgisë akute:
- A) Pulpektomia
 - B) Pulpotomia
 - C) Mbulimi indirekt i pulpës
 - D) Mbulimi direkt i pulpës
232. Shkaku kryesor i reaksioneve indore persistente është:
- A) Trajtimi endodontik me një seancë
 - B) Trajtimi endodontik me shumë seanca
 - C) Instrumentimi i pamjaftueshëm
 - D) Diagnoza paraprake
233. Antibiotikët gjatë trajtimit të dhëmbëve jo vitalë në disa pacientë jepen:
- A) Doza minimale
 - B) Në doza sulmi
 - C) Në doza të zakonshme
 - D) Në doza profilaktike

234. Dalja e materialeve të mbushjes tej apeksit shkakton:

- A) Shërim të shpejtë të proceseve periapikale
- B) Irritim të indeve periapikale
- C) Bllokim të majës së rrënjës
- D) Rrit përqindjen e suksesit

10. Terapi (Dentistri Restorative)

1. Kompozitet makrombushës kanë grimca mbushëse me diametër:

- A) 0,02-0,04 μm
- B) 0,01-0,03 μm
- C) 0,10-0,15 μm
- D) 0,12-0,17 μm

2. Fortësia e adezivitetit të dentinës në gjeneratën e V dhe të VI është:

- A) 15 MP
- B) 20 MP
- C) 30 MP
- D) 25 MP

3. Apeksifikimi i rrënjës mbas përdorimit të Hidroksidit të Calciumit i dedikohet:

- A) Vetive antiinflamatore
- B) Vetive antimikrobike
- C) Potencialit ostogjenik
- D) Të gjitha sëbashku

4. Periudha e kalcifikimit të dhëmbëve të përkohshëm 31-41, 11-21, 32-42, është:

- A) Në muajin e tetë pas lindjes
- B) Në muajin e gjashtë pas lindjes
- C) Në periudhën intrauterine
- D) Në muajin e 12 pas lindjes

5. Niveli i Streptokokut Mutans (CFU/ml) në pështymën e individëve me rrezik të lartë të kariesit është:

- A) $< 5,5 \times 10$
- B) $5,5 \times 10$
- C) $\geq 5,5 \times 10$
- D) $\leq 5,5 \times 10$

6. Shtresa e kompozitet 2mm polimerizohet me fibër optike me intensitet 280më/ cm

- A) 1 minutë
- B) 40 sekonda
- C) 2 minuta
- D) 20 sekonda

7. Në kompozitet mikrombushës grimcat SiO_2 kanë madhësi:

- A) 0,08 μm
- B) 0,02 μm
- C) 0,04 μm
- D) 0,10 μm

8. Adezioni i pjesëzave NANO me smaltin, në përberje të silanteve është:
- A) 16,9 MPa
 - B) 11,5 MPa
 - C) 18,1 MPa
 - D) 22,00 MPa
9. Silantet rezinoze kanë qëndrueshmëri mekanike që varion:
- A) 180 - 220 MPa
 - B) 200 - 250 MPa
 - C) 400 - 450 MPa
 - D) 300 - 350 MPa
10. Fluori që merret me anë të ushqimeve dhe ujit të pijshëm përthithet brënda 1 ore në masën:
- A) 75 %
 - B) 68 %
 - C) 55 %
 - D) 90 %
11. Tkurrja e kompozitit mbas aplikimit është:
- A) 25 mikron në vit
 - B) 100 mikron në vit
 - C) 75 mikron në vit
 - D) 200 mikron në vit
12. Kompozitet me pjesëza nanombushës përbëhen nga SiO₂ të veshura mesilan SiO₂ dhe ZrO₂ në përmasa:
- A) 20-75 μm
 - B) 20-30 μm
 - C) 30-40 μm
 - D) 15-30 μm
13. Ekologjia bucale e favorshme për shëndetin e dhëmbëve (densiteti i bakterieve) është:
- A) Asnjë e vërtetë
 - B) < 150000 CFU
 - C) > 100000 CFU
 - D) < 100000 CFU (Colony Forming Unit)
14. Cila nga këto lloje bakterie nuk është e pranishme në pllakën subgingivare:
- A) Streptococcus mutans
 - B) Bacteriodes forsythus
 - C) PorPHYromonas gingivalis
 - D) Treponema denticola
15. Në lezionet e thella karioze Streptokoku mutans është në masën:
- A) 30%
 - B) 45%
 - C) 60%

D)15%

16. Sa është koha e acidifikimit:

- A)5 sek
- B) 15 sek
- C)60 sek
- D)2 min

17. Cili është dhëmbi i parë i denticionit permanent që del në gojë:

- A)Premolari i parë
- B)Incizivët central
- C)Incizivët lateral
- D)Molari i parë

18. Përcaktimi i ngjyrës kryhet kur dhëmbi është:

- A)I lagur nga pështyma dhe në ndricim natyral
- B)I lagur nga pështyma
- C)I lagur nga pështyma dhe në driten e reflektorit
- D)I thatë

19. Cili nga egzaminimet e mëposhtme na jep të dhëna në lidhje me periodontin:

- A)Perkursioni
- B)Palpacioni
- C)Provat termike
- D)Elektrodiagnostiku

20. Cili nga indet e mëposhtme fikson dhëmbin në alveolë:

- A)Dentina
- B)Cementi
- C)Kocka alveolare
- D)Periodonti

21.Ruber dami shërben për:

- A)Vendosjen e medikamenteve në kavitet
- B)Separimin e dhëmbëve
- C)Diagnostikimin e kariesit
- D)Izolimin e dhëmbit

22. Cili nga faktorët e mëposhtëm ndikon në cilësitë e amalgamit dentar:

- A)Raporti pluhur-zhivë
- B)Koha e perzierjes
- C)Të gjithë faktorët e mësipërm
- D)Shpejtësia e rrotullimeve të amalgamatorit

23. Personat që vuajnë nga hipoparatiroidizmi:

- A)Kanë incidencë të ulët të kariesit
- B)Kanë incidencë të lartë të kariesit
- C)Nuk ka lidhje midis sëmundjes dhe proceseve karioze
- D)Kanë prevalencë të ulët kariesi

24. Në procesin karioz:

- A) Dhimbja largohet me largimin e shkakut
- B) Dhimbja vazhdon me largimin e shkakut
- C) Dhimbja është pa shkak
- D) Dhimbja është natën

25. Cili nga pohimet është i vërtetë:

- A) Kariesi ka formë drejtkëndëshi
- B) Kariesi në smalt ka formën e një koni me bazë në drejtim të sipërfaqes së dhëmbit
- C) Kariesi në smalt ka formën ovale
- D) Kariesi në smalt ka formën e një koni me bazë në drejtim të dentinës

26. Rezina kompozite në kavitetin e preparuar vendoset në:

- A) Shtresa 3-4 mm
- B) Në shtresa 2mm
- C) Në një shtresë të vetme
- D) Në shtresa 5mm

27. PH i Ca(OH)_2 është:

- A) 10-11
- B) 12.4-13.4
- C) 7-8
- D) 5.4-6.4

28. Llaqet:

- A) Nxisin formimin e dentinës sekondare
- B) Obturojnë kanalzat dentinare
- C) Ndihmojnë në adezionin e mbushjes
- D) Bëjnë dezinfektimin e kavitetit

29. Cila nga këto cilësi i përket cementit oksifosfat:

- A) Ka një proces ekzotermik gjatë forcimit
- B) Ndryshon ngjyrë pas forcimit
- C) Stimulon dentinogenezën
- D) Bën diskolorim të dhëmbit

30. Smalti ka:

- A) 96% lëndë organike dhe 4% lëndë inorganike
- B) 70% lëndë inorganike 30% lëndë organike
- C) 96% lëndë inorganike 4% lëndë organike dhe ujë
- D) 92% lëndë inorganike 8% lëndë organike

31. Matrica e smaltit sekretohet nga:

- A) Ameloblastet
- B) Odontoblastet
- C) Cementoblastet
- D) Qelizat e Malasese

32. Përqindja e argjendit në aliazhin e amalgamit është:

- A) 55-60%
- B) 24-29%

- C) 75-80%
- D) 65-70%

33. Diferencimi i qelizave në odontogenëzë ndodh në stadin e:

- A) Lamina dentis
- B) Sythave
- C) Kambanë
- D) Kupës

34. Cili nga pohimet është i vërtetë:

- A) Smalti e ka origjinën nga mezenkima
- B) Smalti dhe dentina kanë origjinën nga ektoderma, ndërsa indet e tjera të dhëmbit nga mezenkima
- C) Invaginacioni Hertwig-Brun i jep fillësë formimit të rrënjës së dhëmbi
- D) Pulpa e organit adamantin i jep origjinë pulpës së dhëmbit

35. Cili pohim është i vërtetë?

- A) Tubulat dentinare përmbajnë në brendësi zgjatime të adamantoblasteve
- B) Tubulat dentinare përmbajnë në brendësi zgjatime të odontoblasteve
- C) Tubulat dentinare kanë diametër më të madh duke shkuar nga pulpa drejt periferisë
- D) Numri i tubulave zvogëlohet në drejtim të kufirit smalt-dentinë

36. Cila fazë i siguron qëndrueshmëri të lartë mekanike amalgamit:

- A) Faza Y2
- B) Faza Y
- C) Faza n'
- D) Faza Y1

37. Acidifikimi i smaltit (kur përdorim kompozite) në nivelin e smaltit të jashtëm penetron në thellësi:

- A) 8 μm
- B) 15 μm
- C) 10 μm
- D) 18 μm

38. Kanalet e shpërndarjes ndodhen në:

- A) Në kufirin smalt-dentinë
- B) Në dentinën e sapoformuar
- C) Strukturën e kristaleve të smaltit
- D) Në cement

39. Matrica organike e rezinave kompozite përmban:

- A) Metil metakrilat
- B) Glycidil metakrilat
- C) Dimetil metakrilat
- D) Bisfenol glycidyl metakrilat

40. Shtimi i grimcave mbushëse të kompozitit:

- A) Ul rezistencën ndaj abrazionit
- B) Rrit tkurrjen e polimerizimit

- C) Rrit qëndrueshmërinë mekanike të kompozitit
- D) Zvogëlon tkurrjen e polimerizimit

41. Smalti është përgjegjës për ndriçimin e:

- A) Grupin e valëve me gjatësi të gjatë
- B) Asnjëra nga të mësipërmet
- C) Gjithë spektrin te dritës
- D) Grupin e valëve me gjatësi te shkurtër

42. Indikacionet e mjekimit të pulpiteve në sistemin dhëmbor të përkohshëm është në varësi të stadi në të cilën ai ndodhet. Sa kohë zgjat stadi i stabilitetit:

- A) 3 vjet ± 6 muaj
- B) 2,5 vjet
- C) 4 vjet
- D) 2 vjet ± 6 muaj

43. Evidentoni kush nga këto materiale nuk përdoret si shtresë izoluese:

- A) Kacimoli
- B) Dykali
- C) Plasmasat
- D) Hidroksidi i Calciumit

44. Glassionomeret përdoren gjerësisht në terapinë stomatologjike:

- A) Si material për mbushje të përhershme
- B) Nuk përdoret në asnjë nga sensitivitetit e mësipërme
- C) Për cimentimin e urave, shtifteve, inlejeve
- D) Si material për mbushje si shtresë izoluese

45. Përçindja e bakrit në aliazhin e amalgamit të dhënë nga Federata Ndërkombëtare e Stomatologëve është:

- A) Jo më pak se 65%
- B) Jo më shumë se 5%
- C) Jo më shumë se 29%
- D) Jo më shumë se 75%

46. Në përgatitjen për zgavra karioze e për të bërë më pas një mbushje me kompozite nuk është e rëndësishme:

- A) Të bëhet pastrimi i mirë i masës karioze
- B) Të bëhet bizotimi i buzëve të kavitetit
- C) Të përgatitet një kavitet ndihmës retentiv
- D) Të sigurohet një tharje absolute e kavitetit të përgatitur

47. Bymimi i amalgamit nuk duhet të jetë më tepër se:

- A) 2%
- B) 0,5 %
- C) 1%
- D) 0,2 %

48. Hidroksidi i Calciumit vepron si nëutralizues kimik i acideve të elementeve në saj të:

- A) PH të lartë acid

- B) PH asnjë
- C) PH të lartë alkaline
- D) Nuk ka fare PH

49. Embrioni i molarit të parë të përhershëm formohet në:

- A) Javën e 23 intrauterinë
- B) Javën e 17 intrauterinë
- C) Muajin e dytë pas lindjes
- D) Asnjë nga pohimet mësipërme nuk është e saktë

50. Cila është doza e fluorit që duhet të marrë fëmija 3-6 vjeç atëherë kur sasia e fluorit në ujin e pijshëm varion nga 0,3 - 0,6ppm F:

- A) 1,00 mgr F
- B) 0,50 mgr F
- C) 0,75 mgr F
- D) 0,25 mgr F

51. Në shumicën e sensitivitetit, pulpiti ireversibel ka shenjë:

- A) Një dhimbje të lehtë në perkusion
- B) Ndjeshmëri nga të ftohtat që zgjat
- C) Ndjeshmëri nga të ngrohtat
- D) Ndjeshmëri nga të ftohtat por që nuk zgjat

52. Në pacientët me sëmundje kardiake:

- A) Nuk duhet të kryhen trajtime endodontike
- B) Medikamentet e përdorura në mjekim ndikojnë në mjekimin dentar
- C) Nuk duhet të përdoret anestezi lokale me epinefrin
- D) Duhet të trajtohen përpara mjekimit me antibiotikë

53. Dentina në kariesin e thellë reagon duke:

- A) Rritur permabilitetin
- B) Me ndryshime të kolagjenit
- C) Skleroza e dentinës
- D) Shkrirje të tubulave dentinar

54. Fluoroza e dhëmbëve është në vartësi të marrjes të suplementeve të pakontrolluara të fluorit në:

- A) Në vitin e parë të jetës
- B) Në gjashtë vitet e para të jetës
- C) Në vitin e katërt të jetës
- D) Asnjëra nga këto

55. Hidroksidi i Calciumit këshillohet të përdoret si një mjekim i përkohshëm sepse:

- A) Ka aftësi të shkrijë indet nekrotike
- B) Ka aktivitet antimikrobial
- C) Ka aftësi për të mbyllur lumenin e kanalit
- D) Ka aftësi të nxit formimin e indit të forte në apeks

56. Mbushja e kanalit duhet të mos tejkalojë apeksin sepse:

- A) Në shumicën e sensitivitetit nuk rezorbohet

- B) Qëndron si tatuazh në inde
- C) Nxisin shumimin bakterial
- D) Është irituese për indet dhe frenon mbylljen apikale

57. Kohët e daljes të dhëmbëve të përkohshëm 55-65 dhe 75-85:

- A) Muaji 14-18
- B) Muaji 24-30
- C) Muaji 8-10
- D) Muaji 10-14

58. Cili nga pohimet është i saktë nqs ka ndonjë të tillë:

- A) Silantet janë me efektin në prevencionin e kariesit në sipërfaqe të lemuar kurse fluoridet në parandalimin e kariesit në sipërfaqet me fisura
- B) Procesi i maturimit natyral të smaltit 1 vit pas eruptimit ka lidhje edhe me remineralizimin e lezioneve fillestare
- C) Kontrolli i pllakës, reduktimi i sheqernave, përdorimi topikal i fluorit jo vetëm janë efikas për frenimin e demineralizimit por nxisin edhe remineralizim
- D) Të gjitha pohimet janë të sakta

59. Cila nga thëniet është e drejtë nëse ka të tillë:

- A) Edhe pasi guri i dhëmbëve është formuar ka mundësi të eliminohet nëpërmjet një higjenë të mirë vetjake
- B) Aplikimi topikal i fluorit bëhet vetëm nga dentisti
- C) Aplikimi i fluorit në koncentrimet të larta për një kohë të gjatë është më efektiv se aplikimi i fluorit në % te ultra për intervale kohe të shkurtra
- D) Fluorizimi i ujit ka berë të mundur uljen e incidencës së kariesit 20-40%

60. Në shtresat sipërfaqësore të smaltit gjejmë më shumë:

- A) Fluorur Calciumi
- B) Fluorapatit
- C) Hidroksilapatit
- D) Fluor fosfat

61. Çfarë është anakoreza:

- A) Formimi artificial i barrierës apikale
- B) Transportimi i mikroorganizmave nga enët e gjakut drejt indit të dëmtuar
- C) Nxitja e formimit të barrierës apikale në mënyrë biologjike
- D) Infeksion sistematik si rrjedhojë e infektimit të pulpës

62. Çfarë është Apeksogeneza:

- A) Vazhdimi në mënyrë natyrale i formimit të apeksit
- B) Heqja e pulpës nekrotike
- C) Përcaktimi i gjatësisë së kanalit
- D) Formimi i barrierës apikale në rastin e apeksit të hapur

63. Amalgami "non ?2 " ka qëndrueshmëri mekanike në masën:

- A) 2500-3000 Kgf /cm
- B) 4000-4500 Kgf /cm
- C) 4500-5000 Kgf /cm

D)4500-5500 Kgf /cm

64. Në kariesin fillestar sasia e zinkut është:

- A)6.5 gama
- B) 1.8 gama
- C)3.2 gama
- D)8.6 gama

65.Në përmbajtje të amalgameve "non gama 2 "sasia e bakrit është:

- A)13%
- B) 12%
- C)18%
- D)20%

66. Adezioni i pjesëzave NANO me smaltin, në përbërje të silanteve është:

- A)16,9 MPa
- B) 11,5 MPa
- C)18,1 MPa
- D)22,00 MPa

67. Lliku transparent Bifluorid 12 që përdoret mbas aplikimit të silantit përmban fluor dhe:

- A)Fosfor
- B) Selenium
- C) Calcium
- D)Vanadium

68. Bis G.M.A bën pjesë në:

- A)Matrix
- B) Agjentin lidhës
- C) Skeleti i polimerit
- D)Grimcat mbushëse

69. Cila nga qelizat përgjegjëse të sistemit imun nuk është prezente në inflamacionin pulpar:

- A)Limfocitet T
- B)Limfocitet B
- C)Odontoklastet
- D)Makrofaget

70. Dens invaginatus hasen më shpesh në:

- A)Kaninët maksilarë
- B)Lateralet mandibularë dhe maksilarë
- C)Lateralet maksilarë
- D)Premolarët e parë mandibularë

71. Në shtresën e jashtme të smaltit sasia e fluorureve është më e madhe se në shtresën e brendshme:

- A)4-5 herë
- B)6-8 herë

- C) 5-10 herë
- D) 2-3 herë

72. Niveli optimal i fluorit në pështyme për prevenimin e kariesit është:

- A) 0,02 ppm F
- B) 0,10 ppm F
- C) 0,08 ppm F
- D) 0,01 ppm F

73. Furçat e dhëmbëve me qime të buta kanë fije me diameter:

- A) 0,025 - 0,03cm
- B) 0,018 - 0,023 cm
- C) 0,030 - 0,035 cm
- D) 0,038 cm

74. Procesi i demineralizimit karakterizohet:

- A) Të gjitha sëbashku
- B) Humbje të Calciumit dhe Magneziumit
- C) Humbje të Vanadiumit
- D) Humbje të Calciumit dhe Fosfateve

75. Në periudhën e shtatzanisë dhe në laktacion doza ditore e Calciumit duhet të jetë:

- A) 700-800 mgr/ditë
- B) 1000-1200 mgr/ditë
- C) 200-300 mgr/ditë
- D) 1500 mgr/ditë

76. Fluori depozitohet në pllakën dhëmbore në formë të:

- A) Monofluor fosfat
- B) Fluorur calciumi
- C) Fosfat calciumi
- D) Fluorur natriumi

77. Përdorimi i tretësirave me fluorur natriumi në individet me risk kariesi, 1 herë në javë janë:

- A) 1%
- B) 0,05%
- C) 0,02%
- D) 2%

78. Cila nga këto komponime nuk përmbahet në pastën e dhëmbëve:

- A) Fluorur Natriumi (NaF)
- B) Oksidi Fosforik (P₂O₅)
- C) Fluorur kallaj (SnF₂)
- D) Monofluorfosfat Natriumi (MFP)

79. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është e saktë për periodontitin akut seroz:

- A) Pacienti ka dhimbje gjatë mastikacionit
- B) Vërehen ndryshime në radiografi
- C) Edema inflamatore mund të arrijë deri në kockë

D) Pacienti ka dhimbje pas përdorimit të të nxehtëve

80. Pacienti ka prekje të përgjithshme të organizmit në rastin e:

- A) Periodontitit kronik granular
- B) Periodontitit akut seroz
- C) Periodontitit akut purulent
- D) Granulomes kistoze

81. Cila nga alternativat është e vërtetë për periodontitin kronik granulomatoz:

- A) Nuk formohet kapsul fibroze
- B) Granuloma është një formë me stabile, më pak septike dhe më pak aktive
- C) Vërehen dukuri eksudative
- D) Nuk ka ndryshime radiologjike

82. Cila nga alternativat nuk është faktor etiologjik për periodontitet marginale:

- A) Protezat totale
- B) Mbushjet e varura
- C) Këllëfet e gjatë
- D) Telat e krosheve

83. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është e vërtetë për periodontitin kronik fibroz:

- A) Mund të lindi si rezultat i një mbingarkese mastikatorë gjatë humbjes të një numri të madh dhembësh ose në një artikulum traumatik
- B) Rezultat i mjekimit të formave granulare ose granulomatoze të periodontiteve kronike
- C) Mund të shfaqet si shkak nga një inflamacion akut i periodontit
- D) Nuk vërehen ndryshime radiologjike

84. Në cilën formë të periodontiteve vërehet prania e neutrofileve në eksudat:

- A) Periodontiti kronik granular
- B) Periodontiti akut purulent
- C) Periodontiti akut seroz
- D) Periodontiti kronik granulomatoz

85. Linjat Retzius vijnë si rrjedhojë e çrregullimeve të lëndëve në:

- A) Kufirin dentine-pulpë
- B) Dentinë
- C) Cement
- D) Smalt

86. Sasia e fluorit në shtresat e jashtme të smaltit është më e madhe se në shtresat e brendshme:

- A) 5-10 herë më shumë
- B) 5-6 herë më shumë
- C) 2-4 herë më shumë
- D) 1-2 herë më shumë

87. Sasia e fluorit në kripën e gjellës duhet të jetë:

- A) 90mgr/Kg
- B) 500mgr/Kg
- C) 250mgr/Kg

D)400 mgr/Kg

88. Floruri i kalciumit formohet nga përdorimi i fluorit:

- A) Egzogjen
- B) Endogjen
- C) Endo-egzogjen
- D) Asnjëra nga pohimet e mësipërme

89. Gelet fluorike të acidifikuara (APF) përmbajnë fluor në masën:

- A) 2.06%
- B) 1.23%
- C) 1.12%
- D) 2.2%

90. Korona e dhëmballes së parë të perkohshme në lindje është e mineralizuar në masën:

- A) 31%
- B) 17%
- C) 2%
- D) 6%

91. Cila nga qelizat e mëposhtme nuk është qelizë e periodontit:

- A) Dentinoblastet
- B) Qelizat e Malasse
- C) Fibroblastet
- D) Cementoblastet

92. Forma më aktive bazuar në ecurinë klinike të periodontiteve kronike është:

- A) Periodontiti kronik fibroz
- B) Granuloma kistoze
- C) Periodontiti kronik granulomatoz
- D) Periodontiti kronik granular

93. Cila nga alternativat e mëposhtme është e vërtetë për periodontitet kronike:

- A) Kanë ndryshime radiologjike
- B) Shoqërohen me dhimbje
- C) Mjekohen në një seance trajtimi
- D) Të gjitha sëbashku

94. Lamina dentalis formohet:

- A) Në javën e 4 - 5 intrauterinë
- B) Në javën 6 - 7 intrauterinë
- C) Në javën e 3 intrauterinë
- D) Në javën e 17 intrauterinë

95. Pulpa e dhëmbit formohet nga:

- A) Odontoblastet
- B) Pulpa e smaltit
- C) Papila mezenkimatoze
- D) Adamantoblastet

96. Smalti i dhëmbit ka lëndë inorganike:

- A) 92%
- B) 46%
- C) 96%
- D) 36%

97. Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk është shkaktar traumatik në periodontite akute seroze?

- A) Traumat
- B) Lënia e arsenikut më shumë se koha e nevojshme
- C) Dalje e mbushjes përtej apeksit
- D) Formimi jokorrekt i pikës së kontaktit

98. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është e vërtetë për periodontitin kronik fibroz:

- A) Mund të shfaqet si shkak nga një inflamacion akut i periodontit
- B) Rezultat i mjekimit të formave granulare ose granulomatoze të periodontiteve kronike
- C) Nuk vërehen ndryshime radiologjike (Vërehen ndryshime kockore në egzaminimin radiologjik)
- D) Mund të lind si rezultat i një mbingarkese mastikatorë gjatë humbjes të një numri të madh dhembësh ose në një artikulum traumatik

99. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është e vërtetë për periodontitin kronik granular:

- A) Pacienti ka dhimbje të provokuara dhe shoqërohen me shfaqjen e një fistule
- B) Shpesh vëmë re zmadhim dhe dhimbje të gjendrave limfatike
- C) Pacienti ka dhimbje të forta
- D) Ka ndryshime radiologjike

100. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është e vërtetë për periodontitin kronik granulomatoz:

- A) Vërehen dukuri eksudative
- B) Nuk formohet kapsule fibroze
- C) Granuloma është një formë më stabile, më pak septike dhe më pak aktive
- D) Nuk ka ndryshime radiologjike

101. Cila nga alternativat nuk është faktor etiologjik për periodontitet marginale:

- A) Këllëfet e gjatë
- B) Mbushjet e varura
- C) Krahët e krosheve
- D) Protezat totale

102. Prania e krisataleve të Kolesetrinës vërehet në rastin e:

- A) Periodontitit granular
- B) Granulomes kristoze
- C) Periodontitit granulomatoz
- D) Periodontitit fibroz

103. Cili nga pohimet e mëposhtme nuk është i drejtë: Faktorët mbrojtës ndajkariesit:

- A) Përdorimi i rregullt i fluorureve
- B) Shtimi i sasisë së pështymës të pastimular

- C) Përdorimi i vaksinës ndaj kariesit
- D) Përdorimi i antimikrobikeve

104. Cili nga përbërësit e mëposhtem nuk gjendet në pështyme:

- A) Ptiolina
- B) Mucina
- C) Irea
- D) IgE

105. Odontoblastet gjenden në:

- A) Dentinë
- B) Smalt
- C) Pjesa perfirekie e pulpës
- D) Cement

106. Përçindja e Argjendit në amalgam është:

- A) 60%
- B) 65%
- C) 35%
- D) 29%

107. Matrica përdoret për:

- A) Mbushje kanali
- B) Hapjen e kavitetit
- C) Zgjerimin e kanalit
- D) Formimin e pikës së kontaktit

108. Blaku e klasifikon procesin karioz sipas:

- A) Indeve të prekura
- B) Ecurisë klinike
- C) Faqeve të prekura
- D) Thellësisë së procesit

109. Kaviteti MOD lokalizohet në:

- A) Faqen mezio-okluzo-distale
- B) Faqen meziale
- C) Faqen distale
- D) Faqen aproksimale

110. Pulpa e dhëmbit është me origjinë nga:

- A) Ektoderma
- B) Kocka
- C) Mezenkima
- D) Asnjëra prej indeve

111. Materialet që përdoren si shtresë izoluese janë:

- A) Cementet (glasionomeret)
- B) Kompozitet
- C) Endometazoni
- D) Amalgami

112. Shenjat e kariesit janë:

- A) Dhimbje të forta natën
- B) Dhimbje në goditje
- C) Asnjëra
- D) Ndryshim ngjyre të indeve të dhëmbit

113. Klasa e III e Blakut lokalizohet në:

- A) Në faqet proksimale të frontalëve
- B) Faqen okluzale të molarëve ç premolarëve
- C) Koletin e dhëmbit
- D) Asnjëra

114. Pastrimi i masës karioze bëhet me frezë:

- A) Fisurë
- B) Rond
- C) Flake
- D) Asnjëra

115. Parimi profilaktik në përgatitjen e zgavrës karioze synon në:

- A) Për qëndrueshmerin e mbushjes
- B) Parandalimin e kariesit dytësor
- C) Mos dëmtimin e indeve të forta të dhëmbit
- D) Asnjëra

116. Kompozitet kanë veti pozitive sepse:

- A) Krijojnë lidhje mekanike me dhëmbin
- B) Sigurojnë anën estetike
- C) Nuk tkurren me kalimin e kohës
- D) Asnjëra

117. Amalgami ka veti negative sepse:

- A) Nuk ka qëndrueshmeri ndaj forcave përthypëse
- B) Ngjyros indet e forta të dhëmbit
- C) Krijon lidhje kimike me dhëmbin
- D) Tkurret me kalimin e kohës

118. Lentyloja shërben për:

- A) Zgjerim kanali
- B) Mbushje kanali
- C) Modelimin e dhëmbit
- D) Pastrim kanali

119. Dentina e dhëmbit formohet nga:

- A) Adamantoblastet
- B) Cementoblastet
- C) Asnjëra
- D) Odontoblastet

120. Shtresa më e fortë e dhëmbit është:

- A) Pulpa
- B) Dentina
- C) Cementi
- D) Smalti

121. Cili nga elementet e mëposhtëm nuk bënë pjesë në aliazhet e amalgamit:

- A) Alumin
- B) Kallaj
- C) Bakër
- D) Zink

122. Klasa e I e Blakut lokalizohet në:

- A) Këndin e frontaleve
- B) Në faqen okuzale të premolareve dhe molareve
- C) Faqen palatinale të centraleve
- D) Faqen vestibulare të dhëmbëve

123. Kaviduri përdoret si material:

- A) Mbushje e përkohshme
- B) Mbushje e përhershme
- C) Shtresë izoluse
- D) Asnjëra

124. Vendosja e materialeve në kavitetin e dhëmbit kryhet me:

- A) Sond
- B) Presel
- C) Eskavator
- D) Fluar-spatul

125. Amalgami ka veti negative sepse:

- A) Nuk ka qëndrueshmeri ndaj forcave përtpese
- B) Krijon lidhje kimike me dhëmbin
- C) Tkurret me kalimin e kohës
- D) Asnjëra nga të sipërmet

126. Mungesa e kripërave minerale të kalciumit dhe fosforit ndikon:

- A) Në hipermineralizim të indeve dhëmbore
- B) Dalje të parakohshme të dhëmbëve
- C) Nxitje të proçesit të mineralizimit
- D) Hipomineralizim të strukturës dhëmbore

127. Cilat nga sheqernat e mëposhtme ka më pak veti kariogjene:

- A) Maltoza
- B) Xylitoli
- C) Glukoza
- D) Sakaroza

128. Për moshën e tretë është më i shprehur:

- A) Kariesi koronar
- B) Kariesi fisural

- C) Kariesi sekondar
- D) Kariesi radikular

129. Cilët nga bakteriet e mëposhtme nuk ka veti kariogjene:

- A) Entereokokku Fekalis
- B) Streptokoku Sobrinus
- C) Streptokoku Mutans
- D) Aktinomicet

130. Cilët nga faktorët e mëposhtëm nuk luan rol në procesin demineralizimit:

- A) Xerostomia
- B) Higjiena e keqe
- C) Porphyromonas gingivalis
- D) Bakteriet

131. Cili nga indekset e mëposhtme përdoret për matjen e eksperinces karioze:

- A) PLI
- B) CPITN
- C) DMFT
- D) PI

132. Dieta e pasur me karbohidrate:

- A) Frenon kariesin dentar
- B) Metabolizohet nga bakteriet e pllakes dhëmbore
- C) Neutralizon PH në zgavrën e gojës
- D) Nxiti remineralizim

133. Në fazën pre-eruptive ushqyerja ndikon në:

- A) Prekshmërinë e individit nga kariesi
- B) Formimin dhe maturimin e indeve të dhëmbëve
- C) Sasinë dhe cilësinë e pështymës
- D) Të gjitha janë të vërteta

134. Në sensitivitetin e një kequshqyerje me proteina kemi:

- A) Nxitet aktiviteti mitotik
- B) Patologjia periodontale është më e shprehur sesa kariesi dentar
- C) Nxitje të demineralizimit
- D) Vetëm karies dentar

135. Numri i tubujve dentinarë është më i madh:

- A) Në afërsi me pulpën
- B) Në afërsi me smaltin
- C) Në afërsi me cementin
- D) Asnjëra prej tyre

136. Me kalimin e moshës formimi i dentinës intratubulare:

- A) Fillon në të njëjtën kohë në drejtim të apeksit dhe të koronës
- B) Fillon me koronën në drejtim të apeksit
- C) Fillon me apeksin dhe vazhdon në drejtim të koronës
- D) Fillon në drejtim të koronës

Qelizat e Shvan-it rrethojnë:

- A) Të dyja të mësipërmet
- B) Fibrat C
- C) Fibrat A
- D) Asnjëra

137. Kufiri dentinë-cement (CDJ):

- A) Ka vlera për të përcaktuar hyrjen e kanaleve
- B) Ka vlera për përcaktimin e fundit të instrumentimit të kanalit
- C) Ka vlera për të përcaktuar gjerësinë e kanaleve
- D) Asnjë vlerë e vërtetë

138. Cila nga qelizat e mëposhtme nuk është prezente në periodoncium:

- A) Histocidet
- B) Qelizat epiteriale
- C) Osteoblastet
- D) Makrofaget

139. Mikroinfiltrimi marginal:

- A) Ndodh në mbushjet me kompozitë
- B) Ndodh në mbushjet me amalgam
- C) Ndodh në të gjitha llojet e mbushjeve
- D) Ndodh në mbushjet me glass-ionomer

140. Kur inflamacioni pulpar i patrajtuar përhapet gradualisht drejt apeksit shkakton

- A) Pulpit akut prulent
- B) Asnjëra nga të mësipërmet
- C) Pulpit akut seroz
- D) Periodontit apikal

141. Si faktor etiologjik në patologjitë pulpare, erozioni klasifikohet në:

- A) Faktorët bakterialë
- B) Faktorët fizikë
- C) Faktorët jatrogjenë
- D) Faktorët kimikë

142. Irritimet e pulpës shkaktojnë:

- A) Çlirimin e inhibitorëve të protezës
- B) Çlirimin e neuropeptideve
- C) Të gjitha të mësipërmet
- D) Aktivizim të mediatorëve të inflamacionit

143. Diagnoza e patologjive pulpare bazohet në:

- A) Radiografi
- B) Të treja sëbashku
- C) Ngjyra e dhëmbit
- D) Shenjat klinike

144. Termi pulpit do të thotë:

- A) Pulpa është devitale dhe e inflamuar
- B) Pulpa është vitale dhe e inflamuar
- C) Pulpa është devitale dhe e pa inflamuar
- D) Pulpa është vitale dhe e pa inflamuar

145. Trajtimi endodontik i një dhëmbi vital rekomandohet në rast kur:

- A) Dhëmbi do të protezohet
- B) Asnjëra
- C) Të dyja të mësipërmet
- D) Dhëmbi është frakturuar

146. Në sensibilitetin dentinar:

- A) Dhimbja ka gjithmonë një shkak
- B) Ndjeshmëria është patologjike
- C) Është irreversibel
- D) Janë dhimbjet më të forta të pulpës

147. Në sensitivitetin e inflamacioneve reversibile të pulpes trajtimi është:

- A) Trajtim endodontik
- B) Lenia pa trajtime dhëmbit
- C) Vendosje e hidroksidit të kalciumit+cement glassionomer
- D) Asnjëra nga të mësipërmet

148. Kavitetet e klasit 2 të Black lokalizohen në:

- A) Faqen palatinale
- B) Faqen okluzale
- C) Faqen vestibulare
- D) Faqen aproksimale të molareve dhe premolareve

149. Indi më i fortë i dhëmbit është:

- A) Dentina
- B) Cementi
- C) Pulpa
- D) Smalti

150. Cila thënie e mëposhtme është e vërtetë:

- A) Alkooli është faktor i vetëm risku në kancerin e gojës
- B) Prania e jonit Fluor nxit demineralizimin
- C) Duhani është i vetmi faktor risku në patologjitë periodontale
- D) Procesi i demineralizimit ndodh në prani të PH acid

151. Cila thënie e mëposhtme është e vërtetë:

- A) Kalciumi rekomandohet të jepet si suplement te individet që hyjnë në grupin me rrezikshmëri të lartë ndaj kariesit
- B) Fluori është më efektiv në parandalimin e kariesit në fisura
- C) Silantet janë efektive në parandalimin e kariesit në siperfaqet e
- D) Filli dentar eliminon totalisht pllakën dhëmbore

152. Cila nga thëniet e mëposhtme është më e plotë dhe e saktë për patologjinë e kariesit dentar:

- A) Kariesi dentar është një sëmundje bakteriale që prek strukturën dhëmbore
- B) Kariesi dentar prek vetëm denticionin e përkohshëm
- C) Kariesi dentar është një patologji multifaktoriale që shoqërohet me prishje të strukturës dhëmbore
- D) Kariesi dentar është një patologji bakteriale e transmetueshme me origjinë multifaktoriale që shoqërohet me shkatërrim të strukturës dhëmbore

153. Kariesi i rrënjes prek më tepër moshën:

- A) Fëminore
- B) Adultet
- C) Adoloshentet
- D) Moshën e tretë

154. Dieta e pasur me karbohidrate:

- A) Frenon kariesin dentar
- B) Nxit remineralizim
- C) Favorizon formimin e dekstranit në pllaken dhëmbore
- D) Neutralizon në zgavrën e gojës

155. Në patologjinë e kariesit dentar faktori gjenetik ndikon në:

- A) Transmetimin gjenetik të patologjisë së kariesit dentar
- B) Transmetimin e bakterieve kariogjenike
- C) Transmetimin e procesit të demineralizimit
- D) Transmetimin e strukturës së indeve të dhëmbëve, gjendrave salivare

156. Gingiviti nuk shoqërohet me:

- A) Inflamacion të gingivave
- B) Inflamacion të kockes alveolare
- C) Gjakderdhje nga gingivat
- D) Enjtje të gingivave

157. Cila nga indet e mëposhtme nuk është pjesë e periodontit:

- A) Gingiva
- B) Indi pulpar
- C) Kocka alveolare
- D) Ligamenti periodontal

158. Prevensioni primar në parandalimin e kariesit përfshin:

- A) Ekstaksionët
- B) Trajtimet protetike
- C) Trajtime endodontike
- D) Higjienë orale dhe fluorizim

159. Pelikula e smaltit është:

- A) Shtresë e fituar me kripera minerale në sipërfaqen e smaltit
- B) Shtresë e fituar me glikoproteinasalivare të dentinës

- C) Shtresë e fituar me glikoproteina salivare në sipërfaqen e smaltit
- D) Shtresë e fituar me kripëra minerale në sipërfaqen e dentinës

160. Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk ndikon në akumulimin e pllakës bakteriale:

- A) Faktorët mekanikë
- B) Indi gingivar
- C) Vendet retentive
- D) Bashkëveprimi i pelikules dhe bakterieve

161. Komponenti aktiv në pastat e dhëmbëve me efekt zbardhues është:

- A) Peroksidi
- B) Sorbitoli
- C) Jonet e Calciumit
- D) Trikloani

162. Shpëlarsat zgjasin efektin e tyre në zgavren e gojës deri në:

- A) 1 orë
- B) 12 orë
- C) 6 orë
- D) 4 orë

163. Cili nga faktorët e mëposhtëm ka më pak rëndësi në lindjen e kariesit të dhëmbëve:

- A) Lloji i karbohidrateve
- B) Shpeshtësia e marrjes së karbohidrateve
- C) Kushtet e ruajtjes të karbohidrateve
- D) Konsistenca e karbohidrateve

164. Cili nga pohimet e mëposhtme nuk është mekanizmi i veprimit të fluorit në strukturën dhëmbore:

- A) Demineralizues
- B) Remineralizues
- C) Antibakterial
- D) Fluor hidroksilapatiti

165. Silantet nuk indikohen të aplikohen:

- A) Në dhëmballë me morfologji okluzale të shprehur
- B) Pacientet me risk të lartë ndaj kariesit
- C) Molarët e përkohshëm dhe të përhershëm
- D) Fisura të prekura nga kariesi

166. Sipas sistemit të numërimit ndërkombëtar (FDI) dhëmbi me numër 36 është:

- A) Lateral maksilar i djathtë
- B) Molari i parë maksilar i djathtë
- C) Molari i parë mandibular i majtë
- D) Premolari i dytë mandibular i majtë

167. Cili nga opsionet mëposhtme nuk ndihmon në aderencën e bakterieve në pllakën dhëmbore:

- A) Lidhjet Kalcike (Ca⁺⁺)
- B) Polisakaridet ekstraqelizore

- C) Lidhje Karboni
- D) Zgjatimet sipërfaqësore nëpërmjet proteinës adezive

168. Cili nga komponentet e mëposhtem është pjesë e gjuhës:

- A) Papila filiforme
- B) Ductus Warton
- C) Glandulat salivare sublinguale
- D) Frenulum labialis

169. Edentulizmi është karakteristike e moshës:

- A) Fëminore
- B) Adoloshencës
- C) Adulteve
- D) Moshës së tretë

170. Suplementet e fluorit tek fëmijët duhet të fillojnë:

- A) Direkt pas lindjes
- B) Në moshën 3 vjeç
- C) Në moshën 6 muaj
- D) Në moshën 6 vjeç

171. Kariesi i fëmijerisë së hershme ndodh më shpesh tek fëmijet që pijnë me biberon:

- A) Ujë gjatë natës
- B) Lëngje gjatë ditës
- C) Lëngje te sheqerosura gjatë natës
- D) Të gjitha te mesipermet janë të vërteta

172. Cili nga faktorët e përgjithshëm nuk ka ndikim në patologjite periodontale:

- A) Moshë
- B) Temperatura e ambientit
- C) Ndryshimet hormonale
- D) Gjenetika

173. Funkzioni i furçës së dhëmbëve për higjienën orale është:

- A) Mekanik
- B) Kimik
- C) Nëutrale
- D) Të treja janë të vërteta

174. Furçat interdentalë nuk përdoren në:

- A) Tek fëmijet me aparate ortodontike fikse
- B) Në hapësirat nderdhëmbore tek fëmijet
- C) Për pastrimin e urave
- D) Për pastrimin e atashmenteve

175. Shkaku kryesor i kancerit të gojës për moshën e tretë është:

- A) Protezat defektoze
- B) Inflamacioni i mukozës së gojës
- C) Konsumi i alkoolit dhe duhanit
- D) Diabeti

176. Kaviduri përdoret si material:

- A) Mbushje e përhershme
- B) Shtresë izoluse
- C) Mbushje e përkohshme
- D) Asnjëra

177. Vendosja e materialeve në kavitetin e dhëmbit kryhet me:

- A) Sond
- B) Eskavator
- C) Fluar-spatul
- D) Presel

178. Në fazën preeruptive ushqyerja ndikon:

- A) Në prekshmerinë e individit nga kariesi
- B) Në formimin dhe maturimin e indeve të dhëmbëve
- C) Sasinë e pështymes
- D) Në procesin remineralizimit

179. D.M.F.T është në vlera mesatare:

- A) 0.0-1.1
- B) 1.2-2.4
- C) 4.4-6.6
- D) 2.4-4.4

180. Klorhexidina për shplarje të gojës është:

- A) 10%
- B) 0.12%
- C) 0.05%
- D) 0.20%

181. Kalciumi në tremujorin e fundit të shtatzanisë duhet të rritet në masën:

- A) 30 %
- B) 40 %
- C) 20 %
- D) 10 %

182. Në fëmijët e moshës shkollore kariesi i sipërfaqes përtypëse është në masën:

- A) 29%
- B) 54%
- C) 20 %
- D) 17%

183. Etanoli dhe acidi formik janë produktet finale të zbërthimit të:

- A) Saharozës
- B) Edul-koranteve
- C) Maltozës
- D) Fruktozës

184. DMFS, maksimumi i saj për 28 dhëmbë është:

- A) 128
- B) 110
- C) 120
- D) 104

185. Indeksi D.D.E përcakton defektet e:

- A) Të fluorozës
- B) Të formimit të pllakes
- C) Smalt-Dentinë
- D) Të smaltit

186. Përqindja e Argjendit në amalgam është:

- A) 29%
- B) 60%
- C) 35%
- D) 65%

187. Palpacioni është një test ekzaminimi për të vërtetuar:

- A) Inflamacionin e pulpës
- B) Inflamacionin periodontale
- C) Inflamacionin periapikal
- D) Inflamacionin e ATM

188. Cili është agjenti më efikas në zbardhimin e dhëmbëve:

- A) Perborati i Na
- B) Peroksid karbamidi
- C) Acidi hidroklorik
- D) Hipoklorit Na

189. Cili është irriguesi që përdoret më shpesh për shplarjen e kanaleve:

- A) Salina
- B) EDTA
- C) MTAD
- D) Hipoklorit Na

190. Vlera e PH të pllakës dhëmbore pas përdorimit të çokollatave është:

- A) 6.4
- B) 5,5
- C) 4
- D) 4.5

191. Nisur nga lokalizimi i procesit patologjik, periodontitet klasifikohen:

- A) Akute, kronike
- B) Seroze, purulente
- C) Marginale, apikale
- D) Akute, kronike dhe ekzacerbuese

192. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është e vërtetë për periodontititn akut purulent:

- A) Vjen si ndërlikim e periodontitit akut seroz
- B) Vjen si ndërlikim i pulpitit akut purulent

- C) Vjen si ndërlikim i periodontit kronik fibroz
- D) Vjen si ndërlikim i erozionit të dhëmbëve

193. Sasia e fluorit në dentinë është:

- A) 190-300 mgr/Kg
- B) 180 mgr- 200 mgr /Kg
- C) 57 mgr /Kg
- D) 310 mgr/Kg

194. Trajtimi i kanaleve në 1 (një) seance i ndikohet:

- A) Pulpa është nekrotike por asimptomatike
- B) Pulpa është vitale por simptomatike
- C) Pulpa është nekrotike dhe simptomatike
- D) Kur kemi pulpit ulceroz

195. Të gjitha alternativat e mëposhtme që përdoren përzgjerimin e kanalit me instrumenta përveç njerit. Cili:

- A) Eliminimin e dentinës duke përdorur lloje të ndryshme instrumentash për të zgjeruar hapësirën e kanalit në tre dimensione
- B) Të bëje të mundur hyrjen e irriganteve dhe instrumentave gjatë trajtimit
- C) Të eliminojnë indet nekrotike dhe bakteret
- D) Të realizoj një formë dhe hapësirë të kanalit që të jetë e përshtatshme për materialet dhe instrumentat obturues

196. Kanali i katërt zakonisht gjendet në:

- A) Rrënjën meziale të premolarit të parë maksilar
- B) Rrënjën meziobukale të molarit të parë maksilar
- C) Rrënjën palatinale të molarit të parë maksilar
- D) Rrënjën distobukale të molarit të parë maksilar

197. Forma e hapjes së dhomës pulpare në centralin maksilar është:

- A) Trapezoide
- B) Rrumbullakët
- C) Trekëndore
- D) Ovale

198. Në pacientet alergjikë nga penicilina ose cefalosporina trajtimi i rekomanduar është:

- A) Amoksicilina
- B) Tetraciklina
- C) Clindamicina.
- D) Eritromicina

199. Fibrat Sharpey janë pjesë:

- A) Periodontit
- B) Pulpës
- C) Cementit
- D) Kockës alveolare

200. Përgjigjja më e shpeshtë e dentinës në rastin e nje kariesi profund është:

- A) Rrit permabilitetin

- B) Ndryshime të kolagjenit
- C) Skleroza e dentinës
- D) Shkrirje e tubulave dentinare

201. Freza e rrumbullakët përdoret për të kryer:

- A) Zgjerimin profilaktik
- B) Dhënien e formës së kavitetit
- C) Llustrimin e mbushjes
- D) Pastrimin e masës karioze

202. Në amputimin vital përdoret:

- A) Eugenat
- B) Pastë kreozot jodoform
- C) Pastë triklezolformalinë
- D) Pastë hidroksid kalciumi

203. Cili nga pohimet është i vërtetë:

- A) Invaginacioni Hertwig-Brun jep fillesë formimit rrënjes së dhëmbit
- B) Smalti dhe dentina kanë origjinë nga ektoderma ndërsa indet e tjera nga mezenkima
- C) Pulpa e organit adamantin i jep origjinë pulpes së dhëmbit
- D) Smalti ka origjinë nga ektoderma

204. Folikujt e dhëmbëve permanentë fillojnë të formohen:

- A) Pas lindjes
- B) Në muajin e gjashtë paslindjes
- C) Në periudhën intrauterinë
- D) Në vitin e 6 të jetës

205. Cilët nga dhëmbët coptojnë ushqimin dhe fillojnë bluarjen:

- A) Kaninët
- B) Premolaret
- C) Frontalet
- D) Molaret e pare

206. Nervi mentalis inervon:

- A) Paradhëmballët
- B) Dhëmbët frontalë mandibularë dhe gingivat rreth tyre
- C) Molarët
- D) Kaninin maksilar

207. Kanali i Wartonit është:

- A) Nga gjendrat mukozale
- B) Nga gjendra sub linguale
- C) Nga gjendra Parotis
- D) Nga gjendra submandibulare

208. Kariesi i klasës së parë diagnostikohet përmes:

- A) Ekzaminimit radiologjik
- B) Ekzaminimit me sonde
- C) Testit të vitalitetit

D)Transiluminimi me fiber optike

209. Cili pohim është i vërtetë:

- A) Tubulat dentinare përmbajnë në brendësi zgjatimet e odontoblasteve
- B) Tubulat dentinare përmbajnë në brendësi zgjatimet e adamantoblasteve
- C) Asnjëra prej tyre
- D) Tubulat dentinare kanë diametër më të madh duke shkuar nga pulpa drejt periferisë

210. Sterilizimi është:

- A) Proçes që zhdok mikroorganizmat por jo sporet e tyre
- B) Proçes që zhdok mikroorganizmat dhe sporet e tyre
- C) Në autoklave realizohet në temperature 120 - 131° C
- D) Realizohet në temperaturë mbi 200 ° C

211. Cementet karboksilate:

- A) Kanë veti më acide se fosfat cementi
- B) Përdoren si mbushje përfundimtare në dhëmbët permanentë
- C) Përdoren si mbushje provizore
- D) Përdoren si shtresa izoluese në kavitete të thella

212. Diferencimi i qelizave në odontogenëzë ndodh në stadin e:

- A) Këmbanës
- B) Sythave
- C) Kupës
- D) Lamina dentis

213. Muskuli kryesor i faqes është:

- A) Muskuli platysma
- B) Muskuli risorius
- C) Muskuli buccinator
- D) Muskuli zygomaticus

214. Cili nga këto grup dhembësh anëstetizohen me veshtirësi:

- A) Premolarët maksilarë
- B) Molarët mandibularë
- C) Premolaret mandibularë
- D) Molarët maksilarë

215. Smalti ka:

- A) 96 % lëndë inorganike dhe 1.7 % lëndë organike dhe ujë, 2.3%
- B) 70 % lëndë inorganike dhe 30 % lëndë organike
- C) 92% lëndë inorganike dhe 8 % lëndë organike
- D) 96 % lëndë organike dhe 4 % lëndë inorganike

216. Matrica e smaltit sekretohet nga:

- A) Ameloblastet
- B) Odontoblastet
- C) Cementoblastet
- D) Qelizat e Malasse

217. Cila nga shprehjet është e vërtetë:

- A) Dezinfektimi përdoret për instrumentat e vizites dhe mjekimit
- B) Dezinfektimi është nje proces i rezervuar për siperfaqet e mëdha të mjedisit që janë te pamundura për tu sterilizuar
- C) Dezinfektimi realizohet me anë të autoklaves
- D) Dezinfektimi realizohet me ajër nën presion

218. Dentina terciare është dentinë që krijohet:

- A) Gjatë odontogjenëzes
- B) Gjatë gjithë jetës
- C) Në vitin e pare të jetës
- D) Si përgjigje ndaj kariesit, abrazionit, atricionit, erozionit, etj.

219. Gudaperka tretet në:

- A) Alkol
- B) Eugenol
- C) Kloroform
- D) Solucion fiziologjik

220. Cila nga këto, janë simptoma të pulpitit akut total:

- A) Zgavër e madhe karioze ku dhoma e pulpës është e hapur
- B) Dhimbje pulsantë
- C) Qetësohet nga të ftohtat
- D) Kriza dhimbje të shpeshta e të gjata dhe me periudha qetësie të shkurtra

221. Zona granulare e Tomsit gjendet në:

- A) Kufirin smalt-dentinë
- B) Cementin qelizor
- C) Kufirin dentinë-cement
- D) Dentinë sekondare

222. Cila nga këto nuk është e vërtetë:

- A) Antiseptiket organik kanë veti të shprehura baktericide
- B) Kanë tension siperfaqesor të ulët
- C) Kanë PH të lartë alkaline
- D) Nuk ngacmojnë indet periapikale

223. Cila nga këto nuk është e vërtetë:

- A) Tymoli është anestetik lokal
- B) Ruan efektin antiseptik për një kohe të gjatë edhe në përqindje të ulura
- C) Tymoli është me pak toksik se fenoli
- D) Përdoret për trajtimin e kariesit profund

224. Në cilat nga këto patologji dhimbja përhapet:

- A) Pulpit akut seroz total
- B) Hiperemi pulpare
- C) Periodontit kronik fibroz
- D) Pulpit kronik ulceroz

225. Amputimi vital përdoret në:

- A) Kariesin e thelle
- B) Nëkroze të pulpes
- C) Pulpit akut seroz parcial
- D) Kur nuk ka përfunduar formimi i rrënjeve

226. Cila nga këto nuk është e vërtetë: Përparësitë e rrymës elektrike janë:

- A) Ngacmimi nuk mund të perseritet se dëmton indet
- B) Vepron shpejt
- C) Reaksionet janë të kthyeshme
- D) Ngacmimi mund të dozohet

227. Cili nga pohimet e mëposhtme nuk është i saktë:

- A) Amalgamet përcjellin nxehtësinë
- B) Nuk kerkojnë formë të rregullt gjeometrike të kavitetit
- C) Absorbojnë dobët lageshtirën
- D) Kanë qëndrueshmeri të lartë mekanike

228. Cila nga këto është e vërtetë:

- A) Hidroksidi i kalciumit është material për mbushje të përhershme
- B) Hidroksidi i kalciumit përdoret për parandalimin e kariesit
- C) Hidroksidi i kalciumit është shtresë izoluese mjekuese
- D) Hidroksidi i kalciumit përdoret për zbardhjen e dhëmbëve

229. Freza e rrumbullakët përdoret për të kryer:

- A) Zgjerimin profilaktik
- B) Dhënien e formës së kavitetit
- C) Lustrimin e mbushjes
- D) Pastrimin e masës karioze

230. Raporti pluhur zhivë në amalgam është:

- A) 2 : 1
- B) 1 : 1
- C) 1 : 2
- D) 1 : 0,5

231. PH i hidroksidit të kalciumit është:

- A) 12,4 - 13,4
- B) 7 - 8
- C) 10 - 11
- D) 5,4 - 6,4

232. Llaket që përdoren në mjekimin e kariesit:

- A) Obturojnë kanalzat dentinare
- B) Bëjnë dezinfektimin e kavitetit
- C) Ndihmojnë në adezionin e mbushjes
- D) Nxisin formimin e dentinës sekondare

233. Medikamentet që vendosen në prani të lagështisë:

- A) Hiqen me lehtësi
- B) Ndryshojnë ngjyrë

- C) Ndryshojnë volumin
- D) Humbim efektin e tyre terapeutik

234. Silanët janë:

- A) Sistemi aktivizues i kompozitëve
- B) Agjentë lidhez te kompozitëve
- C) Sistemi inhibues i kompozitëve
- D) Matrica e kompozitëve

235. Cili nga këto faktorë nuk hyn në grupin e faktorëve jatrogjën në etiologjinë e patologjive pulpare:

- A) Dehidratimi i dentinës
- B) Presioni gjatë marrjes së masës
- C) Anomalitë e strukturës
- D) Nxehësia gjatë ilustrimit të mbushjes

236. Linjat Retzius gjenden në:

- A) Cement
- B) Dentinë
- C) Kufiri smalt-dentinë
- D) Smalt

237. Rubber-damm përdoret për të:

- A) Larguar gjuhën
- B) Thith pështymën
- C) Izolon dhëmbin nga pështyma
- D) Shërben për hapjen e gojës

238. Shtresat izoluese vendosen në trashësi:

- A) 2-3 mm
- B) 1-2 mm
- C) 0,5-1 mm
- D) 0,1-0,2 mm

239. Cila është mënyra më e mirë për të parandaluar dëmtimin e pulpës gjatë kavitetit:

- A) Dezinfektimi
- B) Frezat e mëdha
- C) Përdorimi i ujit të ftohtë
- D) Përdorimi i ajrit të ftohtë

240. Cila nga këto nuk është e vërtetë: Elektrotesti

- A) Shërben për ngacimin e fibrave sensore në pulpe
- B) Asnjë përgjigje nuk është e saktë
- C) Nuk tregon gjendjen e pulpes por vetëm që aty ka fibra nervore të
- D) Jep informacion mbi gjendjen e sistemit vaskular

241. Cila përgjigje nuk është e saktë:

- A) GIC sigurojnë rimineralizimin intern
- B) GIC nuk janë biokompatibelme indet e dhëmbit
- C) GIC janë radioopak

D)GIC çlirojnë fluor

242. Faza e burbuqeve është në:

- A)Javën e 8 intrauterine
- B)Javën e 14 të jetës intrauterine
- C)Javën e 11 të jetës intrauterine
- D)Në javën e 4 - 6 intrauterine

243. Faza gama 2 është lidhja:

- A)Ag₂Hg₃
- B)Ag-Sn
- C)Sn₇Hg₈
- D)Ag-Cu

244. Cila nga këto veti i përket kompozitëve:

- A)Qëndrueshmeri të lartë mekanike
- B)Kursejnë indet e shëndosha
- C)Nuk janë estetike
- D)Kerkojnë kavitete të rregullt gjeometrik

245. Dhimbja spontane që zakonisht fillon natën:

- A)Në periodontitin akut purulent
- B)Pulpit akut seroz total
- C)Në nekroze pulpare
- D)Në pulpitin kronik granganoz

246. Në cilat patologji ka më shume vlere elektrotesti pulpar:

- A)Hipereminë pulpare
- B)Pas një traume akute
- C)Kariesin aproksimal
- D)Erozioni dentar

247. Kompozitët vendosen me shtresa për të:

- A)Parandaluar kariesin sekondar
- B)Asnjëra nga këto
- C)Për qëndrueshmerinë e mbushjes
- D)Për të minimizuar efektin e tkurrjes

248. Rrumbullakimi i mureve të kavitetit varet nga:

- A)Ndërtimi morfologjik i dhëmbit
- B)Materiali i mbushjes
- C)Lloji i kafshimit
- D)Trashësia e smaltit

249. Ptialina është një nga proteinat e domosdoshme të pështymës e cila:

- A)I jep pështymes vizkozitetin e nevojshëm
- B)Shërben si pengese e fundit që duhet të kapërcejnë bakteriet për të arritur në smalt
- C)Luan rol të rëndësishëm në demineralizimin dhe remineralizim e indeve të forta të dhëmbëve
- D)Merr pjesë në shperberjen e karbohidrateve

250. Përqindja e lëndës inorganike në dentinë është:

- A) 70 %
- B) 96 %
- C) 30 %
- D) 50 %

251. Në kushtë normale PH i pështymës luhatët nga:

- A) 5,8 - 7,2
- B) 6,3 - 6,8
- C) 6,8 - 7,2
- D) 7,2 - 8

252. Formimi i rrënjëve të dhëmbëve kryhet nga zgjatimet anësore të këmbanës të cilat duke u zhytur në thellësi formojnë të ashtuquajturin:

- A) Sacculus dentis
- B) Invaginacioni "Hertvig-Brunn"
- C) Lamina dentis
- D) Stomodeum

253. Evidentoni cili nga këto materiale nuk përdoret për mbushje të perhershme:

- A) Dykali
- B) Amalgami
- C) Kompozitet
- D) Silantet

254. Njolla karioze (White Spot) përfaqëson:

- A) Kariesin sekondar
- B) Karies kronik
- C) Karies të dentinës
- D) Fillimin e procesit karioz

255. Në një kavitet të preparuar për inlejt muret anësore duhet të jenë:

- A) Pingul
- B) Të konvergojnë
- C) Të divergojnë
- D) Të formojnë kënd të ngushtë me bazen

256. Hipoplazia e smaltit karakterizohet nga:

- A) Mungesë totale të smaltit
- B) Mungesë e smaltit në margo incizale
- C) Sasi normale të smaltit por defekte në kalçifikimin e tij
- D) Sasi të pamjaftueshme të smaltit

257. Dekompozitet hibride prania e mbushesit inorganik është:

- A) 35 - 50 %
- B) 60 - 70 %
- C) 70 - 80 %
- D) 85 - 90 %

258. Shkaku kryesor i frakturës së ismusit në mbushjet me amalgam të klasës së dytë është:

- A) Thellësia jo e duhur e ismusit
- B) Prania e lageshtires
- C) Gjerësia jo e duhur e ismusit
- D) Asnjëra nga më të mësipërmet

259. Smalti arrin trashësinë më të madhe në:

- A) Tuberkula
- B) Ekuator
- C) Qafën e dhëmbit
- D) Fisura

260. Smaltie merr origjinën nga:

- A) Ektoderma
- B) Mezenkima
- C) Kreshta nërvore
- D) Asnjë e vërtetë

261. Në procesin e histogjenëzës së indevecili është indi që fillon të depozitohet pari:

- A) Smalti
- B) Dentina
- C) Cementi
- D) Pulpa

262. Cementi qelizor formohet:

- A) Në embriogenezë
- B) Si përgjigje ndaj defekteve kunëiforme
- C) Si përgjigje ndaj proceseve karioze
- D) Gjatë gjithë jetës

263. Hapësira periodontale është:

- A) 0,25 mm
- B) 0,45 mm
- C) 0,05mm
- D) 0.10 mm

264. Sasia ditore e sekretimit të pështymës është:

- A) 200-400 ml
- B) 500-700 ml
- C) 2000-2500 ml
- D) 1000-1500 ml

265. Kariesi circular ështëfrekuent në:

- A) Fëmijërinë e hershme
- B) Adoloshencë
- C) Moshat e vjetra
- D) Adulte

266. Kanalzat dentinare janë të pranishme në:

- A) Dentinën sekondare
- B) Zmalt
- C) Dentinë terciare
- D) Dentinë primare

267. Cilët nga dhëmbët coptojnë ushqimin dhe fillojnë bluarjen:

- A) Premolarët
- B) Frontalët
- C) Kaninët
- D) Molarët e parë

268. Materialet e mbushjes së përkohshme përdoren:

- A) Për të mbrojtur pulpën
- B) Midis seancave të mjekimit
- C) Për të rindërtuar formën anatomike të dhëmbit
- D) Për të nxitur formimin e urës dentinare

269. Cila nga pohimet është e vërtetë:

- A) Dezinfektimi përdoret për instrumentat e vizitës dhe mjekimit
- B) Dezinfektimi është një proces i rezervuar për sipërfaqet e mëdha të mjedisit që janë të pamundura për tu sterilizuar
- C) Dezinfektimi realizohet me anë të autoklavës
- D) Dezinfektimi realizohet me ajër nën presion

270. Raporti pluhur-zhivë të amalgami është:

- A) 1:2
- B) 2:1
- C) 1:1
- D) 0.5:1

271. Lustrimi i mbushjeve të amalgamit bëhet:

- A) Menjëherë pas modelimit të tij
- B) 24-48 orë pas vendosjes
- C) 2-3 orë pas vendosjes
- D) 30 min pas vendosjes

272. Klasifikimi i Blakut ka të bëjë me:

- A) Fazat e ndryshme të ecurisë të kariesit
- B) Lokalizimi i kavitetëve në sipërfaqet e dhëmbit
- C) Thellësinë e kavitetëve
- D) Histopatologjinë e kariesit

273. Klasa e tretë të Blakut lokalizohet në:

- A) Faqen aproksimale të incizivëve me prekje të këndit prerës.
- B) Faqen aproksimale të molarëve dhe premolarëve
- C) Në 1/3 cervikale të dhëmbëve
- D) Faqen aproksimale të dhëmbëve frontal

274. Shtresat izoluese vendosen në trashësi:

- A) 0.1-0.2mm

- B) 1-2mm
- C) 2-3mm
- D) 0.5-1mm

275. Pështyma seroze sekretohet nga gjendrat:

- A) Parotis
- B) Submandibulare
- C) Sublinguale
- D) Gjëndrat aksesore

276. Hidroksidi i kalçiumit kur përdoret si shtresë izoluese në kariesin profund përzihet me:

- A) Solucion fiziologjik
- B) Eugenol
- C) Ujë të oksigjenuar
- D) Alkol

277. Muskuli kryesor i faqes është:

- A) Muskuli platysma
- B) Muskuli buccinator
- C) Muskuli zigomaticus
- D) Muskuli risorius

278. Kavitetet karioze të lokalizuara në faqen linguale të incizivëve janë:

- A) Kavitete të klasës së III
- B) Kavitete të klasës së IV
- C) Kavitete të klasës së I
- D) Kavitete të klasës së VI

279. Kavitetet e lokalizuara në kuspidet e dhëmbëve posterior janë:

- A) Kavitete të klasës së VI
- B) Kavitete të klasës së I
- C) Kavitete të klasës së IV
- D) Kavitete të klasës së II

280. Smalti ushqehet nga:

- A) Cementi
- B) Dentina
- C) Pulpa
- D) Gingiva

281. Prizmat e smaltit janë me bazë:

- A) 8-këndore
- B) 3-këndore
- C) 6-këndore
- D) 12 këndore

282. Çfarë këndi duhet të formojë freza me aksin e dhëmbit për rrumbullakimin e mureve:

- A) 45 gradë

- B) 30 gradë
- C) 15 gradë
- D) 90 gradë

283. Kurora e një dhëmbi ka:

- A) 5 faqe
- B) 4 faqe
- C) 6 faqe
- D) 3 faqe

284. Në kavitetinë klasës së dytë mbushjafillon:

- A) Në të dykavitetet njëkohsisht
- B) Nga kaviteti ndihmës
- C) Nga kaviteti aproksimal
- D) Kaviteti karioz

285. Palatine uvula gjendet në:

- A) Kufirin e poshtëm të qiellzës së butë
- B) Kufirin e sipërm të qiellzës së butë
- C) Kufirin e pasëm të qiellzës së fortë
- D) Në afërsi të mukozës nazale

286. Inflamimi i gingivës është i pranishëm në kavitetet e klasës së:

- A) IV të Blakut
- B) I të Blakut
- C) VI të Blakut
- D) II të Blakut

287. Cili nga materialet e mëposhtme nuk përdoret si shtrese izoluese:

- A) Providentina
- B) Hidroksidi i kalçiumit
- C) Cement karboksilatet
- D) Glass ionomer cementet

288. Sterilizimi me kuarç përdoret për:

- A) Anglin e turbinës
- B) Instrumentat e imët
- C) Graduarët
- D) Mikromotorët

289. Shtresat izoluese përdoren për:

- A) Ti siguruar mbushjes përfundimtare adezion
- B) Të rritur qëndrueshmërinë e strukturës së mbetur të dhëmbit pas preparimit
- C) Të rritur qëndrueshmërinë mekanike të mbushjes përfundimtare
- D) Për të mbrojtur pulpën nga ngacmimet

290. Proçesi karioz përparon më shpejt në:

- A) Dentin
- B) Cement
- C) Smalt

D) Në të tre indet njëlloj

291. Cilin nga solucionet e mëposhtëm duhet të përdorim për tualetin e kavitetit karioz:

- A) Alkol
- B) Hipoklorit natriumi
- C) Ujë të oksigjenuar
- D) Solucion fiziologjik

292. Një kavitet i përbërë okluzo-bukal bën pjesë në:

- A) Klasën e II të Blakut
- B) Klasën e VI të Blakut
- C) Klasën e I të Blakut
- D) Klasën e IV të Blakut

293. Proçesi karioz në foramen mollaria bën pjesë në klasën e:

- A) II të Blakut
- B) IV të Blakut
- C) I të Blakut
- D) VI të Blakut

294. Freza Rond përdoret për:

- A) Dhënien e formës kavitetit
- B) Largimin e masës karioze
- C) Zgjerimin e kavitetit
- D) Lustrimin e mbushjes

295. Cili nga pohimet nuk është i vërtetë:

- A) Amalgami nuk e përcjell temperaturën
- B) Amalgami përdoret në mbushjet e kavitetit të klasës së parë të
- C) Amalgami ka qëndrueshmëri të lartë mekanike
- D) Amalgami është aliazh i metaleve të rënda me zhivën

296. Për vendosjen e amalgamit në kavitet përdorim:

- A) Fluar
- B) Spatul
- C) Ekskavator
- D) Preselë

297. Stripsi i celuloidit shërben për mbushjen e kavitetit të klasës së:

- A) II
- B) III
- C) I
- D) V

298. Kavitetet e lokalizuara në faqen linguale të incizivëve bëjnë pjesë në:

- A) Klasën e III të Blakut
- B) Klasën e IV të Blakut
- C) Klasën e I të Blakut
- D) Klasën e VI të Blakut

299. Zbatimi i parimit mekanik në preparimin e kaviteve synon:

- A) Të parandaloje kariesin sekondar
- B) Të ruajë sa më shumë indet e shëndosha
- C) Të gjitha së bashku
- D) Të siguroje qëndrueshmërinë e mbushjes

300. Cilët nga përbërësit e mëposhtëm të pështymës luajnë rol në remineralizim e indeve të forta të dhëmbëve:

- A) Vitaminat
- B) Proteinat
- C) Lizozima
- D) Kripërat minerale

301. Matrica shërben për:

- A) Separimin e dhëmbëve
- B) Marrjen e masës së imët
- C) Izolimin e kavitetit
- D) Mbushjen e kavitetit të klasës së dytë

302. Shenja më e hershme klinike e kariesit është:

- A) Ndryshimi i ngjyrës
- B) Formimi i zgavrës
- C) Dhimbja nga të ëmblat
- D) Dhimbja nga të ftohtat

303. Teoritë e lindjes së kariesit janë ndarë në biologjike dhe mortaliste bazuar në vlerësimin e:

- A) Vitalitetit të smaltit
- B) Rolit të faktorëve të përgjithshëm
- C) Patogenezës së procesit karioz
- D) Rolit të faktorëve lokal në lindjen e kariesit

304. Amalgami vendoset në kavitet:

- A) Në shtresa 3 mm
- B) Në një porcion
- C) Varet nga kaviteti
- D) Pjesë-pjesë

305. Pluhuri i fleçerit përzihet me:

- A) Alkol
- B) Meticelulozë
- C) Ujë të oksigjenuar
- D) Ujë të distiluar

306. Klasifikimi i Blakut bazohet në:

- A) Ecurinë klinike të procesit karioz
- B) Indet që preken
- C) Thellësinë e kaviteve
- D) Lokalizimin e procesit karioz në sipërfaqet e dhëmbit

307. Masa karioze shumë e zbutur hiqet me:

- A) Brozhdikerr
- B) Eskavator
- C) Sond eksplorative
- D) Nërvehqës

308. Cilin nga acidet e mëposhtme përdorin sistemet adezive të kompozitëve:

- A) Acid ortofosforik 37%
- B) Acid polialkenoik 10%
- C) Acid hidrofluorik 10%
- D) Acid ortofosforik 10%

309. Në vestibulim oris derdhet:

- A) Duktuset e të tre çiftëve të gjendrave të mësipërme
- B) Duktusi i gjendrave sublingualis
- C) Duktusi i gjendrave submandibulare
- D) Duktusi i gjendrave parotis

310. Folikujt e dhëmbëve permanentë fillojnë të formohen:

- A) Në periudhën intrauterine
- B) Në muajin e gjashtë pas lindjes
- C) Në vitin e gjashtë të jetës
- D) Pas lindjes

311. Cementet glassjonomere kanë veti pozitive sepse:

- A) Çlirojnë jonë fluori
- B) Treten në kloroform
- C) Bymehen në lagështirë
- D) Stimulojnë dentinogenezën

312. Sterilizimi:

- A) Është një proces që zhdok mikroorganizmat si dhe sporet e tyre
- B) Është një proces që zhdok mikroorganizmat por jo sporet e tyre
- C) Realizohet në temperatura mbi 200 gradë celcius
- D) Në autoklava realizohet në temperatura 100-110 gradë Celsius

313. Linjat Ebner janë defekte në mineralizimin e:

- A) Dentinës
- B) Smaltit
- C) Cementit primar
- D) Ostëocementit

314. Dentina demineralizohet në PH:

- A) 5.5
- B) 3.5
- C) 6.5
- D) 2

315. Cili nga pohimet është i vërtetë:

- A) Adamantoblastët sekretojnë lëndën organike të smaltit
- B) Adamantoblastët sekretojnë lëndën organike të dentinës
- C) Adamantoblastët luajnë rol të rëndësishëm në mineralizimin e smaltit dhe dentinës
- D) Adamantoblastët janë elementët qelizor në strukturën e smaltit të maturuar

316. Cili nga përbërësit e mëposhtëm është përgjegjës për rolin mbrojtës të pështymës:

- A) Urea
- B) Immunoglobulina A sekretore
- C) Mucina
- D) Fosfataza alkaline

317. Kur sasia e sekretimit të pështymës është e ulët:

- A) Përqëndrimi i laktobacileve është i ulët
- B) Nuk ka asnjë lidhje midis sekretimit të pështymës dhe përqëndrimit të laktobacileve
- C) Përqëndrimi i laktobacileve është i lartë
- D) Përqëndrimi i bikarbonatëve është i lartë

318. Rritja e viskozitetit të pështymës:

- A) Nuk ndikon fare në procesin karioz
- B) Ul predispozitën për karies
- C) Rrit predispozitën për karies
- D) Vështirson gëlltitjen e ushqimit

319. Shtimi i bakrit në formulën e amalgamit:

- A) Rriti qëndrueshmërinë mekanike të amalgamit
- B) Rriti qëndrueshmërinë ndaj korrozionit
- C) Eliminon fazën gama 2
- D) I siguroi aliazhit shkëlqim

320. Cili nga pohimet e mëposhtme nuk është i saktë për amalgamet:

- A) Amalgamet përcjellin nxehtësinë
- B) Absorbojnë dobët lagështirën
- C) Kanë qëndrueshmëri të lartë mekanike
- D) Nuk kërkojnë formë të rregullt gjeometrike të kavitetit

321. Cili nga pohimet e mëposhtme është i saktë:

- A) Rezistenca ndaj abrazionit tek GIC rritet me kalimin e kohës
- B) Rezistenca ndaj abrazionit të GIC nuk ndryshon me kalimin e kohës
- C) Rezistenca ndaj abrazionit tek GIC (glass ionomer cementë) zvogëlohet me kalimin e kohës
- D) Rezistenca ndaj abrazionit tek GIC konvencional është më e lartë se të GIC rezin modifikuar

322. Cila përgjigje nuk është e saktë:

- A) GIC (glass ionomer cementë) çlirojnë fluor
- B) GIC sigurojnë rimineralizimin intern
- C) GIC janë radiopak
- D) GIC nuk janë biokompatibël me indet e dhëmbit

323. Të GIC (glass ionomer cementet) rezin modifikuar Komponenti rezin siguron:

- A) Adezionin me smaltin dhe dentinën

- B) Uljen e sensitivitetit ndaj ujit
- C) Biokompatibilitetin
- D) Radio opacitetin

324. Glass ionomer cementet nuk përdoren në:

- A) Në rindërtimin e tuberkulave
- B) Erozionët cervikale
- C) Në kariesin e rrënjëve
- D) Mbushje në dhëmbët e qumështit

325. Në cilin nga sensitivitetit e mëposhtme nuk indikohet procedura e zbardhimit:

- A) Fluorozë
- B) Dekolorimet nga tetraciklina
- C) Pacientë me retraksion gingivar
- D) Dekolorimet nga duhani

326. Cili nga pohimet nuk është i vërtetë:

- A) Sasia e lartë e Laktobacileve është tregues i prodhimit të ulur të pështymës
- B) Në hyposekretim të pështymës favorizohet mikroflora kariogjenike e pasur me laktobacile dhe streptokoke mutans
- C) Në hypofunksionin e gjendrave të pështymës demineralizimi dhe aktiviteti karioz ulet
- D) Mungesa e pështymës çon në një zhvillim të shpejtë të procesit karioz në zona atipike si në faqet linguale, në kuspide, margo

327. Gërryerja mekanike, fiziologjike e dhëmbëve si rezultat i mastikacionit quhet:

- A) Abrazion
- B) Abfraksion
- C) Erozion
- D) Atricion

328. Cili prej bakterieve të mëposhtme nuk luan rol në procesin karioz:

- A) Streptococcus mutans
- B) Lactobacillus acidiphillus
- C) Staphylococcus aureus
- D) Actinomyces

329. Sipërfaqja e smaltit e pasur me fluorapatit:

- A) Rritet me kalimin e moshës
- B) Zvogëlohet me kalimin e kohës për shkak të konsumimit sipërfaqësor
- C) Nuk ndryshon në lidhje me moshën
- D) Organizohet në disa shtresa

330. Klinikisht shenja fillestare e kariesit është:

- A) Ashpërsimi i sipërfaqes së dhëmbit
- B) Ndjeshmeria nga të ëmblat
- C) Njolla e errët
- D) Njolla e bardhë si shkumës

331. Në një pacient që vuan nga kserostomia:

- A) Ka procese karioze atipike

- B) Ka kariese të arrestuar
- C) Ka ulje të aktivitetit karioz
- D) Ka procese karioze kronike

332. Baza në një kavitet të klasës së tretë është:

- A) Muri gingivar
- B) Muri aksial
- C) Muri lingual
- D) Muri vestibular

333. Qëllimi i formave të retensionit në kavitetet e preparuara është të ndalojë zhvendosjen e mbushjes nga:

- A) A+B+C
- B) Forcat okluzale
- C) Forcat vestibulo orale
- D) Forcat laterale

334. Thellësia e kavitetit të klases se V duhet të jetë:

- A) Më e thellë në drejtim të gingivës
- B) Uniform
- C) Më e thellë në drejtim të margos prerëse
- D) Më e thellë në muret proksimale

335. Cili nga përbërësit e mëposhtëm i siguron viskozitetin pështymës:

- A) Mucina
- B) Kriperat minerale
- C) Imunoglobulina A sekretore
- D) Urea

336. Cili nga përbërësit e mëposhtëm i siguron shkëlqim amalgamit:

- A) Bakri
- B) Zinku
- C) Indiumi
- D) Kallaji

337. Cili nga pohimet e mëposhtme nuk është i vërtetë për amalgamin:

- A) Absorbon lagështinë duke bërë të mundur adezionin e pllakës bakteriale
- B) Nuk ndryshon kimikisht
- C) Ka plasticitetin e duhur gjatë vedosjes në kavitet duke mundësuar edhe kondensim të mirë
- D) Ka qëndrueshmëri të lartë ndaj presionit përtypës

338. Amalgami nuk indikohet të përdoret si mbushje përfundimtare në:

- A) Klasën e parë të Blakut
- B) Klasën e IV të Blakut
- C) Kavitetet në qafat e molarëve dhe premolarëve
- D) Klasën e dytë të Blakut

339. Në zbuliminë kariesit aproksimal cili nga egzaminimet e mëposhtme është më sensitive:

- A) Radiogرافia në kafshim ose Bite Wing
- B) Panorameksi
- C) Egzaminimi me sond dhe pasqyrë
- D) Elektrodiagnostiku

340. Cila nga pohimet e mëposhtme nuk është i vërtetë:

- A) Smalti mund të ripërtërihet
- B) Smalti është asensitiv
- C) Smalti është ind aqelizor
- D) Smalti është i ndërtuar nga prizma

341. Sa është thellësia e preparimit për fasetë:

- A) 1-1.5 mm
- B) 1.5-2mm
- C) 0,2-0,3 mm
- D) 0,5-0,7 mm

342. Në preparimin për fasetë margoja incizale:

- A) Vetëm rrumbullakoset
- B) Nuk preparohet
- C) Vetëm bizotohet
- D) Preparohet

343. Dentina sekondare depozitohet në:

- A) Tavanin e dhomës pulpare
- B) Në dyshe-menë e dhomës pulpare
- C) Nën lezionin karioz
- D) Në gjithë perimetrin e dhomës pulpare

344. Në pulpë me kalimin e moshës:

- A) Rritet vaskularizimi
- B) Reduktohen elementët fibrilare
- C) Reduktohen elementët qelizor
- D) Rritet inervimi

345. Precipitimi i kripërave minerale në kanalzat dentinare çon në formimin e:

- A) Dentinës së tejdukshme ose sklerotike
- B) Dentinësterciare
- C) Dentinës sekondare
- D) Dentinës peritubulare

346. Cilat nga qelizat e mëposhtme luajnë rol mbrojtës në pulpë:

- A) Fibroblastët
- B) Odontoblastët
- C) Osteoblastët
- D) Histocitët

347. Shiritat Hunter -Shreger janë:

- A) Fenomenë optike
- B) Defekte në strukturën e smaltit

- C) Shirita hiperkromatik
- D) Difektë nga fluoroza

348. Qëllimi i acidifikimit është:

- A) Të sigurojë një sipërfaqe të pastër të smaltit
- B) Të gjitha të mësipërmet
- C) Të sigurojë mikroretensionin e cilat të penetrojnë rezina
- D) Të rrisë sipërfaqen e bondimit të smaltit

349. Shpejtësia mesatare e rrotullimeve të turbinës është:

- A) 200 000 rpm
- B) 100 000 rpm
- C) 6 000 rpm
- D) 10 000 rpm

350. Forma e jashtme e kavitetit për inlejt është:

- A) E njëjtë me atë të kavitetit për amalgam
- B) Varet nga shtrirja e procesit karioz
- C) Më e ngushtë se e kavitetit për amalgam
- D) Më e gjerë se e kavitetit për amalgam

351. Në kavitetin e klasës së parë gjerësia e hyrjes së kavitetit duhet të jetë sa:

- A) 1/6 e distancës interkuspitale
- B) 1/2 e distancës interkuspitale
- C) 1/3 e distancës interkuspitale
- D) 1/4 e distancës interkuspitale

352. Sa është thellësia minimale në kavitetet për amalgam:

- A) 0,5 mm
- B) 1mm
- C) 3mm
- D) 1,5-2mm

353. Fibrat e Tomsit janë zgjatime protoplazmatike të:

- A) Fibroblasteve
- B) Odontoblasteve
- C) Cementoblasteve
- D) Osteoblastëve

354. Cementet karboksilate:

- A) Kanë veti më acide se fosfat cementi
- B) Përdoren si shtresa vecuese në kavitate të thella
- C) Përdoren si mbushje përfundimtare në dhëmbët permanentë
- D) Përdoren si mbushje provizore

355. Pinlay është:

- A) Mbushje indirekte retensionit i të cilave realizohet me anë të kunjave pulpore, parapulpar
- B) Mbushje indirekte që mbulojnë 3/4 e kurorës

- C) Mbushje indirekte që mbulon në tërezi ose në pjesën më të madhe sipërfaqen okluzale të dhëmbit
D) Mbushje indirekte që vendoset në kavitetin e preparuar që rrethohet me mure të forta të dhëmbit

356. Gingiva e lirë gjendet:

- A) E lidhur pas dhëmbëve dhe kockës alveolare
B) Në procesin alveolar
C) Pranë lidhëses muko-gingivare
D) Në qafën e dhëmbit

357. Maturimi i pllakës bakteriale arrihet pas:

- A) 1 javë
B) Ditës së parë
C) 14-21 ditë
D) 2 muajsh

358. Intensiteti i dhimbjes është më i fortë në:

- A) Kariesin kronik
B) Njollën karioze
C) Kariesin inaktiv
D) Kariesin akut

359. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë:

- A) Kariesi rampant prek vetëm adoleshentët
B) Kariesi rampant prek vetëm infantët
C) Kariesi rampant prek vetëm moshat e vjetra
D) Kariesi rampant prek të gjitha moshat

360. Gutaperka tretet në:

- A) Alkol
B) Eugenol
C) Kloroform
D) Solucion fiziologjik

361. Cili nga materialet e mëposhtme ka qëndrueshmëri mekanike më të lartë:

- A) Kaviduri
B) Gutaperka
C) Fleçeri
D) Oksid-zink eugenoli

362. Cili nga pohimet e mëposhtme nuk është i vërtetë:

- A) Hidroksidi i kalçiumit ka PH të lartë alkaline
B) Hidroksidi i kalçiumit nuk ka veti baktericide
C) Hidroksidi i kalçiumitnxit fosfatazën alkaline
D) Hidroksidi i kalçiumit ka shkrishmëri të vogël

363. Cila nga metodat e sterilizimit është më efektive:

- A) Sterilizimi me avuj kimik
B) Sterilizimi me avull nën presion

- C) Sterilizimi me kuarc
- D) Sterilizimi me ajër të nxehtë të thatë

364. Cili nga pohimet e mëposhtme nuk është i vërtetë? Materialet që përdoren për mbushje të përkohshme duhet të:

- A) Adaptohen lehtë
- B) Të kenë fortësinë e duhur
- C) Të shkrihen në prani të pështymës
- D) Të mbyllin në mënyrë hermetike kavitetin

365. Kariesi fisural prek më shumë:

- A) Dhëmbët e adulteve
- B) Dhëmbët e sapoeruptuar
- C) Dhëmbët e të moshuarve
- D) Të tre grupet njëjloj

366. Kariesi recidivant lokalizohet:

- A) Në bifurkacion
- B) Në anët e mbushjes
- C) Nën mbushje
- D) 1/3 cervikale

367. Cili nga pohimet e mëposhtëm nuk është i saktë:

- A) Kaviduri mbyll në mënyrë hermetike kavitetin
- B) Kaviduri nuk forcohet në prani të pështymës
- C) Kaviduri i reziston presionit përtypës
- D) Kaviduri nuk vepron mbi indet e dhëmbit

368. Në një karies profund cilin nga preparatet e mëposhtëm do të përdorni si shtresë izoluese:

- A) Cement karboksilatet
- B) Hidroksidin e kalçiumit
- C) Cement oksifosfatët
- D) Oksid zink eugenolin

369. Muret e kavitetit të preparuar duhet të jenë:

- A) Pingul me drejtimin e prizmave
- B) Nuk ka rëndësi drejtimi
- C) Të formojnë kënd 30 gradë me drejtimin e prizmave
- D) Paralel me drejtimin e prizmave

370. Në amputimin vital përdoret:

- A) Trikrezol-formalinë
- B) Kreozot , jodoform, oksid zinku
- C) Ca(OH)₂
- D) Dykal, kalcimol

371. Frezat e diamantit janë superior në krahasim me frezat e çelikut në preparimin e:

- A) Dentinës
- B) Smaltit

- C) Cementit
- D) Masës karioze

372. Gjerësia e istmusit (hyrjes së kaviteve) në kavitetet për inleje është:

- A) $1/3$ e distancës interkuspitale
- B) $1/4$ e distancës interkuspitale
- C) $>1/2$ e distancës interkuspitale
- D) $1/6$ e distancës interkuspitale

373. Humbja e strukturës dhëmbore nga një proces kimik jobakterial quhet:

- A) Abrazion
- B) Erozion
- C) Atricion
- D) Abfraksion

374. Teoria Brännströme shpjegon mekanizmin e dhimbjes gjatë preparimit të kavitetit me:

- A) Çlirimin e acetilkolinës
- B) Praninë e fijeve nërvore në $1/3$ e dentinës
- C) Lëvizjen kapilare të likidit në kanalzat dentinare
- D) Çlirimin e histaminës

375. Elektrodiagnostiku përdoret për:

- A) Përcaktimin e Apeksit
- B) Diagnostikimin e kariesit aproksimal
- C) Matjen e vitalitetit
- D) Në të gjitha

376. Në teorinë e Lukomskit vlerësohet:

- A) Roli i mikroorganizmave në lindjen e kariesit
- B) Roli i imunoglobulinës A sekretore
- C) Çrregullimet e balancit të proteinave dhe vitaminave
- D) Roli trofik i odontoblastëve

377. Cili nga përbërësit e pështymës është përgjegjës për zbërthimin e karbohidrateve:

- A) Ptialina
- B) Mucina
- C) Urea
- D) Lizozima

378. Cili nga përbërësit e mëposhtëm është përgjegjës për qëndrueshmërinë mekanike të kompoziteve:

- A) Lënda organike
- B) Adezivi
- C) Silanet
- D) Lënda inorganike

379. Në kariesin aproksimal kaviteti Box preparohet:

- A) Për mbushjet me amalgam
- B) Për rinleje

- C) Për inlejt
- D) Për mbushjet me kompozit

380. Cili nga preparatet e mëposhtme që përdoren si shtresa izoluese çliron fluor:

- A) Glass ionomer cementet
- B) Cement karboksilatet
- C) EBA cementet
- D) Hidroksidi i kalçiumit

381. Parimi biologjik në preparimin e kavitetve konsiston në:

- A) Eliminimin e kariesit sekondar
- B) Sigurimin e qëndrueshmërisë së mbushjeve ndaj forcave të presionit përtypës
- C) Kursimin e indeve të shëndosha
- D) Eliminimin e zmaltit

382. Në cilin nga kavitetet e mëposhtme zbatohet më shumë parimi biologjik:

- A) Kavitetin e preparuar për kompozit
- B) Kavitetin e preparuar për inlejt
- C) Kavitetin e preparuar për amalgam
- D) Kavitetin për pinlejt

383. Klasifikimi i kompoziteve bazohet në:

- A) Madhësinë e grimcave mbushëse
- B) Sistemet e rezinave
- C) Sistemet adezive
- D) Monomerin

384. Në egzaminimin subjektiv nuk bën pjesë:

- A) Historiku i sëmundjes
- B) Egzaminimi klinik me sond dhe pasqyrë
- C) Anamneza familjare
- D) Anamneza vitae

385. Ngjyrosja e dhëmbëve nga mosha vjen nga:

- A) Depozitimi i dentinës sekondare
- B) Fluoroza
- C) Trauma
- D) Tetraciklina

386. Cili është indi më i mineralizuar i dhëmbit:

- A) Cementi
- B) Smalti
- C) Dentina
- D) Dentina sekondare

387. Me anë të radiografisë dentare nuk mund të përcaktojmë:

- A) Topografinë e kanaleve
- B) Lokalizimin e procesit karioz

- C) Numrin e rrënjëve
- D) Stadin e inflamacionit në pulpë

388. Cili nga preparatet e mëposhtme nxit formimin e urës dentinare:

- A) Hidroksidi i kalçiumit
- B) Eugenati
- C) Oksifosfat cementi
- D) Cement karboksilati

389. Cili është agjenti aktiv i pastave që përdoren për zbardhjen e dhëmbëve:

- A) Karbamid peroksidi
- B) Perhidroli
- C) Ujë i oksigjenuar
- D) Superoksoli

390. Cili nga acidet e mëposhtme bën pjesë në likidin e glass-ionomer cementëve:

- A) Acidi fluorhidrik
- B) Acidi ortofosforik
- C) Acidi polialkenoik
- D) Acidi citric

390. Cili nga materialet e mëposhtme përdoret njëkohësisht si për mbushje të përkohshme, mbushje perfundimtare, si shtresa izolues:

- A) Kompomeret
- B) Kompozitet
- C) Karboksilat cementet
- D) Glass-ionomer cementet

392. Cili nga materialet restorativ është biokompatibël me indet e dhëmbit:

- A) Glass-ionomer cementet
- B) Amalgami
- C) Kompozitet
- D) Kompomerët

393. Cili nga materialet e mëposhtëm ka qëndrueshmëri mekanike më të vogël:

- A) Kompomeret
- B) Kompozitet
- C) Glass ionomer cementet
- D) Amalgami

394. Cili nga materialet e mëposhtëm shkakton ngjyrosje të indeve të dhëmbit:

- A) Glass-ionomer cementet
- B) Kompozitet
- C) Kompomeret
- D) Amalgami

395. Cili nga materialet e mëposhtëm është më radioopak:

- A) Kompoziti
- B) Kompomerët
- C) Glass ionomer cementi

D) Amalgami

396. Pika e kontaktit:

- A) Të gjitha të vërteta
- B) Shpërndan presionin përthypës në rrafshin horizontal
- C) Eleminohet në proceset karioze aproksimale
- D) Mbron papilën interdental nga mbeturinat ushqimore

397. Në kavitetet për amalgam këndi që formohet midis mbushjes dhe strukturës së dhëmbit (Cavo-surface margo) është:

- A) 45 gradë
- B) 30 gradë
- C) 6 gradë
- D) 90 gradë

398. Amortizimi hidraulik i presionit përthypës në periodont kryhet nga:

- A) Fibroblastet
- B) Mbaresat nërvore
- C) Mbeturinat epiteliale të Malases
- D) Enët e gjakut

399. Cili është shkaku i inflamimit të papilës interdental:

- A) Kariesi sekondar
- B) Kariesi okluzal
- C) Mbushjet e varura
- D) Mbushja me kompomere

400. Foetor ex oris shkaktohet nga:

- A) Sëmundjet e veshkave
- B) Sëmundjet kardiake
- C) Sëmundjet e heparit
- D) Sëmundjet kockore

401. Pulpa radikulare ka:

- A) Më shumë enë gjaku se pulpa koronare
- B) Më shumë elementë qelizor se pulpa koronare
- C) Të gjitha të vërteta
- D) Më shumë elementë fibrilar se pulpa koronare

402. Masën për inlejt porcelani e marrim me:

- A) Alginat
- B) Dyll
- C) Silikonë
- D) Allçi

403. Cili është shkaku i rënies së mbushjeve me kompozit:

- A) Kariesi sekondar
- B) Të gjitha shkaqet e mësipërme
- C) Mos respektimi i kohës së acidifikimit
- D) Prania e lagështisë në kavitet

404. Zëvendësimi i mbushjeve me kompozit në dhëmbët e trajtuar me agjentë zbardhues bëhet:

- A) Menjëherë pas procedurës së zbardhimit
- B) 1 javë pas zbardhimit
- C) Pas 1 ditë
- D) Pas 2 javësh nga zbardhimi

405. Cila nga vitaminat e mëposhtme luan rol në mineralizimin e dhëmbëve:

- A) Vitamina D
- B) Vitamina C
- C) Vitamina A
- D) Vitamina E

406. Cila nga vitaminat e mëposhtme luan rol në formimin e indit lidhor:

- A) Vitamina A
- B) Vitamina D
- C) Vitamina C
- D) Vitamina E

407. Cementet karboksilate:

- A) Kanë veti më acide se fosfat cementi
- B) Përdoren si mbushje provizore
- C) Përdoren si shtresa veçuese në kavitete të thella
- D) Përdoren si mbushje përfundimtare në dhëmbët permanentë

408. Linjat Retzius gjenden në:

- A) Kufirin smalt-dentinë
- B) Smalt
- C) Kufirin smalt -cement
- D) Dentinë

409. Dentina terciare është dentina që krijohet:

- A) Gjatë odontogjenëzës
- B) Si përgjigje ndaj kariesit, abrazionit, atricionit, erozionit, traumave
- C) Gjatë gjithë jetës
- D) Gjatë amelogjenëzës

410. Në lëndën organike të smaltit ka:

- A) Kolagjen të tipit të parë, glukozaminoglikanë, fosfoproteina
- B) Enamelin, fosfolipide, fosfoproteina, mukopolisaharide
- C) Enamelin, ameloblastinë, tuftelinë
- D) Kristale të hidroksiapatitit

411. Zona granulare e Tomsit gjendet në:

- A) Kufirin smalt-dentinë
- B) Cementin qelizor
- C) Kufirin dentinë-cement
- D) Cementin joqelizor

412. Në zbardhimin në klinikë cili nga përqendrimit e karbamid peroksidit përdoret:
- A) 10%
 - B) 15%
 - C) 50 %
 - D) 35%
413. Cili nga elementët e mëposhtëm ndikon në tkurjen fillestare të amalgamit:
- A) Ag
 - B) Zn
 - C) Sn
 - D) Hg
414. Faza gama2 është lidhja:
- A) Sn₇Hg₈
 - B) Ag-Sn
 - C) Ag-Cu
 - D) Ag₂Hg₃
415. Kaviteti i preparuar për mbushje me kompozit nuk kërkon:
- A) Kavitet retëntiv
 - B) Bizotim të smaltit
 - C) Acidifikim
 - D) Heqje të mureve të varura
416. Cili është PH kritik për inicimin e procesit karioz
- A) 6,5
 - B) 5.5
 - C) 3.5
 - D) 7.5
417. Në procesin karioz:
- A) Dhimbja spontane
 - B) Dhimbja vazhdon me largimin e shkakut
 - C) Dhimbja është pa shkak
 - D) Dhimbja largohet me largimin e shkakut
418. Në një kavitet të preparuar për inlej muret anësore duhet të jenë:
- A) Pingul
 - B) 90 gradë
 - C) Të konvergojnë
 - D) Të divergojnë
419. Në kavitetet për inlej këndi që formohet midis mbushjes dhe strukturës së dhëmbit (Cavo-surface margo) është:
- A) 45 gradë
 - B) 30 gradë
 - C) 6 gradë
 - D) 90 gradë
420. Indikacionet për përdorimin e hidroksidit të kalciumit janë:

- A) Mbushje provizore e kavitetit në seancat ndërmjetëse
- B) Shtresë veçuese në karies sipërfaqësor
- C) Mbulimi i pulpës në kavitate të thella
- D) Si material për devitalizimin e pulpës

421. Medikamentet që vendosen në kavitet në prani të lageshtisë:

- A) Hiqen me lehtësi
- B) Ndryshojnë ngjyrë
- C) Ndryshojnë volumin
- D) Humbin efektin e tyre terapeutik

422. Inlejet përgatitën prej:

- A) Ari
- B) Të treja së bashku
- C) Kompoziti
- D) Porcelani

423. Prezenca e Zinkut në amalgamin e argjendit:

- A) Redukton proceset karioze
- B) Shkakton tkurrje
- C) Shkakton bymim të vonshëm të mbushjes
- D) Shkakton fortësimin

424. Bymimi i vonshëm i amalgamit fillon:

- A) Pas 3-5 ditësh
- B) Pas 2 vjetësh
- C) Pas 24 orësh
- D) Pas 3-5 muajsh

425. Llaqet indikohen në mbushjet me amalgam sepse:

- A) Parandalojnë fenomenët galvanike
- B) Janë izolues të mirë termik
- C) Përmirsojnë adaptimin marginal
- D) Të gjitha opsionet e mësipërme

426. Cili nga pohimet e mëposhtme nuk është i vërtetë:

- A) Pelikula është një shtresë proteinike aqelizore
- B) Pelikulaluan rol të rëndësishëm në transportin selektiv të joneve
- C) Pelikula është e pasur me qeliza bakteriale
- D) Pelikula përcakton mikroflorën fillestare bakteriale

427. Në cilat nga lezionet e mëposhtme është i mundur procesi i rimeneralizimit:

- A) Macula alba
- B) Atricione
- C) Abrazion
- D) Erozione

428. Në sistemet vetacidifikues të fortë:

- A) PH > 1
- B) PH > 2

- C) PH=<1
- D) PH=5

429. Kariesi insipient aproksimal zakonisht lokalizohet në:

- A) Pikën e kontaktit
- B) Nën pikën e kontaktit në drejtim të gingivës
- C) Lingualisht pikës së kontaktit
- D) Vestibularisht pikës së kontaktit

430. Formula numerike einstrumentave e vendosur në bishtin e tyre është sipas kësaj renditje:

- A) Kënd, gjatësi, gjerësi
- B) Gjatësi, gjerësi, kënd
- C) Gjerësi, gjatësi, kënd
- D) Kënd, gjerësi, gjatësi

431. Madhësia e grimcave të qelqit të glass ionomer cementeve është:

- A) 100 μ
- B) 0,1mm
- C) 15-1 μ
- D) 0.01mm

432. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë:

- A) Në karriesin e arrestuar lezioni është në ngjyrë bezhë të hapur dhe i butë në sondim
- B) Në kariesin e arrestuar nuk është e pranishme skleroza tubulare
- C) Në kariesin e arrestuar procesi progreson shpejt
- D) Në karriesin e arrestuar lezioni është në ngjyrë kafe të errët dhe i fortë në sodim

433. Në një kavitet të klasës së parë cilët nga kompozitet e mëposhtëm do të preferoni:

- A) Kompozit mikrombushës
- B) Kompozit fluid
- C) Kompozit nanombushës
- D) Kompozit hybrid

434. Si ndikon smear layer-i në adezionin e rezinave kompozite:

- A) Negativisht
- B) Pozitivisht
- C) Varet nga kaviteti
- D) Nuk ndikon fare

435. Zbardhimi i dhëmbëve vital nuk mund të kryhet në:

- A) Dhëmbë me dhomë pulpare të madhe
- B) Në të gjitha sensitivitetit e mësipërme
- C) Dhëmbë me retraksion gingivar
- D) Dhëmbëme sensitivitetet të lartë

436. Cili nga pohimet e mëposhtme nuk është i vërtetë:

- A) Inlejet zëvendësojnë defektetë mëdha duke i rikthyer dhëmbit formën dhe funksionin
- B) Inlejet ndryshojnë vëllimin

- C) Inlejet realizohet shumë mirë sipërfaqja proksimale dhe okluzale
- D) Inlejet riformojnë pikën e kontaktit

437. Në sensitivitetin e frakturave të inlejeve cili prej tyre mund të riparohet:

- A) Inlejet e porcelanit
- B) Inleji i metaleve fisnike
- C) Inlejet e metalit
- D) Inlejet e kompozitit

438. Cili nga inlejet e mëposhtëm shkaktojnë më shumë konsumim sipërfaqësor të dhëmbëve antagonist:

- A) Inlejet e arit
- B) Inlejet e kompozitit
- C) Inlejet e porcelanit
- D) Të gjithë shkaktojnë të njëjtin konsumim

439. Në restaurimet e mbylljeve të diastëmave duhet:

- A) Duhet të theksohet perikimata gingivare
- B) Duhet të theksohen elementët horizontale
- C) Duhet të theksohen elementët vertikale të dhëmbit
- D) Duhet të zbutën elementët vertikale

440. Metodat fizike të diagnostikimit japin të dhëna të rëndësishme në:

- A) Proçeset karioze
- B) Trauma
- C) Anomalitë e strukturës
- D) Pulpitet akute

441. Raporti ideal gjerësi - gjatësi i incizivëve central për të patur një buzëqeshje të bukur është:

- A) 1:1
- B) 0,40-0,50
- C) 0,20-0,30
- D) 0.75-0.80

442. Cili nga pohimet është i vërtetë:

- A) Me rritjen e madhësisë së grimcave mbushëse të kompozitet zvogëlohet ashpërsimi i sipërfaqes
- B) Me zvogëlimin e madhësisë së grimcave mbushëse të kompozitet rritet ashpërsimi i sipërfaqes
- C) Me rritjen e madhësisë së grimcave mbushëse të kompozitet rritet ashpërsimi i sipërfaqes
- D) Madhësia e grimcave mbushëse nuk ndikon në ashpërsinë e sipërfaqes

443. Sistemet inhibuese të kompozitet:

- A) Parandalojnë proçesin e polimerizimit spontan
- B) Luajnë rol në cilësitë optike
- C) Bëjnë të mundur lidhjen midis rezines dhe mbushësit
- D) Sigurojnë cilësitë estetike

444. Fasetat nuk indikohen në:
A) Frakturat e dhëmbëve në adoleshencë
B) Dhëmbë devital të dekoloruar
C) Bruksizëm
D) Errozione labiale të mëdha
445. Trashësia e smear layer në muret e kavitetit të preparuar:
A) Nuk varet nga ashpërsia e frezave
B) Rritet me numrin e frezës
C) Zvogëlohet me rritjen e ashpërsisë së frezave të diamantit
D) Rritet me rritjen e ashpërsisë së frezave të diamantit
446. Lezionet jokarioze karakterizohen nga:
A) Hipersensitivitet dentinar
B) Dhimbje pa shkak
C) Dhimbje natën
D) Dhimbje në perkursion
447. Cili nga solucionet e mëposhtme shkakton emboli gazore në pulpë:
A) Uji i oksigjenuar
B) Solucioni fiziologjik
C) Alkoli
D) Uji i distiluar
448. Cili është shkak i dekolorimit të një dhëmbi të vetëm:
A) Trauma
B) Përdorimi i tetraciklinës
C) Fluoroza
D) Porfiria
449. Tkurrja e polimerizimit të kompozitit:
A) Rritet në kavitetet minimal
B) Zvogëlohet në kavitetet ekstensive
C) Rritet në kavitetet ekstensive
D) Nuk lidhet me përmasat e kavitetit
450. Cili nga materialet e mëposhtme realizon adezion jon shkëmbyes me indet e dhëmbit:
A) Amalgami
B) Kompozitet
C) Cement oksifosfati
D) Glass ionomer cementet
451. Cili është komplikacioni më i shpeshtë në zbardhjen e dhëmbëve:
A) Gangrena pulpare
B) Polipi pulpar
C) Hipersensitivitet dentinar
D) Gingiviti hipertrofik
452. Agjenti zbardhues në gingivat e paizoluara shkakton:

- A) Hiperplazi të gingivave
- B) Hipertrofi gingivare
- C) Djegie të gingivave
- D) Gingivit ulcero-nekrotik

453. Përdorimi jo korrekt i furçës së dhëmbëve mund të shkaktojë:

- A) Hiplazi të smaltit
- B) Erozion
- C) Defekte kunëiforme
- D) Amelogenesis imperfekta

454. Në dekolorimin e gradës së tretë nga fluoroza cilin nga trajtimet e mëposhtme do të zgjidhni:

- A) Zbardhimin në shtëpi
- B) Trajtim restorativ fasetë
- C) Zbardhimin në klinik
- D) Asnjë nga trajtimet e mësipërme

455. Qëndrueshmëria mekanike e glass-ionomer cementeve:

- A) Rritet me rritjen e raportit pluhur- likid
- B) Zvogëlohet me rritjen e raportit pluhur-likid
- C) Nuk ndikohet nga raporti pluhur- likid
- D) Varet nga adezioni me indet e dhëmbit

456. Sa është vlera e monomerit rezinoz HEMA në likidin e glass ionmer cementeve:

- A) 5-7%
- B) 30-40%
- C) 60-70%
- D) 18-20%

457. Koeficienti i bymimit termik të materialet restorative vlerëson:

- A) Qëndrueshmërinë mekanike
- B) Përcjelljen e temperaturës
- C) Qëndrueshmërinë dimensionale
- D) Konsumimin sipërfaqësor

458. Cili nga materialet e mëposhtëm restorativ ka konsumimin më të madh sipërfaqësor:

- A) Glass-ionomer cementet
- B) Kompozitet
- C) Kompomeret
- D) Amalgami

459. Faza gama 2 në formulën e amalgamit duhet të eliminohet sepse:

- A) Është e paqëndrueshme në vëllim
- B) Rrit korrozionin
- C) Rrit thyeshmerinë e materialit
- D) Rrit konsumimin sipërfaqësor

460. Cili nga faktorët e mëposhtëm ndikon në adezionin e kompoziteve:

- A) Përbërja e smaltit

- B) Acidi 37 %
- C) Smear Layer
- D) Prania e fluoropatitit

461. Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk ndikon në efektin e agjentit zbardhues:

- A) Koha e ekspozimit
- B) Abrazioni
- C) Përqëndrimi i principit aktiv
- D) PH

462. Shtimi i rezines në formulën e glass inomerëve konvencional u siguron atyre:

- A) Ulje të sensitivitetit ndaj ujit
- B) Cilësi të e larta fizike
- C) Të gjitha të vërteta
- D) Cilësi të mira estetike

463. Skleroza tubulare e dentinës është më e shprehur në:

- A) Kariesin akutisima
- B) Kariesin e arrestuar (inaktiv)
- C) Kariesin akut
- D) Kariesin kronik

464. Mbushja e kavitetëve të mëdha karioze realizohet me:

- A) Inlej ari
- B) Inleje dhe pinleje
- C) Inlej porcelani
- D) Pinlej kompoziti me shtifte parapulpar

465. Njolla e bardhë është e dukshme në smaltin e njomur nga pështyma kur:

- A) Demineralizimi ka prekur shtresën sipërfaqësore të smaltit
- B) Demineralizimi ka ndodhur në të gjithë trashësinë
- C) Demineralizimi ka avancuar në gjysmën e trashësisë së smaltit
- D) Demineralizimi sapo ka filluar

466. Pelikula ndihmon në:

- A) Remineralizim e smaltit
- B) Fortësimin e smaltit
- C) Demineralizimin e smaltit
- D) Përbërjen e mikroflorës fillestare të pllakës

467. Smalti është:

- A) Transparent
- B) Opak
- C) Opaleshent
- D) Translucent

468. Në moshat e reja smalti ka:

- A) Translucencë të lartë
- B) Densitet të lartë
- C) Densitet të ulët

D) Translucence të ulët

469. Cila nga sheqernat e mëposhtme është më shumë kariogjenike:

- A) Glukoza
- B) Fruktoza
- C) Sukroza
- D) Laktoza

470. Aplikimi i Primerit të sistemeve adezive:

- A) E bën dentinën me hidrofile
- B) Eleminon smear layerin
- C) E bën dentinën me hidrofobe
- D) Nuk ndikon në sipërfaqen e dentinës

471. Matrica organike e rezinave kompozite përmban:

- A) Dimetil metakrilat
- B) Glycidil metakrilat
- C) Bisfenol glycidyl metakrilat
- D) Metil metakrilat

472. Shtimi i grimcave mbushëse të kompozitet:

- A) Ul rezistencën ndaj abrazionit
- B) Rrit tkurrjen e polimerizimit
- C) Rrit qëndrueshmërinë mekanike të kompozitit
- D) Zvogëlon tkurrjen e polimerizimit

473. Shkaku kryesor i frakturës së istmusit në mbushjet me amalgam të klasës së dytë është:

- A) Thellësia jo e duhur e istmusit
- B) Prania e lageshtirës
- C) Gjerësia jo e duhur e istmusit
- D) Asnjë përgjigje e saktë

474. Transiluminimi me fibra optike shërben për të detektuar:

- A) Kariesin aproksimal
- B) Kariesin okluzal
- C) Kariesin cervical
- D) Kariesin sekondar

475. Të kompozitet hibride prania e mbushësit inorganik është:

- A) 35-50%
- B) 85-90%
- C) 60-70%
- D) 70-80%

476. Hipoplazia e smaltit karakterizohet nga:

- A) Sasi të pamjaftueshme të smaltit
- B) Mungesë totale të smaltit
- C) Sasi normale të smaltit por defekte në kalcifikimin e tij
- D) Sasi e mjaftueshme e dentinës

478. Smalti është përgjegjës për ndriçimin e:

- A) Grupinë valëve me gjatësi të shkurtër
- B) Grupinë valëve me gjatësi të gjatë
- C) Gjithë spektrin të dritës
- D) Grupinë valëve me gjatësi mesatare

479. Dentina është përgjegjëse për:

- A) Opaleshencën
- B) Valoren
- C) Kromen
- D) Translucencen

480. Përqëndrimi i HCO_3^- :

- A) Ulet me uljen e sekretimit të pështymës
- B) Nuk ndikohet nga sekretimi i pështymës
- C) Rritet me uljen e sekretimit të pështymës
- D) Ulet me rritjen e sekretimit të pështymës

11. Dentistri Restorative

1. Cili nga elementët e mëposhtëm nuk është pjesë e historisë së pacientit?

- A) Historia mjekësore
- B) Historia dentare
- C) Ankesat e pacientit
- D) Historia personale

2. Cili nga pohimet mëposhtme nuk është qëllimi i anamnezës tek pacientët?

- A) Vendosja e diagnoses
- B) Vendosja e një raporti me pacientin
- C) Zbulimi i patologjive të ndryshme
- D) Zgjedhja e teknikës operative

3. Cili nga elementët nuk është i nevojshëm të përfshihet në historinë mjekësore?

- A) Historia sociale
- B) Alergjitë
- C) Statusi i gjëndjes shëndetësore të pacientit
- D) Mjekimet që merr pacienti

4. Cili nga komponentët e mëposhtëm ka rëndësi në historinë sociale të pacientit?

- A) Duhan pirja dhe Alkooli
- B) Mardhënja me kolegët
- C) Vendbanimi
- D) Numri i vizitave tek dentist

5. Cili është interesi kryesor i historisë familjare të pacientit për mjekun?

- A) Statusi ekonomik
- B) Profesionit
- C) Sëmundje me origjinë gjenetike
- D) Statusi social

6. Një mask këshillohet të mbahet mesatarisht:
- A) 10 minuta
 - B) 2 ditë
 - C) 1 orë
 - D) 3-4 ditë
7. Cila nga pjesët e mëposhtme nuk sterilizohet dhe duhet të zëvendësohet?
- A) Frezat
 - B) Brozhdikerët
 - C) Maja e shiringës ajër-ujë
 - D) Kanjulat
8. Cili nga faktorët e mëposhtëm luan rol në procesin e demineralizimit?
- A) Dieta e pasur me proteina
 - B) Dieta e pasur me yndyrna
 - C) Dieta e pasur me kripra minerale
 - D) Dieta e pasur me karbohidrate
9. Cili nga faktorët e mëposhtëm luan rol në procesin e demineralizimit?
- A) Dieta e pasur me kripra minerale
 - B) Dieta e pasur me karbohidrate
 - C) Dieta e pasur me proteina
 - D) Dieta e pasur me yndyrna
10. Dentina është:
- A) Ind i mineralizuar dhe qelizor
 - B) Ind i minërlaizuar dhe inërvuar
 - C) Ind i mineralizuar dhe aqelizor
 - D) Ind i mineralizuar dhe vaskularizuar
11. Kolonizimi fillestar i zgavrës së gojës së fëmijës ndodh:
- A) Gjatë dhe pak kohë pas lindjes
 - B) 4 vjet pas lindjes
 - C) Në jetën intrauterine
 - D) 1 vit pas lindjes
12. Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk ka ndikim në akumulimin e pllakës bakteriale?
- A) Aparatët ortodontike
 - B) Keqpozicionim i dhëmbëve
 - C) Lloji i bakterieve
 - D) Konsistënca e ushqimeve
13. Cili nga përbërësit e mëposhtëm nuk largohet me higjenën orale shtëpiake?
- A) Materia alba
 - B) Gurëzat
 - C) Pllaka dentare e pa maturuar
 - D) Pelikula
14. Cili nga faktorët nuk ka ndikim në patologjinë periodontale?

- A) Sëmundjet sistemike
- B) Koha e eruptimit
- C) Mosha
- D) Stresi

15. Për pastrimin e hapësirës ndërdhëmbore tek një individ që ka aparatortodontik fiks përdorim:

- A) Furçën dhëmbore
- B) Furçën interdental
- C) Fillin dentar
- D) Kunjat Interdentare

16. Cili nga funksionët nuk i përket fillit dentar?

- A) Eleminon gurët
- B) Konstaton mbushjet e varura
- C) Pastron hapësirën ndërdhëmbore
- D) Redukton hemoragjin gingivare

17. Principi aktiv kryesor në pastat antikaries janë:

- A) Jonet Zn
- B) Jonet Ca
- C) Jonet F
- D) Jonet Na

18. Përberësit abraziv të pastave të dhëmbëve kanë veprim:

- A) Zbardhues
- B) Kimik
- C) Antibakterial
- D) Mekanik

19. Cilat nga të dhënat nuk nevojitet për përcaktimin e diagnozës?

- A) Historia mjeksore
- B) Të dhënat objektive dhe testet e diagnostikimit
- C) Plani i trajtimit
- D) Të dhënat subjektive

20. Egzaminimi radiologjik është i indikuar vetëm në rast urgjence në individë me:

- A) Infarkt miokardi
- B) Sëmundje tumorale
- C) Shtatëzani
- D) Hemangiomë

21. Nëpërmjet egzaminimit visual të jashtëm nuk dallojmë dhe egzaminojmë:

- A) Asimetrinë faciale
- B) Fistulat intraorale
- C) Ngjyrën e lëkurës
- D) ATM (artikulacionin temporo mandibular)

22. Testi i perkusionit kryhet duke e aplikuar goditje:

- A) Goditje vertikale dhe horizontale në dhëmbin e dyshuar dhe
- B) Vertikale vetëm në dhëmbin e dyshuar

- C) Goditje vertikale dhe horizontale në dhëmbin e dyshuar
- D) Goditje horizontale vetëm në dhëmbin e dyshuar

23. Një dhimbje me origjinë nga periapeksi ka si karakteristikë:

- A) Dhëmbi shkaktar përcaktohet me vështirësi
- B) Dhimbja është e përqëndruar vetëm natën
- C) Dhimbja është vetëm spontane
- D) Dhimbja intërsifikohet nga përtpypja

24. Shkalla e lëvizshmërisë së dhëmbit përcakton:

- A) Shtrirjen e inflamacionit të indi pulpar
- B) Vitalitetin e indit pulpar
- C) Shtrirjen e inflamacionit të indi periodontal
- D) Shtrirjen e inflamacionit të indi gingivar

25. Testi termik përcakton:

- A) Nëse pulpa është e inflamuar
- B) Vitalitetin e pulpës
- C) Shkallën e inflamacionit pulpar
- D) Pragun e ndjeshmërisë

